RAPORT AUDITIMI
Mbi
Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

BASHKIA POGRADEC

Tiranë, tetor 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**5**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	5
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	7
II.	**HYRJA**	**10**
1.	Objektivat dhe qëllimi	10
2.	Identifikimi i çështjes.....	11
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	11
5.	Kriteret e vlerësimit.....	12
5.	Standardet e auditimit.....	13
7.	Metodat e auditimit.....	13
8.	Dokumentimi i auditimit.....	14
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	16-178
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, përformancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	16-42
2.1.1	Auditimin mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	16
2.2	Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	42-144
2.3	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	145-159
2.4	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).....	160-174
2.5	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.....	174-178
2.6	Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....	178-181
IV	**REKOMANDIME**	181-204

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
MF	Ministria e Financave
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Pogradec:

Bashkia Pogradec, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe Ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Pogradec për periudhën e aktivitetit viti 2023, 2024 dhe 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Pogradec si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*" nenit 50 "*Auditi i jashtëm*" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose audituesë të tjerë ligjorë".* Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Pogradec si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2023 deri më datën 31.12.2025.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

-Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi;

- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe

zbatimin e kontratave të punimeve;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV);
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM;
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe tekNt e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:
Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 43 gjetje dhe ka dhënë 48 rekomandime, nga ku masa organizative 29 gjetje me 32 rekomandime, masa për shpërblim dëmi 9 gjetje me 9 rekomandime, masa për përdorimin e fondeve sipas 3-E, 5 gjetje dhe 7 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi, konstatohet se llogaria 202 "Studime dhe projektime" në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 55,620,029 lekë, e analizuar për 45 objekte inventari. Nga verifikimi i inventarit kontabël u konstatua se ka vlera të paanalizuara sipas projekteve, projekte të cilat i përkasin periudhave të hershme për të cilat nuk ka informacion nëse ato janë vënë në zbatim për tu sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e AAM, të numrit të tyre për efekt të inventarizimit fizik dhe llogaritjes së amortizimit, veprim në mospërputhje me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (a) "Njohja fillestare e AAGJM".
- Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me vlerë kontabël (kosto-amortizim/provigjone) është larg vlerës reale të tyre. Vlera fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarëve kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" janë për vlerën nga 2,400 – 99,700 lekë dhe për llogarinë 215 "Mjete transporti" janë 5 mjete me vlerë 1 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, pika 105 "Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar" dhe Aneksin 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pika 2 "Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël), pasi nga ana e Bashkisë Pogradec, nuk është ndërmarrë asnjë

procedurë rivlerësimi ndaj tyre.

- Në 9 (nëntë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2 "për prokurimet" pjesë e projektraportit, është konstatuar se, disa prej kritereve për kualifikim rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës. Mungesa e një argumentimi teknik, i cili do të justifikonte dhe ligjëronte vendosjen e secilit kriter të kërkuar, vjen si rezultat i moszbatimit të plotë të kuadrit ligjor, në fazën e hartimit dhe argumentimit të kritereve nga personat përgjegjës.
- Në 2 (dy) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht, në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2025, me objekt "Blerje mjeti, makinë borëpastruese" dhe "Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale", është konstatuar se, dosjet fizike të prokurimit, të cilat, ndër të tjera, përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk janë pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Mosveprim, për shkak të neglizhencës së personit përgjegjës.
- Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit rezultoi se në 11 nga 14 rastet e verifikuara dokumentacioni teknik dhe administrativ nuk ishte i plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. U konstatuan mungesa të policave të sigurimit profesional, deklaratave të përgjegjësisë, kontratave të sigurimit, mangësi në nënshkrimin elektronik të dokumenteve, si dhe mangësi në projektet arkitektonike, konstruktive, elektrike dhe hidrosanitare. Në tre raste, shqyrtimi i aplikimeve është kryer me tejkalim të afateve ligjore. Gjithashtu, në një rast zhvilluesi nuk ka filluar punimet brenda afatit të përcaktuar me ligj, duke sjellë humbjen e vlefshmërisë së lejes së ndërtimit. U evidentuan edhe raste të dokumentacionit të paplotë për certifikatat e përdorimit, përfshirë projekte "as-built" jo në përputhje me gjendjen faktike të objektit dhe mungesë të dokumenteve të detyrueshme teknike e ligjore në sistemin elektronik të lejeve.
- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit rezultoi se në 5 nga 10 rastet e audituara nuk është respektuar numri minimal i vend-parkimeve / KSHT. Në të pesë rastet, projektet kanë parashikuar vend-parkime si në katet nëntokësore ashtu edhe në kuotën e sistemimit, pa përcaktuar nëse këto parkime do të ishin për shitje apo për përdorim publik.
- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit rezultoi se në 6 nga 14 rastet e verifikuara metodologjia e përdorur për përllogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- Në 9 raste, nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike në Bashkinë Pogradec u konstatuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërin e punimeve në vlerën 2,202,585 lekë pa TVSH.
- Janë konstatuar debitorë progresiv me datë 31.12.2025 në vlerën 292,156,538 lekë nga kjo debitorë të evidentuar për vitin 2025 janë për vlerën 116,461,725 lekë, të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Pogradec.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në lidhje me pasqyrimin si pjesë të AAMGJ të të gjithë elementëve të tyre përfshirë dhe vlerën e studim projektimeve.

- Kryetari i Bashkisë Pogradec duhet të marrë masa, për ngritjen e grupeve të punës për rivlerësimin e aktiveve të klasifikuara në llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe konstruksione*" dhe llogarinë 215 "*Mjete transporti*", si dhe sistemimin e veprimeve kontabël pas rivlerësimit të tyre.
- Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave, specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kritere të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.
- Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec (*personi përgjegjës për prokurimin*), me qëllim mundësimin e audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit, në lidhje me procedurat e sipërcituara, si dhe ato që do të zhvillohen në vijim, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.
- Titullari i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **2,202,585 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësit e punimeve për 9 kontrata për punë publike.

2. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pogradec për periudhën ushtrimore 2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, arrijmë në përfundimin se pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Pogradec nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për opinion e *kualifikuar*[1]:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Pogradec, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (SNA-700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e

[1] Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë*;

performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 49,455 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë parregullsitë si më poshtë:

-Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, llogaria 211 "Pyje, kullota plantacione" paraqitet në vlerën prej 765,318,602 lekë, referuar inventarit kontabël u konstatua se nga Njësia shpenzuese Agjencia e Mbrojtjes së Territorit në këtë llogari ka kontabilizuar vlerën 37,723,682 lekë si shtesë aktivi kur në fakt janë shpenzime për inventarë qarkullues (Dru zjarri) duke mbivlerësuar këtë llogari për këtë vlerë.

-Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" paraqitet në vlerën prej 138,216,794 lekë, referuar inventarit kontabël u konstatua se Njësia shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike ka kontabilizuar në këtë llogari vlerën 41,663,840 lekë që i përket llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" nga transferimet që janë bërë nga bashkia për gjatë vitit 2025 duke mbivlerësuar llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe nënvlerësuar llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore",

- Nga verifikimi i inventarit kontabël të llogarisë 202 "Studime dhe projektime" ka rezultuar se për vlerën 55,620,029 lekë, nuk ka informacion nëse janë vënë në zbatim ose jo pavarësisht faktit që disa nga këto studime e kërkime i përkasin investimeve për objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim.

-Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me vlerë kontabël (kosto-amortizim/provigjone) është larg vlerës reale të tyre. Vlera fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarëve kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" janë për vlerën nga 2,400 – 99,700 lekë dhe për llogarinë 215 "Mjete transporti" janë 5 mjete me vlerë 1 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet.

-Nga auditimi ka rezultuar se për aktivet afatgjata materiale Llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" dhe llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" për linjat teknologjike të prodhimit, makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, amortizimi nuk është llogaritur veçmas me vlerën e mbetur për çdo artikull me normë 5% por në grup për gjithë vlerën e mbetur.

II. Opinioni për përputhshmërinë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Pogradec për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Pogradec.

"Ne opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Pogradec janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur ***janë materiale por jo të përhapura*** *dhe justifikojnë dhënien e një* ***opinioni të kualifikuar****, e shprehur kjo në bazën për opinion.*

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Pogradec, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 217, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga Bashkia Pogradec dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e ***opinionit të kualifikuar[2].***
Raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara janë si më poshtë:

-Janë konstatuar debitorë progresiv me datë 31.12.2025 në vlerën 292,156,538 lekë nga kjo debitorë të evidentuar për vitin 2025 janë për vlerën 116,461,725 lekë, të ardhura të munguar për buxhetin e Bashkisë Pogradec.

-Në 9 (nëntë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2 "për prokurimet" pjesë e raportit të auditimit, është konstatuar se, disa prej kritereve për kualifikim rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jo reale. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës.

-Në 2 (dy) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", u konstatua se, dosjet fizike të prokurimit, të cilat, ndër të tjera, përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk janë pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.

-Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit rezultoi se në 11 nga 14 rastet e verifikuara dokumentacioni teknik dhe administrativ nuk ishte i plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. U konstatuan mungesa të policave të sigurimit profesional, deklaratave të përgjegjësisë, kontratave të sigurimit, mangësi në nënshkrimin elektronik të dokumenteve, si dhe mangësi në projektet arkitektonike, konstruktive, elektrike dhe hidrosanitare. Në tre raste, shqyrtimi i aplikimeve është kryer me tejkalim të afateve ligjore. Gjithashtu, në një rast zhvilluesi nuk ka filluar punimet brenda afatit të përcaktuar me ligj, duke sjellë humbjen e vlefshmërisë së lejes së ndërtimit. U evidentuan edhe raste të dokumentacionit të paplotë për certifikatat e përdorimit, përfshirë projekte "as-built" jo në përputhje me gjendjen faktike të objektit dhe mungesë të dokumenteve të detyrueshme teknike e ligjore në sistemin elektronik të lejeve.

-Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit rezultoi se në 5 nga 10 rastet e audituara nuk është respektuar numri minimal i vend-parkimeve / KSHT. Në të pesë rastet, projektet kanë parashikuar vend-parkime si në katet nëntokësore ashtu edhe në kuotën e sistemimit, pa përcaktuar nëse këto parkime do të ishin për shitje apo për përdorim publik.

-Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit rezultoi se në 6 nga 14 rastet e verifikuara metodologjia e përdorur për përllogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

[2] **Opinion i modifikuar/ kualifikuar:** Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale por jo të përhapura**".

-Në 9 raste, nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike në Bashkinë Pogradec u konstatuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërin e punimeve në vlerën 2,202,585 lekë pa TVSH.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 870/1, datë 08.09.2025 "*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Pogradec*", i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin "*Bashkia Pogradec*", nga data 15.09.2025 deri në datën 29.05.2026, u krye "*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*", për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2025 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. Z. S.M., *përgjegjës grupi*
2. Z. K. T., *auditues*
3. Z. P. G., *auditues*
4. Z. P. Xh., *auditues*
5. Z. F. Ç., *auditues*

1. OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat dhe Qëllimi i auditimit

- Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
- Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.
- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
- Për auditimin e përputhshmërisë, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

2. Identifikimi i çështjes.

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*", duke ofruar raporte të besueshme nëse fondet janë administruar siç duhet dhe nëse të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Raporti i Auditimiti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pogradec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm

të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Pogradec.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", etj.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.
Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Pogradec, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit

mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

5. Kriteret e vlerësimit.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";

▪ ***Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:***

- Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "*Për buxhetin e vitit 2023*", Ligji nr. 97, datë 07.12.2023 *"Për buxhetin e vitit 2024"* dhe aktet normative që kanë ndryshuar këto ligje.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*"
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*" ndryshuar me Ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 "*Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për huamarrjen e qeverisjes vendore*";
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" i ndryshuar, për kontabilitetin;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", etj;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore*",
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, "*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*"), Fletore zyrtare 196/2014;

▪ ***Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:***

- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*";
- Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 "*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*".

▪ ***Në fushën e prokurimeve publike:***

- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12,06.2014, "*Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*".

▪ ***Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:***

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "*Për sistemin e taksave lokale*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*" i ndryshuar;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;

- ***<u>Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:</u>***

- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, "*Për kundërvajtjet administrative*";
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*";
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "*Për lejet e mjedisit*";
- Ligji nr. 107/2014, "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*";
- Ligji nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*";
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

- ***<u>Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:</u>***

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar
- Ligji nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar;
- *Rregullore e brendshme "Mbi procedurat e auditimit në KLSH";*
- *Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së";*
- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të auditimit financiar*";
- ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";
- ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*";
- INTOSAI "*Për implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI mbi auditimin e përputhshmërisë*"; etj.
- Standardet kombëtare të kontabilitetit;
- Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i auditimit të brendshëm, etj.
- Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7. Metodat e auditimit.

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që

auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik dhe,
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën tek N....t e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt nuk u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- *Kontrolli i vlerësimeve*

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmimi nga të tretët*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK*

8. Dokumentimi i auditimit.

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit financiar

dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua Projekt Raporti i Auditimit i cili u dërgua Subjektit me shkresë nr. 870/7, datë 06.07.2026, mbi të cilin, nga subjekti i audituar nëpërmjet shkresës nr. 642/24 prot., datë 07.08.2026, administruar në KLSH me nr. 870/8 prot., datë 10.08.2026 u paraqitën observacione dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Bashkia Pogradec shtrihet në juglindje të Shqipërisë, përgjatë bregut perëndimor të liqenit të Ohrit. Me një sipërfaqe prej 548.77 km² dhe popullsi rreth 46,000 banorë, ajo përbëhet nga 8 njësi administrative: Pogradec, Udënisht, Buçimas, Çërravë, Dardhas, Hudenisht, Proptisht dhe Trebinjë.

Misioni i Bashkisë Pogradec është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Pogradec, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Pogradec për periudhën e aktivitetit 2023, 2024 dhe 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor,

pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Bashkia Pogradec shtrihet në juglindje të Shqipërisë, përgjatë bregut perëndimor të liqenit të Ohrit dhe, përbëhet nga 8 njësi administrative: Pogradec, Udënisht, Buçimas, Çërravë, Dardhas, Hudenisht, Proptisht dhe Trebinjë. Bashkia Pogradec, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" *dhe* ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Pogradec, etj. Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Pogradec.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Si pjesa më e rëndësishme e raportimit të auditimit, në të përfshihen përshkrimet narrative dhe gjetjet e auditimit të vlerësuara për sa i përket materialitetit, ligjshmërisë dhe evidencës faktike të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim.

2.1. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performances financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

-Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
-Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
-Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bakës dhe arkës.

2.1.1 Auditimin mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

<u>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</u>

Programimi i PBA për vitet 2025-2027.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen **PBA 2025-2027**, rezultoi se miratimi i treguesve ekonomik financiarë dhe tavanet përgatitore janë miratuar me VKB nr. 32, datë 28.03.2024 "Për miratimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së Pogradec dhe tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2025-2027". Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 641, datë 31.12.2024 është miratuar "Ngritja e grupit për menaxhim strategjik" dhe ekipeve të menaxhimit të programeve, për vazhdimin e procesit të përgatitjes së PBA 2025-2027, i cili është i detajuar sipas 11 programeve buxhetore, njësive shpenzuese dhe klasifikimit ekonomik, për vitin 2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj totalit
1	Planifikimi Menaxhimi Administrimi	619,978	34%
2	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	48,556	3%
3	Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit	14,449	0.8%
4	Menaxhimi I pyjeve dhe kullotave	36,822	2%
5	Rrjeti rrugor rural	275,454	15%
6	Menaxhimi I mbetjeve	35,000	2%
7	Strehimi lokal dhe urbanistika	5,933	0.3%

8	Shërbimet publike vendore	368,623	20%
9	Arsimi baze përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	377,272	21%
10	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	13,370	0.7%
11	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	14,936	0.8%
	TOTAL	**1,810,393**	

Burimi: Drejtoria e Buxhetit.

Programimi i shpenzimeve sipas llogarive për periudhën viti 2025-2027, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	%	000/lekë	000/lekë	000/lekë	%
1	Paga (600+601)	919,157	51%	929,845	51%	941,716	51%
2	Shp. Operative (602+603+604+605+606+609)	676,112	38%	676,694	38%	686,294	38%
3	Investime (230,231)	190,941	11%	193,436	11%	196,391	11%
	Totali	**1,786,210**	**100**	**1,799,975**	**100**	**1,824,401**	**100**

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se tendenca e shpenzimeve sipas PBA vjen në rritje kështu për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime në vlerën 1,786,210 mijë lekë, për vitin 2026 në vlerën 1,799,975 mijë lekë ose me rritje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 13,765 mijë lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 1,824,401 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2026 me rritje në vlerën 24,426 mijë lekë.

Sipas PBA tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2025-2027.

Nr.	Të ardhurat	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
1	Të ardhura tatimore	338,085	340,810	344,538
2	Të ardhura jo tatimore	443,775	443,776	443,775
I	**Total të ardhura**	**781,860**	**784,586**	**788,313**
3	Transferta e pakusht. e përgjithshme	579,950	600,542	620,784
4	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	324,399	314,847	315,304
II	**Total transferta**	**904,349**	**915,389**	**936,088**
III	**Të ardhura të mbartura**	**100,001**	**100,000**	**100,000**
	Totali	**1,786,210**	**1,799,975**	**1,824,401**

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se të ardhurat sipas PBA nga njëri vit në tjetrin rezultojnë me rritje për vitin 2025 janë planifikuar të ardhura në vlerën 1,786,210 mijë lekë, për vitin 2026 në vlerën 1,799,975 mijë lekë ose me rritje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 13,765 mijë lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 1,824,401 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2026 me rritje në vlerën 24,426 mijë lekë.

Mbi dokumentacionin mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Buxheti fillestar i vitit 2025, është miratuar me **VKB nr. 141, datë 27.12.2024,** bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetë Qeverisjes Vendore, ligjit nr. 115/2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, me shkresën nr.39 prot., datë 10.01.2025, si më poshtë:

Nr	Vendimi K.B		Struktura e të ardhurave	Të ardhura Plan (në 000/lekë)	Struktura e shpenzimeve	Shpenzimet (në 000/lekë)
	Nr.	Datë				
	141	27.12.2024				
1			Të ardhura tatimore	348,126	Paga (600)	650,554
2			Të ardhura jo tatimore	349,374	Sig. Shoq. (601)	124,504
3			Transferta e pakusht. përgjithshme	579,950	Shp. Operative (602)	510,873

4			Transferta e pakushtëzuar sektoriale	324,399	Shpenzime (603,604,606,609)	70,300
5			Të ardhura të mbartura		Investime (230,231)	245,618
			Total	**1,601,849**	**Total**	**1,601,849**

Burimi i financimit të buxheti fillestar për vitin 2025, janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta të vitit në shumën 697,500 mijë lekë ose 43 % e totalit, nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme në shumën 579,950 mijë lekë ose 36 % e totalit dhe nga transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 324,399 mijë lekë ose 21% .
Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2025 shpenzimet për paga e sigurime zënë 48 % ose në vlerën 775,058 mijë lekë, shpenzime operative zënë 32 % ose për vlerën 510,873 mijë lekë, shpenzime për (603,604,606,609) zënë 4% ose në vlerën 70,300 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 15% ose në vlerën 245,618 mijë lekë.

Për vitin 2025, buxheti ka pësuar ndryshime në rritje për vlerën **208,545 mijë lekë**, kjo e analizuar si më poshtë:

Art	**2025**				
	Plan Fillestar	**Ndryshimet +/-**	**Plani fund viti**	**Realizimi**	**Realizimi %**
600	650,554	34,224	684,778	640,355	94%
601	124,504	-1,734	122,770	105,629	86%
602	510,873	105,218	616,091	411,094	67%
604-609	70,300	44,252	114,552	111,156	97%
230-231	245,618	26,584	272,202	182,712	67%
TOTAL	***1,601,849***	***208,545***	**1,810,393**	**1,450,946**	**80%**

Ndryshimet e buxhetit në rritje për vlerën 208,545 mijë lekë, janë kryer me VKB nr.18 datë 27.02.2025 Fondet e trashëguara të vitit 2024 në shumën 126,810 mijë lekë (01= 86.735 mijë lekë , 05=37.483 mijë lekë), VKB nr. 158 datë 26.12.2025 në shumën 84,326 mijë lekë kapitulli 01 në zbatim të nenit 44, germa a, b, c, ç, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Mbi dokumentacionin mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me shkresën nr. 995 Prot, datë 27.02.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025" është dërguar në Ministrinë e Financave tabela mbi treguesit fiskal të konsoliduar të Bashkisë dhe realizimi faktik i buxhetit sipas planit të rishikuar si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti vjetor (Plan rishikuar) viti 2025	Periudha e raportimit (Fakt progresiv) 31.12.2025
I	Të ardhurat gjithsej	697,500,270	528,486,081
1	Taksa e veta vendore	301,425,887	144,186,907
2	Të ardhura jo tatimore	346,629,783	321,151,332
3	Taksa të ndara	49,444,600	63,129,842
II	Shpenzimet të buxhetit vendor	1,819,156,076	1,431,674,266
1	Shpenzime korrente	1,546,954,764	1,254,679,726
a	Paga dhe fond i veçantë	686,546,141	640,354,496
b	Kontribut për sigurime shoqërore	122,770,213	105,628,072
c	Shpenzime operative	623,086,002	397,540,934
d	Të tjera korente	114,552,408	111,156,223
2	Shpenzime kapitale investime	272,201,312	176,994,541
3	Burimet e financimit	1,810,393,000	1,450,946,000
a	Të ardhura të veta vendore	734,983,332	495,102,194
b	Transferta e pakushtëzuar	720,723,964	669,051,167
c	Transferta specifike	363,448,780	267,520,904

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit në total për Bashkinë për periudhën **viti 2025,** referuar akt rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Ne mijë lekë

Nr.	E M E R T I M I Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	650,554	684,778	640,355	94%
2	Llog 601 -	124,504	122,770	105,629	86%
3	Llog 602-	510,873	616,091	411,094	67%
4	Llogaria 604	70,000	106,850	105,585	99%
5	Llogaria 606	300	7,702	5,571	72%
6	Llog 231	245,618	272,202	182,712	67%
	Shuma	**1,601,849**	**1,810,393**	**1,450,946**	**80%**

Realizimi i buxhetit në tërësi sipas akt rakordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 1,810,393 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 1,450,946 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 359,447 mijë lekë ose 21% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Me mosrealizim më të madh janë shpenzimet operative në vlerën 204,997 mijë lekë *(planifikuar 616,091 mijë lekë janë realizuar 411,094 mijë lekë ose 67%) dhe shpenzimet* për investime në vlerën 89,490 mijë lekë *(planifikuar 272,202 mijë lekë janë realizuar 182,712 mijë lekë ose 67%)* kjo më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi i cili është realizuar në masën 80%.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga granti i pakushtëzuar** paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr.	E M E R T I M I Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	131,267	151,051	153,242	98%
2	Llog 601 -	21,949	19,547	19,867	86%
3	Llog 602-	241,630	314,479	288,723	92%
4	Llogaria 604	7,838	27,588	26,470	96%
5	Llogaria 606	300	4,685	4,352	69%
6	Llog 231	176,966	194,202	168,018	87%
	Shuma	**579,950**	**711,552**	**655,627**	**92%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga gand i pakushtëzuar sipas akt rakordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 711,552 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 655,627 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 55,925 mijë lekë ose 11% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Me mosrealizim paraqiten shpenzimet operative në vlerën 25,756 mijë lekë *(planifikuar 314,479 mijë lekë janë realizuar 288,723 mijë lekë ose 86%) dhe shpenzimet* për investime në vlerën 26,184 mijë lekë *(planifikuar 194,202 mijë lekë janë realizuar 168,018 mijë lekë ose 84%)* kjo më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi nga grandi i pakushtëzuar i cili është realizuar në masën 92 %.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga të ardhurat e veta** paraqitet si më poshtë:

Nr	E M E R T I M I	Viti 2025

.	Sipas Artikujve Te shpenzimeve				
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	305,192	320,231	292,518	91%
2	Llog 601 -	59,933	59,933	53,582	89%
3	Llog 602-	214,963	218,397	66,439	30%
4	Llogaria 604	62,162	79,262	79,115	100%
5	Llogaria 606		1,430	1,220	85%
6	Llog 231	55,250	55,730	2,228	4%
	Shuma	**697,500**	**734,983**	**495,102**	**67%**

Realizimi i buxhetit nga **të ardhurat e veta,** sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, nga 734,983 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 495,102 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 239,881 mijë lekë ose në masën 67%.

Me mosrealizim paraqiten shpenzimet operative në vlerën 151,958 mijë lekë *(planifikuar 218,397 mijë lekë janë realizuar 66,439 mijë lekë ose 30%) dhe shpenzimet* për investime në vlerën 53,502 mijë lekë *(planifikuar 55,730 mijë lekë janë realizuar 2,228 mijë lekë ose 4%)* kjo më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi nga të ardhurat i cili është realizuar në masën 67 %.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga transferta specifike** paraqitet si më poshtë:

Nr.	E M E R T I M I Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit perfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	214,094	213,497	197,585	92%
2	Llog 601 -	42,623	43,290	32,647	75%
3	Llog 602-	54,280	83,214	55,932	67%
4	Llogaria 606		1,587	1,587	100%
	Llog 231	13,402	22,270	12,466	56%
	Shuma	**324,399**	**363,858**	**300,217**	**82%**

Realizimi i buxhetit nga **Transferta specifike ,** sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, nga 363,858 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 300,217 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 63,641 mijë lekë ose në masën 82 %.

Me mosrealizim paraqiten shpenzimet operative në vlerën 27,282 mijë lekë *(planifikuar 83,214 mijë lekë janë realizuar 55,932 mijë lekë ose 68%) dhe shpenzimet* për investime në vlerën 9,804 mijë lekë *(planifikuar 22,270 mijë lekë janë realizuar 12,466 mijë lekë ose 56%)* kjo më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi nga transferta specifike i cili është realizuar në masën 83 %.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2025, janë dërguar MFE me shkresat nr. 2133 Prot, datë 30.05.2025 "Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë", nr. 914 Prot , datë 30.09.2025 "Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin" dhe shkresa nr. 995 Prot, datë 27.02.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025", brenda afateve ligjore.

Konkluzion: *Nga auditimi ka rezultuar se realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me degën e thesarit për periudhën objekt auditimi nga 1,810,393 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 1,450,946 mijë lekë ose në masën 80 %, me mosrealizim në vlerën 359,447 mijë lekë, konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative në vlerën 204,997 mijë lekë (planifikuar 616,091 mijë lekë janë realizuar 411,094 mijë lekë ose 67%) dhe shpenzimet për investime në vlerën 89,490 mijë lekë (planifikuar 272,202 mijë lekë janë realizuar 182,712 mijë lekë ose 67%) kjo si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore,*

mosrealizimi i procedurave të prokurimit të planifikuara dhe shpenzimeve operative të planifikuara, me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se realizimi i tyre është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar neni 5, germa "a" ku përcaktohet.....në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për vitin 2025 Bashkisë Pogradec i janë transferuar fonde nga ministritë e linjës në formë granti i kushtëzuar në vlerën gjithsej 1,049,494 mijë lekë, nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për bursat e nxënësve të shkollës profesionale "Enver Qeraxhi" tek llogaria 602 shpenzime operative në shumën 14,954,760 lekë dhe për objektin "Përforcim banesash kolektive " në llogarinë 231 investime në shumën 3,326,870 lekë, Ministria e Mbrojtjes për investime në llogarinë 231 investime në shumën 6,625,522 lekë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës për investime llogaria 231 në shumën 80,134,715 lekë, Ministria e Arsimit për investime llogaria 231 në shumën 60,451,463 lekë dhe në llogarinë 602 në shumën 2,635,200 lekë, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale për Ndihmat ekonomike në llogarinë 602-606 në shumën 840,665,296 lekë, Ministria e Brendshme për Gjendje Civile në llogarinë 600 në shumën 15,507,875 leke lekë dhe llogaria 602 në shumën 293,500 lekë, AKMC në llogarinë 602 në shumën 13,318,317 lekë dhe në llogarinë 231 në shumën 7,608,381 lekë dhe Çelje për materialet zgjedhore në shumën 3,973,639 lekë në llogarinë 602.

Realizimi i buxhetit nga **Transferta e kushtëzuar ,** sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, nga 1,049,494 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 1,033,817 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 15,677 mijë lekë ose në masën 99 % të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Art			
	Grant i kushtëzuar	**Realizimi i grantit te kushtëzuar**	**Realizimi %**
600	13,254	13,092	99%
601	2,253	2,009	89%
602	35,175	31,030	88%
604-609	840,665	835,316	99%
230-231	158,147	152,370	96%
TOTAL	**1,049,494**	**1,033,817**	**99%**

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me shkresën nr. 995 Prot, datë 27.02.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025" është dërguar në Ministrinë e Financave tabela për detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara, vendime gjygjësore etj., rezulton se totali i detyrimeve të pa likuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 203,975,819 lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 1,431,674,266 lekë zënë 14.25%.

Detyrime për fatura të palikujduara për shërbime në vlerën 68,984,130 lekë të analizuara paraqiten në pasqyrën **Aneks nr. 1,** bashkëlidhur, fatura të palikujduara për mallra dhe mirëmbajtje në vlerën 11,886,554 lekë të analizuara paraqiten në pasqyrën **Aneks nr. 2,** bashkëlidhur dhe fatura të palikujduara për investime në vlerën 53,089,228 lekë të analizuara paraqiten në pasqyrën **Aneks nr. 3,** bashkëlidhur.

Nga auditimi ka rezultuar se detyrimet për vendime gjygjësore në fillim të vitit janë për

vlerën 62,770,605 lekë të cilat gjatë vitit janë shtuar për vlerën 5,660,642 lekë dhe janë likuiduar për vlerën 26,882,892 lekë dhe në fund të periudhës janë për vlerën 41,548,355 lekë, të analizuara si më poshtë:

Nr.	Emri person/subjektit	Vendim Gjykate		Detyrim 01.01.2025	Shtesa Viti 2025	Likuidim Viti 2025	Gjenda Me 31.12.2025
		Nr.	Date				
1	"Xh. K."	467	16.05.2008	31,842	0	0	31,842
2	"Q. H."	377	23.12.2009	114,143	0	114,143	0
3	"J. T."	1112	02.12.2008	886,674	0	886,674	0
4	"L. B."	2026	30.09.2015	17,874,314	0	0	17,874,314
5	"Agj."	771	31.12.201	1,061,000	0	0	1,061,000
6	"V." shpk	407	28.07.2015	517,051	0	0	517,051
7	"H. d."	1672	22.07.2013	9,990,434	0	9,990,434	0
8	"K."	6649	23.09.2015	534,858	0	0	534,858
9	"V. T."	5544	2017	0	757,308	757,308	0
10	"A. Xh."	1495	11.04.2018	260,044	0	260,044	0
11	"I."("A.V.")	63	24.01.2018	2,128,000	0		2,128,000
12	"R. S."	332	07.03.2024	3,903,782	0	3,903,782	0
13	"A."	852	09.11.2023	24,773,549	0	7,536,903	17,236,646
14	"N. V."	334	18.11.2009	694,914	0	694,914	0
15	"M.L."	307		0	344,520	344,520	0
16	"B. K."	1794	2024-	0	355,800	355,800	0
17	"R. D."			0	667,221	667,221	0
18	"T."			0	3,000,000	1,391,953	1,608,047
19	Detyrime te tjera			0	535,793		556,597
				62,770,605	5,660,642	26,882,892	41,548,355

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykate të raportuara ne MFE në fund të vitit me shkresën nr. 995 Prot., datë 27.02.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025", janë për vlerën 203,975,819 lekë *(shpenzime mirëmbajtje, shërbime e mallra në vlerën 80,870,684 lekë, shpenzime kapitale në vlerën 53,089,228 lekë, shpenzime gjygjësore në vlerën 41,548,355 lekë dhe shpenzime tatime të tjera sigurime shoqërore e shëndetësore, të ardhura personale dhe transferta te individë në vlerën 28,467,552 lekë)* në raport me shpenzimet e kryera zënë 14,25% të tyre. Nga verifikimi i faturave të palikuiduara u konstatua se nuk është ndjekur radha e pagesës. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 40,42. Udhëzimin i MFE nr. 9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", pikat 82-91

Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore mbahet ky akt konstatimi me znj. I. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiarë, për periudhën e auditimit.

Mbi planifikimin dhe realizmin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025

Për vitin 2025 ka funksionuar Drejtoria e Taksave dhe Tarifave me 17 punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor, 1(një) Përgjegjës Sektori dhe 15 Specialist e punonjës.
Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është bërë duke mbajtur në konsideratë numrin e bizneseve dhe familjeve, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas

paketës fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.
Nga të dhënat e paraqitura rezulton se planifikimi i të ardhurave është parashikuar për 17,645 familje dhe 1976 biznese të vogla dhe të mëdha të cilat janë klasifikuar sipas xhiros sipas Nj/Administrative të dhënat në pasqyrat Aneks nr. 4, bashkëlidhur

Për periudhën objekt auditimi planifikimi i taksave dhe tarifave vendore është kryer në zbatim të VKB nr. 133, datë 11.12.2023 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Pogradec"
Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore të mbledhura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 5, bashkëlidhur.

Nga të dhënat rezulton se për vitin 2025, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej, nga 403,873,886 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 332,954,380 lekë ose 82 %, **me një mosrealizim në vlerën 70,919,506 lekë** *(të ardhura tatimore nga 108,645,887 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 101,763,741 lekë ose 94%, të ardhura jo tatimore nga 294,227,999 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 229,676,572 lekë ose 78 % dhe të ardhura të tjera nga 1,000,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 1,514,067 lekë ose 151 %),* **të ardhura të munguara dhe të kontabilizuara për vitin 2025.**
Për vitin 2025 janë parashikuar të ardhura nga taksat e ndara dhe realizimi i tyre paraqitet në tabelën si më poshtë:

Nr.	**Emërtimi**	**Viti 2025**	
		Plan	***Fakt***
1	Tatim mbi Biznesin e vogël	400,000	451,868
2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve te përdorura	24,000,000	33,491,320
3	Taksa e rentës minerare	200,000	184,971
4	Taksa mbi te ardhurat personale	22,744,600	24,283,565
5	Taksa mbi të drejtën e kalimit të pronësisë	2,500,000	5,169,986
	Totali	**49,844,600**	**63,518,710**
	Realizimi	**127%**	

Nga të dhënat e tabelës rezulton se kemi një tejkalim në vlerën 13,674,110 lekë, rezulton se për këto taksa nga bashkia nuk ka një databazë numrin e mjeteve të përdorura, bizneseve që janë subjekte të pagesës për rentën minerare, numrin e punonjësve dhe transaksionet që janë kryer për kalimin e të drejtës së pronësisë këto taksa planifikohen duke mbajtur në konsideratë realizimin e një vitit paraardhës. Të ardhura që planifikohen nga sektorë të tjerë të Bashkisë për vitin 2025 janë planifikuar dhe realizuar sipas të dhënave të pasqyrës Aneks nr. 6, bashkëlidhur.:
Nga të dhënat mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave me ndikim në mosrealizimin e planit të të ardhurave është "Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja" e cila është realizuar në masën 22%, nga 192,380,000 lekë *e* planifikuar është realizuar 41,971,298 lekë.

-Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2025 për subjektet e biznesit të vogël e të madh që kanë ushtruar aktivitet në territorin e bashkisë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se debitorët progresiv për mospagesën e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore nga biznesi i madh, biznesi i vogël dhe familjarët në fund të periudhës rezulton se janë **gjithsej për vlerën 207,477,511 lekë** *(për 504 subjekte në vlerën 84,961,348 lekë dhe 5135 familje për vlerën 122,516,163 lekë),* dinamika në lidhje me gjendjen në fillim e në fund të periudhës paraqiten në pasqyrat Aneks nr. 7, bashkëlidhur.

Nga të dhënat e pasqyrave më sipër rezulton se debitorët familjarë progresivë në fund të periudhës viti 2025 janë për vlerën 122,516,163 lekë të krahasuar me vitin 2024 të cilat janë për vlerën 80,590,449 lekë, rezultojnë me shtesë në vlerën 41,925,714 lekë dhe debitorët e biznesit në fund të periudhës viti 2025 janë për vlerën 84,961,348 lekë të krahasuara me vitin 2024 të cilat janë për vlerën 134,442,187 lekë, janë ulur për vlerën 49,480,839 lekë.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Brendshëm nr. 17, datë 20.06.2022 "Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore", ka ndërmarrë masa shtrënguese të mbledhjes me forcë të detyrimit të papaguar për tatimpaguesit debitorë për taksa dhe tarifa vendore duke dërguar shkresat për, rinjoftim për detyrime të papaguara dhe urdhër bllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, masën e sigurimit tatimor/barrë siguruese pranë Regjistrit të Barrëve Siguruese (RBS), për këto detyrime të palikujduara të vitit 2025, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresë nr. 392, datë 21.01.2026 ka dërguar listat e subjekteve të cilat nuk kanë arkëtuar detyrimet e vitit në vlerën 68,496,833 lekë Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiarë për kontabilizimin e tyre.

Konkluzion: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore edhe pse ka zbatuar përcaktimet Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konstatohet se në fund të periudhës janë debitorë progresiv janë 504 subjekte për vlerën 84,961,348 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën 26,571,119 lekë)* të krahasuara me vitin 2024 të cilët kanë qenë në vlerën 134,442,187 lekë rezultojnë me ulje në vlerën 49,480,839 lekë dhe debitorë progresiv familjarë janë 5135 familje për vlerën 122,516,163 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën 41,925,714 lekë)* të krahasuara me vitin 2024 të cilët kanë qenë në vlerën 80,590,449 lekë rezultojnë me një rritje në vlerën 41,925,714 lekë, pra debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar **janë për vlerën 207,477,511 lekë, nga e cila vlera prej 68,496,833 lekë janë debitorë të vitit 2025 që janë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë.**

Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet legalizimit.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për periudhën deri më 31.12.2025, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **458 persona me vlerë progresive 50,880,735 lekë *(detyrim i vitit 2025 në vlerën 34,617,521 lekë)*, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Pogradec, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:**

	Detyrim deri ne 2024	Detyrim I 2025	Pagesa gjithsej leke
Takse ndikimi nga legalizimet	24,611,080	48,031,432	72,642,512
Paguar	8,347,866	13,413,911	21,761,777
Numri I subjekteve	142	316	458
Totali	**16,263,214**	**34,617,521**	**50,880,735**

Sa më sipër rezulton se nga Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e

mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 3/c, për këto detyrime të palikujduara të vitit 2025, nga Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit me shkresë nr. 1099/1, datë 06.03.2026 ka dërguar listat e subjekteve të cilat nuk kanë arkëtuar detyrimet e vitit në vlerën 34,617,521 lekë Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiarë për kontabilizimin e tyre.

Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për kontratat për dhënie me qira për toka bujqësore, antena dhe HECE.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje arkëtimin e detyrimeve për dhënie me qira toka bujqësore, vendosje Antena dhe HECE, për periudhën deri më 31.12.2025, rezulton nuk kanë likuiduar **54 subjekte me vlerë progresive 33,798,292 lekë *(detyrim i vitit 2025 në vlerën 13,347,371 lekë)*, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Pogradec, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:**

Kontrata qiraje	Progresive deri në 31.12.2024	Debitorë për vitin 2025	Detyrime Total deri ne 31.12.2025
Kontrata qiraje te Nj. Administrative	23,518,423	13,347,371	37,145,663
Likuiduar	3,347,371		3,347,371
Total	20,171,052		33,798,292

Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore me shkresë nr. 2703/2, datë 05.08.2025 drejtuar Sektorit të Monitorimit dhe Zbatimit të Kontratave, Zbatimit të Kushteve të Lejes dhe Shpronësimeve i ka dërguar listën e subjekteve që nuk kanë likuiduar detyrimet për kontratat e lidhura, gjithashtu për këto detyrime të palikujduara të vitit 2025, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me shkresë nr. 392,/1, datë 21.01.2026 ka dërguar listat e subjekteve të cilat nuk kanë arkëtuar detyrimet e vitit në vlerën 13,347,371 lekë Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiarë për kontabilizimin e tyre.
Sa më sipër rezulton se nga Sektori i Monitorimit dhe Zbatimit të Kontratave, Zbatimit të Kushteve të Lejes dhe Shpronësimeve, për gjatë vitit 2025 nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin" i ndryshuar neni 12, germa g dhe kushteve të kontratës.
Për sa trajtuar më sipër mbahet akt konstatimi me znj. A. P. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për periudhën e auditimit.

Nënpika 2.1.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktive neto dhe fluksit të parasë bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, ka përpunuar informacionin kontabël të vitit 2025 për aparatin e Bashkisë Pogradec dhe 4 Ndërmarrjet në varësi (Njësi shpenzuese).
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara përfshijnë informacionin e depozituar nga njësitë

shpenzuese sipas shkresave si më poshtë:
- Bashkia Pogradec, janë përgatitur nga znj I. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec, z. I.Xh. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar me shkresën nr.1469, datë 31.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Pogradec në datën 31.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.
-Qendra Arsimore Pogradec, janë përgatitur nga Znj M. Ç. me detyrë përgjegjës i Financës dhe Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Drejtori, znj. A. A. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar me shkresën nr. 28, datë 24.02.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Pogradec në datën 24.02.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.
-Ndërmarrja e Parqeve dhe e Rekreacionit, janë përgatitur nga znj. R. K. me detyrë Përgjegjës i Financës dhe Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Drejtori, z. A.B. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar me shkresën nr. 49, datë 26.02.2026, dhe miratuar nga dega e thesarit Pogradec në datën 26.02.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.
-Ndërmarrja e Infrastrukturës dhe Punëve Publike, janë përgatitur nga znj. Z.S. me detyrë Përgjegjës i Financës dhe Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Drejtori, z .E.B. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar me shkresën nr. 184, datë 31.03.2026, dhe miratuar nga dega e thesarit Pogradec në datën 17.04.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.
Agjencia e Mbrojtjes te Territorit, janë përgatitur nga z. A. Sh. me detyrë Përgjegjës i Financës dhe Nëpunës Zbatues dhe janë konfirmuar nga Drejtori, z. M.H. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar me shkresën nr. 195, datë 26.03.2026 dhe miratuar nga dega e thesarit Pogradec në datën 26.03.2026, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.
Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimit financiar janë akt-rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me degën e Thesarit Pogradec, të konfirmuara dhe nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues, Specialisti i shpenzimeve, Specialisti i të Ardhurave i Degës së Thesarit Pogradec për çdo institucion.
Nxjerrja e pasqyrave financiare të konsoliduara, për vitin 2025.
Për vitin 2025, në përputhje me kërkesat e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara, të përbëra si vijon:
Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.
Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).
Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.
Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.
Pasqyrat financiare të konsoliduara janë të firmosura nga hartuesi i llogarive znj. I.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiarë,si nëpunës zbatues dhe Kryetari z. I.Xh. si nëpunës autorizues, dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1912 prot., datë 29.04.2026.
Mbajtja e kontabilitetit v. 2025.
Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.
Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2024, të pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar Bashkia Pogradec; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 3,998,142,689 lekë.

Aktivet 4,745,943,955 lekë
Pasivet 747,801,267lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën 808,641,123 lekë dhe përbëhen nga:
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 261,177,338 lekë,
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 82,021,657 lekë,
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 465,442,128 lekë
dhe

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
520	Disponibilitete në thesar	260,644,238	229,196,570	31,447,668
50	Vlera të tjera	533,100	533,100	0
	Totali	261,177,338	229,729,670	31,447,668

Gjendja e "Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre" analizon mjetet monetare (në arkë dhe bankë), si dhe ekuivalentët e tyre (si letra me vlerë, disponibilitete në thesar etj.). Në mbyllje të vitit ushtrimor 2025 paraqitet në vlerën 261,177,338 lekë, me shtesë nga viti paraardhës në vlerën 31,447,668 lekë.

Llogaria 520 "Disponibiltete në thesar" në vlerën 260,644,238 lekë përbëhet:
-Nga të ardhurat e trashëguara në vlerën 198,090,293 lekë, të rakorduara me Degën e Thesarit dhe për gjendjen e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në vlerën 62,553,945 lekë për vlerën e ngurtësimeve të punimeve të kryera në masën prej 5% të investimeve në proces (në rrugë, rrjete e kanalizime, ndërtesa shkollore, etj., kryesisht nga Bashkia Pogradec në vlerën 54,905,697 lekë e cila zë pjesën më të madhe të saj.

Llogaria 50 "Letra me vlerë" në vlerën prej 533,100 lekë e cila përfaqëson letra me vlere që i përkasin Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike

Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e "Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre" e pasqyruar në mbyllje të vitit ushtrimor 2025, në vlerën 261,177,338 lekë rakordojnë me rubrikën VI "Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte".

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Lëvizja gjatë vitit buxhetor e mjeteve monetareve dhe ekuivalenteve të tyre sipas njësive shpenzuese paraqitet si më poshtë:

Mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre dhe lëvizjet e tyre për Njësitë shpenzuese, viti 2025.

Njësia shpenzuese	Gjendja me 31.12.2024	Shtesa	Pakësime	Gjendja me 31.12.2025
Bashkia Pogradec	195,005,322	68,187,211	57,126,916	206,065,617
Qendra arsimore Pogradec	5,914,077	7,080,872		12,994,949
Ndërmarrja e Parqeve dhe e Rekreacionit	832,720		649,778	182,942
Ndërmarrja e Punëve Publike	27,977,551		869,765	27,107,786
Agjensia e Mbrojtjes te Territorit	0	14,826,044	0	14,826,044

Shuma	229,729,670			261,177,338

- Llogaritë e klasës 3 "Gjendja e Inventarit qarkullues" e cila analizon të gjitha elementet e inventarit të materialeve, inventarë i imët dhe mallra kjo gjendje paraqitet në mbyllje të bilancit të konsoliduar të vitit 2025 në vlerën 82,021,657 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2024 në vlerën 166,531,806 lekë. Diferenca e tyre në ulje për vitin ushtrimor prej 84,510,149 lekë përfshihet në gjendjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në formatin Nr. 2 "Pasqyra e Performancës Financiare", dhe në mënyrë analitike sipas ndërmarrjeve të varësisë paraqiten si më poshtë:

Gjendja e inventarit qarkullues sipas ndërmarrjeve të varësisë dhe lëvizjet gjatë vitit

Njësia shpenzuese	**Gjendja me 31.12.2024**	**Shtesa**	**Paksime**	**Gjendja me 31.12.2025**
Bashkia Pogradec	52,920,877	13,245,158	51,343,100	14,822,935
Qendra arsimore Pogradec	32,972,027	16,609,510	13,631,456	35,950,081
Ndërmarrja e Parqeve dhe e Rekreacionit	9,386,403	11,176,191	11,060,611	9,501,983
Ndërmarrja e Punëve Publike	71,252,499		55,719,206	15,533,293
Agjensia e Mbrojtjes te Territorit	0	6,213,365		6,213,365
	166,531,806			82,021,657

Këto llogari janë të analizuara për gjendjen më datë 31.12.2025 me inventarin fizik për 4 njësitë shpenzuese përfshi Bashkinë Pogradec.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2025, mbështetur dhe në udhëzimin nr. 30 datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr. 530 datë 06.10.2025 i Kryetarit të Bashkisë, për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve afatshkurtëra dhe afatgjata të Bashkisë Pogradec dhe të NJ/Administrative, si më poshtë:

Urdhri 530 datë 06.10.2025 për Bashkinë Pogradec.
Urdhri 533 datë 06.10.2025 për Nj/A Velçan.
Urdhri 534 datë 06.10.2025 për Nj/A Trebinjë
Urdhri 535 datë 06.10.2025 për Nj/A Buçimas
Urdhri 536 datë 06.10.2025 për Nj/A Çërravë
Urdhri 537 datë 06.10.2025 për Nj/A Udenisht
Urdhri 538 datë 06.10.2025 për Nj/A Dardhas
Urdhri 539 datë 06.10.2025 për Nj/A Proptisht, komisionet e inventarizimit me mbarimin e procesit të verifikimit fizik nuk kanë hartuar procesverbal përmbledhës por vetëm kanë firmosur kartelat sipas çdo artikulli kontabël dhe personave përgjegjës.

Në Agjencinë e Mbrojtjes së Territorit është ngritur komisioni inventarizimit me urdhrin nr. 32 datë 16.10.2025.

Në ndërmarrjen e Parqeve dhe Rekreacionit është ngritur komisioni inventarizimit me urdhrin nr. 29 datë 09.10.2025.

Në Ndërmarrjen e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike është ngritur komisioni inventarizimit me urdhrin nr. 203 datë 31.12.2024.

Në Qendrën Arsimore është ngritur komisioni inventarizimit me urdhrin nr. 6 datë 27.01.2025.

Komisionet e inventarizimit dhe të vlerësimit nuk ka hartuar raport lidhur me inventarizimin e kryer në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".

85. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për:
a) Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit.
b) Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet.
c) Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues.
Gjatë vitit 2025 Qendra Arsimore ka ngritur komisionin me urdhrin nr. 7, datë 27.01.2025 për nxjerrjen jashtë përdorimit nga komisioni është hartuar procesverbali datë 04.12.2025 për materiale të vlerësuar për jashtë përdorimi n vlerën 15,077 lekë. Nga komisioni për asgjësimin i dalë me urdhrin nr. 8, datë 27.01.2025 është kryer procesi i asgjësimit.

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" përbëhet nga:
- Gjendja e llogarisë së Arkëtueshme pasqyron llogaritë e të drejtave që kanë të gjitha njësitë e Bashkisë Pogradec për të arkëtuar në fund të periudhës raportuese (si: klientë, tatime dhe taksa, debitorë të ndryshëm, etj.), këto llogari paraqiten në bilancin e konsoliduar në vlerën prej 465,442,128 lekë, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët. Peshën më të lartë të këtij detyrimi e zënë debitorët për tatim taksa vendore .
Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 84,408,987 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare.
Vlera raportuar e kësaj llogarie duhet të përfaqësoi llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, që përbëhet nga:
Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën më poshtë.
Detajet e nën rubrikës "Të tjera operacione me shtetin".

Emërtimi i llogarive	**2025**	**2024**
Llogari 401-408	169,229,654	238,326,670
Paga personeli llog 42	45,408,813	42,277,579
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	4,938,017	4,374,895
Sigurime shoqërore llog.435	32,008,042	31,013,048
Sigurime shëndetësore llog.436	4,433,300	4,291,956
Kreditor të ndryshëm llog.467	47,663,255	68,885,505
Totali	**303,681,081**	**389,169,653**

Konstatim: Referuar udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar citohet.

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin" (detyrime).
Kjo është një llogari që në pasqyrat financiare të NJQP paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzimet/shërbimet e kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme.
Llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin" është kontabilizuar në kundërshtim me udhëzimin nr.5 si mësipërm.

Referuar të dhënave më sipër llogaria 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)" duhet

të kontabilizohej për vlerën 303,681,081 lekë. Kjo llogari është kontabilizuar në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 84,408,987 lekë e cila është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 219,272,094 lekë.

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 200,942,622 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 381,033,141 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2025 ka pasur rritje në vlerën 180,090,519 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" kemi detyrimet si më poshtë:

Detajet e llogarisë *468 "Debitorë të ndryshëm".*

Lloji i Detyrimit	**Detyrim 31.12.2024**	**Shtesa viti 2025**	**Pakësim viti 2025**	**Detyrim datë 31.12.2025**
Detyrime Biznesi	72,324,382	26,571,119	13,894,153	85,001,348
Detyrime Drejtoria Urbanistikës	16,263,214	34,617,521	0	50,880,735
Gjoba IMTV	4,751,238	0	0	4,751,238
Detyrime ish-Komuna	27,394,901	0	0	27,394,901
Kontrata qeraje Nj. Administrative	15,098,008	0	0	15,098,008
Taksa Pulle	2,792,300	0	0	2,792,300
Bileta parkimi	1,611,900	0	0	1,611,900
Kontrata qeraje	8,420,415	13,627,240	3,347,371	18,700,284
Taksa familjet	0	122,516,163	0	122,516,163
Shuma	**200,942,622**	**197,332,043**	**17,241,524**	**381,033,141**

Burimi: Bashkia Pogradec

Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" vetëm për vitin 2025 janë për vlerën 197,332,043 lekë të cilat janë kontabilizuar sipas listave që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për debitorë familjarë në vlerën 122,516,163 lekë dhe debitorë të biznesit në vlerën 26,571,119 lekë të dërguara me shkresën nr. 392, datë 21.01.2026, listave që disponon Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për debitorë për leje legalizimi në vlerën 34,617,521 lekë, dërguar me shkresë nr. 1099/1, datë 06.03.2026 dhe lista e subjekteve debitorë që disponon Sektori i Monitorimit dhe Zbatimit të Kontratave, Zbatimit të Kushteve të Lejes dhe Shpronësimeve, për kontrata qiraje në vlerën 13,347,371 lekë me shkresën 392/1,21.01.2026 drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiarë për kontabilizimin e tyre.

AKTIVET AFATGJATA përfaqësojnë shumat e:

- Aktiveve afatgjata jomateriale që përfshin: studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme;
- Aktiveve afatgjata materiale që përfshin: toka, pyje, ndërtesa, rrugë, mjete transporti etj;
- Aktiveve afatgjata financiare që përfshin: huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet;
- Investimeve që përfshin: aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale.

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llogaria 202 "Studime dhe kërkime" të cilat në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 55,620,029 lekë. Krahasuar me vitin 2024, janë bërë shtesa në vlerën 84,888 lekë të cilat konsistojnë në kapitalizimin e aktiveve afatgjata jomateriale kryesisht studim projektime për kopshtin Liri Çomo, kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 45 artikuj me kosto historike në vlerën 55,620,029 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 3, bashkëlidhur.

Konstatimi: Nga auditimi, konstatohet se llogaria 202 "Studime dhe projektime" në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 55,620,029 lekë, e analizuar për 45 objekte inventari, Nga verifikimi i inventarit kontabël u konstatua se ka vlera të paanalizuara sipas projekteve, projekte të cilat i përkasin periudhave të hershme për të cilat nuk ka informacion nëse ato janë vënë në zbatim për tu sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të

përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e AAM, të numrit të tyre për efekt të inventarizimit fizik dhe llogaritjes së amortizimit, veprim në mospërputhje me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (a) "Njohja fillestare e AAGJM"

- ***Llogaria 210 "Toka, Troje, Terrene"*** sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 21,299,391 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 21,299,391 lekë, për gjatë vitit 2025 kemi transferime brenda sistemit në vlerën 2,013,000 lekë pakësuar nga Bashkia kaluar në Njësinë shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike si shtesë aktivi, kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 7 artikuj me kosto historike në vlerën 21,299,391 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 4, bashkëlidhur.

- ***Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, kullota plantacione"*** sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 765,318,602 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 716,833,599 lekë, shtesa me pagesë në vlerën 9,502,717 lekë dhe dhurime në vlerën 2,267,700 lekë gjatë vitit 2025. Transferime brenda sistemit në vlerën 720,128,648 lekë është shtuar nga Agjencia e Mbrojtjes së Territorit vlera 37,723,682 lekë si shtesë aktivi kur në fakt janë shpenzime për inventarë qarkullues (Dru zjarri) pakësuar nga Bashkia në vlerën 682,404,966 lekë kaluar në Njësinë shpenzuese Agjencia e Mbrojtjes së Territorit si shtesë aktivi, në këtë rast kemi mbivlerësim të llogarisë 211 "Pyje, kullota plantacione" në vlerën 37,723,682 lekë, kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 39 artikuj me kosto historike në vlerën 765,318,602 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 5, bashkëlidhur.
Objektet e kapitalizuara në llogarinë 211 gjatë vitit 2025.

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Pemë fotinia,jumperius, emerald	133860
2	Ligustrum	29700
3	Fidane dekorative	81600
4	Pemë bliri	439200
5	Hartim plan mbarështimi	8,818,357
Total		**9,502,717**

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, llogaria 211 "Pyje, kullota plantacione" paraqitet në vlerën prej 765,318,602 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se nga Njësia shpenzuese Agjencia e Mbrojtjes së Territorit në këtë llogari ka kontabilizuar vlerën 37,723,682 lekë si shtesë aktivi kur në fakt janë shpenzime për inventarë qarkullues (Dru zjarri) duke mbivlerësuar këtë llogari për këtë vlerë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerën e saj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b).

- ***Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtime konstruksione"*** sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 1,415,697,397 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 1,407,410,660 lekë, shtesa me pagesë në

vlerën 8,286,737 lekë dhe brenda sistemit në vlerën 140,289,390 lekë, pakësuar nga Bashkia kaluar në Qendra Arsimore e Bashkisë si shtesë aktivi për të njëjtën vlerë, kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 181 artikuj me kosto historike në vlerën 1,415,697,397 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 6, bashkëlidhur.
Objektet e kapitalizuara në llogarinë 212 gjatë vitit 2025.

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Kolaudim për objektin "Rehabilitim dhe ambjente shtese këndi i lojërave me dorë	141,479
2	Mbikëqyrje Rikonstruksion I qendrës multifunksionale	55,153
3	Riparim tarrace	416,394
4	Rivitalizim I mureve te kalasë	7,673,711
Total		**8,286,737**

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" paraqitet në vlerën 1,415,697,397 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se nuk ka regjistër me të dhëna për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, gjithashtu nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së , por janë trajtuar si aktive më vete, gjithashtu nuk jep informacion se sa nga asetet e transferuara me VKM me listë përfundimtarë janë të regjistruara në kontabilitet, amortizimi nuk është llogaritur për çdo artikul por në grup, në këtë llogari ka vlera të paanalizuara me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerat neto dhe inventarin fizik, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b).

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet "vlerën reale" të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Pogradec, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale", Paragrafi "Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale", pika 23-32 "Modeli i rivlerësimit". Vlera fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarëve kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" janë për vlerën nga 2,400 – 99,700 lekë dhe për llogarinë 215 "Mjete transporti" janë 5 mjete me vlerë 1 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, pika 105 "Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar"

- ***Gjendja e Llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 2,359,160,943 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 4,314,930,948 lekë, shtesa me pagesë në vlerën 425,417,374 lekë dhe brenda sistemit në vlerën 143,061,656 lekë kemi pakësimi në vlerën 2,524,249,035 lekë pakësuar nga Bashkia në vlerën 184,725,496 lekë kaluar në

Njësinë shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike, si shtesë aktivi, pakësimi për transferimi jashtë sistemit për aktive të UK Pogradec në vlerën 2,339,523,539 lekë, kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 217 artikuj me kosto historike në vlerën 2,359,160,943 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 7, bashkëlidhur.
Objektet e kapitalizuara në llogarinë 213 gjatë vitit 2025.

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Rikonstruksion rruge Fshati Çervenake	1,596,456
2	Mbikëqyrje Shtesa e sistemimit te Lumit Buçimas	30,881
3	Ndriçimi rrugor	60,892,982
4	Kolaudim"Sistemim I Lumit Buçimas dhe rehabilitim I infrastruktures rrugore Loti I I	35,510
5	Mbikëqyrje Rehabilitim skema ujitëse "Rezervuari Bregu I lendinave Çerrave Loti V	152,694
6	Mbikëqyrje Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari I pusisë , Gjollet Leshnice Loti VI	31,527
7	Kolaudim Rikonstruksion I kanalit ujitës Rezervuari I pusisë Gjollet Leshnice	12,324
8	Kolaudim rikonstruksion I kanalit ujitës Rezervuari Bregu I lëndinave Çerrave	13,704
9	Shtesa e sistemimit te Lumit Buçimas	10,804,812
10	Rehabilitim skema ujitëse "Rezervuari Bregu I Lëndinave , Çerrave ",	5,205,602
11	Rikonstruksion kanali ujitjes rezervuari I Pusisë -Gjollet Leshnice	9,690,360
12	Mbikëqyrje Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal Çerrave Dardhas	692,332
13	Ujësjellësi i Mokrës Faza e II,Bashkia Pogradec	78,277,822
14	Ujësjellës	133,544,656
15	Supervizion punimesh për objektin :Ujësjellësi I Mokrës Faza e II,Bashkia Pogradec	1,000,864
16	Fatkeqësi natyrore te menaxhuara	2,003,558
17	Ndërtim mur mbajtës ne fshatin rrodokal I sipërm	6445929
18	Mbikëqyrje Rikonstruksion kanali ujitjes rezervuari I pusise , Gjollet Leshnice Loti VI	283737
19	Mbikëqyrje sistemim I Lumit Buçimas	1513342
20	Tubo te brinjezuara HDPE Ø315	888,797
21	Rakorderi 315	486,000
22	Pllaka betoni 16x20x64	2,856,000
23	Pllaka betoni 20x10x84	6,742,080
24	Bordura betoni15x25	2,700,000
25	Pllaka betoni 40x40x3	112,320
26	Pllaka betoni 20x10x08	5,054,400
27	Pllaka Betoni	6,040,008
28	Lumi I qytetit + Lumi Bucimas	88,308,677
	Totali	**425,417,373**

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën 2,359,160,943 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se nuk ka regjistër me të dhëna për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, gjithashtu nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv që ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së , por janë trajtuar si aktive më vete, amortizimi nuk është llogaritur për çdo artikull por në grup, në këtë llogari ka vlera të paanalizuara me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerat neto dhe inventarin fizik, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b).

- ***Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 138,216,794 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 74,319,074 lekë, shtesa me pagesë në vlerën 3,004,738 lekë dhe shtesa brenda sistemit në vlerën 60,892,982 lekë, rezulton se në

shtesën brenda sistemit nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike nga vlera prej 184,725,496 lekë ka kontabilizuar në këtë llogari vlerën 41,663,840 lekë që i përket llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" nga transferimet që janë bërë nga bashkia për gjatë vitit 2025 duke mbivlerësuar llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe nënvlerësuar llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 187 artikuj me kosto historike në vlerën 138,216,293 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 8, bashkëlidhur.

Objektet e kapitalizuara në llogarinë 214 gjatë vitit 2025.

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Blerje pajisje muzikore	227,640
2	Blerje pajisje kondicionere	595,344
3	Pompe zhytese	120,000
4	Sharre me krahe zgjatuese	67,200
5	Motosharre	78,000
6	Pompe sperkatese	6,000
7	Makine korrese	69,600
8	Shkalle alumini	14,400
9	Saldatrice	14,400
10	Shtylla metalike ndricim	739,355
11	Piston bllokues trafiku	472,800
12	Betoniere	112,800
13	Prerese asfalti	96,000
14	Saldatrice me nafte	120,000
15	Saldatrice elektrike	12,000
16	Matrapikplus 150ë	19,200
17	Pajisje AMT	239,999
	Totali	**3,004,738**

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, ***214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** paraqitet në vlerën prej 138,216,794 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se Njësia shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike ka kontabilizuar në këtë llogari vlerën 41,663,840 lekë që i përket llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" nga transferimet që janë bërë nga bashkia për gjatë vitit 2025 duke mbivlerësuar llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe nënvlerësuar llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerën e saj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, aneksi 1, pika 2, Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa (b).

Llogaria 215 "Mjete transporti" sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 në vlerën prej 148,249,832 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 133,338,302 lekë, shtesa me pagesë në vlerën 9,008,000 lekë dhe transferime brenda sistemit në vlerën 13,356,440 lekë dhe pakësuar për vlerën 7,452,910 lekë, " kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 60 mjete me kosto historike në vlerën 148,249,837 lekë, të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 9, bashkëlidhur.

Llogaria kontabël 218 "Inventar ekonomik". Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Pogradec. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë gjendja e llogarisë 218 "Inventari ekonomik" më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën 178,633,636 lekë, në vitin 2024 është

raportuar 164,447,812 lekë shtesa me pagesë në vlerën 6,762,708 lekë.
Objektet e kapitalizuara në llogarinë 218 gjatë vitit 2025.

Nr.	Objekti	Vlera e Kontabilizuar
1	Mobilim i ambienteve te qendrës multifunksionale	706,800
2	Blerje pajisje kompjuterike	292,800
3	Orendi zyre	890,800
4	Blerje karrike me strukture metalike	143,160
5	Cadra	527,520
6	Kazan	72,780
7	Pedane	162,864
8	Elemente druri	213,480
9	Stola krahe gize	120,480
10	Materiale per rinov e varrezave te deshmoreve	258,000
11	Kamera sigurie	42,000
12	Te tjera pajisje zyre bashkia	3,331,944
	Totali	**6,762,708**

Llogaria 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Pogradec në fund të vitit 2025, paraqitet në vlerën (1,521,592,605) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2025. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara" paraqitet me shtesë prej (7,596,503) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2025.

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se për aktivet afatgjata materiale Llogaria llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" dhe llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" për linjat teknologjike të prodhimit, makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, amortizimi nuk është llogaritur veçmas me vlerën e mbetur për çdo artikull me normë 5% por në grup për gjithë vlerën e mbetur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kap. III, pika 36, ku përcaktohet ..... Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit, dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur.

Llogaria 24 "Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara" paraqitet sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në vitit 2024 dhe në vitin 2025 në vlerën 4,631,125 lekë, nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlerën 4,631,125 lekë është e mbartur nga vitet e mëparshme për të cilat kontabilizimi është kryer pa dokumentacion mbështetës si procesverbal mbi vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit apo vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak për nxjerrje të aktiveve jashtë përdorimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Aneksi nr. 1, "Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)", 2.1, "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2".

Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 7,410,000 lekë, e cila përfaqëson 3,610,0000 lekë kapital ne Shoqëria Rajonale UK Pogradec sha dhe 3,500, 000 lekë kapital Qendra Multifunksionale sha Pogradec dhe 300,000 lekë kapital

Gjendja e llog. "Investime" paraqiten në pasqyrat e konsoliduara financiare vjetore me gjendje në llogaritë:

Llogaria 230 "AAGJ jomaterjale" paraqitet si në mbyllje të vitit 2024, në vlerën dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 415,109 lekë, të cilat përfaqësojnë projekte të vjetra.
Llogaria 231 "AAGJM Investime në proces" paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 449,688,239 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 354,927,872 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2025. Analiza e këtyre investimeve sipas llogarive dhe kontratave paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Analizae llogarise 231 "AAGJM Investime në proces", sipas objekteve.	**Gjendja me 31.12.2025**
Shpenz. Për rritjen e AQT-plantacione	1,314,355
Hidrolzolim tarace	2,108,508
Shpenzime për rritjen e AQT-ndërtesa shkollore	132,762,814
Shpenzime për rritjen e AQT-ndert.sociale	3,751,729
Shpenzime për rritjen e AQT-ndërtimin e mureve rrethuese	5,400
Shpenzime për rritjen e AQT-te tjera ndërtimore	9,659,922
Shpenzime për rritjen e AQT-konstruksione te rrugëve	3,895,122
Shpenz. Për rritjen e AQT-konstruksione te urave	98,604,777
Shpenz. Për rritjen e AQT-orendi zyre	25,000
Shpenz. Për rritjen e AQT-pajisje kompjuteri	78,000
Ndricimi (NMIPP)	6,098,046
Asfaltim rrjeti rrugor njësite administrative	96,624,200
Totali	**354,927,872**

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Pogradec më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		**Viti 2025**	**Viti 2024**	**Diferenca/ndryshimi**
	Llogari të pagueshme	**742,908,967**	**689,315,651**	**53,593,316**
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	169,229,654	238,326,670	(69,097,016)
42	Detyrime ndaj personelit	45,408,813	42,277,579	3,131,234
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	4,938,017	4,374,895	563,122
435	Sigurime shoqërore	32,008,042	31,013,048	994,994
436	Sigurime shëndetësore	4,433,300	4,291,956	141,344
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	62,553,945	103,607,576	(41,053,631)
467	Kreditorë të ndryshëm	47,663,255	68,885,505	(21,222,250)
4341	Operacione me shtetin Detyrime	376,673,941	196,538,422	180,135,519
	Të tjera afatshkurtëra	4,892,300	4,937,300	(4,448,100)
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese	4,892,300	4,937,300	(4,448,100)

Llogaria 401-408 "Furnitor e llogari të lidhura me to", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për vitin 2025 paraqiten në vlerën 169,229,654 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks bashkëlidhur.
Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 45,408,813 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.
Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 4,938,017 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.
Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" dhe llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet

vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2025, përkatësisht në vlerat 32,008,042 lekë dhe 4,433,300 lekë.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 103,607,576 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 62,553,945 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 1 bashkëlidhur.

Për vlerat e garancive për objektet të cilat nga bashkia janë marrë në dorëzim dhe u ka kaluar afati i garancisë duhet të bëjë njoftimin e subjekteve me qëllim likuidimin e këtyre garancive, për pasqyrimin e saktë të vlerës së llogarisë në mbyllje të vitit ushtrimorë,

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara dhe vendime gjykate për vitin 2025 paraqiten në vlerën 47,663,255 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks nr.10, bashkëlidhur. Llogaria 4341 "Operacione me shtetin Detyrime", për vitin 2025 paraqiten në vlerën 376,673,941 lekë, e cila përfaqëson debitorët për taksa dhe tarifa vendore.

Llogaria 475 "Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse", për vitin 2025 paraqitet në vlerën 4,892,300 lekë, e cila përfaqëson 533,100 leke letra me vlere , bileta parkimi 1,566,900 dhe 2,792,300 pulla Gjendja Civile.

Analizë: Formati nr.2 "Pasqyra e performancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 2,771,781,906 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Pogradec paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike ***70 "Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"*** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 282,344,514 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 309,142,039 lekë, me shtesë në vlerën 26,797,525 lekë.

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	309,142,039	282,344,514
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	451,868	676,790
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale		-
7001	Tatimi mbi fitimin		-
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	451,868	676,790
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat		-
702	2. Tatimi mbi pasurinë	87,748,433	80,264,153
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	82,578,446	77,278,997
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	5,169,986.70	2,985,155
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	220,941,738	201,377,309
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	220,941,738	201,377,309
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kolipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	5. Taksë e rrugës		0
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare	0	26,263
709	7. Gjoba e kamatë vonesa		

Referuar të dhënave të akt rakordimit të të ardhurave me Degën e Thesarit Pogradec sipas

shkresës nr. 34/1 prot, datë 02.02.2026 kemi informacioni si mëposhtë:
1) Sipas kodifikimit 700 *" Tatim mbi të ardhurat"* e cila është kontabilizuar për vlerën 451,868 lekë janë përfshirë.
-Tatim mbi biznesin e vogël me vlerë 451,868 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 700 *"Tatim mbi të ardhurat"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.
2) Sipas kodifikimit 702 *"Tatim mbi Pasuritë"* e cila është kontabilizuar për vlerën 87,748,433 lekë janë përfshirë.
a)Tatim mbi pasuritë e paluajtshme me vlerë 82,578,446 lekë;
b) Të tjera tatime mbi pasuritë me vlerë 5,169,986 lekë;
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Taksa e ndërtesës me vlerë 78,578,844 lekë;
-Taksë mbi tokën bujqësore me vlerë 3,073,632 lekë;
-Taksë trualli me vlerë 924,426 lekë;
-Taksë mbi rivlersim pasurie me vlerë 1,544;
Taksë për kalim e të drejtës së pronësisë me vlerë 5,169,987 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.
3) Sipas kodifikimit 703 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* e cila është kontabilizuar për vlerën 220,941,738 lekë janë përfshirë.
a)Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave (7035) me vlerë 220,941,738 lekë.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7035 *"Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Taksë për zënien e hapsirës publike me vlerë 13,646,159 lekë;
-Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me vlerë 41,971,298 lekë;
-Taksë vendore për fjetjen në hotel me vlerë 8,651,927 lekë;
-Taksë vendore për reklamat me vlerë 4,827,173 lekë;
-Taksë vendore e tabelës me vlerë 1,506,221 lekë;
-Tarifë vendore për shfrytëzim (dru të prerë) me vlerë 728,100 lekë;
-Taksë vendore e përkohëshme me vlerë 265,500 lekë;
-Taksë vendore e gjelbërt me vlerë 30,087,225 lekë;
-Tarifë vendore për pastrimin me vlerë 59,397,390 lekë;
-Tarifë vendore për ndriçimin me vlerë 8,356,528 lekë;
-Taksë vendore për truallin me vlerë 4,204,517 lekë;
-Tarifë vendore për certifikatën e përdorimit me vlerë 194,020 lekë;
-Tarifë vendore për urbanistikën me vlerë 27,801,442 lekë;
-Tarifë vendore për sisteme të jashtme ndërtimi me vlerë 291,000 lekë;
-Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi me vlerë 645,924 lekë;
-Tarifë vendore për ndotje me vlerë 1,514,067 lekë;
-Tarifë vendore për leje ndërtimi me vlerë 10,000 lekë;
-Tarifë vendore për varrezat me vlerë 24,617 lekë;
-Taksë vendore e përkohshme për linjat ajrore me vlerë 1,912,500 lekë;
-Kontribut i subjekteve me vlerë 14,906,128 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7035 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 127,462,036 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë **144,295,812 lekë** ose me shtesë në vlerën 16,833,776 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën në vijim:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**144,295,812**	**127,462,036**
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	**11,136,432**	**9,722,915**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	11,136,432	9,722,915
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	**133,141,737**	**117,739,121**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatorë	119,105,606	107,879,049
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	14,036,131	8,404,237
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	0	479,530
7114	Të ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime		976,305
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	**17,643**	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec

1) Sipas kodifikimit 710 *"Tatim nga ndërmarrjet dhe pronësia"* e cila është kontabilizuar për vlerën 11,136,432 lekë janë përfshirë.

a)Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia (7109) me vlerë 11,136,432 lekë;

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7109 *"Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Të ardhura nga qeratë për pyjet dhe kullotat me vlerë 290,024 lekë;

-Të ardhura nga qera për ndërtesat me vlerë 10,778,408 lekë;

Të ardhura nga qera për trojet me vlerë 68,000 lekë.

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 710 *"Tatim nga ndërmarrjet dhe pronësia"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

2) Sipas kodifikimit 711*"Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare"* e cila është kontabilizuar për vlerën 133,141,737 lekë janë përfshirë.

a)Tarifa administrative dhe rregullatorë (7110) me vlerë 119,105,606 lekë;

b)Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh (7111) me vlerë 14,036,131 lekë;

c)Të tjera të ardhura jo tatimore (7119) me vlerë 17,643 lekë;

c)Të tjera të ardhura jo tatimore (7119) me vlerë 0 lekë;

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Tarifa për leje transporti me vlerë 451,736 lekë;

-Tarifë për regjistrim barrë siguruese me vlerë 19,400 lekë;

-Tarifë pastrimi dhe higjene me vlerë 57,305,437 lekë;

-Të tjera tarifa administrimi dhe regjistrimi të njësisë vendore me vlerë 61,329,033 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Të ardhurat nga kopshtet dhe çerdhet me vlerë 6,859,440 lekë;

-Tarifë regjistrimi për kopshtet dhe çerdhet me vlerë 1,865,340 lekë;

-Të ardhura nga parkingu me vlerë 483,984 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* nuk rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin në vlerën **4,827,367 lekë.**

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* janë për vlerën 0 lekë:

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* për*:*

-Të ardhura miratim projekt MNZ me vlerë 8,298 lekë;

-Të ardhura nga shërbimi MNZ me vlerë 480,000 lekë;

-Të ardhura të tjera nga shitja me vlerë 4,000 lekë.

Rezultojnë se nuk rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin, për vlerën 492,298 lekë.

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7119 *"Të tjera të ardhura jo tatimore "* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

- Të tjera të ardhura jo tatimore me vlerë 17,643 lekë.

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 710 *"Tatim nga ndërmarrjet dhe pronësia"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7115 *"Gjoba. Kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* janë për vlerën 0 lekë :

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7115 *"Gjoba. Kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime"* për*:*

-Gjoba të policisë rrugore me vlerë 305,250 lekë;

- Gjoba të policisë bashkiake me vlerë 449,500 lekë;

-Të tjera gjoba me vlerë 3,527,439 lekë

-Kamatëvonesa me vlerë 52,880 lekë

Rezultojnë se nuk rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin, për vlerën 4,335,069 lekë.

3. Grante korente:

-Llogaria 72 "Grante korente", në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 2,595,703,054 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 2,408,810,322 lekë ose me një ulje në vlerën 186,892,732 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	V. GRANTE KORENTE	**2,408,810,322**	**2,595,703,054**
720	1. Grant korent i brendshëm	**2,399,039,948**	2,595,703,054
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	859,897,162	1,513,949,455
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	1,388,866,889	749,465,878
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	125,551,439
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	65,866,911	57,746,443
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	84,408,986	148,876,103
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)		113,736
7209	Të tjera grante korente të brendshme		
721	2. Grant korent i huaj	**9,770,374**	0
7211	Nga Qeveri të Huaja	9,770,374	
	Nga Organizata Ndërkombëtare		

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	VII. Ndryshim i gjendjes së inventarit të produkteve	**-90,466,267**	**0**

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec

<u>Analiza e shpenzimeve</u> në vitin 2025 , të cilat në total janë në vlerën 2,573,691,613 lekë paraqitet më poshtë:

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 537,982,268 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 659,822,087 lekë ose me një rritje në vlerën 121,839,819 lekë.

-Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 89,822,096 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 108,421,882 lekë ose me një rritje në vlerën 18,599,786 lekë.

Analiza për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
6001	Paga, personel i përhershëm	648,579,104	532,434,033
602	Paga personel i përkohshëm	6,671,661	5,310,681
603	Shpërblime	4,571,322	237,554
609	Shpenzime të tjera të personelit		
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	97,327,331	79,922,485
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	11,094,551	9,899,612

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime", në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 454,363,474 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është në vlerën 409,109,423 lekë ose me ulje në vlerën 45,254,051 lekë.

Analiza e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën në vijim:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	409,109,423	454,363,474
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	13,806,963	32,550,820
6021	Materiale dhe shërbime speciale	98,963,611	102,978,905
6022	Shërbime nga të tretë	131,234,163	178,266,439
6023	Shpenzime transporti	41,065,289	40,340,404
6024	Shpenzime udhëtimi	18,288,164	545,755
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	0	35,864,189
6026	Shpenzime për qiramarrje	2,248,523	3,123,414
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	71,127,727	34,092,049
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	-	
6029	Shpenzime të tjera operative	32,374,983	26,601,498

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec

3. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve 606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë" paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 1,042,133,647 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	V. TRANSFERIME KORENTE	974,811,539	1,042,133,647
604	Transferime korente të brendshme	122,596,080	123,529,593
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	852,215,459	918,604,054
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të	852,215,459	918,604,054

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
	pushtetit vendore		

Burimi i të dhënave: Bashkia Pogradec

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
63	Ndryshimi i gjendjeve të inventarit	84,510,149	-53,038,269
	Shpenzime të tjera	337,016,533	757,054,189

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 2,771,781,906 lekë dhe totali shpenzimeve është 2,573,691,613 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 198,090,293 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 198,090,293 lekë.

Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. U krye verifikimi i likuidimeve të kontratave për mallra, shërbime e punime ndërtimi ku rezultoi se ato janë kryer brenda afateve të paraqitjes së faturës për të cilën Drejtoria e Financës ka plotësuar urdhër-shpenzime për likuidimin e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore mbahet ky akt konstatimi me znj. I.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiarë, për periudhën e auditimit.

2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.2.1. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

2.2.1.1. Programi i nevaojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
2.2.1.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.
2.2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.) si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.
2.2.1.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

2.2.1. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023, 01.01.2024 - 31.12.2024 dhe 01.01.2025 - 31.12.2025 të miratuara në sistem (SPE) nga APP-ja dhe të dërguara pranë degës së thesarit.

Për auditimin mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për periudhën objekt auditimi, nga grupi i auditimit, në lidhje me AK Bashkia Pogradec, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Regjistri i parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitet 2023, 2024 dhe 2025.

- Dokumentacioni i vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurave si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave.

  Në mënyrë të përmbledhur[3], nga të dhënat mbi procedurat e prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2025, situata paraqitet si më poshtë vijon:

  -Nga subjekti (AK) Bashkia Pogradec për periudhën 01.01.2023-31.12.2025 janë zhvilluar gjithsej, duke përfshirë të gjitha llojet, 181 procedura prokurimi, për një fond limit total pa TVSh 1,163,837,913 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 969,747,839 lekë pa TVSh.

  Në mënyrë të detajuar, situata për secilin vit paraqitet si vijon:

  -Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 janë zhvilluar gjithsej, duke përfshirë të gjitha llojet, 70 procedura prokurimi, për një fond limit total pa TVSh 422,406,736 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 322,867,695 lekë pa TVSh. Procedurat e realizuara për këtë periudhë janë specifikisht: 28 procedura të llojit "blerje nën vlerën 100 000 lekë" për një fond limit total pa TVSh 2,481,070 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 2,437,803 lekë pa TVSh; 28 procedura të llojit "Blerje me vlerë të vogël" për një fond limit total pa TVSh 16,928,745 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 12,060,686 lekë pa TVSh; 9 procedura të llojit "E hapur e thjeshtuar" për një fond limit total pa TVSh 27,383,549 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 22,064,997 lekë pa TVSh; 5 procedura të llojit "E hapur" për një fond limit total pa TVSh 375,613,372 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 286,304,208 lekë pa TVSh;

  -Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 janë zhvilluar gjithsej, duke përfshirë të gjitha llojet, 61 procedura prokurimi, për një fond limit total pa TVSh 212,533,898 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 144,807,171 lekë pa TVSh. Procedurat e realizuara për këtë periudhë janë specifikisht: 14 procedura të llojit "blerje nën vlerën 100 000 lekë" për një fond limit total pa TVSh 1,150,842 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 1,084,876 lekë pa TVSh; 28 procedura të llojit "Blerje me vlerë të vogël" për një fond limit total pa TVSh 17,469,461 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 10,634,874 lekë pa TVSh; 14 procedura të llojit "E hapur e thjeshtuar" për një fond limit total pa TVSh 58,754,002 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 41,714,432 lekë pa TVSh; 5 procedura të llojit "E hapur" për një fond limit total pa TVSh 135,159,593 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 91,372,987 lekë pa TVSh;

  -Për periudhën 01.01.2025-31.12.2025 janë zhvilluar gjithsej, duke përfshirë të gjitha llojet, 50 procedura prokurimi, për një fond limit total pa TVSh 528,897,279 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 502,072,973 lekë pa TVSh. Procedurat e realizuara për këtë periudhë janë specifikisht: 8 procedura të llojit "blerje nën vlerën 100 000 lekë" për një fond limit total pa TVSh 800,000 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 656,882 lekë pa TVSh; 33 procedura të llojit "Blerje me vlerë të vogël" për një fond limit total pa TVSh 13,199,326 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 10,280,092 lekë pa TVSh; 5 procedura të llojit "E hapur e thjeshtuar" për një fond limit total pa TVSh 23,063,549 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 17,965,482 lekë pa TVSh; procedura të llojit "E hapur" për një fond limit total pa TVSh 490,501,071 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 471,840,516 lekë pa TVSh; 1 procedurë e llojit "negocim pa shpallje" për një fond limit total pa TVSh 1,333,333 lekë dhe vlerë totale të kontratave të lidhura 1,330,000 lekë pa TVSh.

  Për një pjesë të procedurave të prokurimit, të audituara me përzgjedhje nga grupi i auditimit (15 me vlerë të vogël dhe 19 me vlerë mbi 1 milion lekë, të specifikuara në aneksin bashkëlidhur), u konstatuan disa parregullsi në shkelje apo mospërputhje të Ligjit nr. 162,

[3] *Në mënyrë të detajuar dhe tabelore, të dhënat mbi procedurat e prokurimeve publike të zhvilluara dhe të audituara për periudhën objekt auditimi 01.01.2023-31.12.2025, paraqiten në aneksin bashkëlidhur materialit.*

datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" si dhe Udhëzimin nr. 05 datë 25.06.2021.

<u>Në lidhje me auditimin e procedurave të llojit "E hapur" dhe "E hapur e thjeshtuar", me vlerë të fondit limit më të lartë se ajo "Blerje me vlerë të vogël".</u>

1- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Rehabilitim i Lumit të Çërravës**"*, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit:</u>

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim i Lumit të Çërravës"</td></tr>
<tr><td>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF-62163-03-10-2023
Urdhri nr. 831/3 prot.,datë 27.02.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 831/2 prot., datë 22.02.2023
1. N.T.
2. K.I.
3. B.Ç.</td><td>2 Njësia e Prokurimit
1. N.T.
2. K.I.
3. B.Ç.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 831/5 prot., datë 09.03.2023
1. I.C.
2. R.J.
3. V.B.
-Ndryshuar me Urdhin nr. 831/6 prot., datë 23.03.2023
1. I.C.
2. R.J.
3. M.T.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
12,499,950 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
12,196,899 lekë
Fitues: OE "B." ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
303,051 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 28.03.2023
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Bashkisë Pogradec</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 OE
b) Skualifikuar 3 OE
c) Kualifikuar 2 OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE):
Data: 24.04.2023 (komunikimi i renditjes)
Data: 22.05.2023 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 31.05.2023 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 07.06.2023
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 13.06.2023</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 831/1prot., datë 22.02.2023 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rehabilitim i Lumit të Çërravës*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ing. V.Ç. dhe Ing. F.K.

Referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se Ing. V.Ç. është e pajisur me licencën e projektimit nr. K. 2625 dhe Ing. F.K. me licencën e projektimit nr. T. 1482. Gjithsesi licencat e cituara janë për projektim të kategorive 3, 4, 6, 7, 8 dhe 11, ndërkohë që për objektin "Rehabilitim i Lumit të Çërravës" kërkohet licenca e kategorisë 5 (Projektues vepra hidraulike).

Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe*

disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*
Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".
Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungersë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.
Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit.
Së dyti, në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se AK, me shkresën nr. 3662 prot., datë 07.09.2023, ka kërkuar dhe ka kryer një oponencë teknike nga Instituti i Ndërtimit, veprim në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, si dhe VKM-në nr.1055, datë 22.12.2010 "*Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit*".
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 09.03.2023 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për disa prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jo realiste. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës.
Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:
AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.5., ndër të tjera, për 1 manovrator dhe 5 shofera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:
-"*dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente...*".
Në lidhje me këtë kriter, grupi i auditimit vlerëson se, "pajisja me Çertifikatë për sigrimin teknik ose Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik" shërben për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike. Referuar dispozitave të ISHTI, dëshmitë jepen për kategoritë: Naftën dhe Gazin Natyror, Pajisje nën Presion, Instalime Elektrike dhe Labrator të Kontrolleve. Në kushtet kur procesi i punës për punonjësit e sipërcituar nuk ka të bëjë me rrjetin, apo skemat elektrike, atëherë është e qartë se kjo dëshmi e sigurimit teknik nuk ndikon në vlerësimin e kualifikimit të stafit duke pasur parasysh për më tepër natyrën (rehabilitim kanalesh) dhe vlerën e kontratës. Në procesverbalin "për argumentimin e miratimin e kritereve", nuk ka asnjë argumentim për këtë kriter.
AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.8., ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim/Kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesmarrëse në procedurë të ofertojë këto mallra/produkte në këtë procedurë prokurimi, si: Materiale elektrike, Tubo të brinjëzuara, Rërë kuarcore. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin* ".

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, si dhe duke ju referuar sasisë së tyre sipas preventivit, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë. Pikërisht, duke qenë se këto mallra gjenden lehtësisht në treg, nuk ka asnjë arsye që aftësia zbatuese e një ofertuesi të kushtëzohet apo të konsiderohet si e lidhur ngushtë me dokumentacionin e sipërcituar.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. N.T., z. K.I. dhe z. B.Ç., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 24.04.2023 njoftimin e klasifikimit, në datën 22.05.2023 njoftimin paraprak dhe në datën 31.05.2023 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"B." ShPK	**12,196,899**	**Kualifikuar/Fituesi**
2	"R." ShPK	10,567,665	Skualifikuar
3	"I." ShPK	10,809,832	Skualifikuar
4	"N." ShPK	9,125,235	Skualifikuar
5	"Z." ShPK	**10,499,275**	**Kualifikuar/Skualifikuar**

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 4 (katër) OE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"R." ShPK:*** *Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht: Nuk ka paraqitur Grafikun e zbatimit të punimeve. Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim /kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/produkte në këtë procedurë prokurimi, si: Rërë kuarcore. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që*

vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Operatori ka paraqitur një kontratë të lidhur me një person fizik (PF) "Ermal Gjoza", kontratë e cila nuk ka një objekt të përcaktuar qartë dhe nuk vërehet nëse personi në fjalë është prodhues apo distributor. Paraqitja vetëm e një fature blerjeje nuk vërteton dot lidhjen që ka distributori me prodhuesin.

2. ***"I." ShPK:*** *Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht: Nuk ka paraqitur Grafikun e zbatimit të punimeve. Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim /kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/produkte në këtë procedurë prokurimi, si: Materiale elektrike, Rërë kuarcore. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

   Për rastin konkret, operatori ka paraqitur një Autorizim për materiale elektrike nga "L.M.E" ShPK nën cilësinë e distributorit për materiale elktrike, por nuk ka paraqitur dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. E njëjta situatë është dhe për rërën kuarcore.
3. ***"N." ShPK:*** *Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht: Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi /distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/ produkte në këtë procedurë prokurimi, si: Materiale elektrike, Rërë kuarcore. Për rastin konkret operatori nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni Autorizim/ kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori për rërën kuarcore. Gjithashtu dhe për materialet eletrike operatori ekonomik nuk ka paraqitur ashtu siç duhet Autorizimet e prodhuesit, pasi i ka paraqitur në gjuhën angleze, ndërkohë që LPP dhe rregullat e prokurimit publik e kanë të përcaktuar qartë që dokumentacioni i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer dhe i noterizuar.*
4. ***"Z." ShPK:*** *Brenda afatit të kërkuar operatori ekonomik nuk u paraqit për të dorëzuar dokumentacionin fizik pranë Autoritetit Kontraktor, por me kalimin e afatit të kërkuar, KVO-ja është loguar në SPE për të bërë rivlerësim dhe ka vënë re se operatori "Z." ShPK ka paraqitur në SPE nje shkresë me lëndë: "Kthim përgjigje", ku ka cituar arsyet e tij të tërheqjes nga oferta, prandaj ky operator konsiderohet i skualifikuar, duke qenë se ka sjellë shkresë për tërheqje nga oferta.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 28.03.2023, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Tërhiqet për verifikimin korrigjimin dhe vlerësimin e ofertave ...*".

-Me procesverbalin e datës 19.04.2023, ndër të tjera, KVO-ja ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar, fillimisht, nga OE "Z." ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues.

-Në datën 27.04.2023 është administruar dorëheqja nga gara e OE "Z." ShPK me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur se: "*nisur nga fakti i vonesës së vlerësimit të procedurës ka angazhuar mjetet në një tjetër procedurë prokurimi*".

-Pas dorëheqjes së OE "Z." ShPK, me procesverbalin e datës 03.05.2023, ndër të tjera, KVO-ja ka pasqyruar rivlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "B." ShPK, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues.
-Në procesverbalin e datës 17.05.2023, ndër të tjera, pasqyrohet se: "*KVO më datë 08.05.2023 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues "B." ShPK, protokolluar pranë bashkisë Pogradec me nr. 831/8 prot., datë 08.05.2023. Nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori "B." ShPK rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 831/9 prot., datë 22.05.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 30.05.2023, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Nëpunësi i Autorizuar.
-Me shkresën nr. 831/10 prot., datë 31.05.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet që kontrata e sipërmarrjes nr. 831/11 prot., datë 07.06.2023, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "B." ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 13.06.2023 ose jashtë afatit të përcaktuar.
Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*". Shkelja e afateve në procedurat e prokurimit është problematike. Në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës.
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të pajustifikuara të cilat bien ndesh me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", konkretisht për situatat si vijon:

I)- Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 28.03.2023, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 12.04.2023 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 22.05.2023 ose 40 ditë jashë afatit. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021.

II)- Në lidhje me dorëheqjen nga gara të OE të renditur i pari ("Z." ShPK) në datën 27.04.2023. Në kushtet kur braktisja e garës nga OE është kryer pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave (28.03.2023) dhe për sa kohë nuk rezulton që OE të jetë tërhequr përpara këtij afati, KVO-ja duhet të kishte kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës, në zbatim të nenit 83, pika 3/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe nenit 30, pika 6/a të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021.
Si konkluzion, mosveprimi i sipërcituar ka shkaktuar mungesën e përfitimit dhe cenimin e ekonomicitetit në vlerën 249 999 lekë (vlera e sigurimit të ofertës).

III)- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit, grupi i auditimit vlerëson se KVO-ja nuk ka konstatuar devijime për operatorin ekonomik "B." ShPK. Për sa më sipër, konkretisht si vijon:
-Në ndryshim nga disa ofertues të skualifikuar për të njëjtën arsye, në lidhje me OE "B." ShPK, KVO-ja, nuk ka konstatuar se ky i fundit, nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka arritur të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto mallra/produkte në këtë procedurë prokurimi, si: Materiale elektrike. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
-Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE "B." ShPK, KVO-ja, nuk ka konstatuar se ky i fundit nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik të DST, pasi: Nga një inxhinier ndërtimi dhe një hidroteknik të kërkuar nga AK, OE ka paraqitur dy inxhiniera hidroteknik (referuar diplomave përkatëse të kërkuara në DST); Për inxhinierin hidroteknik (E.Ç., të deklaruar me mbështetje) nuk disponohet "kontratë noteriale pune e vlefshme" ashtu sikundër është përcaktuar në DST.
-Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE "B." ShPK, KVO-ja, nuk ka konstatuar se ky i fundit nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të DST, pasi: Për elektriçistin e paraqitur P. Ll. (referuar kërkesave të përcaktuara në DST) diploma/çertifikata e arsimit profesional i përket kualifikimit "elektro-auto" dhe jo "elektriçist". Për hidraulikun e paraqitur P.G. (referuar kërkesave të përcaktuara në DST) mungon diploma/çertifikata e arsimit profesional.
Si konkluzion përmbledhës, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, rezulton se, kjo e fundit, nuk ka vlerësuar drejt shoqërinë pjesëmarrëse në garë.
Në kushtet si më sipër dhe në funksion të zbatimit literal të LPP-së, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar OE "B." ShPK dhe në mungesë të ofertuesve të vlefshëm, Autoriteti Kontraktor, pasi njësia e prokurimit të analizonte dhe rivlerësonte kriteret e pjesëmarrjes, të rihapte garën me një procedurë të re prokurimi.
Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*" Neni 83, pika 3/a: "*Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave*"; Neni 92 pika 3: "*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*". Neni 82 pika 1 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Neni 30, pika 6/a e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021: "*Autoriteti/enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës, në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave*".
Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, ngarkohen me përgjegjësi: znj. I.C., z. R.J. dhe z. M.T., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

2- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore**"*, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore"</td></tr>
<tr><td>1.Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF-78330-08-25-2023
Urdhri nr. 578/6 prot., datë 27.07.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 578/5 prot., datë 26.07.2023
1. N.T.
2. V.Ç.
3. R.Y.</td><td>2 Njësia e Prokurimit
1.N.T.
2.V.Ç.
3.R.Y.
Ndryshuar me urdhrin Nr. 578/15 prot., datë 14.12.2023
1.N.T.
2.V.Ç.
3.A.L.</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 578/7 prot., datë 27.07.2023
1. E.B.
2. I.C.
3. V.B.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
79,282,029 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
70,743,198 lekë
Fitues: OE "R."ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
8,538,831 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 19.09.2023
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 8 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 9 OE
b) Skualifikuar 8 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime
AK-s'ka/ka;-PO
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-PO</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 20.10.2023 (komunikimi i renditjes)
Data: 14.12.2023 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 22.12.2023 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 22.12.2023
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 26.12.2023</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 578 prot., datë 06.02.2023 Autoriteti Kontraktor (Bashkia Pogradec) ka aplikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për financimin e projektit "*Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore*". Bashkëlidhur aplikimit është dërguar edhe projekt-preventivi, grafiku i punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës. Me shkresën nr. 398/3 prot., datë 02.05.2023 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka miratuar aplikimin e Autoritetit Kontraktor (Bashkia Pogradec) për financimin e projektit.

-Me shkresën nr. 578/4 prot., datë 26.07.2023 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ark. DH.GJ., Ing. E.XH. dhe Ing. F.K.

Referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se Ing. F.K. është i pajisur me licencën e projektimit nr. T. 1482. Gjithsesi licenca e cituar është për projektim të kategorisë 8 (a, b), ndërkohë që për objektin "Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore" kërkohet licenca e kategorisë 5 (Projektues vepra hidraulike). Ark. DH.GJ. është i pajisur me licencën e projektimit nr. A. 0088/4. Ing. E.XH. nuk është e pajisur me licencë projektimi.

Hartimi i projekteve të zbatimit në mungersë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*
Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".
Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungersë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.
Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit.
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 09.03.2023 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për dy prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose i ekzagjeruar dhe/ose i argumentuara mbi bazën e parakushteve jo realiste. Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:
AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.6., ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:
-"*Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Maj - Korrik 2023 dhe në vazhdim, ose duhet të paraqitet një kontratë e vlefshme për ofrimin e këtij shërbimi me një subjekt të liçensuar sipas ligjit. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili nga operatorët ekonomikë duhet ta plotësojë këtë kusht në përputhje me numrin respektiv të punonjësve sipas kërkesave ligjore*".
Nga sa më sipër rezulton se, në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011*", të Këshillit të Ministrave "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "*Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë*", ***shfuqizohet.*** Në çdo rast, njësia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri duhet të merrte parasysh faktin se në *VKM nr. 108, datë 9.2.2011* ndër të tjera përcaktohet se: "*shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim*".
Gjithashtu punësimi i mjekut, në listëpagesat e shoqërisë, për të paktën 3 muaj, rezulton të jetë një kriter i pa-argumentuar i cili sjell ngushtime të konkurencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listëpagesë.

Nga ana tjetër, vendosja e kriterit se, në rastin e BOE sejcili prej operatoreve ekonomike duhet të plotësoje këtë kriter është i padrejtë dhe në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 74 pika 3 ku citohet ...." *secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*".
Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme sforcon kërkesat kualifikuese dhe zvogëlon konkurrencën, ku një operator, i cilit nuk disponon "*Mjek*" nuk mund të kryej bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit si dhe OE të cilët këtë shërbim mund ta marrin nëpërmjet kontraktimit dhe jo punësimit të drejtpërdrejtë të një mjeku.
AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.4.2., ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:
-"*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim/Kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesmarrëse në procedurë të ofertojë këto mallra/produkte në këtë procedurë prokurimi, si: Materialet hidraulike (Tub PVC etj), Pllaka/Bordura betoni, Materiale elektrike. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin* ".
Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, si dhe duke ju referuar sasisë së tyre sipas preventivit, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë. Pikërisht, duke qenë se këto mallra gjenden lehtësisht në treg, nuk ka asnjë arsye që aftësia zbatuese e një ofertuesi të kushtëzohet apo të konsiderohet si e lidhur ngushtë me dokumentacionin e sipërcituar.
Kriteri i sipërcituar është sugjeruar për rishikim edhe nga APP-ja, sugjerim i cili nuk është marrë në konsideratë nga njësia e prokurimit.
Si konkluzion, veprimet apo mosveprimet e mësipërme, përveçse rezultojnë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.05.2021 "*Për prokurimin publik*", ndikojnë negativisht mbi konkurrencën, në kundërshtim me nenin 2 të LPP-së. Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteret e sipërcituara dhe mungesa e argumentimit të tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.
Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".
Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. N.T., znj. V.Ç. dhe z. A.L., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 9 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 20.10.2023 njoftimin e klasifikimit, në datën 14.12.2023 njoftimin paraprak dhe në datën 22.12.2023 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"A." ShPK	(nuk ka ofertë)	Skualifikuar
2	"T."ShPK & "B." ShPK	62,535,675	Skualifikuar
3	"A." ShPK	75,269,973	Skualifikuar
4	"D. & R." & "H. " ShPK	65,297,640	Skualifikuar
5	"L."ShPK	53,454,049	Skualifikuar
6	"SH."ShPK	61,342,932	Skualifikuar
7	"RR.& B. " ShPK	67,039,298	Skualifikuar
8	"V.& LL. " ShPK	63,009,633	Skualifikuar
9	"R."ShPK	**70,743,198**	**Skualifikuar/Kualifikuar/Fituesi**

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke skualifikuar fillimisht të gjithë ofertuesit, dhe më pas, me vendim të KPP-së, ka kualifikuar OE R.ShPK, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"A." ShPK:*** *Operatori ekonomik nuk përmbush Kriteret e Veçanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultojnë mangësi për të gjitha kriteret si dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.*
2. ***"T."ShPK & "B." ShPK:*** *Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.3 të DST, pasi nuk disponon Leje Mjedisi tipi III.1.B me titull "Menaxhim i Mbetjeve", pasi nga dokumentat e paraqitura në SPE rezulton se Leja Mjedisore III.1.B e Bashkimit të Operatorëve është me titull "Përzierja e Çimentos, por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos. Prodhimi i produkteve abrasive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike. Veprimtaritë që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.*
3. ***"A." ShPK:*** *Nuk nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës; Nuk disponon Leje Mjedisi tipi III.1.B "Menaxhim i Mbetjeve"; Nuk ka deklaruar disponimin e 6 (gjashtë) manovratoreve; Nuk ka deklaruar të gjitha mjetet e kërkuara; Nuk ka paraqitur Autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori i autorizuar për materialet e kërkuara.*
4. ***"D. & R." & "H." ShPK:*** *Leja e Mjedisit tipi III.1.B "Menaxhim i Mbetjeve", nuk përmban aktivitetet e kërkuara; Drejtuesit teknikë në licencën e shoqërisë të OE "R. & H" nuk figurojnë në raport me përqindjen e deklaruar; Mjetet dhe pajisjet e angazhuara nuk figurojnë në raport me përqindjen e deklaruar; Për materialet pllaka/bordura betoni ka paraqitur autorizim prodhuesi nga firma "Nazmi Kazani" P.F., i cili nga verifikimi në regjistrin tregtar nuk rezulton të jetë prodhues.*
5. ***"L."ShPK:*** *Nuk disponon Leje Mjedisi tipi III.1.B "Menaxhim i Mbetjeve"; Ka deklaruar se disponon asaltobeton, binder me furnizues "Varaku E". Në rastin konkret, OE "Varaku E", në cilësinë e operatorit ekonomik ofertues në procedurën e prokurimit nuk mund të jetë njëkohësisht edhe subjekt mbështetës për operatorët e tjerë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi.*
6. ***"SH." ShPK:*** *Nuk disponon Leje Mjedisi tipi III.1.B "Menaxhim i Mbetjeve"; OE SH.ka paraqitur Autorizim të Distributorit "Sali Elektrik" për materialet elektrike, autorizim i cili është pa datë dhe nuk ka të përcaktuar periudhën kohore gjatë së cilës*

OE SH.mund të ofertojë këto mallra në procedurën e prokurimit, gjë e cila krijon pasigurinë te AK për vlefshmërinë ose jo të ketyre deklaratave/autorizimeve. Gjithashtu deklaratat e prodhuesve për "Sali Elektrik" janë me data të vjetra përkatësisht vitet: 2016, 2017, 2018 dhe 2019 dhe nuk ka paraqitur deklarate prodhuesi të azhornuar të viteve te fundit, gje e cila nuk krijon besueshmeri nëse këto deklarata janë të vlefshme dhe për vitet pasardhëse.

7. ***"RR.& B." ShPK:*** *Nuk disponon Leje Mjedisi tipi III.1.B "Menaxhim i Mbetjeve";*
8. ***"V.& LL." ShPK:*** *Leja e Mjedisit tipi III.1.B "Menaxhim i Mbetjeve", nuk përmban aktivitetet e kërkuara; Në rastin konkret, OE "Varaku E", në cilësinë e operatorit ekonomik ofertues në procedurën e prokurimit nuk mund të jetë njëkohësisht edhe subjekt mbështetës për operatorët e tjerë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi. Ka paraqitur autorizimin e prodhuesit për distributorin Sali Elektrik të pa përkthyer.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 20.10.2023, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar anullimin e procedurës pasi ka skualifikuar, fillimisht, edhe OE "R." ShPK me arsyetimin se: "*ka paraqitur autorizim distributori nga "E.", i cili është distributori i prodhuesit "T." për furnizim me materiale elektrike, por nuk ka paraqitur dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin...*".

-Me shkresën nr. 578/13 prot., datë 20.10.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Anulimit", me arsyetimin se nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme, i cili i është komunikuar OE në datën 24.10.2023.

-Në datën 30.10.3023 pranë AK Bashki Pogradec, është protokolluar ankesa me nr. 4472 prot., e OE "R." ShPK, ankesë e cila është paraqitur njëkohësisht edhe pranë KPP-së, me të cilën OE kundërshton arsyet e skualifikimit.

-Titullari i AK, në datën 30.10.2023 ka marrë vendimin (urdhër) nr. 4472/1 prot., me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedures dhe ka caktuar Komisionin për Shqyrtimin e Ankesës (KSHA) të përbërë nga tre punonjës (znj. A.K., z. S.K.dhe z. B.Ç.).

-Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me ankimin, rezulton se, pas shqyrtimit, KSHA ka marrë vendim nr. 4472/1 prot., datë 03.11.2023 për mospranimin e tij. Venidmi i është komunikuar OE "R.ShPK, brenda afateve ligjore, me shkresën nr. 4472/3 prot., datë 03.11.2023.

-Nga sa më sipër, procedurialisht, në lidhje me ankesën e paraqitur dhe shqyrtimin e saj, rezulton se titullari i AK dhe KSHA ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në lidhje me praktikën e shqyrtimit të ankesës, nga KSHA nuk janë administruar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*", në kundërshtim me LPP ***ngarkohet me përgjegjësi*** znj. A.K., z. S.K. dhe z. B.Ç., në cilësinë e anëtarëve të KSHA-së.

-Nga ana tjetër, me shkresën nr. 4472/4 prot., datë 24.11.2023 të KPP-së, AK është njohur me vendimin nr. 1196/2023 datë 21.11.2023 të KPP-së, me të cilin, ndër të tjera, është vendosur: "*1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik R.ShPK... 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik R.ShPK, sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik*".

Në vijim të vendimit të sipërcituar, konstatohet se, AK ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore, me qëllim zbatimin e vendimit.

-Me shkresën nr. 578/16 prot., datë 14.12.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 22.12.2023, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.
-Me shkresën nr. 578/17 prot., datë 22.12.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht R.ShPK.
-Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit me nr. 578/22 prot., datë 26.12.2023, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 26.12.2023 në përputhje dhe zbatim të, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, i cili citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 19.09.2023, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 04.10.2023 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 20.10.2023 ose 16 ditë jashë afatit. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në rastin konkret, moszbatimi i dispozitave të LPP-së apo shkelja e afateve ligjore, veçanërisht gjatë fazës së vlerësimit të ofertave është problematike. Ato jo vetëm që mund të shkaktojnë shqetësime për ofertuesit, por gjithashtu mund të krijojnë hapësira për praktika abuzive ose të paktën të krijojnë një perceptim të dyshimtë dhe të dëmtojnë sigurinë dhe besimin në praktikën e prokurimit publik të AK-së dhe të gjithë sistemit të prokurimit publik.
Në përfundim, në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, ngarkohen me përgjegjësi: z. E.B., znj. I.C. dhe znj. V.B., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

3- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Rehabilitimi i shkolles Myredin Bashalli", fshati Lin Nj. A. Udënisht, Bashkia Pogradec**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rehabilitimi i shkolles Myredin Bashalli", fshati Lin Nj. A. Udënisht, Bashkia Pogradec*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-76789-08-04-2023 Urdhri nr. 1495/7 prot., datë 27.07.2023	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 1495/6 prot., datë 26.07.2023 1. N.T. 2. V.Ç. 3. R.J.	**2. Njësia e Prokurimit** 1. N.T. 2. V.Ç. 3. R.J.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr.1495/8 prot., datë 27.07.2023. 1. D.B. 2. A.I. 3. V.B. -Ndryshuar me Urdhin nr.1495/16 prot., datë 07.09.2023 1. D.B. 2. A.I. 3. K.I.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 50,886,277 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 49,487,636 lekë Fitues: OE "V.K." ShPK		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 1,398,640 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 07.09.2023 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 8 muaj	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit 80% Buxheti Bashkisë Pogradec 20%		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 **OE** b) Skualifikuar 4 **OE** c) Kualifikuar 1 **OE**
10. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;-Jo** **APP–**s'ka/ka**;-Jo** **KPP**-s'ka/ka;-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 27.09.2023 (komunikimi i renditjes) Data: 03.10.2023 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 13.10.2023 (njoftimi përfundimtar i fituesit)		**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 14.11.2023 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 21.11.2023

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 1495/1 prot., datë 07.04.2023 Autoriteti Kontraktor (Bashkia Pogradec) ka aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për financimin e projektit "*Rehabilitimi i shkolles Myredin Bashalli", fshati Lin Nj. A. Udënisht, Bashkia Pogradec*". Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 3124/2 prot., datë 15.05.2023, ka miratuar dhe shpallur fitues projektin e propozuar nga Bashkia Pogradec.

Me shkresën nr. 578/4 prot., datë 26.07.2023 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rehabilitimi i shkolles Myredin Bashalli", fshati Lin Nj. A. Udënisht, Bashkia Pogradec*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ark. M.T., Ing. V.Ç. dhe Urb. E.P.

Referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se Ing. V.Ç. është e pajisur me licencën e projektimit nr. K. 2625. Në lidhje me Ark. M.T., grupit të auditimit nuk i është paraqitur asnjë liçencë. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*

Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".

Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo

të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.
Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit (anëtarët e paliçensuar).

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 04.08.2023 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për disa prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose i ekzagjeruar dhe/ose i argumentuara mbi bazën e parakushteve jo realiste. Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.5, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*1(një) Inxhinier Mjedisi".*

Kërkesa e AK në lidhje me 1 (një) Inxhinier Mjedisi, konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi kriteri në fjalë mund të konsiderohet i nevojshëm në fazën e projektimit por jo të zbatimit të objektit. Referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se nuk ka të parashikuar lloje të punimeve konkrete për të cilat të kërkohet një Inxhinier Mjedisi. Në rast se nga AK vlerësohet nevoja e një Inxhinier Mjedisi për zbatimin e punimeve me cilësi, një i tillë mund të kërkohet në procedurën e prokurimit të mbikqyrjes dhe jo zbatimit. Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të paargumentuar, të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.6, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*1(një) Arkitekt".*

Kërkesa e AK në lidhje me 1 (një) Arkitekt, ashtu sikundër grupi i auditimit ka argumentuar edhe për "*1(një) Inxhinier Mjedisi*", nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi kriteri në fjalë mund të konsiderohet i nevojshëm në fazën e projektimit por jo të zbatimit të objektit. Në rast se nga AK vlerësohet nevoja e një Arkitekti për zbatimin e punimeve me cilësi, një i tillë mund të kërkohet në procedurën e prokurimit të mbikëqyrjes dhe jo zbatimit. Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të paargumentuar, të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.9, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin, si staf mbështetës, si vijon:

-"*Specialist IT 1 (një), Specialist elektronik 1 (një)".*

Kërkesa e AK në lidhje me të dy specialistët njëkohësisht, pjesë e stafit mbështetës konstatohet se nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës. Referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se nuk ka një sasi aq të madhe të punimeve për të kërkuar (justifikuar apo argumentuar) një mbështetje të tillë. Grupi i auditimit, në konstatimin e kryer, ka marrë parasysh faktin se njësia e

prokurimit, përveç dy specialistëve të sipërcituar, ka kërkuar edhe 3 elektriçistë, 1 Inxhinier Elektrik dhe 1 Inxhinier Elektronik.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.4.1, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*ISO 9001- 2015, ISO 14001- 2015, ISO 45001-2018, ISO PAS 99:2012"*.

Në lidhje me këtë kriter, NjP ka kryer argumentimin përkatës. Nga ana tjetër, dy nga elementët e argumentimit (ISO) që nuk janë pjesë e listës por vetëm pjesë e cituar e argumentimit të kriterit janë: "*ISO 27001:2013 është standart ndërkombëtar, mbi Menaxhimin e sigurisë së informacionit Informacioni është vlera më e mirë e një shoqërie prandaj dhe duhet mbrojtur në mënyrën e duhur.*

Për nga rëndësia dhe volumi i dokumentacionit që ka ndërtimi i këtij objekti <u>është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 27001:2013</u> si dhe *…ISO 50001-2011 – Kjo ISO specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë…*". Në këto kushte rezulton e paqartë dhe konfuzionale si për grupin e auditimit ashtu edhe për ofertuesit fakti nëse, për plotësimin e kriterit të sipërcituar, nga ofertuesit duhet apo jo të paraqiten ISO 27001:2013 dhe ISO 50001-2011, të cilat gjithsesi vlerësohen si të ekzagjeruara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.4.2, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/ mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Materiale elektrike, Materialet hidraulike, Materialet e rrjetit ngrohës (HVAC), Materialet e sistemit të mbrojtjes kundra zjarrit (MNZ), Materiale durale, Materiale hidroizoluese, Materiale termo-izoluese (Sistem Kapote), Materiale kolle, llac, fino, Pajisje hidrosanitare, Pllaka Laminat, Bojra. Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim)që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin"*

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, si dhe duke ju referuar sasisë së tyre sipas preventivit, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë. Pikërisht, duke qenë se këto mallra gjenden lehtësisht në treg, nuk ka asnjë arsye që aftësia zbatuese e një ofertuesi të kushtëzohet apo të konsiderohet si e lidhur ngushtë me dokumentacionin e sipërcituar.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. N.T., znj. V.Ç. dhe z. R.J., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në

përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 27.09.2023 njoftimin e klasifikimit, në datën 03.10.2023 njoftimin paraprak dhe në datën 13.10.2023 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"I." ShPK	50,806,209	Skualifikuar
2	"I." ShPK	38,415,666	Skualifikuar
3	"SH" ShPK	48,894,443	Skualifikuar
4	"Z" ShPK	50,168,739	Skualifikuar
5	"V.K." ShPK	49,487,636	**Kualifikuar/Fituesi**

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke skualifikuar 4 (katër) OE dhe kualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

> ***"I." ShPK:*** *Operatori ekonomik nuk përmbush Kriteret e Veçanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezultojnë mangësi për të gjitha kriteret si dhe nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës ekonomike.*
>
> ***"I."ShPK:*** *Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.4.3. të DST pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në përmbushje të kësaj pike, rezultojnë mangësi, si më poshtë: Punimet Elektrike, Punime HVAC, Punime MNZ, Punime Shtresash, Hidraulike.*
>
> ***"SH." ShPK:*** *Nuk nuk ka paraqitur certifikatat ISO të kërkuara; Nuk përmbush pikën 2.4.3. të DST pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në përmbushje të kësaj pike, rezultojnë mangësi, si më poshtë: Punimet Elektrike, Punime HVAC, Punime MNZ, Punime Shtresash, Hidraulike, Suvatimi, Murature, Veshje.*
>
> ***"Z." ShPK:*** *Nuk ka paraqitur Licencë (QKL) Kodi III.2.B; Nuk ka deklaruar të plotë stafin teknik të kërkuar; Nuk plotëson pikën 2.3.10, Makineri dhe Pajisje, pasi nuk ka deklaruar se disponon: 1 Autovinc me Kosh, 1 Balone Ndricimi, 1 Pompë për Lyerje; Nuk përmbush pikën 2.4.2 pasi nuk ka paraqitur certifikata prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 07.09.2023, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Me procesverbalin e datës 27.09.2023, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE V.K.ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 02.10.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 27.09.2024 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE"V.K. ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 1495/17 prot., datë 02.10.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 13.10.2023, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.

-Me shkresën nr. 1495/19 prot., datë 13.10.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 1495/20 prot., datë 14.11.2023, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "V.K." ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 1495/22 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 21.11.2023 ose jashtë afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës.
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 07.09.2023, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 22.09.2023 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 03.10.2023 ose jashë afatit të përcaktuar. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në përfundim, në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, ngarkohen me përgjegjësi: z. D.B., z. A.I. dhe z. K.I., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

4- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Shërbim transporti për materiale ndërtimi**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Shërbim transporti për materiale ndërtimi*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur e thjeshtuar" REF-71357-06-01-2023 Urdhri nr. 1455/5 prot., datë 31.05.2023	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 1455/4 prot., datë 31.05.2023 1. B.Ç. 2. N.SH. 3. DH.G.	**2. Njësia e Prokurimit** 1. B.Ç. 2. N.SH. 3. DH.G.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 1455/7 prot., datë 01.06.2023 1. A.B. 2. N.Ç. 3. E.B.(ndryshuar me urdhër nr. 1455/8 prot., datë 13.06.2023)
4. Fondi Limit (pa TVSh) 4,965,853 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 4,697,005 lekë Fitues: OE "M." ShPK		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 268,848 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit:	**8. Burimi Financimit** Buxheti Bashkisë Pogradec		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 **OE**

Data 12.06.2023 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 3 muaj		b) Skualifikuar 1 **OE** c) Kualifikuar 1 **OE**
10. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;-Jo** **APP**–s'ka/ka**;-Jo** **KPP**-s'ka/ka;-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 16.06.2023 (komunikimi i renditjes) Data: 23.06.2023 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 03.07.2023 (njoftimi përfundimtar i fituesit)	**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 07.07.2023 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 11.07.2023

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 279 prot., datë 04.05.2023 Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike (Bashkia Pogradec) ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike zhvillimin e procedurës për objektin e sipërcituar, duke bashkëlidhur edhe marrëveshjen e nënshkruar me FSHZH-në për përfitimin e materialeve të ndërtimit.

-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit komisioni ka studiuar ofertat e tregut, të marra nga 3 OE të ndryshëm ("R."ShPK, "A." ShPK dhe "B." ShPK) duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë 4,965,853 lekë pa TVSh.

Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021.

Përveç administrimit të ofertave, nga anëtarët e komisionit (punonjësi i caktuar) është mbajtur procesverbali nr. (pa numër) prot., datë 19.05.2023 për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, në përputhje me nenin 2 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 sipas të cilit "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 01.06.2023 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 16.06.2023 njoftimin e

klasifikimit, në datën 23.06.2023 njoftimin paraprak dhe në datën 03.07.2023 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"M." ShPK	4,697,005	Kualifikuar/Fituesi
2	"T." ShPK	4,698,548	Skualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 1 (një) OE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"T." ShPK:*** *Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.2.2. të DST-ve, pasi, nga verifikimi i bilanceve të viteve ushtrimore 2020, 2021 dhe 2022, rezulton që vitet 2021 dhe 2022 janë me humbje.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 12.06.2023 dhe atë të datës 15.06.2023, ndër të tjera, KVO-ja, , ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "M." ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

- Në datën 21.06.2023 KVO-ja, pasi ka evidentuar një gabim aritmetik në lidhje me ofertën e OE "M." ShPK, ka njoftuar këtë të fundit për pranimin e korrigjimit të saj. Konkretisht në zërin "transport çimento" ka një mospërputhje midis çmimit për njësi çmimit në total, gjithsesi shuma e korrigjimit është me e vogël se 2% e vlerës së ofertës dhe ofertuesi e ka pranuar korrigjimin duke dhënë edhe shpjegimin se mospërputhja ka ardhur si pasojë e rrumbullakosjes së çmimit për njësi.

-Në procesverbalin e datës 23.06.2023, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "M." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 1455/10 prot., datë 23.06.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 03.07.2023, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari, dhe me shkresën nr. 1455/11 prot., datë 03.07.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e shërbimit nr. 1455/12 prot., datë 07.07.2023, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "M." ShPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 11.07.2023, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Për sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se KVO ka vepruar përgjithësisht në zbatim të LPP-së.

-Në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 1455/13 prot., datë 10.07.2023, Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për monitorimin e zbatimit të kontratës" të përbërë nga z. DH.G., z. R.H. dhe z. A.S.

Komisioni i sipërcituar, me situacionet përkatëse, ka marrë në dorrëzim në mënyrë periodike shërbimin objekt kontrate duke e cilësuar atë si në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet.
Grupi i auditimit, edhe në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, në lidhje me praktikën e marrjes në dorëzim, nga komisioni përkatës nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë *ngarkohet me përgjegjësi* z. DH.G., z. R.H. dhe z. A.S., në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe z. P.Z., në cilësinë e personit të autorizuar.

5- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Rehabilitim i objekteve në rrezik shembje**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës u konstatua, konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim i objekteve në rrezik shembje".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"
REF-90073-12-06-2023
Urdhri nr. 4918/3 prot., datë 05.12.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 4918/2 prot., datë 04.12.2023
1. K.I.
2. L.F.
3. K.L.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. K.I.
2. L.F.
3. K.L.
Ndryshuar me Urdhër nr. 4918/7 prot., datë 26.12.2023
1. K.I.
2. I.C.
3. K.L.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 4918/4 prot., datë 05.12.2023
1. D.B.
2. A.L.
3. B.Ç.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
4,009,181 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
3,052,251 lekë
Fitues: OE "A" ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
956,930 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 18.12.2023
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 javë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE
b) Skualifikuar 0 OE
c) Kualifikuar 4 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 18.12.2023 (komunikimi i renditjes)
Data: 19.12.2023 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 27.12.2023 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 28.12.2023
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 28.12.2023</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 4918 prot., datë 04.12.2023 Drejtoria e Emergjencave Civile ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rehabilitim i objekteve në rrezik shembje*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.
Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Emergjencës Civile dhe Strehimit Social. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësi: Ing. B.N.(Drejtor).
Në lidhje me Ing. B.N., grupit të auditimit nuk i është paraqitur asnjë liçencë. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji*

ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.
Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".
Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungersë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.
Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** hartuesi i projektit (i paliçensuar).
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 06.12.2023 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.
Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 18.12.2023 njoftimin e klasifikimit, në datën 19.12.2023 njoftimin paraprak dhe në datën 27.12.2023 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"A." ShPK	3,052,251	Kualifikuar/Fituesi
2	"S." ShPK	3,219,909	Kualifikuar
3	"I."ShPK	3,559,320	Kualifikuar
4	"A." ShPK	3,708,625	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 4 (katër) OE dhe mos skualifikuar asnjë prej tyre.
Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:
-Me procesverbalin e datës 18.12.2023, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".
-Me procesverbalin e datës 18.12.2023, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "A" ShPK,

i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin e datës 19.12.2023, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 19.12.2024 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "A" ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 4918/6 prot., datë 04.12.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 27.12.2023, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.
-Me shkresën nr. 4918/8 prot., datë 27.12.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 4918/9 prot., datë 28.12.2023, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "A" ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 28.12.2023 brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, përgjithësisht, ka vepruar në zbatim të dispozitave të LPP-së.

6- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Ndërtim mur mbajtes, Lagjja nr. 1, Lumi i Vërdovës**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim mur mbajtes, Lagjja nr. 1, Lumi i Vërdovës".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"
REF-76508-08-01-2023
Urdhri nr. 3016/3. prot. datë 25.07.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 3016/2. prot., datë 24.07.2023
1. V.Ç.
2. B.Ç.
3. R.Y.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. V.Ç.
2. B.Ç.
3. R.Y.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 3016/5 prot., datë 25.07.2023
1. D.B.
2. V.B.
3. A.I.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
4,061,279 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
3,361,505 lekë
Fitues: OE "B." ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
699,774 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 14.08.2023
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 javë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 6 OE
b) Skualifikuar 1 OE
c) Kualifikuar 5 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 31.08.2023 (komunikimi i renditjes)
Data: 13.09.2023 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 29.09.2023 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 13.10.2023
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 20.10.2023</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 3016 prot., datë 24.07.2023 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (PKZHT), ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: "*Ndërtim mur mbajtes, Lagjja nr. 1, Lumi i Vërdovës*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.
Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ing. V.Ç. dhe Ing. E.XH.
Referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se Ing. V.Ç. është e pajisur me licencën e projektimit nr. K. 2625 në përputhje me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*
Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 02.08.2023 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për një prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezulton i paargumentuar teknikisht dhe/ose i argumentuar mbi bazën e parakushteve jo realiste. Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:
AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.6, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:
-"*Minimalisht 4 (katër) shoferë dhe 2 (dy) Manovratorë".*
Kërkesa e AK në lidhje me numrin në total të tyre (6-gjashtë), konstatohet se nuk ka lidhje me volumin e punimeve objekt kontrate. Gjithashtu, grupi i auditimit thekson se në lidhje me këtë procedurë, njësia e prokurimit ka kërkuar, në pikën 2.3.7, disponimin e gjithësesj 5 mjeteve, në këto kushte nuk ka asnjë arsye që të kërkohen gjithësej 6 shoferë/manovratore.
Si konkluzion, njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteret e sipërcituara dhe mungesa e argumentimit të tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.
Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** znj. V.Ç., z. B.Ç. dhe z. R.Y., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 31.08.2023 njoftimin e klasifikimit, në datën 13.09.2023 njoftimin paraprak dhe në datën 29.09.2023 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"I." ShPK	4,008,138	Kualifikuar
2	"B." ShPK	3,361,505	Kualifikuar (Fituesi)
3	"P.& S." ShPK	3,407,083	Kualifikuar
4	"R." ShPK	2,681,971	Skualifikuar
5	"S." ShPK	3,928,596	Kualifikuar
6	"SH." ShPK	3,855,181	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 5 (pesë) OE dhe skualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"R." ShPK:*** *Oferta e paraqitur nga OE "R." ShPK rezulton të jetë anomalisht e ulët. Me anë të analizës së paraqitur, operatori nuk ka mundur të krijojë bindjen tek KVO-ja lidhur me këtë fakt, për shkak se në analizën teknike rezultojnë çmime tepër të ulëta…".*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 14.08.2023, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Me shkresën nr. (pa numër SPE) prot., datë 21.08.2023, në zbatim të dispozitave përkatëse të LPP, KVO-ja ka kërkuar shpjegime nga OE "R."ShPK, për sa kohë, nga përllogaritja e kryer, oferta e këtij të fundit ka rezultuar anomalisht e ulët.

Nga analiza e paraqitur, operatori nuk ka mundur të krijojë bindjen tek KVO-ja për shkak se në analizën teknike rezultojnë çmime tepër të ulëta.

-Me procesverbalin e datës 31.08.2023, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "B." ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 12.09.2023, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 04.09.2023 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "B." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 3016/9 prot., datë 13.09.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 21.09.2023, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.
-Me shkresën nr. 3016/10 prot., datë 13.09.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 3016/11 prot., datë 13.10.2023, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "B." ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 20.10.2023 ose jashtë afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Në lidhje me sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës.

7- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF- 46203-10-17-2022
Urdhri nr. 4714/2 prot., datë 13.10.2022</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 4714/1 prot., datë 12.10.2022
1. N.T. P.P.
2. V.Ç. (sp. i fushës)
3. E.K.(jurist)</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. N.T.
2. V.Ç.
3. E.K.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 4714/3 prot., datë 13.10.2022. Ndryshuar me Urdhër nr. 48 prot., datë 05.01.2023 dhe nr. 48/1 prot., datë 11.01.2023
1. P.Z./E.B.
2. D.T.
3. V.B.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
220,320,000 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
153,876,474 lekë
Fitues: OE "A." ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
66,443,526 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 02.11.2022
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Fondi limit total prej 220,320,000 lekë pa TVSh, me burim financimi "Buxheti i Shtetit", bazuar në VKB-në Nr. 91 dt.19.08.2022, "Për miratimin e programit të rishikuar buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Pogradec".</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 OE
b) Skualifikuar 4 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Po
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Po
Gjykatë: PO</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 05.12.2022 (komunikimi i renditjes)
Data: 12.02.2024 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 22.02.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 01.03.2024
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 08.03.2024</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 4714 prot., datë 11.10.2022 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Loti IV, Ura e Zëmçës – Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Studio e Projektimit E. ShPK, në bazë të kontratës së projektimit nr. 1010/12 datë 02.07.2021.

Së dyti, në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se AK, me shkresën nr. 42 prot., datë 05.01.2023, ka kërkuar dhe ka kryer një oponencë teknike nga Instituti i Ndërtimit, konkretisht atë me nr. 19/3 prot., datë 02.02.2023. Në rastin konkret, veprimet e AK janë në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 14.10.2022 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe pas ndryshimeve të sugjeruara nga APP, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për një prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezulton i paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose i ekzagjeruar dhe/ose i argumentuara mbi bazën e parakushteve jo realiste. Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.11, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si: Materiale elektrike, Tubo të brinjëzuara, tombino betoni, Hekur, Cimento.*

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij".

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë. Pikërisht, duke qenë se këto shërbime apo mallra gjenden lehtësisht në treg, si dhe referuar sasisë së kërkuar për objektin, nuk ka asnjë arsye që aftësia zbatuese e një ofertuesi të kushtëzohet apo të konsiderohet si e lidhur ngushtë me dokumentacionin e sipërcituar (autorizim, pronësi, kontratë noteriale qiraje apo furnizimi). Çdo nevojë e AK në lidhje me cilësitë e mallrave mund të mirëpërcaktohet lehtësisht në specifikimet teknike.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me sa më sipër, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. N.T., znj. V.Ç. dhe znj. E.K., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 05.12.2022 njoftimin e klasifikimit, në datën 12.02.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 22.02.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"T." ShPK	187,369,889	Skualifikuar
2	*"A.I."* ShPK	192,578,543	Skualifikuar
3	*"P."* ShPK	171,719,233	Skualifikuar
4	*"S."* ShPK	195,845,297	Skualifikuar
5	"A." ShPK	153,876,474	**Kualifikuar/Fituesi**

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke skualifikuar 4 (katër) OE dhe kualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"T." ShPK:*** *Operatori ekonomik nuk përmbush Kriteret e Veçanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se: Nuk disponon mjet (Skrep); Për dy punonjës nuk disponon certefikatë nëpërmjet të cilës të jenë akreditуar si përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë; Për tubo të brinjëzuar dhe tombino betony, nuk është deklaruar asnjë e dhënë e shoqërisë ARIEL dhe nuk specifikohet nëse është distributor ose prodhues; Për çimenton, nuk specifikohet nëse është distributor ose prodhues; Për 6 mjetet autovetëshkarkues mbi 8 ton rezulton se certifikata e kontrollit teknik ka skaduar.*
2. ***"A.I." ShPK:*** *Nga shoqeria mbështetëse "A. ", nuk janë paraqitur listëpagesat e kërkuara për periudhën korrik-shtator 2022, për të verifikuar punonjësit e paraqitur nga kjo shoqëri (teknikë ndërtimi + manovratorë), të cilët do të mbështesin OE ofertues "A." ShPK.*
3. ***"P." ShPK:*** *Mjeti autobitumatrice 1 copë, rezulton se Certifikata e Kolaudimit të mjetit ka përfunduar 1 ditë para zhvillimit të procedures; Mjeti Kamioncinë me targë AB036BU, rezulton se Polica e Sigurimit të mjetit ka përfunduar dhe Taksa Vjetore e mjetit ka përfunduar përpara dorëzimit të dokumentacionit; "Autorizim Prodhuesi / Kontratë Bashkëpunimi", OE ka paraqitur autorizim prodhuesi për materialin (Hekur-Cimento) nga "Rafaelo 2002" ShA, i cili mban datën 26.12.2022, datë kjo në të cilën procedura e prokurimit ende nuk ishte zhvilluar; OE rezulton që të ketë ndryshuar analizën teknike dhe cmimin për zërin Punime Elektrike – Analiza 3.FV ndricues MINITONALE-SAP-T 250 Ë, i zëvëndësuar me Ndricues LED Philips 116Ë 17600 Lumen, me arsyen që produkti i kërkuar nuk gjendet në treg, pa kërkuar me parë miratimin e Autoritetit Kontraktor; Mjeti me targë AA730HA i ka përfunduar polica e sigurimit; Për dy Manovratorë Dëshmia e Aftësimit Profesional e palexueshme; Në të dyja vetëdeklarimet (P. dhe P.) rezultojnë të deklaruar të njëjtët emra për 12 punonjës.*
4. ***"S." ShPK:*** *Operatori ekonomik nuk përmbush Kriteret e Veçanta të kualifikimit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se: Nuk disponon mjet*

(Skrep); Ka paraqitur dy mjete Grejder, përkatësisht me fatura zhdoganimi dhe me foto, por nuk ka paraqitur dokumentacionin tjetër të nevojshëm për këto mjete, siç parashikon Kodi Rrugor dhe Ligji "Për sigurimin e detyrueshëm në trasportin publik", konkretisht (Leje qarkullimi, Certifikatën e kontrollit teknik si dhe policë sigurimi).

Paraprakisht, në funksion të qartësisë së veprimeve, vlen të theksohet se, AK, njoftimin e fituesit, e ka shoqëruar me shënimin si vijon:

"*Pas publikimit të njoftimit të anulimit, brenda afatit të ankimit, janë paraqitur ankesa nga Operatoret Ekonomike "A." ShPK, e cila mban numrin prot. 561/2023, datë 15.03.2023, dhe "A." me nr. aplikimi A/2023/2963, datë 16.03.2023, të trajtuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, i cili ka dalë me Vendimin Përfundimtar nr. 337/2023, datë 03.05.2023.*

Më pas, ky Vendim, është kundërshtuar nga ana e Operatorit Ekonomik "A." në Gjykatën Administrative të Apelit, nëpërmjet kërkesë padisë NR. 154 Akti, datë 22.05.2023, protokolluar pranë Bashkisë Pogradec, si palë e tretë, me nr. 2117/1 prot, datë 26.05.2023.

Me vendimin e formës së prerë Nr. 79 (86-2023-1022), datë 10.10.2023, protokolluar pranë Bashkisë Pogradec me nr. 707 prot, datë 12.02.2024, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vendosur "Pranimin e padisë së paditësit "A." ShPK dhe Shfuqizimin e pikës 6 të Vendimit nr. 337/2023 të Komisionit të Prokurimit Publik…", nëpërmjet të cilës, legjitimohet Autoriteti Kontraktor me vazhdimin e procedurës së prokurimit me fazat e mëtejshme të saj".

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 02.11.2022, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Me shkresën nr. (pa numër SPE) prot., datë 24.11.2022, në zbatim të dispozitave përkatëse të LPP, KVO-ja ka kërkuar shpjegime nga OE "A." ShPK, për sa kohë, nga përllogaritja e kryer, oferta e këtij të fundit ka rezultuar anomalisht e ulët. Analiza dhe shpjegimet janë paraqitur nga OE në datën 26.11.2022.

-Fillimisht, me procesverbalin e datës 05.12.2022, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, dhe ka kualifikuar të gjithë OE pjesëmarrës në garë, duke kërkuar nga OE "A." ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 16.12.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO-ja mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit "A." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet nuk janë në përputhje me DST pasi: Mjeti i deklaruar si skreper rezulton të jetë fadromë; Mjeti me targë TR5481P dhe TR5569P, nuk ka çertifikatë pronësie; Për fabrikën e asfaltobetonit nuk ka asnjë dokument...*".

Në të njëjtin procesverbal, në vijim, KVO-ja ka kërkuar nga OE "*P."* ShPK, i renditur i dyti, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 25.01.2023, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO-ja mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit "P." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet nuk janë në përputhje me DST (duke renditur mangësitë e cituara në njoftimin përfundimtar të fituesit, si më sipër)*".

Në të njëjtin procesverbal, në vijim, KVO-ja ka kërkuar nga OE "T." ShPK, i renditur i treti, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 07.02.2023, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO-ja mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit "T." ShPK, dhe nga*

verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet nuk janë në përputhje me DST (duke renditur mangësitë e cituara në njoftimin përfundimtar të fituesit, si më sipër)".
Në të njëjtin procesverbal, në vijim, KVO-ja ka kërkuar nga OE "A." ShPK, i renditur i katërti, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin e datës 23.02.2023, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO-ja mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit "A." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet nuk janë në përputhje me DST (duke renditur mangësitë e cituara në njoftimin përfundimtar të fituesit, si më sipër)*".
Në të njëjtin procesverbal, në vijim, KVO-ja ka kërkuar nga OE "*S."* ShPK, i renditur i pesti, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin e datës 07.03.2023, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO-ja mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit "S." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet nuk janë në përputhje me DST (duke renditur mangësitë e cituara në njoftimin përfundimtar të fituesit, si më sipër)*".
-Në kushtet si më sipër, kur, në vlerësimin e KVO-së, asnjë nga ofertuesit nuk i ka plotësuar kriteret, është vendosur anulimi i procedurës dhe është publikuar formulari përkatës nr. 441/4 prot., datë 09.03.2023.
-Pas publikimit të njoftimit të anulimit, brenda afatit të ankimit, janë paraqitur ankesa nga Operatoret Ekonomike "A." ShPK, e cila mban numrin prot. 561/2023, datë 15.03.2023, dhe "A." me nr. aplikimi A/2023/2963, datë 16.03.2023, ankesa të cilat janë paraqitur njëkohësisht edhe pranë KPP-së, me të cilat OE kundërshtojnë arsyet e skualifikimit duke kërkuar ndryshimin e vendimit të KVO-së dhe kualifikimin përkatës.
-Titullari i AK (Personi i Autorizuar), në datën 16.03.2023 ka marrë vendimin (urdhër) nr. 1144/1 prot., me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedurës dhe ka caktuar Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave (KSHA) të përbërë nga tre punonjës (z. *F.H.*, z. S.K.dhe z. R.J.).
-Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me ankimet, rezulton se, pas shqyrtimit, KSHA ka marrë vendim nr. 1144/2 prot., datë 23.03.2023 për ankesën e paraqitur nga OE "A." ShPK duke vendosur pranimin e saj dhe vendim nr. 1144/5 prot., datë 31.03.2023 për ankesën e paraqitur nga OE "A." ShPK duke vendosur mospranimin e saj. Venidmet i janë komunikuar OE "A." ShPK, "A." ShPK dhe KPP-së, brenda afateve ligjore, përkatësisht me shkresat nr. 1144/3 prot., datë 24.03.2023 dhe nr. 1144/6 prot., datë 04.04.2023.
Ndërkohë, me vendimin nr. 209/2023 të KPP-së, AK Bashkia Pogradec është njohur me dorëheqjen nga ankimi të OE "A." ShPK.
-Nga sa më sipër, procedurialisht, në lidhje me ankesën e paraqitur dhe shqyrtimin e saj, rezulton se titullari i AK dhe KSHA ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.
Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në lidhje me praktikën e shqyrtimit të ankesës, nga KSHA nuk janë administruar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi*** z. *F.H.*, z. S.K.dhe z. R.J., në cilësinë e anëtarëve të KSHA-së si dhe z. P.Z. në cilësinë e personit të autorizuar. Në lidhje me këtë të fundit, neni 21 pika 5 e LPP-së citon se:

"*Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij...".*
-Nga ana tjetër, pas pikës së vendimit të KPP-së për anulimin e procedurës, mbi problematikën (ankimin) është vendosur me vendimin e formës së prerë Nr. 79 (86-2023-1022), datë 10.10.2023, protokolluar pranë Bashkisë Pogradec me nr. 707 prot, datë 12.02.2024, nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur "*Pranimin e padisë së paditësit "A." ShPK dhe Shfuqizimin e pikës 6 të Vendimit nr. 337/2023 të Komisionit të Prokurimit Publik...*", nëpërmjet të cilës, legjitimohet Autoriteti Kontraktor me vazhdimin e procedurës së prokurimit me fazat e mëtejshme të saj.
Në vijim të vendimit të sipërcituar, konstatohet se, AK ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore, me qëllim zbatimin e vendimit.
-Me shkresën nr. 707/1 prot., datë 12.02.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 20.02.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.
-Me shkresën nr. 707/3 prot., datë 20.02.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 707/5 prot., datë 01.03.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "A." ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, **grupi i auditimit konstaton se**, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. pa numër prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 08.03.2024 ose jashtë afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Në lidhje me sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës.
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 02.11.2022, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 17.11.2022 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer jashë afatit të përcaktuar. Në lidhje me shkeljen e afatit mjafton referimi i shkresës nr. (pa numër SPE) prot., datë 24.11.2022, për të kërkuar shpjegime mbi ofertën anomalisht e ulët, kërkesë e cila është bërë në një kohë kur vlerësimi duhet të kishte mbaruar. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në përfundim, në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. *J.S.* , z. D.T. dhe znj. V.B., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

8- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rikonstruksion dhe shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Gështenjas, Bashkia Pogradec**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rikonstruksion dhe shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Gështenjas, Bashkia Pogradec*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-27702-11-01-2024 Urdhri nr.4531/2 prot., datë 31.10.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 4531/1 prot., datë 30.10.2024 1. N.T. P.P. 2. K.I. 3. A.I.	**2. Njësia e Prokurimit** 1. N.T. 2. K.I. 3. A.I.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 4531/3 prot., datë 31.10.2024 1. D.B. 2. V.Ç. 3. R.J.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 88,879,920 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 58,464,150 lekë Fitues: OE R.ShPK		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 30,415,769 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 19.11.2024 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 7 muaj	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Pogradec 20% Buxheti i Shtetit 80%		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 8 **OE** b) Skualifikuar 3 **OE** c) Kualifikuar 5 **OE**
10. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;-Jo** **APP**–s'ka/ka**;-Jo** **KPP**-s'ka/ka;-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)*):** Data: 03.12.2024 (komunikimi i renditjes) Data: 06.12.2024 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 17.12.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)		**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 18.12.2024 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 23.12.2024

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion dhe shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Gështenjas, Bashkia Pogradec*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ark. DH.GJ., Ing. K.I. dhe Ing. A.L.

Së dyti, referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës që ka punuar projekt-preventivin, në lidhje me objektin e prokurimit, rezulton se, Ark. DH.GJ. është i pajisur me licencën e projektimit nr. A. 0088/4 ndërsa Ing. K.I. dhe Ing. A.L. nuk janë të pajisur me licencë projektimi. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*

Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".

Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo

të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.
Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit (anëtarët e paliçensuar).
Së treti, në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se, në datën 09.10.2024, AK ka kërkuar dhe ka kryer oponencën teknike, në zbatim të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik*".
Së katërti, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se, Autoriteti Kontraktor është pajisur me "leje ndërtimi", konkretisht lejen nr. 3627 datë 28.08.2024. Në rastin konkret, veprimet e AK janë në përputhje me nenin 39 të Ligjit nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, sipas të cilit: "*Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji*".
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 01.11.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), pas reflektimeve të sugjerimeve të dhëna nga APP, në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.
Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 03.12.2024 njoftimin e klasifikimit, në datën 06.12.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 17.12.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"*A.I.*"	79,990,879	Skualifikuar
2	*"R."*	58,464,150	**Kualifikuar/Fituesi**
3	"*B.K.* "	86,248,160	Skualifikuar
4	"*D.* " & "*N.* "	74,945,855	Kualifikuar
5	"I.& "*L.* " & " *J.* "	62,032,113	Kualifikuar

6	"*S.* " & "Z"	78,750,000	Kualifikuar
7	"*I.*"	85,159,914	Skualifikuar
8	*"I."*	66,609,706	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 5 (pesë) OE dhe skualifikuar 3 (tre) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

"A.I." ShPK: *"A." ShPK, i cili deklaron se do të mëbshtetet tek "A." ShPK, nuk përmbushin pikën 2.3.9 të kritereve të veçanta për kualifikim të DST (stafin teknik), pasi vetë OE ofertues disponon me pak se 50% të stafit teknik të kërkuar, ndërkohë që duhej të dispononte minimumi 50% të tyre (ka paraqitur 19 punonjës nga 45 totali).*

"B.K." ShPK: *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës; Nuk plotëson vlerën për përvojën e mëparshme të ngjashme; Nuk disponon liçencën N.P - 12 A, N.S – 14 dhe N.S - 18 A; Operatori nuk ka deklaruar në Shtojcën nr. 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" se disponon inxhinier hidroteknik, inxhinier elektrik dhe inxhinier mjedisi, etj.*

"I." ShPK: *Nga verifikimi në SPE, operatori nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, përveç Ekstraktit Historik të QKB-së dhe ofertës.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 19.11.2024, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Me procesverbalin e datës 03.12.2024, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE R.ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 06.12.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 05.12.2024 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE R.ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 4531/9 prot., datë 06.12.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 17.12.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.

-Me shkresën nr. 4531/10 prot., datë 17.12.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 4531/11 prot., datë 18.12.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "R." ShPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 4531/15 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 23.12.2024, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 19.11.2024, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës

04.12.2024 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer jashë afatit. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në rastin konkret, moszbatimi i dispozitave të LPP-së apo shkelja e afateve ligjore, veçanërisht gjatë fazës së vlerësimit të ofertave është problematike. Ato jo vetëm që mund të shkaktojnë shqetësime për ofertuesit, por gjithashtu mund të krijojnë hapësira për praktika abuzive ose të paktën të krijojnë një perceptim të dyshimtë dhe të dëmtojnë sigurinë dhe besimin në praktikën e prokurimit publik të AK-së dhe të gjithë sistemit të prokurimit publik.
Në përfundim, në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. D.B., znj. V.Ç. dhe z. R.J., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

9- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rikonstruksion, Rehabilitim i banesave sociale për vitin 2024**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion/Rehabilitim i banesave sociale për vitin 2024".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF-16891-08-23-2024
Urdhri nr. 335/13 prot., datë 13.08.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr.335/10 prot., datë 29.07.2024
1. S.K..
2. M.T.
3. H.M.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 335/11 prot., datë 07.08.2024
1. G.H.
2. K.I.
3. E.K.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 335/14 prot., datë 13.08.2024
1. D.B.
2. K.L.
3. A.L.
-Ndryshuar me Urdhin nr. 335/17 prot. datë 13.09.2024
1. D.B.
2. N.O.
3. A.L.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
20,083,333 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
15,269,688 lekë
Fitues: OE "R. " ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
4,813,645 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 11.09.2024
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit
Buxheti Bashkisë Pogradec</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 OE
b) Skualifikuar 0 OE
c) Kualifikuar 5 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 20.09.2024 (komunikimi i renditjes)
Data: 26.09.2024 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 08.10.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 10.10.2024
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 15.10.2024</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 23964 prot., datë 20.06.2024 Autoriteti Kontraktor (Bashkia Pogradec) ka aplikuar pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për financimin e projektit "*Rikonstruksion/Rehabilitim i banesave sociale për vitin 2024*".

Bashkëlidhur aplikimit është dërguar edhe projekt-preventivi, grafiku i punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës. Me shkresën nr. 8086/16 prot., datë 20.06.2024 Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka miratuar aplikimin e Autoritetit Kontraktor (Bashkia Pogradec) për financimin e projektit.

-Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion/Rehabilitim i banesave sociale për vitin 2024*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): M.T. dhe *S.K.*

Së dyti, referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës që ka punuar projekt-preventivin, në lidhje me objektin e prokurimit, grupit të auditimit nuk i është paraqitur asnjë liçencë. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën <u>përkatëse</u>.*

Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".

Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit (anëtarët e paliçensuar).

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 23.08.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për dy prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.2, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: N.P - 1 A".*

Kërkesa e AK në lidhje me pikën e liçencës **N.P -1 A** (Punime gërmimi në tokë), konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se nuk ka të parashikuar lloje të punimeve të përfshira në përkufizimin e licencës N.P-1. Në rastin konkret, sipas VKM-së Nr. 42, datë 16.01.2008, liçensa N.P-1 konsiderohet për punime: "*gërmimet, sistemimet dhe*

ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore". Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.9. dhe 2.4.2, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Fabrike Asfalto Betoni, në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi noteriale";*

-"*Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/ mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Koll dhe Çimento, Pllaka, Bojra, Tjegulla marseleze. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin".*

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, si dhe duke ju referuar sasisë së tyre sipas preventivit, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë. Pikërisht, duke qenë se këto mallra gjenden lehtësisht në treg, nuk ka asnjë arsye që aftësia zbatuese e një ofertuesi të kushtëzohet apo të konsiderohet si e lidhur ngushtë me dokumentacionin e sipërcituar.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. *G.H.*, z. K.I. dhe znj. E.K., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 20.09.2024 njoftimin e klasifikimit, në datën 26.09.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 08.10.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"I."	16,062,657	Kualifikuar
2	"A."	18,856,788	Kualifikuar
3	"*R.* "	15,269,688	**Kualifikuar/Fituesi**
4	*"R."*	15,949,681	Kualifikuar
5	"*T.*" & "*M.* & *R.* "	18,772,766	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 5 (pesër) OE dhe shpallur fitues atë me ofertën ekonomike më të ulët, konkretisht OE "*R.* " ShPK.

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 19.09.2024, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".
-Në vijim me të njëjtin procesverbal, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "*R.* " ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin e datës 26.09.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "R. " ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 335/19 prot., datë 26.09.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 08.10.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.
-Me shkresën nr. 335/21 prot., datë 08.10.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 335/22 prot., datë 10.10.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "*R.* " ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 335/23 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 15.10.2024, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Për sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se KVO ka vepruar përgjithësisht në zbatim të LPP-së.

10- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Përfundim punimesh, Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore" Loti 1**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Përfundim punimesh, Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore" Loti 1*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-18495-09-10-2024 Urdhri nr. 3573/2 prot. datë 26.08.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 3573/1. prot., datë 26.08.2024 1. B.Ç., P.P. 2. K.I. 3. A.L.	**2. Njësia e Prokurimit** 1. B.Ç. P.P. 2. K.I. 3. A.L.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 3573/3 prot., datë 26.08.2024 1. D.B. 2. *S.K.* 3. M.T. -Ndryshuar me Urdhin nr. 3573/5 prot. datë 27.09.2024 1. D.B. 2. *S.K.* 3. *K.L.*

4. Fondi Limit (pa TVSh) 13,329,189 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 9,004,010 lekë Fitues: OE "*A.* " ShPK	**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 4,325,179 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 27.09.2024 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 2 muaj	**8. Burimi Financimit** Buxheti Bashkisë Pogradec	**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 **OE** b) Skualifikuar 0 **OE** c) Kualifikuar 5 **OE**
10. Ankimime **AK-**s'ka/ka**;-Jo** **APP**–s'ka/ka**;-Jo** **KPP-**s'ka/ka;-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 03.10.2024 (komunikimi i renditjes) Data: 11.10.2024 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 23.10.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)	**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 31.10.2024 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 04.11.2024

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 3005/1 prot., datë 11.07.2024 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Përfundim punimesh, Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore" Loti 1*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të institucionit, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ing. K.I. dhe Ing. A.L.

Së dyti, referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës që ka punuar projekt-preventivin, në lidhje me objektin e prokurimit, grupit të auditimit nuk i është paraqitur asnjë liçencë. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*

Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".

Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit (anëtarët e paliçensuar).

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 10.09.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur*

nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...", për dy prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezultojnë të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.9. dhe 2.4.2, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Fabrike Asfalto Betoni, në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi noteriale";*

-"*Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/ kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/ mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Pllakë betoni dekorative. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin".*

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, si dhe duke ju referuar sasisë së tyre sipas preventivit, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë. Pikërisht, duke qenë se këto mallra gjenden lehtësisht në treg, nuk ka asnjë arsye që aftësia zbatuese e një ofertuesi të kushtëzohet apo të konsiderohet si e lidhur ngushtë me dokumentacionin e sipërcituar.

Si konkluzion, veprimet apo mosveprimet e mësipërme, përveçse rezultojnë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.05.2021 "*Për prokurimin publik*", ndikojnë negativisht mbi konkurrencën, në kundërshtim me nenin 2 të LPP-së. Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteret e sipërcituara dhe mungesa e argumentimit të tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.

Situata e sipërcituar bie në kundërshtim me përcaktimet e Nenit 39 pika 4: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës…*", si dhe Nenit 78 pika 2: "*Hartimi i kërkesave për kualifikim…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht...*".

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. B.Ç., z. K.I. dhe z. A.L., në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 03.10.2024 njoftimin e klasifikimit, në datën 11.10.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 23.10.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"*A.* "	9,004,010	**Kualifikuar/Fituesi**
2	"A."	10,014,550	Kualifikuar
3	"N."	9,127,500	Kualifikuar
4	*"R. "*	11,005,500	Kualifikuar

5	"I.& "*T.*"	9,961,000	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 5 (pesër) OE dhe shpallur fitues atë me ofertën ekonomike më të ulët, konkretisht OE "*A.*" ShPK.

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 29.09.2024, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Me procesverbalin e datës 03.10.2024, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "*A.* " ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 07.10.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 07.10.2024 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "A." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 3573/7 prot., datë 11.10.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 23.10.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.

-Me shkresën nr. (pa nr.) prot., datë 23.10.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 3573/9 prot., datë 31.10.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "*A.* " ShPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 3573/10 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 04.11.2023, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka respektuar afatet ligjore për vlerësimin e ofertave.

Së katërti, KVO-ja nuk ka konstatuar faktin se OE i shpallur fitues ka devijime në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në Dokumentet Standarte të Tenderit (DST), konkretisht si vijon:

Fillimisht vlen të theksohet se në DST, ndër të tjera, është kërkuar: "*1-autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë Pllakë betoni dekorative; 2-Për Pllakë betoni dekorative duhet të paraqiten kataloget/skedat teknike të shoqeruara me Çertifikatë Konfirmiteti CE/Deklarata performance lëshuar nga prodhuesi nga ku të rezultojë pllaka e prodhuar me çimento 42,5 R dhe me mesataren e rezistencës në përkulje mbi 5,7 N, absorbimi i ujit 4,7 %, vlera mesatare e fortësisë mbi 4 mpa*".

Për sa më sipër, OE fitues ka paraqitur një autorizim prodhuesi "*B.L.*", "P.F.", i cili në mënyrë të paqartë, edhe pse në brendësi autorizon OE fitues, i drejtohet fillimisht një subjekti tjetër. Nga ana tjetër, raportet e testimit dhe çertifikatat e cilësisë të paraqitura, për mallin "pllakë betoni dekorative", i referohen produktit që prodhuesi i ka shitur OE "R." ShPK në

një periudhë paraprake apo më të hershme se ajo e shpalljes së procedurës konkrete. Gjithashtu, referuar raportit të testimit, absorbimi i ujit është paraqitur për vlerën 2,4 % ndërkohë që në DST është kërkuar me vlerën 4,7 %.
Në kushtet si më sipër dhe në funksion të zbatimit literal të LPP-së, KVO-ja, përpara kualifikimit të OE, edhe pse me ofertën me vlerë më të ulët, duhet të kishte kërkuar sqarime nga ky i fundit dhe më pas të merrte një vendim kualifikimi ose skualifikimi për të vijuar procedurat me OE të radhës. Kualifikimi dhe shpallja fitues i një OE i cili nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga AK, edhe pse me ofertë ekonomike me vlerë më të ulët, përbën një risk të shtuar për realizimin në kohë dhe cilësi të objektit të kontratës, duke cënuar në të njëjtën kohë efiçencën dhe efektivitetin e fondeve të prokuruara. Neni 92 pika 3 e LPP-së përcakton se: "*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*".
Në përfundim, në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. D.B., z. S.K.dhe z. *K.L.*, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

11- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari i Pusis-Gjollet, Leshnicë**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari i Pusis-Gjollet, Leshnicë".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur"
REF-25463-10-18-2024
Urdhri nr. 4324 prot., datë 18.10.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 4120/2 prot., datë 03.10.2024
1. B.Ç.
2. J.D.
3. E.M.</td><td>2. Njësia e Prokurimit

1. B.Ç.
2. J.D.
3. E.M.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 4324/1 prot., datë 18.10.2024
1. D.B.
2. DH.G.
3. E.P.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
11,941,854 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
8,075,300 lekë
Fitues: BOE "I. & L." ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
3,866,554 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 05.11.2024
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 8 OE
b) Skualifikuar 4 OE
c) Kualifikuar 4 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 20.11.2024 (komunikimi i renditjes)
Data: 26.11.2024 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 05.12.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 11.12.2024
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 16.12.2024</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, Autoriteti Kontraktor (Bashkia Pogradec) ka aplikuar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për financimin e projektit, pjesë e procedures së prokurimit. Me shkresën nr. 6488/4 prot., datë 02.10.2024 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka miratuar aplikimin e Autoritetit Kontraktor (Bashkia Pogradec) për financimin e projektit.
-Ndërmarrja e Mirëmbajtjes, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion kanali*

ujitës rezervuari i Pusis-Gjollet, Leshnicë", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.
Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët/inxhinierët): *J.D., E.M.* dhe V.Ç.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 18.10.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), edhe pse në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", për një prej tyre, grupi i auditimit vlerëson se rezulton i paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.2, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: N.S - 9 A".*

Së pari, në lidhje me këtë kriter, konsatatohet se Njësia e Prokurimit nuk ka kryer një argumentim teknik në bazë të së cilit të konkludohej se **për cilin zë konkret të preventivit** kërkohet një licensë e caktuar. Në procesverbalin "*Për argumentimin e miratimin e kritereve*" citohet se "*Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit...*", por grupit të auditimit nuk i është paraqitur një analizë teknike konkrete (zërat dhe vlerat përkatëse).

Së dyti, kërkesa e AK në lidhje me pikën e licencës **N.S -9 A** (Punime strukturore speciale), konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se nuk ka të parashikuar lloje të punimeve të përfshira në përkufizimin e licencës N.S-9. Në rastin konkret, sipas VKM-së Nr. 42, datë 16.01.2008, licensa N.S-9 konsiderohet për punime: "*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratori nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve*". Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Si konkluzion, njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteri i sipërcituar dhe mungesa e argumentimit të tij mund të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës.

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** B.Ç., *J.D.* dhe *E.M.*, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 20.11.2024 njoftimin e klasifikimit, në datën 26.11.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 05.12.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"A." ShPK	8,476,600	Skualifikuar
2	"B." ShPK	8,879,200	Skualifikuar
3	"*A.*" ShPK	8,998,260	Kualifikuar
4	"*D.* " ShPK dhe "*N.* " ShPK	10,126,350	Kualifikuar
5	"*G.*" ShPK	(nuk ka ofertë)	Skualifikuar
6	**"*I.* & *L.* " ShPK**	**8,075,300**	**Kualifikuar/Fituesi**
7	"R." ShPK	10,241,050	Kualifikuar
8	"V.K." ShPK	11,709,350	Skualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 4 (katër) B/OE dhe skualifikuar 4 (katër) B/OE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"A." ShPK:*** *Nga verifikimi i kryer rezulton se: Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2.3.1 të DST (punët e ngjashme); Nuk nuk përmbush pikën 2.3.2 të DST (Licenca profesionale), pasi licenca e operatorit ofertues ka më pak se 50 % të kategorive të licencës të kërkuara.*
2. ***"B." ShPK:*** *Nga verifikimi i kryer rezulton se: nuk ka deklaruar disponueshmërinë e punonjësit të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë"; Nuk nuk përmbush pikën 2.3.2 të DST (Licenca profesionale), pasi licenca e operatorit ofertues ka më pak se 50 % të kategorive të licencës të kërkuara; Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar disponimin e certifikatave ISO.*
3. ***"G." ShPK:*** *Nga verifikimi i kryer rezulton se: nuk është paraqitur asnjë ofertë ekonomike si dhe mungon i gjithë dokumentacioni i kërkuar në DST.*
4. ***"V.K." ShPK:*** *Nga verifikimi i kryer rezulton se: nuk përmbush pikën 2.3.8 të DST (mjetet dhe makineritë), pasi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar se disponon dy Autoveteshkarkuese 7-10 ton, por ka deklaruar se diponon vetëm, një të tillë (me qera).*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 05.11.2024, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas hapave procedurialë të ndjekur për të arritur në vlerësimin e ofertës përfundimtare të shpallur fituese, ka mbajtur paraprakisht procesverbalin e datës 20.11.2024 (mbi ofertat anomalike, korrigjimet eventuale dhe vlerësimin e tyre), me të cilin, ndër të tjera, KVO-ja ka kërkuar nga BOE "*I.* & *L.*" ShPK, dorëzimin fizikisht, brenda 3 ditëve, të dokumentacionit shkresor provues.

-Në procesverbalin e datës 26.11.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues BOE "I. & L." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST dhe SPE*".

-Me shkresën nr. 4324/4 prot., datë 26.11.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 10.12.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.
-Me shkresën nr. 4324/5 prot., datë 10.12.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 4324/6 prot., datë 11.12.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesit e BOE, konkretisht "*I.* & *L.*" ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 4324/8 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 16.12.2024, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 05.11.2024, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 20.11.2024 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak dhe komunikimit të renditjes datë 26.11.2024) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer jashë afatit. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në përfundim, në lidhje me vonesën e konstatuar në vlerësim, **ngarkohen me përgjegjësi** z. D.B., z. DH.G. dhe z. *E.P.*, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

12- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rehabilitim skema ujitese "Rezervuari Bregu i Lëndinave, Çërravë**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rehabilitim skema ujitese "Rezervuari Bregu i Lëndinave, Çërravë*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur e thjeshtuar" REF-31036-11-26-2024 Urdhri nr. 4530/2 prot., datë 31.10.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 4530/1 prot., datë 30.10.2024 1. E.K. 2. *J.D.* 3. *E.M.*	**2. Njësia e Prokurimit** 1. E.K. 2. *J.D.* 3. *E.M.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 4530/3 prot., datë 31.10.2024 1. D.B. 2. DH.G. 3. *E.P.*

4. Fondi Limit (pa TVSh) 5,783,857 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 4,338,002 lekë Fitues: BOE "*A. & D.*" ShPK	**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 1,445,855 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 11.12.2024 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 1 muaj	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 **OE** b) Skualifikuar 1 **OE** c) Kualifikuar 3 **OE**
10. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;-Jo** **APP**–s'ka/ka**;-Jo** **KPP**-s'ka/ka;-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 12.12.2024 (komunikimi i renditjes) Data: 16.12.2024 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 24.12.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)	**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 27.12.2024 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 27.12.2024

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 409 prot., datë 02.10.2024 Ndërmarrja e Mirëmbajtjes ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rehabilitim skema ujitese "Rezervuari Bregu i Lëndinave, Çërravë*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët/inxhinierët): V.Ç., *J.D.* dhe *E.M.*

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 26.11.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*", me përjashtim të njërit prej tyre.

AK në lidhje me "Kapacitetin Teknik" dhe konkretisht në pikën 2.3.2, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:

-"*Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: N.P - 6 A".*

Kërkesa e AK në lidhje me pikën e licencës N.P -6 A (Diga dhe tunele hidroteknike), konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv), rezulton se nuk ka të parashikuar lloje të punimeve të përfshira në përkufizimin e licencës N.P-6. Në rastin konkret, sipas VKM-së Nr. 42, datë 16.01.2008, licensa N.P-6 konsiderohet për punime: "*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes. Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali*". Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Si konkluzion, sa më sipër, përveçse rezulton në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.05.2021 "*Për prokurimin publik*", ndikojn negativisht mbi konkurrencën, në kundërshtim me nenin 2 të LPP-së.

Në përfundim, në lidhje me veprimet apo mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** E.K., *J.D., E.M.*, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 12.12.2024 njoftimin e klasifikimit, në datën 16.12.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 24.12.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"B." ShPK	4,920,588	Kualifikuar
2	*"A."* & "D. C." ShPK	4,338,002	Kualifikuar/Fituesi
3	"N." ShPK	3,699,974	Skualifikuar
4	"R."ShPK	4,650,760	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 3 (tre) OE dhe skualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

> ***"N." ShPK:*** *Nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht: Nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës; Nuk ka paraqitur të gjitha mjetet e kërkuara.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 11.12.2024, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas hapave procedurialë të ndjekur për të arritur në vlerësimin e ofertës përfundimtare të shpallur fituese, ka mbajtur paraprakisht procesverbalin e datës 12.12.2024 (mbi ofertat anomalike, korrigjimet eventuale dhe vlerësimin e tyre), me të cilin, ndër të tjera, KVO-ja ka kërkuar nga BOE "*A.* & *D."* ShPK, dorëzimin fizikisht, brenda 3 ditëve, të dokumentacionit shkresor provues.

-Në procesverbalin e datës 16.12.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues BOE "A. & D.' ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST dhe SPE*".

-Me shkresën nr. 4530/9 prot., datë 16.12.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 24.12.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.

-Me shkresën nr. 4530/10 prot., datë 24.12.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 4530/12 prot., datë 27.12.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe vetëm përfaqësuesi i OE "A." ShPK.

Neni 88, pika 5 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 përcakton se: "*Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi*".
Si konkluzion, mungesa e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nga secili prej anëtarëve të BOE, eventualisht, në rast problematikash, sjell përjashtimin nga përgjegjësitë kontraktore të anëtarit që nuk ka nënshkruar kontratën.
Në përfundim, në lidhje me sa konstatuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Personi përgjegjës për prokurimin.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 27.12.2024, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, ka vepruar në përputhje me kërkesat e LPP-së.

13- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rehabilitimi i skarpateve të lumit të qytetit dhe kanalizimi i ujrave të zeza**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i skarpateve të lumit të qytetit dhe kanalizimi i ujrave të zeza".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"
REF-21953-09-27-2024
Urdhri nr. 3869/2 prot. datë 25.09.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 3869/1. prot., datë 23.09.2024
1. K.L.
2. V.Ç.
3. A.I.</td><td>2. Njësia e Prokurimit

1. K.L.
2. V.Ç.
3. A.I.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 3869/3 prot., datë 25.09.2024
1. D.B.
2. B.Ç.
3. S.K.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
6,666,666 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
4,650,350 lekë
Fitues: OE "I."ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
2,016,316 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 11.10.2024</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE
b) Skualifikuar 0 OE
c) Kualifikuar 4 OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 muaj</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 18.10.2024 (komunikimi i renditjes)
Data: 29.10.2024 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 12.11.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 25.11.2024
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 27.11.2024</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.
Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:
Së pari, me shkresën nr. 3869 prot., datë 18.09.2024 D.P.ZH.T. ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rehabilitimi i skarpateve të lumit të qytetit dhe kanalizimi i ujrave të zeza*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit, i cili ka marrë edhe miratimin e titullarit të Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes, është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët/inxhinierët): V.Ç., *F.K.* dhe *M.T.* (ark.).

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 27.09.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi apo për pjesën më të madhe, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 18.10.2024 njoftimin e klasifikimit, në datën 29.10.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 12.11.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"I." ShPK	4,650,350	Kualifikuar/Fituesi
2	"A." ShPK	4,695,954	Kualifikuar
3	"A." ShPK	4,762,830	Kualifikuar
4	"B." ShPK	5,677,150	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 4 (katër) B/OE dhe mos skualifikuar asnjërin prej tyre.

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 11.10.2024, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas hapave procedurialë të ndjekur për të arritur në vlerësimin e ofertës përfundimtare të shpallur fituese, ka mbajtur paraprakisht procesverbalin e datës 18.10.2024 (mbi ofertat anomalike, korrigjimet eventuale dhe vlerësimin e tyre), me të cilin, ndër të tjera, KVO-ja ka kërkuar nga OE "I." ShPK, dorëzimin fizikisht, brenda 3 ditëve, të dokumentacionit shkresor provues.

-Në procesverbalin e datës 25.10.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "I." ShPK dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST dhe SPE*".

-Me shkresën nr. 3869/10 prot., datë 29.10.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 12.11.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.
-Me shkresën nr. 3869/11 prot., datë 12.11.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 3869/12 prot., datë 25.11.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht I.ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit, nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 27.11.2024, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 11.10.2024, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 26.11.2024 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak datë 29.11.2024) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer jashë afatit. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në përfundim, në lidhje me vonesën e konstatuar në vlerësim, **ngarkohen me përgjegjësi** z. D.B., z. B.Ç. dhe z. *S.K.*, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

14- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Blerje Mjeti për zhvillimin e kanaleve Ujitëse (Eskavator)**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Blerje Mjeti për zhvillimin e kanaleve Ujitëse (Eskavator)*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-00345-04-05-2024 Urdhri nr. 1610 prot., datë 04.04.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (ST)** Urdhri nr. 1388/1 prot., datë 20.03.2024 1. *K.P.* 2. *J.D.* 3. *L.T.*	**2. Njësia e Prokurimit** Urdhri nr. 1388/2 prot., datë 20.03.2024 1. N.SH. 2. B.Ç. P.P. 3. *J.D.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 1610/2 prot., datë 05.04.2024 1. D.B. 2. E.B. 3. *E.M.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 7,327,692 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 7,250,000 lekë Fitues: OE "*T.G.*" ShPK		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 77,692 lekë

7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 18.04.2024 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 2 muaj	**8. Burimi Financimit** Grant nga Ambasada Japoneze	**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 **OE** b) Skualifikuar 2 **OE** c) Kualifikuar 1 **OE**
10. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;-PO** **APP–**s'ka/ka**;-Jo** **KPP**-s'ka/ka;**-PO**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 22.04.2024 (komunikimi i renditjes) Data: 29.04.2024 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 29.05.2024 (njoftimi përfundimtar i fituesit)	**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 05.06.2024 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 10.06.2024

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën "kërkesë" datë 06.04.2023 NMIPP ka kërkuar, nga Njësia e Koordinimit të Integrimit Europian dhe Ndihmës së Huaj, vlerësimin e mundësisë së aplikimit për financimin e blerjes së mjetit objekt procedure, duke parashtruar disa nga specifikimet teknike të mundshme referuar nevojave dhe terrenit. Në vijim të kërkesës dhe procedurave të ndjekura nga Autoriteti Kontraktor (Bashkia Pogradec) është siguruar granti nga Ambasada Japoneze për vlerën 71,420 euro.

-Në lidhje me Hartimin e Specifikimeve Teknike, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, procesverbali përkatës, i datës 01.04.2024, ka të përcaktuar në mënyrë rendore dhe variabile (me marzh) specifikimet teknike, të cilat, janë të shoqëruara me një argumentim ligjor por, edhe pse jo të ekzagjeruara, nuk shoqërohen me një argumentim teknik (*psh (për orientim): përse karburanti duhet të jetë naftë dhe jo i një lloji tjetër; Cila është arsyeja teknike që cilindrata/vëllimi duhet të jetë 4.2-4.8?!;*).

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se, mungesa e argumentimit teknik, rezulton në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 2, pika 2/c, ku përcaktohet se: "*Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit*" si dhe nenin 78, pika 2, ku përcaktohet se "*…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*".

Si konkluzion, për sa më sipër, hartimi i specifikimeve teknike pa një argumentim teknik, mund të krijojë konfuzion dhe papërshtatshmëri në ofertat eventuale të operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** *K.P., J.D.* dhe *L.T.*, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Specifikimeve Teknike.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 05.04.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit,

procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.
Grupi i auditimit ka konstatuar se, në dosjen e prokurimit nuk janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, konstatim për të cilin janë bërë cilësimet përkatëse hap pas hapi.
b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.
Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 22.04.2024 njoftimin e klasifikimit, në datën 29.04.2024 njoftimin paraprak dhe në datën 29.05.2024 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE ShPK***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"*A.*"	7,198,500	Skualifikuar
2	"*C.*"	7,227,000	Skualifikuar
3	"*T.G.*"	7,250,000	**Kualifikuar/Fituesi**

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 1 (një) OE dhe skualifikuar 2 (dy) OE me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"A." ShPK:*** *Operatori për kriterin autorizim/kontratë bashkëpunimi, ka paraqitur vërtetim përkthimi dhe jo vërtetim noterizimi (Njehsim me origjinalin); Nga ana e OE nuk është paraqitur asnjë dokument identifikues i mjetit (katalog/skede teknike/ librezë/ leje qarkullimi), që të dëshmojë origjinalitetin e tij, lidhjen e tij me prodhuesin; Mungon viti i prodhimit për mjetin e ofertuar;*
2. ***"C." ShPK:*** *Operatori për kriterin autorizim/kontratë bashkëpunimi, ka paraqitur vërtetim i cili nuk provon lidhjen me prodhuesin; Mungon viti i prodhimit për mjetin e ofertuar.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:
-Me procesverbalin e datës 18.04.2024 dhe atë të datës 19.04.2024, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "*T.* " ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin e datës 29.04.2024, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "T.G." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 1610/2 prot., datë 29.04.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Në datën 07.05.3024 pranë AK Bashki Pogradec, është protokolluar ankesa me nr. 1610/3 prot., e OE "*A.*" ShPK, ankesë e cila është paraqitur njëkohësisht edhe pranë KPP-së, me të cilën OE kundërshton arsyet e skualifikimit.
-Titullari i AK (Personi i Autorizuar), në datën 08.05.2024 ka marrë vendimin (urdhër) nr. 1610/3 prot., dhe nr. 1610/5 prot., datë 13.05.2024 me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedurës dhe ka caktuar Komisionin për Shqyrtimin e Ankesës (KSHA) të përbërë nga tre punonjës (z. *E.P.*, znj. *B.Ç.* dhe znj. E.K.).
-Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me ankimin, rezulton se, pas shqyrtimit, KSHA ka marrë vendim nr. 1610/6 prot., datë 13.05.2024 për mospranimin e tij. Venidmi i është komunikuar OE "*A.*" ShPK dhe KPP-së, brenda afateve ligjore, me shkresën nr. 1610/7 prot., datë 13.05.2024.
-Nga sa më sipër, procedurialisht, në lidhje me ankesën e paraqitur dhe shqyrtimin e saj, rezulton se titullari i AK dhe KSHA ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Gjithsesi, grupi i auditimit konstaton se, në lidhje me praktikën e shqyrtimit të ankesës, nga KSHA nuk janë administruar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi*** z. *E.P.*, znj. *B.Ç.* dhe znj. E.K., në cilësinë e anëtarëve të KSHA-së si dhe z. P.Z. në cilësinë e personit të autorizuar. Në lidhje me këtë të fundit, neni 21 pika 5 e LPP-së citon se: "*Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij...*".

-Nga ana tjetër, me shkresën nr. 1106/6 prot., datë 23.05.2024 (AK nr. 1610/8 prot., datë 27.05.2024) të KPP-së, AK është njohur me vendimin nr. 561/2024 datë 23.05.2024 të KPP-së, me të cilin, ndër të tjera, është vendosur: "*1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "A." ShPK. 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit*".

Në vijim të vendimit të sipërcituar, konstatohet se, AK ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore, me qëllim zbatimin e vendimit.

-Me shkresën nr. 578/16 prot., datë 14.12.2023 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, KVO-ja ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 28.05.2024, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK.

-Me shkresën nr. 1610/10 prot., datë 29.05.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e shit-blerjes nr. 1610/11 prot., datë 05.06.2024, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "*T.* " ShPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 1610/12 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 10.06.2024, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Për sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se KVO ka vepruar përgjithësisht në zbatim të LPP-së.

-Në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 1610/13 prot., datë 06.06.2024, Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" të përbërë nga z. *I.K.* , z. *A.A.*dhe z. *A.D.*

Komisioni i sipërcituar, me procesverbalin e datës 24.06.2024, ka marrë në dorrëzim objektin e kontratës duke e cilësuar atë si në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike.

Grupi i auditimit, edhe në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, në lidhje me praktikën e marrjes në dorëzim, nga komisioni përkatës nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi*** z. *I.K.*, z. *A.A.* dhe z. *A.D.*, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe z. P.Z., në cilësinë e personit të autorizuar.

15- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur mbi kufirin e lartë monetar"
REF-54224-07-10-2025
Urdhri nr. 2672 prot.,datë 09.07.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 4968/1 prot., datë 06.12.2024
1. B.K.
2. M.K.
3. N.SH.
4. G.H.
5. K.B.
-Ndryshuar me Urdhin nr. 4968/2 prot., datë 31.12.2024
1. B.K.
2. V.Ç.
3. N.SH.
4. S.K.
5. K.B.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
Urdhri nr. 2275 prot.,datë 12.06.2025
1. N.T.
2. K.I.
3. B.Ç.

-Ndryshuar me Urdhin nr. 2275/6 prot., datë 03.07.2025
1. N.T.
2. K.I.
3. K.L.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 2275/4 prot., datë 23.06.2025
1. D.B.
2. A.P.
3. E.B.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
436,332,183 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
429,917,129 lekë
Fitues: OE "R."ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
6,415,053 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 11.08.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 48 muaj</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit
Buxheti Bashkisë Pogradec</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 3 OE
b) Skualifikuar 2 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 15.08.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 27.08.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 09.09.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 22.09.2025
Minikontrata e parë data: 01.10.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 03.10.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 4968 prot., datë 06.12.2024 Drejtoria e Emergjencave Civile, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative*".

Me shkresën/urdhër nr. 4968/1 prot., datë 06.12.2024, ndryshuar me urdhin nr. 4968/2 prot., datë 31.12.2024 Titullari i AK ka ngritur grupin e punës "*Për përllogaritjen e kostos totale për menaxhimin e mbetjeve në qytetin e Pogradecit dhe Njësitë Administrative*".

Në zbatim të urdhrit të sipërcituar, grupi i punës ka përgatitur preventivët për Qytetin Pogradec dhe Njësitë Administrative, Specifikimet Teknike, Hartat për vendosjen e kontenierëve, fshirjen e rrugëve, larjen dhe lagien e shesheve, pastrimin e thelluar të lumenjve, mirëmbajtjen e rrugëve ditën si dhe relacionin përkatës, për të cilat ka marrë paraprakisht miratimin e Titullarit.

-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit/kostos totali, për hartimin e preventivit, komisioni, ndër të tjera, ka studiuar edhe ofertat e tregut, të marra nga OE të ndryshëm duke përllogaritur si fondit limit/kosto totale vlerën 523,598,619 lekë me TVSh.

Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021.

Përveç administrimit të ofertave, nga anëtarët e komisionit janë mbajtur procesverbalet përkatëse për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, në përputhje me nenin 2 të VKM-së nr. 258,

datë 19.05.2021 sipas të cilit "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".

-Në lidhje me Hartimin e Specifikimeve Teknike, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, komisioni ka përcaktuar në mënyrë rendore specifikimet, përgjithësisht në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 2, pika 2/c, ku përcaktohet se: "*Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit*".

Materiali i sipërcituar, me shkresën nr. 1867/1 prot., datë 12.05.2024, është përcjellë për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit Bashkiak. Ky i fundit, me vendimin nr. 46, datë 29.05.2025 "*Për miratimin e kryerjes së shërbimit me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësitë Administrative*", ndër të tjera, ka vendosur: "*Të miratojë koston e kryerjes së shërbimit me objekt: "Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetit të Pogradecit dhe Njësitë Administrative, për një periudhë 48 muajsh*".

Në vijim të sa më sipër, në kushtet e përcaktimit të llojit të Procedurës së Prokurimit si "E hapur mbi kufirin e lartë monetar", njësia e prokurimit, pas relacionit nr. 2275/1 prot., datë 12.06.2025, në zbatim të LPP-së, ka përgatitur DST në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 09.07.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, pas ndryshimeve të reflektuara nga sugjerimet e APP-së, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 15.08.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 27.08.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 09.09.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"R." ShPK	429,917,129	Kualifikuar/Fituesi
2	"*K.*" ShPK	433,466,606	Skualifikuar
3	"*A.*" ShPK	431,333,058	Skualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke skualifikuar 2 (dy) OE dhe kualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

> ***"K." ShPK:*** *OE nuk ka paraqitur "Sigurimin e Ofertës", sipas Shtojcës 3 të DST; Nga verifikimi në sistem, në vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korcë, e ngarkuar në sistem nga operatori ekonomik, rezulton se vlera e xhiros është më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit të kontratës; Ka deklaruar se disponon 4 copë, Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 5-7 ton, ndërkohë, që nga AK janë kërkuar 6 copë; Nuk ka deklaruar se disponon Traktor me goma per plugim, frezim dhe diskim te rërës, jo me pak se 40 kuaj fuqi, (në pronësi / me qira / porosi); Nuk ka deklaruar se disponon Eskavator per pastrimin e lumenjve, jo më pak se 1 (nje) copë, (në pronësi / me qira / porosi).*
>
> ***"A. " ShPK:*** *OE nuk ka paraqitur "Sigurimin e Ofertës", sipas Shtojcës 3 të DST; Ka deklaruar se disponon 4 (katër) Shoferë, ndërkohë që nga AK janë kërkuar 12 (dymbëdhjetë) Shoferë; Nuk ka deklaruar se disponon Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 10 deri ne 12 ton, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi); Nuk ka deklaruar se disponon Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 5-7 ton, jo më pak se 6 (gjashte) copë, (në pronësi / me qira / porosi); Nuk ka deklaruar se disponon Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi); Nuk ka deklaruar se disponon Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës/fryrës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 1 (nje) copë, (në pronësi / me qira / porosi); Nuk ka deklaruar se disponon Traktor me goma per plugim, frezim dhe diskim te rërës, jo me pak se 40 kuaj fuqi, (në pronësi / me qira / porosi); Nuk ka deklaruar se disponon Eskavator per pastrimin e lumenjve, jo më pak se 1 (nje) copë, (në pronësi / me qira / porosi).*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 11.08.2025, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Me procesverbalin e datës 15.08.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE R.ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 25.08.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 19.08.2025 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "R." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 2672/6 prot., datë 28.08.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 11.09.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.

-Me shkresën nr. 2672/7 prot., datë 11.09.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm".

-Konstatohet se Marrëveshja Kuadër nr. 2672/8 prot., datë 22.09.2025, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "R." ShPK.

-Me shkresën nr. 2672/10 prot., datë 23.09.2025 "Urdhër", është krijuar komisioni "Për monitorimin e zbatimit të kushteve të kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimit" me përbërje: z. *B.K.*, z. *L.B.* dhe z. *E.Ç*. Gjithashtu, me shkresën nr. 2672/11 prot., datë

26.09.2025 "Urdhër", është krijuar komisioni "Për hartimin dhe administrimin e procesverbaleve ditore mbi kryerjen e shërbimit të kontratës".
Grupi i auditimit konstaton se, në lidhje me anëtarët e komisionit të sipërcituar, nuk janë administruar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi:*** (anëtarët e komisioneve) si dhe z. P.Z. në cilësinë e personit të autorizuar. Në lidhje me këtë të fundit, neni 21 pika 5 e LPP-së citon se: "*Të gjitha proceset e parashikuara në këtë nen zhvillohen nën mbikëqyrjen e titullarit të autoritetit kontraktor ose personit të autorizuar prej tij...".*
Në lidhje me nënshkrimin e minikontratave konstatohet se:
AK ka dërguar pranë OE ftesën për ofertë nr. 2672/13 prot., datë 26.09.2025 duke kërkuar fillimisht shërbimin për 3 muaj (Tetor-Nëntor-Dhjetor 2025).
Me shkresën nr. 2672/14 prot., datë 30.09.2025, OE ka dërguar pranë AK ofertën përkatës me vlerë 26,961,993 lekë pa TVSh duke bashkëlidhur gjithashtu edhe sigurimin përkatës.
Nga komisioni i monitorimit dhe supervizimit, në lidhje me ofertën e paraqitur, është përgatitur relacioni (procesverbali) nr. 2672/15 prot., datë 01.10.2025 drejtuar Titullarit të AK, në të cilin, ndër të tjera, citohet se: "*Nga verifikimet e kryera nga komisioni rezulton se oferta e paraqitur me volumet përkatëse si dhe çmimet e ofertuara në ofertën e marrëveshjes kuadër, përputhen me çmimet e ofertës fituese*". Në vijim, midis palëve, është nënshkruar kontrata e shërbimit nr. 1, nr. 2672/16 prot., datë 01.10.2025.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 2672/17 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 03.10.2025 brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Në zbatim të kontratës së sipërcituar dhe të kërkesave të LPP-së është hartuar "Plani i Zbatimit të Kontratës" nr. 2672/18 prot., datë 10.10.2025.
Në vijim, AK ka dërguar pranë OE ftesën për ofertë nr. 2672/22 prot., datë 24.02.2025 duke kërkuar shërbimin për 3 muaj (Janar-Shkurt-Mars 2026).
Me shkresën nr. 2672/23 prot., datë 30.12.2025, OE ka dërguar pranë AK ofertën përkatës me vlerë 27,984,144 lekë pa TVSh duke bashkëlidhur gjithashtu edhe sigurimin përkatës.
Nga komisioni i monitorimit dhe supervizimit, në lidhje me ofertën e paraqitur, është përgatitur relacioni (procesverbali) nr. 2672/24 prot., datë 30.12.2025 drejtuar Titullarit të AK, në të cilin, ndër të tjera, citohet se: "*Nga verifikimet e kryera nga komisioni rezulton se oferta e paraqitur me volumet përkatëse si dhe çmimet e ofertuara në ofertën e marrëveshjes kuadër, përputhen me çmimet e ofertës fituese*". Në vijim, midis palëve, është nënshkruar kontrata e shërbimit nr. 2, nr. 2672/25 prot., datë 31.12.2025.

16- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Rehabilitim dhe ambiente shtesë, kopshti "Liri Çomo", Pogradec**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Rehabilitim dhe ambiente shtesë, kopshti "Liri Çomo", Pogradec*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur" REF-58806-08-22-2025 Urdhri nr. 3121/2 prot. Datë 14.08.2025	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)** Urdhri nr. 3121/1 prot., datë 13.08.2025 1.E.K. 2.K.I. 3.*M.Ç.*	**2. Njësia e Prokurimit** 1.E.K. 2.K.I. 3.*M.Ç.* Ndryshuar me urdhrin Nr. 3121/5 datë 08.09.2025 1.B.Ç. 2.K.I. 3.*M.Ç.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr. 3121/4 prot., datë 14.08.2025 1. D.B. 2. *A.A.* 3. A.L.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 34,169,003 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 26,353,427 lekë Fitues: BOE "*A.* & *R.*" ShPK		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 7,815,575 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 09.09.2025 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 6 muaj	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit Buxheti Bashkisë Pogradec		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 **OE** b) Skualifikuar 2 **OE** c) Kualifikuar 3 **OE**
10. Ankimime **AK**-s'ka/ka**;-Jo** **APP**–s'ka/ka**;-Jo** **KPP**-s'ka/ka;-**Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 19.09.2025 (komunikimi i renditjes) Data: 01.10.2025 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 09.10.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)		**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 16.10.2023 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 05.11.2025

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, Autoriteti Kontraktor (Bashkia Pogradec) ka aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për financimin e projektit "*Rehabilitim dhe ambiente shtesë, kopshti "Liri Çomo", Pogradec*". Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën nr. 2174/2 prot., datë 05.04.2025, ka miratuar dhe shpallur fitues projektin e propozuar nga Bashkia Pogradec.
Me shkresën nr. 719/6 prot., datë 25.06.2025 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rehabilitim dhe ambiente shtesë, kopshti "Liri Çomo", Pogradec*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 21.08.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurave të sipërcituara, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila, ndër të tjera, përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.
Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, kërkohet që, për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.
Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e

Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.
Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.
Për sa më sipër, AK (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.
Në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës për prokurimin.
Në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 19.09.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 01.10.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 09.10.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"C." ShPK	33,544,082	*Kualifikuar*
2	"I." ShPK	27,270,593	*Kualifikuar*
3	"*I.*" & "*N.*" ShPK	26,827,563	*Skualifikuar*
4	"A. & R." ShPK	26,353,427	*Kualifikuar/Fituesi*
5	"*L.*" & "I".& "*J.* "	23,213,139	*Skualifikuar*

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 3 (tre) OE dhe skualifikuar 2 (dy) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"I." & "N." ShPK:*** *BOE ka paraqitur Sigurimin e ofertës vetem në emër të një operatori; Mungon një manovrator; Nënkontraktimi i paraqitur nga operatori ekonomik "N." (për punë të ngjashme) nuk është lidhur konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik duke e cilësuar kështu si të pavlefshëm; Ka deklaruar se disponon kamiocinë me kapacitet mbajetës 3.5 deri në 7 ton ndërkohë që AK, në këtë kriter ka kërkuar disponimin e një kamioni me vinç me kapacitet mbartës 3.5 deri në 7 ton.*
2. ***"L." & "I.& J. " ShPK:*** *Operatori ekonomik ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:
-Me procesverbalin e datës 09.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".
-Me procesverbalin e datës 19.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga BOE "*A. & R."* ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin e datës 29.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 22.09.2025 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues BOE "A. & R." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 3121/7 prot., datë 01.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 09.10.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.
-Me shkresën nr. 3121/8 prot., datë 01.10.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 3121/10 prot., datë 16.10.2025, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesit e BOE, konkretisht "*A. & R."* ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, **grupi i auditimit konstaton se**, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 3121/11 prot., datë 16.10.2025), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 05.11.2023 ose jashtë afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".
Në lidhje me mosveprimin e konstatuar më sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës.
Në vijim, në zbatim të LPP-së, nga Titullari i AK është nxjerrë urdhri i monitorimit të zbatimit të kontratës nr. 3121/12 prot., datë 20.10.2025 si dhe "Plani i Zbatimit të Kontratës" nr. 3121/14 prot., datë 28.10.2025.
Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të oferatave është hapur në datën 09.09.2025, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 24.09.2025 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit (paraprak) dhe SPE, rezulton se vlerësimi i ofertave dhe njoftimi përkatës është kryer në datën 01.10.2025 ose jashë afatit të përcaktuar. Në lidhje me shkeljen e afatit të vlerësimit nga KVO-ja, në dosjen e prokurimit nuk rezulton të ketë një justifikim ligjor, i cili të përmbajë një nga arsyet e përcaktuara në nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 sipas të cilit: "*Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë...15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*".
Në përfundim, në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** z. D.B., znj. *A.A.* dhe z. A.L., në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.
17- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Blerje mjeti makinë borëpastruese**"*, si vijon:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Blerje mjeti makinë borëpastruese*".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "E hapur e thjeshtuar" REF-59904-09-01-2025 Urdhri nr. 3247 prot., datë 27.08.2025	**1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (ST)** Urdhri nr. 2111/2 prot., datë 23.06.2025 1. *V.M.* 2. N.SH. 3. *M.I.*	**2. Njësia e Prokurimit** Urdhri nr.2111/8 prot., date 30.07.2025 1. *I. B.* 2. N.SH. 3. *V.M.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhri nr.3247/2 prot., datë 27.08.2025 1. D.B. 2. B.Ç. 3. A.I.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 7,400,000 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 7,284,000 lekë Fitues: OE "*S.A".* "P.F."		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 116,000 lekë
7/1. Data e hapjes së tenderit: Data 12.09.2025 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 30 ditë	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 **OE** b) Skualifikuar 0 **OE** c) Kualifikuar 1 **OE**
10. Ankimime **AK-s'ka;-Jo** **APP–ka;- Jo** **KPP-s'ka;-Jo**	**11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (*nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE*):** Data: 16.09.2025 (komunikimi i renditjes) Data: 19.09.2025 (njoftimi paraprak i fituesit) Data: 22.09.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)		**12. Data e lidhjes së kontratës:** Data: 01.10.2025 **12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):** Data: 03.10.2025

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 4542/1 prot., datë 18.11.2024 Autoriteti Kontraktor (Bashkia Pogradec) ka aplikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për financimin e projektit "Blerje mjeti makinë borëpastruese". Me shkresën nr. 1016/1 prot., datë 27.05.2025 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka miratuar aplikimin e Autoritetit Kontraktor (Bashkia Pogradec) për financim.

Grupi i auditimit ka konstatuar se kjo procedurë është shpallur fillimisht nga AK dhe më pas, me vendimin e Titullarit nr. 2111/12 prot., datë 18.08.2025, është anuluar për shkak të mungesës së ofertave. Në zbatim të vendimit të sipërcituar, nga njësia e prokurimit, janë analizuar shkaqet dhe me procesverbalin e datës 25.08.2025 është arritur në përfundimin se anulimi ka ardhur nga shkaqe të pavarura nga AK dhe se i njëjti dokumentacion, i vlerësuar konform rregullave të prokurimit dhe LPP-së, do të përdoret për rihapjen e procedurës.

Së dyti, me shkresën nr. 2111/1 prot., datë 23.06.2025 Drejtoria e Emergjencave Civile, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje mjeti makinë borëpastruese".

Me urdhrin e Titullarit nr. 2111/2 prot., datë 23.06.2025, është nrgitur grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit, specifikimeve teknike si dhe kushteve të veçanta të kualifikimit (KVK), me përbërje: z. *V.M.*, z. N.SH. dhe z. *M.I.*

-Në lidhje me përllogaritjen e vlerës së fondit limit, për hartimin e preventivit komisioni ka studiuar ofertat e tregut, të marra nga 3 OE të ndryshëm ("*C.*" ShPK, "S.&C.C." ShPK dhe "T.L." ShPK) duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare të përafërt të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë 7,400,000 lekë pa TVSh.

Theksojmë se mënyrat në lidhje me përllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021.

Përveç administrimit të ofertave, nga anëtarët e komisionit është mbajtur procesverbali nr. 2111/7 prot., datë 17.07.2025 për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, në përputhje me nenin 2 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 sipas të cilit "*Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera*".

-Në lidhje me Hartimin e Specifikimeve Teknike, nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, procesverbali përkatës nr. 2111/3 prot., datë 07.07.2025, ka të përcaktuar në mënyrë rendore dhe variabile (me marzh) specifikimet teknike, të cilat, janë të

shoqëruara me një argumentim ligjor por, edhe pse jo të ekzagjeruara, nuk shoqërohen me një argumentim teknik (*p.sh. për orientim: përse jo më i vjetër se 2015, Kabina me ekip, Standarti Euro 5?!*).
Për sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se, mungesa e argumentimit teknik, rezulton në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 2, pika 2/c, ku përcaktohet se: "*Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit*" si dhe nenin 78, pika 2, ku përcaktohet se "*…Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht_dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*".
Si konkluzion, për sa më sipër, hartimi i specifikimeve teknike pa një argumentim teknik, mund të krijojë konfuzion dhe papërshtatshmëri në ofertat eventuale të operatorëve ekonomikë.
Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me LPP, **ngarkohen me përgjegjësi:** *V.M.*, N.SH. dhe *M.I.* , në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Specifikimeve Teknike.
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e kritereve të kualifikimit*" të datës 01.09.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, pas modifikimit të tyre, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila, ndër të tjera, përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.
Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, kërkohet që, për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.
Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.
Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.
Për sa më sipër, AK (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.
Në lidhje me mosveprimin, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës për prokurimin.

Në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, deklaratat e anëtarëve të komisioneve (NjP dhe KVO) mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 16.09.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 19.09.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 22.09.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	*"S.A.* P.F."	7,284,000	**Kualifikuar/Fituesi**

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 12.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar OE të vetëm pjesëmarrës në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Me procesverbalin e datës 15.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka konstatuar devijime për operatorin ekonomik "*S.A"*. P.F., konkretisht si vijon:

KVO-ja, ka konstatuar se OE, edhe pse në shtojcën nr. 9 ka deklaruar se i përmbush specifikimet teknike, nuk ka paraqitur në SPE "*Katalog /Skedë teknike /Librezë /Leje qarkullimi, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Llojin e mjetit, marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij)*". Nisur edhe nga fakti se në procedurën e prokurimit ka qenë vetëm një OE pjesëmarrës, KVO-ja ka vendosur të kërkojë, në SPE, sqarime mbi devijimin e konstatuar.

Në lidhje me kërkesën e KVO-së, konstatohet se OE ka ngarkuar në sistem (SPE) librezën e qarkullimit të mjetit të propozuar në të cilën pasqyrohen specifikimet teknike.

Në kushtet si më sipër, në lidhje me këtë situatë, neni 92 pika 1 e LPP-së përcakton se: "*Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave...*".

-Më pas, me procesverbalin e datës 16.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivin e ofertuesit me qëllim korrigjimin eventual të tij, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta, ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "*S.A.* P.F.", dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 19.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "S.A". "P.F.", dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 3247/5 prot., datë 19.09.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, KVO-ja ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 23.09.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari i AK datë 24.09.2025.

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e shit-blerjes nr. 3247/6 prot., datë 01.10.2025, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht " *S.A."* ShPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 3247/7 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 03.10.2025, brenda afatit të përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti*

kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar".

Së treti, në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 3247/8 prot., datë 07.10.2025, Titullari i AK ka ngritur "Komisoinin për marrjen në dorëzim të mallit" të përbërë nga z. *V.M.*, z. *K.P.* dhe z. *M.I.*

Komisioni i sipërcituar, me procesverbalin nr. 3247/10 prot., datë 17.10.2025, ka marrë në dorrëzim objektin e kontratës duke e cilësuar atë si në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike.

Grupi i auditimit, në këtë pjesë të procedurës së prokurimit, konstaton se, në lidhje me praktikën e marrjes në dorëzim, nga komisioni përkatës nuk janë administruar apo plotësuar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, ashtu sikundër kërkohet nga VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*". Në lidhje me këtë situatë ***ngarkohet me përgjegjësi*** z. *V.M.*, z. *K.P.*, z. *M.I.* , në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim si dhe z. P.Z., në cilësinë e personit të autorizuar.

18- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt:*"**Ndërtim mure mbajtëse në fshatin Rrodokal i Sipërm**"*, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim mure mbajtëse në fshatin Rrodokal i Sipërm".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"
REF-47488-05-09-2025,
Urdhri nr. 1835/2 prot., datë 08.05.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 1835/1 prot., datë 08.05.2025
1. B.Ç.
2. K.I.
3. A.I.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. B.Ç.
2. K.I.
3. A.I.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 1835/4 prot., datë 09.05.2025
1. D.B.
2. A.L.
3. K.L.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
7,499,712 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
5,118,844 lekë
Fitues: OE " I." ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
2,380,867 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 22.05.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 7 javë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 7 OE
b) Skualifikuar 2 OE
c) Kualifikuar 5 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 29.05.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 05.06.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 18.06.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 25.06.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 30.06.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 1835 prot., datë 08.05.2025 Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Ndërtim mure mbajtëse në fshatin Rrodokal i Sipërm*", për të cilën ka përgatitur paraprakisht projekt-preventivin, grafikun e punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Projekt-preventivi në lidhje me objektin e prokurimit është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-zbatimi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ing. A.L.dhe Ing. K.I..
Referuar formimit profesional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, konstatohet se asnjë nga punonjësit e sipërcituar nuk është e pajisur me licencë projektimit. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*
Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".
Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.
Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit (anëtarët e paliçensuar).
AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":
-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 09.05.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".
AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurave të sipërcituara, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila, ndër të tjera, përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.
Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, kërkohet që, për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.
Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.
Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.

Për sa më sipër, AK (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.
Në lidhje me mosveprimin ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës për prokurimin.
Në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 29.05.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 05.06.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 18.06.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"*I.*"	5,118,844	Kualifikuar/Fituesi
2	"A." & "D. C."	6,301,462	Kualifikuar
3	"*A.*"	(nuk ka paraqitur ofertë)	Skualifikuar
4	"*D.*"	6,101,368	Kualifikuar
5	"*K.*"	6,418,683	Kualifikuar
6	*"R."*	6,988,486	Skualifikuar
7	"*R.* "	5,497,988	Kualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke kualifikuar 5 (pesë) OE dhe skualifikuar 2 (dy) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"A." ShPK:*** *Nuk është paraqitur asnjë ofertë ekonomike dhe as dokumentacioni i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST.*
2. ***"R." ShPK:*** *OE nuk ka deklaruar në Shtojcën 8 (Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit) se disponon 8 (tetë) specialistë ndërtimi dhe 1 (një) teknik ndërtimi, ashtu siç kërkohen në pikën 2.3.4 të DT, por ka deklaruar se disponon 8 (tetë) teknik ndërtimi dhe asnjë specialist ndërtimi.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:
-Me procesverbalin e datës 22.05.2025, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".
-Me procesverbalin e datës 29.05.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "I." ShPK, i renditur i pari, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.
-Në procesverbalin e datës 04.06.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 03.06.2025 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "I."ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".
-Me shkresën nr. 1835/6 prot., datë 05.06.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".
-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 18.06.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.
-Me shkresën nr. 1835/8 prot., datë 18.06.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konstatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 1835/9 prot., datë 25.06.2025, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht "I."ShPK.

Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 1835/11 prot., datë 30.06.2025), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 30.06.2025 duke respektuar afatin e përcaktuar. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, neni 86 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 citon se: "*Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar*".

Në vijim, në zbatim të LPP-së, nga Titullari i AK është nxjerrë urdhri për monitorimin e zbatimit të kontratës nr. 1835/10 prot., datë 25.06.2025.

Së treti, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, grupi i auditimit vlerëson se KVO-ja ka vepruar përgjithësisht në zbatim të LPP-së, me përjashtim të faktit se, në mënyrë të gabuar (automatikisht ose menjëherë), ka skualifikuar një nga shoqëritë pjesëmarrëse në garë, edhe pse kjo e fundit ka ofertuar me vlerë më të lartë dhe gjithsesi nuk do të rezultonte fituese.

Konkretisht, në lidhje me skualifikimin e OE "R." ShPK, KVO-ja ka arsyetuar/"argumentuar" se: "*OE nuk ka deklaruar në Shtojcën 8 (Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit) se disponon 8 (tetë) specialistë ndërtimi dhe 1 (një) teknik ndërtimi, ashtu siç kërkohen në pikën 2.3.4 të DT, por ka deklaruar se disponon 8 (tetë) teknik ndërtimi dhe asnjë specialist ndërtimi*".

Ky arsyetim i KVO-së nuk është i plotë dhe i saktë, pasi, është e vërtetë që, OE ofertues ka kryer vetëdeklarimin sikundër citohet në njoftim, por në formularin e vetëdeklarimit ka vendosur emrat e secilit punonjës, profesioni i të cilëve, në kohën e ofertimit, është i "identifikueshëm".

Vlen të theksohet fakti se, pika 1 e nenit 92, të ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", për një vlerësim sa më të drejtë të ofertave, i jep të drejtën KVO-së për të kërkuar sqarime nga ofertuesit për ofertat e tyre.

Vlerësimi i përmbushjes së kriterit të sipërcituar, për rastin konkret, është bërë duke mos konsideruar faktin se, në funksion të qëllimit të ligjit, për sa i përket fazës së vlerësimit të ofertave, LPP parashikon instrumentin/mekanizmin e përcaktuar në nenin 92 pika 4 sipas të cilit: "*oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit*".

Grupi i auditimit vlerëson se, në kushtet si më sipër, KVO-ja përpara skualifikimit të menjëhershëm, duhet të kërkonte fillimisht sqarime nga operatori dhe, më pas, në qoftë se devijimi do të qëndronte të vijonte me skualifikimin. Në lidhje me këtë situatë, neni 92 pika 1 e LPP-së përcakton se: "*Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave...*".

Nga intervistat e kryera me anëtarë të KVO-së, këta të fundit kanë sqaruar se, edhe pse devijimi konsiderohet si "devijim i vogël", mungesa e kërkesës për sqarim ka ndodhur për shkak të faktit apo vlerësimit se, së pari OE "R." ShPK ka ofertuar me vlerën më të lartë dhe gjithsesi nuk do të rezultonte fitues, së dyti, kërkesa për sqarim si dhe përgjigjia në rastin konkret do të zgjasnin afatet e vlerësimit në mënyrë jo efektive.

Në lidhje me mosveprimet e konstatuara më sipër, **ngarkohen me përgjegjësi** z. D.B., z. A.L.dhe *K.L.*, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

19- Dokumentacioni në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *"**Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale**"*, si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", etj., konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<table>
<tr><td colspan="4">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale".</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"E hapur e thjeshtuar"
REF-42532-03-26-2025
Urdhri nr. 695/3 prot., datë 20.03.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të kritereve kualifikuese (DST)
Urdhri nr. 695/2 prot., datë 13.03.2025
1. K.I.
2. J.GJ.
3. K.L.</td><td>2. Njësia e Prokurimit
1. K.I.
2. J.GJ.
3. K.L.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhri nr. 4918/4 prot., datë 05.12.2023
1. D.B.
2. A.L.
3. B.Ç.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
3,886,722 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
3,127,138 lekë
Fitues: OE "R."ShPK</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
759,584 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1. Data e hapjes së tenderit:
Data 07.04.2025
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 javë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i UNICEF</td><td>9. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender Numër 5 OE
b) Skualifikuar 4 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>10. Ankimime
AK-s'ka/ka;-Jo
APP–s'ka/ka;-Jo
KPP-s'ka/ka;-Jo</td><td colspan="2">11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit/vlerësimit (nga AK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE)):
Data: 09.04.2025 (komunikimi i renditjes)
Data: 24.04.2025 (njoftimi paraprak i fituesit)
Data: 02.05.2025 (njoftimi përfundimtar i fituesit)</td><td>12. Data e lidhjes së kontratës:
Data: 12.05.2025
12/1. Data e njoftimit të lidhjes (në SPE):
Data: 19.05.2025</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:

Së pari, me shkresën nr. 695/1 prot., datë 03.03.2025 Njësia e Integrimit Europian, ka kërkuar nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike Juridike, realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale*", për të cilën është përgatitur paraprakisht projekt-preventivi, grafiku i punimeve, specifikimet teknike dhe relacionin përkatës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekt-preventivi është punuar nga punonjësit (specialistët): Ark. M.T., Ing. K.I.

Referuar formimit professional si dhe dosjeve personale të secilit punonjës, nuk konstatohet të jenë pajisur me licencën e projektimit. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5, sipas të cilit: "*Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.*

Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit".

Si konkluzion, pavarësisht qëllimit të institucionit për shmangien e shpenzimeve, grupi i auditimit vlerëson se, hartimi i projektit të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse përbën një risk të shtuar për realizimin e projekteve në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit si dhe kushtet teknike të zbatimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, **ngarkohet me përgjegjësi:** grupi i hartimit të projektit (anëtarët e paliçensuar).

AK (NjP), në lidhje me "Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kritereve për kualifikim":

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" të datës 26.03.2025 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), në përgjithësi, kanë të argumentuar vendosjen e kritereve për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me "Administrimin e Dokumentacionit":

Referuar procedurës së sipërcituar, konstatohet se dosja fizike e prokurimit, e cila, ndër të tjera, përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk është e pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes.

Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, kërkohet që, për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.

Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.

Për sa më sipër, AK (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor.

Në lidhje me mosveprimin, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës për prokurimin.

Në dosjen e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave, argumentimi i llojit të procedurës si dhe publikimet e nevojshme.

b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO-ja dhe lidhjen e kontratës.

Së pari, në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, në datën 09.04.2025 njoftimin e klasifikimit, në datën 24.04.2025 njoftimin paraprak dhe në datën 02.05.2025 njoftimin përfundimtar, duke pasqyruar klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Skualifikuar/ Kualifikuar***
1	"*Ç.*" ShPK	2,499,895	Skualifikuar
2	"R." ShPK	3,127,138	Kualifikuar/Fituesi
3	"I."ShPK	2,564,920	Skualifikuar
4	*"A.* & "*D."* ShPK	2,923,387	Skualifikuar
5	"*T.*" ShPK	3,449,515	Skualifikuar

Për sa më sipër, KVO-ja ka kryer vlerësimin në SPE, duke skualifikuar 4 (katër) OE dhe kualifikuar 1 (një) OE, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. ***"A. & D." ShPK:*** *BOE nuk përmbush pikën 2.3.4 dhe pikën 2.3.6 të kritereve të veçanta për kualifikim të DST-së. Ata kanë paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit, ku zotohen se shoqëria A. shpk do të përmbushë 60% të zërave të preventivit dhe shoqëria "D. shpk do të përmbushë 40% të zërave të preventivit. Nga verifikimi i Formularit të vetëdeklarimit "Shtojca 8", e paraqitur nga "D." shpk rezulton se operatori nuk ka deklaruar mbi disponimin e fuqisë punëtore dhe makinerive të nevojshme për përmbushjen me sukses të kontratës, në masën 40 % të deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit.*
2. ***"Ç." ShPK:*** *Nuk ka arritur te paraqesë të gjithëdokumentacionin e plotë dhe të saktë për të provuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim ashtu sic deklaron në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me DST-në; Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE "Ç." rezulton se në përmbushje të pikës 2.3.4 të kapacitetit teknik, OE ka paraqitur për specialistët e kërkuar (specialist ndertimi, pllakashtrues, suvatues, shtrues parketi dhe elektricist,) certifikata trajnimi të lëshuara nga Shoqëria "R/B" shpk me Nipt L.....P, e cila rezulton se nuk është e akredituar sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH" për ofrimin e kurseve profesionale për profesionët e mësipërme; OE nuk përmbush pikën 2.3.6 të kritereve të veçanta për kualifikim të DST-së, (Makineri dhe Pajisje), si një kamioncine deri në 3.5 ton dhe një Autovetëshkarkuese 3.5 deri në 7 ton.*
3. ***" I." ShPK:*** *Komisioni i vlerësimit të ofertave pas zbatimit të formulës së mësipërme, vë re se oferta e OE "I." shpk, me Nipt J.....M me vlerë prej 2 564 920 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa TVSh është anomalisht e ulët.*
4. ***"T." ShPK:*** *Nuk është arritur të paraqitet i gjithë dokumentacioni i plotë dhe i saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim siç kërkohen në DST. Konkretisht: OE nuk përmbush pikën 2.3.2 të kritereve të veçanta për kualifikim të DST-së (Licenca), pasi "T." shpk ka paraqitur Licencen e tij të shoqërisë por nuk janë ato të kërkuara nga AK përkatësisht mungon kategoria N.S – 14; Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk është deklaruar disponimi i 2 (dy) shtruesve të parketit.*

Së dyti, kronologjikisht, referuar procesverbaleve të mbajtur nga KVO-ja rezulton se:

-Me procesverbalin e datës 07.04.2025, ndër të tjera, KVO-ja, pasi ka evidentuar B/OE të cilët kanë marrë pjesë në garë, është shprehur se: "*Vlerësimi i ofertave do të vijojë individualisht në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i KVO-së*".

-Fillimisht me procesverbalin e datës 09.04.2025 dhe me pas me atë të datës 17.04.2025, ndër të tjera, KVO-ja, ka kontrolluar preventivat e ofertuesve me qëllim korrigjimin eventual të tyre, ka verifikuar ofertat anomalisht të ulëta, ka vlerësuar fillimisht ofertën e OE "*Ç.*" ShPK të cilin e ka skualifikuar dhe ka pasqyruar vlerësimin e paraqitur në tabelën e sipërcituar duke kërkuar nga OE "R." ShPK, dorëzimin fizikisht të dokumentacionit shkresor provues brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e kërkesës.

-Në procesverbalin e datës 24.04.2025, ndër të tjera, KVO-ja, në mënyrë të përmbledhur, shprehet se: "*KVO më datë 22.04.2024 mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues OE "R." ShPK, dhe nga verifikimi i dokumentacionit të noterizuar dhe origjinal të dorëzuar nga operatori rezultoi se dokumentacionet janë në përputhje me DST*".

-Me shkresën nr. 695/9 prot., datë 26.04.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)".

-Më pas, pasi KVO-ja nuk ka konstatuar ankime brenda afatit 7 (shtatë) ditor, ka hartuar Raportin Përmbledhës më datë 02.05.2025, për të cilin ka marrë edhe miratimin nga Titullari.

-Me shkresën nr. (pa numër) prot., datë 02.05.2025 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".
-Pas paraqitjes së sigurimit përkatës, konsatatohet se kontrata e sipërmarrjes nr. 695/9 prot., datë 12.05.2025, është nënshkruar nga Titullari i Bashkisë Pogradec dhe përfaqësuesi i OE, konkretisht " R." ShPK.
Në lidhje me këtë të fundit, grupi i auditimit konstaton se, dërgimi për publikim i "*Njoftimit të Lidhjes së Kontratës*", i cili administrohet në dosjen e prokurimit (nr. 695/15 prot.), nga Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës), referuar SPE, është kryer në datën 19.05.2023.

2.2.2. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, "Blerje me vlerë të vogël".
Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 870/1 prot., datë 11.09.2025, u shqyrtua dokumentacioni mbi procedurat e prokurimit ("blerje me vlerë të vogël") të zhvilluara dhe realizuara gjatë vitit 2023, 2024 dhe 2025, nga i cili u konstatua se:
Me urdhrin nr. 20, datë 16.01.2023, nga Autoriteti Kontraktor janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. *D.Ç.*dhe znj. *I. B.*, i ndryshuar, dhe në vend të znj. *D.Ç.* është caktuar z. *R.B.*
Me urdhrin nr. 98, datë 16.02.2023, nga Autoriteti Kontraktor (z. P.Z., person i autorizuar) janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, z. *R.B.* dhe znj. *I. B.*, i ndryshuar, në vend të znj. *D.Ç.*është caktuar znj. L.F. dhe në vend të znj. *I. B.* është caktuar z. *E.B.*.
Me urdhrin nr. 247, datë 29.05.2023, nga Nëpunësi i Autorizuar i AK (z. P.Z.) janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. L.F. dhe z. *E.B.*, i ndryshuar, dhe në vend të znj. L.F. është caktuar znj. E.K.
Me urdhrin nr. 682, datë 21.12.2023, nga Titullari i AK janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. E.K.dhe z. *E.B.*
Me urdhrin nr. 726, datë 29.12.2023, nga Titullari i AK janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. *D.Ç.*dhe znj. *T.B.*, i ndryshuar, dhe në vend të znj. *T.B.* është caktuar z. *E.B.*
Me urdhrin nr. 326, datë 07.08.2024, nga Nëpunësi i Autorizuar i AK (z. P.Z.) janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. *D.Ç.*dhe z. *E.B.*, i ndryshuar, dhe në vend të znj. *D.Ç.*është caktuar znj. E.K.
Me urdhrin nr. 541, datë 14.11.2024, nga Nëpunësi i Autorizuar i AK (z. P.Z.) janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. E.K. dhe z. *E.B.*
Me urdhrin nr. 653, datë 31.12.2024, nga Titullari i AK janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. *D.Ç.*dhe znj. *K.L.*, i ndryshuar, dhe në vend të znj. *K.L.* është caktuar znj. *I. B.*
Me urdhrin nr. 610, datë 20.11.2025, nga Titullari i AK janë përcaktuar personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", konkretisht: znj. *E.B.*, znj. *D.Ç.*dhe znj. *I. B.*
Grupi i auditimit, duke vlerësuar riskun si dhe duke ju referuar vlerës së procedurave, ka audituar për vitin 2023, 2024 dhe 2025 gjithësej 15 (pesëmbëdhjetë) procedura (5 për secilin vit) si vijon:
-Në lidhje me procedurat e audituara të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2023:
Të dhëna mbi objektin e prokurimit (1):

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Pjesë këmbimi"*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-73775-0-27-	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit (KBV)** 1. *E.B.*	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. L.F. 3. *E.B.*	**3.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. L.F. 3. *E.B.*

2023; Urdhri nr. 38 datë 27.06.2023	2. L.F. 3. *E.B.*		
4. Fondi Limit (pa TVSh) 459,570 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 384,000 lekë Fitues: *S.H.*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 75,570 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 29.06.2023	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Pogradec		**9. Operatoret Ekonomike** a) Pjesëmarrës në tender Numër **16 B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë			b) S'kualifikuar **14 B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 2561 prot., datë 22.06.2023 Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka kërkuar realizimin e procedurës së prokurimit me objekt: "Pjesë këmbimi".
Grupi për përllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike (komisioni BBV), në datën 26.06.2023, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar vlerën e fondit limit për procedurën, në vlerën 459,570 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 2561/1 prot., datë 27.06.2023.
Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 27.06.2023 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e ST dhe kritereve të kualifikimit*".
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 29.06.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE *S.A.* me vlerë oferte 384,000 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 30.06.2023, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues S.H., i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Me urdhër nr. 322 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim, i përbërë nga z. *V.M.*, z. *K.Ç.* dhe z. R. P.
Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim datë 12.07.2023 në lidhje me kontratën e furnizimit (fatura) nr. 244/2023, datë 12.07.2023.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (2):

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*Veshje pune për shërbimin zjarrfikës***"**			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-71177-05-31-2023; Urdhri nr. 29 datë 29.05.2023	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit** 1. *A.G.* 2. *G.M.* 3. *N.H.*	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. L.F. 3. *E.B.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. L.F. 3. *E.B.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 999,236 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 833,000 lekë Fitues: *G.S.*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 166,236 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 01.06.2023	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 26 **B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë			b) S'kualifikuar 1 **B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 1454 prot., datë 06.04.2023 nga Sektori i MZSH-së është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Veshje pune për shërbimin zjarrfikës".
Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, fondit limit dhe kritereve për kualifikim me përbërje: z. *A.G.*, z. *G.M.* dhe z. *N.H.*, në datën 30.05.2023, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike, kriteret për kualifikim dhe FL në vlerën 999 236

lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 29 prot., datë 29.05.2023.
Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 23.08.2023 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e ST dhe kritereve të kualifikimit*".
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 01.06.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt "Veshje pune për shërbimin zjarrfikës", duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "*G.S.*" me vlerë oferte 833,000 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 13.06.2023, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Me urdhër nr. 297 datë 15.06.2023 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim. Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim datë 22.06.2023 në lidhje me kontratën e furnizimit (fatura) nr. 31/2023, datë 22.06.2023.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (3):

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale për Policinë Bashkiake"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"Blerje me vlerë të vogël"; REF-72685-06-15-2023; Urdhri nr. 37 datë 14.06.2023</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit(KBV)
1. E.B.
2. L.F.
3. E.B.</td><td>2. Komisioni i BVV
1. E.B.
2. L.F.
3. E.B.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
1. E.B.
2. L.F.
3. E.B.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
408,333 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
348,600 lekë
Fitues: "S.H."</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 59,733 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 16.06.2023</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Bashkisë Pogradec</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender Numër 14 B/OE
b) S'kualifikuar 4 B/OE,</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 2340 prot., datë 07.06.2023 të Policisë Bashkiake është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje materiale për Policisë Bashkiake ".
Grupi i punës (KBV) për hartimin specifikimeve teknike, fondit limit dhe kritereve për kualifikim me përbërje: znj. *E.B.*, znj. L.F. dhe z. *E.B.*, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike, kriteret për kualifikim për procedurën dhe FL në vlerën 408,333 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 37 prot., datë 14.06.2023 dhe nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 14.06.2023 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e ST dhe kritereve të kualifikimit*".
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 16.06.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt "Blerje materiale për Policisë Bashkiake", duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE *S.A.* me vlerë oferte 348,600 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 17.06.2023, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Me urdhër nr. 301 datë 22.06.2023 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim nga i cili është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim datë 22.06.2023 në lidhje me kontratën e furnizimit (fatura) nr. 230/2023, datë 30.06.2023.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (4):

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Uniforma për Policinë Bashkiake"*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-62882-03-20-2023; Urdhri nr. 10 datë 15.03.2023	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit** 1. *K.Ç.* 2. *K.Ç.* 3. *B.L.*	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *I. B.*	**3.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. D. Ç. 3. *I. B.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 579,583 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 516,000 lekë Fitues: "*B.S."*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 63,583 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 21.03.2023	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Pogradec		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 19 **B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë			b) S'kualifikuar 3 **B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:

Me shkresën nr. 912 prot, datë 27.02.2023 të Policisë Bashkiake është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Uniforma për Policisë Bashkiake ".

Grupi i punës për hartimin specifikimeve teknike, fondit limit dhe kritereve, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike, kriteret dhe FL në vlerën 579,583 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.

Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 10 prot., datë 15.03.2023 dhe është hartuar "ftesa për ofertë" si dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*".

Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 21.03.2023, ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt "Uniforma për Policisë Bashkiake", duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "*B.S.*" me vlerë oferte 516,000 lekë (pa TVSh).

Në procesverbalin e datës 24.03.2023, ndër të tjera, KVO-ja shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".

Me urdhër nr. 154 datë 27.03.2023 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim nga i është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim datë 31.03.2023 në lidhje me kontratën e furnizimit (fatura) nr. 4/2023., datë 31.03.2023.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (5):

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Blerje fishekzjarre"*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-90722-12-12-2023; Urdhri nr. 88, datë 12.12.2023	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit(KBV)** 1. *E.B.* 2. L.F. 3. *E.B.*	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. L.F. 3. *E.B.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. L.F. 3. *E.B.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 812,633 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 782,500 lekë Fitues: "A."		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 30,133 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data13.12.2023	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Pogradec		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 9 **B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë			b) S'kualifikuar 1 **B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:

Me shkresën nr. 5015 prot., datë 27.02.2023 të Policisë Bashkiake është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje fishekzjarre".
Grupi i punës (KBV) për hartimin specifikimeve teknike, fondit limit dhe kritereve për kualifikim, në datën 12.12.2023, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike, kriteret dhe FL në vlerën 812,633 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 88 prot., datë 12.12.2023 si dhe është hartuar "ftesa për oferte" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*".
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 13.12.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt "Blerje fishekzjarre", duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "A." me vlerë oferte 782,500 lekë (pa TVSh).
Me urdhrin nr. 678 datë 20.12.2023 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim nga i cili është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim datë 29.12.2023, në lidhje me kontratën e furnizimit (fatura) nr. 113/2023, datë 31.12.2023.

-Në lidhje me procedurat e audituara të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2024:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (1):

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale të ndryshme që i shërbejnë veprimtarisë së strukturave të emergjencave civile"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"Blerje me vlerë të vogël"; REF-15934-08-12-2024; Urdhri nr.38 datë 08.08.2024</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit
1. M.Z.
2. A.I.
3. K.L.</td><td>2.Komisioni i BVV
1. E.B.
2. D.Ç.
3. E.B.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
1. E.B.
2. D.Ç.
3. E.B.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
892,000 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
792,000 lekë
Fitues: "T."</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 100,000 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data13.08.2024</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender Numër 25 B/OE
b) S'kualifikuar 17 B/OE,</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 5 ditë</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 3033 prot, datë 10.07.2024 të Drejtorisë të Emergjencave Civile, është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit.
Grupi i punës për hartimin specifikimeve teknike, fondit limit dhe kritereve për kualifikim me përbërje: znj. *M.Z.*, z. A.I. dhe z. *K.L.*, në datën 12.08.2024, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën, FL në vlerën 892,000 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 38 prot., datë 08.08.2024.
Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 08.08.2024 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e ST dhe kritereve të kualifikimit*".
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 13.08.2024 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "Blerje materiale të ndryshme që i shërbejnë veprimtarisë së strukturave të emergjencave civile", duke kryer vlerësimin sipas të

dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "*T.*" me vlerë oferte 792,000 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 16.08.2024, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 364/2024, datë 23.08.2024.
Me urdhër nr. 353 datë 19.08.2024 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim i përbërë nga znj. *M.Z.*, z. A.I. dhe z. *K.L.*. Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim datë 23.08.2024.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (2):

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Blerje pajisje topogjeodezike"*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-07471-05-30-2024; Urdhri nr. 21 datë 10.05.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit** 1. *F.K.*	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *T.B.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *T.B.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 750,000 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 739,500 lekë Fitues: "*A.*"		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 10,500 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: 31.05.2024	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 9 **B/OE** b) S'kualifikuar 3 **B/OE,**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë			

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 1241 prot, datë 12.03.2024 të Drejtorisë të Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje pajisje topogjeodezike".
Grupi i punës për hartimin specifikimeve teknike, fondit limit dhe kritereve për kualifikim, në datën 10.05.2024, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën, FL në vlerën 750,000 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 21 prot., datë 10.05.2024.
Nga njësia e prokurimit, në datën 08.08.2024 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*".
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 31.05.2024 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: *"Blerje pajisje topogjeodezike"*, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "*A.*" me vlerë oferte 739 500 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 06.06.2024, ndër të tjera, KVO-ja shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 47/2024, datë 19.06.2024.
Me urdhër nr. 250 datë 07.06.2024 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim nga i cili është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim datë 19.06.2024.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (3):

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Uniforma për Policinë Bashkiake"*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-97956-03-11-2024; Urdhri nr.7 datë 11.03.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit** 1. *M.H.* 2. *K.Ç.* 3. *B.L.*	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *T.B.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *T.B.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 820,805 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 590,000 lekë Fitues: "*G.S."*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 230,805 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: 31.05.2024 **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 10 ditë	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 19 **B/OE** b) S'kualifikuar 5 **B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:

Me shkresën nr.1050 prot, datë 12.03.2024 të Policisë Bashkiake, është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Uniforma për Policinë Bashkiake".

Me urdhrin nr. 98, datë 28.02.2024, nga titullari i AK është ngritur grupi i punës për hartimin specifikimeve teknike, fondit limit dhe kritereve për kualifikim. Grupi në fjalë, në datën 11.03.2024, ka mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën, në vlerën 820 805 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.

Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 7 prot., datë 11.03.2024.

Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 11.03.2024 është hartuar "ftesa për oferte" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*". Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 12.03.2024 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "Uniforma për Policinë Bashkiake*"*, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "*G.S.*" me vlerë oferte 590,000 lekë (pa TVSh).

Në procesverbalin e datës 19.03.2024, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues* "*G.S.", i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".

Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 6/2024, datë 02.04.2024.

Me urdhër nr. 98 datë 28.02.2024 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim nga i cili është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim datë 02.04.2024.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (4):

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Pajisje Informatike"*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-97435-03-05-2024; Urdhri nr.3 datë 13.02.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit (KBV)** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *T.B.*	**2 . Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *T.B.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. *D.Ç.* 3. *T.B.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 959,290 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 487,360 lekë Fitues: "*I.S."*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 471,930 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 06.03.2024	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës: Numër 33 **B/OE** b) S'kualifikuar:13 **B/OE,**

7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 5 ditë		

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 613 prot., datë 05.02.2024 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Pajisje Informatike".
Personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", në datën 12.02.2024, kanë mbajtur procesverbalin në të cilin kanë përcaktuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën, FL në vlerën 959,290 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh çmimet e botuara nga AKSH-I, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 3 prot., datë 13.02.2024.
Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 13.02.2024 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*". Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 06.03.2024 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "Pajisje Informatike*"*, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe ka shpallur fitues OE "*I.S.*" me vlerë oferte 487,360 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 19.03.2024, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Me urdhër nr. 120 datë 11.03.2024 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim i përbërë nga i cili është mbajtur procesverbali "për marrjen në dorëzim" datë 12.03.2024.
<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit (5):</u>

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Pajisje Informatike"*			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-33472-12-17-2024; Urdhri nr.75 datë 17.12.2024	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit(KBV)** 1. *E.B.* 2. *E.B.* 3. E.K.	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. *E.B.* 3. E.K.	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1. *E.B.* 2. *E.B.* 3. E.K.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 803,667 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 800,000 lekë Fitues: "*A."*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 3,667 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: 06.03.2024	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 8 **B/OE** b) S'kualifikuar 3 **B/OE,**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 31.12.2024			

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 5058 prot., datë 17.12.2024 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit.
Personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", në datën 12.02.2024, kanë mbajtur procesverbalin në të cilin kanë përcaktuar specifikimet teknike, kriteret për kualifikim për procedurën dhe FL në vlerën 803,667 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 75 prot., datë 17.12.2024.
Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 17.12.2024 është hartuar "ftesa për oferte" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*". Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 18.12.2024 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "Blerje fishekzjarre*"*,

duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe ka shpallur fitues OE "*A.*", me vlerë oferte 800,000 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 23.12.2024, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 97/2024, datë 31.12.2024.
Me urdhër nr. 627 datë 27.12.2024 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim, nga i cili është mbajtur procesverbali "për marrjen në dorëzim" në datën 31.12.2024.

-Në lidhje me procedurat e audituara të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2025:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (1):

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Kancelari"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"Blerje me vlerë të vogël";
REF-54276-07-10-2025;
Urdhri nr. 34,
datë 26.06.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit (KBV)
1. E.B.
2. K.L.
3. D.Ç.</td><td>2. Komisioni i BVV
1. E.B.
2. K.L.
3. D.Ç.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
1. E.B.
2. K.L.
3. D.Ç.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
607,506 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
312,499.50 lekë
Fitues: "I.O."</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
295,007 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit: 06.03.2024
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 ditë</td><td colspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Bashkisë Pogradec</td><td>9. Operatorët Ekonomikë
a)Pjesëmarrës në tender Numër 20 B/OE
b) S'kualifikuar 2 B/OE,</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 2170 prot., datë 03.06.2025 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit.
Personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", në datën 26.062025, kanë mbajtur procesverbalin në të cilin ka përcaktuar specifikimet teknike, kriteret për kualifikim dhe vlerën e FL 607,506 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 34 prot., datë 26.06.2025.
Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 26.06.2025 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*". Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 14.07.2025 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "*Kancelari"*, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe ka shpallur fitues OE "*I.O.*", me vlerë oferte 607,506 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 23.12.2024, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 10887/2024, datë 18.07.2025.
Me urdhër nr. 627 datë 27.12.2024 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim, nga i cili është mbajtur procesverbali "për marrjen në dorëzim" datë 18.07.2025.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit (2):

<table>
<tr><td colspan="4">a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Pjesë këmbimi"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit</td><td>2. Komisioni i BVV
1. E.B.
2. K.L.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
1. E.B.</td></tr>
</table>

"Blerje me vlerë të vogël"; REF-61929-09-18-2025; Urdhri nr.56 datë 18.09.2025	**limit(KBV)** 1. *E.B.* 2. *K.L.* 3. *D.Ç.*	3. *D.Ç.*	2. *K.L.* 3. *D.Ç.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 340,650 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 312,850 lekë Fitues: "*B."*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 27,800 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 06.03.2024	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkisë Pogradec		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 14 **B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 2 ditë			b) S'kualifikuar 7 **B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 3210 prot., datë 22.08.2025 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit.
Personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", në datën 18.09.2025, kanë mbajtur procesverbalin për specifikimet teknike, kriteret për kualifikim për procedurën dhe vlerën e FL në 340,650 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 56 prot., datë 18.09.2025.
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 19.09.2025 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "*Pjesë këmbimi"*, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe ka shpallur fitues OE "*B.* " me vlerë oferte 312,850 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e vlerësimit, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues, i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 137/2025, datë 29.09.2025.
Me urdhrin nr. 508, datë 25.09.2025 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim nga i cili është mbajtur procesverbali "për marrjen në dorëzim" datë 29.09.2025.
Të dhëna mbi objektin e prokurimit (3):

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale për zjarrfikësit**"**			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Blerje me vlerë të vogël"; REF-54131-07-09-2025; Urdhri nr. 39 datë 07.07.2025	**1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit** 1. *A.G.* 2. *G.M.* 3. *D.J.*	**2. Komisioni i BVV** 1. *E.B.* 2. *K.L.* 3. *D.Ç.*	**3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** 1.*E.B.* 2. *K.L.* 3. *D.Ç.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 993,604 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 602,900 lekë Fitues: "*A.K."*		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 390,704 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 10.07.2025	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 19 **B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë			b) S'kualifikuar 5 **B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 823 prot, datë 21.02.2025 të Sektorit të MZSH-së është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: "*Blerje materiale për zjarrfikësit*".
Personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", në datën 07.07.2025, kanë mbajtur procesverbalin për përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret për kualifikim dhe vlerën e FL në 993,604 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.

Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 39 prot., datë 07.07.2025.
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 10.07.2025 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "Blerje materiale për zjarrfikësit*"*, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe ka shpallur fitues OE "*A.K.*" me vlerë oferte 602,900 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 25.07.2025, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues", i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 58/2025, datë 25.07.2025.
Me urdhrin nr. 399, datë 15.07.2025 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim, nga i cili është mbajtur procesverbali "për marrjen në dorëzim" datë 25.07.2025.
Të dhëna mbi objektin e prokurimit (4):

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Materiale Pastrimi"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit
"Blerje me vlerë të vogël"; REF-62168-09-22-2025; Urdhri nr. 55 datë 18.09.2025</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit
1. E.B.
2. K.L.
3. D.Ç.</td><td>2. Komisioni i BVV
1. E.B.
2. K.L.
3. D.Ç.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
1. E.B.
2. K.L.
3. D.Ç.</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa TVSh)
301,230 lekë</td><td colspan="2">5. Oferta fituese (pa TVSh)
174,500 lekë
Fitues: "H."</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)
126,730 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:
Data 23.09.2025</td><td colspan="2" rowspan="2">8. Burimi Financimit
Buxheti i Bashkisë Pogradec</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike
a)Pjesëmarrës në tender Numër 33 B/OE
b) S'kualifikuar 11 B/OE,</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 ditë</td></tr>
</table>

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:
Me shkresën nr. 3355 prot, datë 02.09.2025 të Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt:*" Materiale Pastrimi".*
Personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", në datën 18.09.2025, kanë mbajtur procesverbalin për përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret për kualifikim dhe vlerën e FL në 301,230 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh ofertat apo studimi i tregut, çka është dokumentuar në procesverbal.
Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 55 prot., datë 18.09.2025.
Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: "Materiale Pastrimi*"*, duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "*H.*" me vlerë oferte 174,500 lekë (pa TVSh).
Në procesverbalin e datës 23.09.2025, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues", i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë*".
Kontrata e furnizimit (fatura) nr. 75/2025, datë 01.10.2025.
Me urdhrin nr. 515, datë 26.09.2025 është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim, nga i cili është mbajtur procesverbali "për marrjen në dorëzim" datë 01.10.2025.
Të dhëna mbi objektin e prokurimit (5):

<table>
<tr><td colspan="4">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Riparim i Wc-së, shkolla Hudënisht"</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</td><td>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit</td><td>2. Komisioni i BVV
1. E.B.
2. K.L.</td><td>3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
1. E.B.</td></tr>
</table>

"Blerje me vlerë të vogël"; REF-44147-04-08-2025; Urdhri nr. 14 datë 08.04.2025	1. K.I.	3. *D.Ç.*	2. *K.L.* 3. *D.Ç.*
4. Fondi Limit (pa TVSh) 999,072.26 lekë	**5. Oferta fituese (pa TVSh)** 649,999 lekë Fitues: "A."		**6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** 349,073.26 lekë
7/1 Data e hapjes së tenderit: 09.04.2025	**8. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit		**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër 12 **B/OE**
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 javë			b) S'kualifikuar 2 **B/OE,**

Nga shqyrtimi i sipërcituar, mbi realizimin e procedurës së prokurimit, konstatohet që:

Me shkresën nr.1420 prot., datë 07.04.2025 të Drejtorisë së PKZhT-së është kërkuar realizimi i procedurës së prokurimit me objekt: *"*Riparim i Wc-së shkolla Hudënisht*".*

Personat përgjegjës për prokurimet "blerje me vlerë të vogël", kanë mbajtur procesverbalin në të cilin kanë përcaktuar specifikimet teknike, kriteret për kualifikim dhe vlerën e FL në 999,072.26 lekë pa TVSh, duke specifikuar se për përllogaritjen janë marrë parasysh çmimet e botuara nga INSTAT ose çmimet zyrtare, çka është dokumentuar në procesverbal.

Në lidhje me sa më sipër është nxjerrë urdhër prokurimi me nr. 14 prot., datë 08.04.2025.

Nga njësia e prokurimit (KBV), në datën 08.04.2025 është hartuar "ftesa për ofertë" dhe procesverbali "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit*". Njësia e prokurimit, në cilësinë e KVO-së, në datën 09.04.2025 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit përfundimtar për procedurën me objekt: *"*Riparim i Wc-së shkolla Hudënisht*",* duke kryer vlerësimin sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme dhe shpallur fitues OE "A." me vlerë oferte 649 999 lekë (pa TVSh).

Në procesverbalin e datës 10.04.2025, ndër të tjera, KVO-ja (KBV) shprehet se: "*KVO mori në dorëzim dokumentacionin e operatorit fitues", i cili rezultoi në përmbushje të plotë me kërkesat e përcaktuara në DST dhe ftesën për ofertë* ".

Kontrata pune publike nr. 1420/4 prot., datë 14.04.2025.

Nga sipërmarrësi kolaudatori dhe mbikqyrësi është mbajtur Akti i kolaudimit datë 17.07.2025.

Konkluzion i përgjithshëm.

Nga auditimi i procedurave të sipërcituara, për vitin 2023, vitin 2024 dhe 2025, grupi i auditimit konstaton, në mënyrë të përmbledhur, sa vijon:

-Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjeve fizike, procesverbalit "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve tëkualifikimit*" dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK, Komisioni i Blerjeve të Vogla, në cilësinë e njësisë së prokurimit (NjP), në përgjithësi, është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim dhe është mbajtur procesverbali përkatës, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 78, pika 2 "*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" ku citohet se: "*...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...*".

-Referuar procedurave të sipërcituara, konstatohet se dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., janë pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Gjithashtu në dosjet e prokurimit janë administruar, në përputhje me kërkesat e LPP-së, të gjitha deklaratat e anëtarëve të komisioneve mbi konfliktin e interesave.

-Për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjet fizike, në lidhje me procedurat e sipërcituara, grupi i auditimit vlerëson se, Komisioni i Blerjeve të

Vogla, në cilësinë KVO-së, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

Konstatim problematike (Situata/Gjetja):

-Nga verifikimi i procedurave të sipërcituara, rezulton se nga Autoriteti Kontraktor, në një rast gjatë vitit 2023, është kryer ndarja e procedurave/fondit të prokurimit duke sjellë si pasojë ndryshimin e kufirit monetar pa arsye objektive të cilat do të justifikonin veprimin konkret.

Konkretisht rasti i pasqyruara si vijon:

Të dhëna mbi Realizimin e Procedurave të Prokurimit:

Prokurime të realizuara për periudhën objekt auditimi.			
Objekti i procedurës së prokurimit, "*blerje me vlerë të vogël*"	Numër dhe datë i Urdhër Prokurimit	Fondit limit (lekë/pa tvsh).	Vlera e kontratës (lekë/pa tvsh).
"Uniforma për Policinë Bashkiake"	Urdhri nr. 10 datë 15.03.2023	579,583	516,000
"Veshje pune për shërbimin zjarrfikës"	Urdhri nr. 29 datë 29.05.2023	999,236	833,000
TOTALI	*2 procedura prokurimi*	*1,578,819*	*1,349,000*

Në lidhje me dy procedurat e sipërcituara, prokurimi duhet të kryhej në një procedure të vetme. Konkretisht, duke u nisur nga ngjajshmëria apo funksionaliteti i tyre, objektet duhet të prokuroheshin bashkë nëpërmjet procedurës "*e hapur e thjeshtuar*".

Për sa konstatuar më sipër, veprimet e AK-së bien në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e cila konkretisht në nenin 56 pika 2 të saj përcakton se: "*Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure*"

Gjithashtu, pika 11 e të njëjtit nen të dispozitës së sipërcituar përcakton se: "*Në asnjë rast, autoriteti/enti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit*".

Si konkluzion, në rrethanat e sipërcituara, hartimi i regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik në kundërshtim me mënyrën e parashikuar, ka ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike, pasi përdorimi apo zhvillimi i disa procedurave për të njëjtin objekt, në kohë të ndryshme dhe pa arsye objektive, nga njëra anë rrit shpenzimet procedurale dhe nga ana tjetër ul efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik. Kjo situatë rezulton në mospërputhje me nenin 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*" ku ndër të tjera përcaktohet se: "*Qëllimi i këtij ligji është... a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale...*".

Për sa më sipër, janë ***veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi*** komisionin e prokurimit për blerjet e vogla në periudhën e konstatuar: znj. *D.Ç.*, znj. *I. B.* znj. *E.B.*, znj. L.F. dhe z. *E.B.*.

Për rastin konkret, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, specifikisht neni 74, pika 3, anëtarët e komisionit të caktuar kanë cilësinë e personave përgjegjës, të cilët duhet të sigurojnë të dhënat e nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion me qëllim përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik si dhe përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit.

Për sa trajtuar më sipër, është hartuar Projekt Raporti i Auditimit i dërguar pranë subjektit Bashkia Pogradec me shkresën nr. 870/7 datë 06.07.2026 mbi të cilin, nga subjekti i audituar (znj. E.K.dhe znj. A.K.), nëpërmjet shkresës nr. 642/24 prot., datë 07.08.2026, administruar në

KLSH me nr. 870/8 prot., datë 10.08.2026, është paraqitur observacioni dhe janë shprehur objeksionet, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Gjetje në akt konstatimet Nr. 1, Nr. 2 dhe Nr. 3, mbi deklarimin e konfliktit të interesit, ne procedurat e prokurimit publik si me poshte:*

- Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore.- Sherbim transporti per materiale ndertimi. - Loti IV, Ura e Zëmçës - Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë.- Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të qytetittë Pogradecitdhe Njësive Administrative. - Blerje mjeti makinë borëpastruese. - Blerje Mjeti për zhvillimin e kanaleve Ujitëse (Eskavator).

Grupi i Auditimit konstaton se ne lidhje me anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe anëtarët e Grupeve të Marrjes në dorëzim nuk janë administruar deklaratat e anëtarëve mbi konfliktin e interesave, sipas nenit 74, pika 4 të VKM 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" ku ndër të tjera përcaktohet se: "Cdo nëpunës që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit". Në lidhje me këtë gjetje, e cila është konstatuar në disa procedura prokurimi në te tre akt- konstatimet e më sipër cituara, sqarojmë si më poshtë:

Në Ligjin për Prokurimin Publik, Neni 19 i LPP, citon se:... Nga ana tjetër, me qëllim mirë zbatimin e Legjislacionit të Prokurimit Publik, mbi shmangien e gjendjes së konfliktit të Interesit, Agjencia e Prokurimit Publik ka publikuar Udhëzimin Nr. 1, datë 21.01.2022 "Mbi deklarimin e Konfliktitt ë Interesit nga Zyrtarët / Nëpunësit në procesin e prokurimit dhe zbatimin e Kontratës", protokolluar me numër 618 Prot.... -Pra, në interpretim të Udhëzimit mbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit, I cili daton në datë 21.01.2022, si një Akt Nënligjor, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", rezulton përcaktimi i shtojcës nr. 1 dhe shtojcës nr. 2 si deklaratat që do të nënshkruajnë të gjithë zyrtarët e përfshirë në procesin e prokurimit. Pjesë e këtyre shtojcave janë kategori të mirëpërcaktuara të zyrtarëve të cilët duhet të nenshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit, në momentin e emërimit si zyrtarë.

Për sa më sipër, vihet re se anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe Grupi I Marrjes në Dorëzim nuk janë ndër kategoritë e zyrtarëve të cituar në asnjërën prej shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, të cilat shoqërojnë Udhëzimin.

Të ndodhur në këto rrethana, kur akti nënligjor, në zbatim të Ligjit dhe VKM-së së Prokurimeve Publike, nuk e rregullon mënyrën e deklarimit mbi konfliktin e interesit të zyrtarëve të përfshirë në Komisionin e Shqyrtimitt të Ankesave dhe të Grupeve të Marrjes në Dorëzim, vlerësojmë se kjo pikë shkon përtej përgjegjësisë së Autoritetit Kontraktor, të cilët do të duhej ta gjenin shtojcën e deklarimit bashkëngjitur Udhëzimit nr. 1, datë 21.01.2022 , njësoj si kategoritë e tjera të zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit.

•Gjetje në akt konstatimet Nr. 1, Nr. 2 dhe Nr. 3, mbi procesin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, per procedurat si me poshte:

- Rehabilitim i Lumit të Çërravës -Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore - Loti IV, Ura e Zëmçës - Kryqëzimi Proptisht, Bishnicë - Rehabilitimi i shkolles Myredin Bashalli", fshati Lin Nj. A. Udënisht, Bashkia Pogradec

Grupi i Auditimit konstaton se në disa prej procedurave të prokurimit publik, të audituara, rezulton se afati i vlerësimit të ofertave është tejkaluar nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në tejkalim të afatit 15 ditor të përcaktuar nga VKM 285/2021 "Rregullat e Prokurimit Publik", I cili shprehet:... Pra, Neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", parashikon pikat si më lart 1, 2, 3, 4 dhe 5, si hapat për vlerësimin e ofertave duke iu referuar vlerësimit që KVO bën në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), duke mos përmendur fazën e dorëzimit të dokumentacionit fizik, as afatin që iu vendoset në dispozicion operatorit ekonomik për dorëzim dokumentacioni dhe as afatin për vlerësim të dokumentacionit fizik nga

KVO. Gjithashtu nuk rregullohen në këtë nen as rastet kur operatori që ka dorëzuar dokumentacionin fizik skualifikohet dhe Njësisë së Prokurimit do t'i duhet të kthejë procedurën për rivlerësim, për të vazhduar më tej KVO me Rivlerësim të Procedurës dhe për të kaluar më tej në operatorin e radhës të kualifikuar.

Pra, mbetet e paqartë, në intepretim të nenit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ofertave, nëse afati 15 ditor I referohet vetëm fazës së vlerësimit të Ofertave në SPE apo të gjithë procesit të vlerësimit deri në shpalljen e fituesit.

Nga ana tjetër, në një procedurë prokurimi ku marrin pjesë një numër I konsiderueshëm operatorësh ekonomikë, do të ishte e pamundur që i gjithë procesi i vlerësimit të ofertave në tërësi, deri në shpalljen e fituesit, te zgjaste gjithsej 15 ditë, marrim parasysh këtu edhe faktin se cdo anëtar i Vlerësimit të Ofertave, përvec kësaj detyre, ngarkohet edhe me detyra të tjera, sipas detyrave të veta funksionale...

•Gjetje në akt konstatimin nr Nr. 2 në procedurën me objekt: "Rehabilitim Skema Ujitëse "Rezervuari Bregu I Lëndinave , Çërravë" - Kërkesa e AK per piken e licences NP-6A konstatohet se nuk ka lidhje me natyren dhe objektin e kontrates.

Sqarojmë si më poshtë: Kërkesa për licencën NP-6A është vendosur duke qënë se objekti i projektit përfshin rehabilitimin e digës ekzistuese . Punimet parashikojnë gërmime, mbushje dhe ngjeshje të trupit të digës me mjete mekanike me qellim eleminimin e çarjes së digës dhe rikthimin e stabilitetit të sigurisë së veprës hidroteknike. Një nga problematikat kryesore që synohej të zgjidhej me anë të këtij projekti ishte çarja e trupit të digës e pranishme prej rreth 15 vitesh, e cila paraqiste rrezik në funksionimin normal të veprës. Për shkak se ndërhyrjet kryhen drejtpërdrejt në trupin e digës dhe lidhen me rehabilitimin e saj strukturor është konsideruar e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë licencën NP-6A "Diga të cdo lloj madhësie".

•Gjetje në akt konstatimin nr Nr. 2 në procedurën me objekt: "Rikonstruksion Kannali Ujitës Rezervuari Pusisë – Gjollet, Leshnicë" - Kërkesa e AK per piken e licences NS- 9A konstatohet se nuk ka lidhje me natyren dhe objektin e kontrates.

Sqarojmë si më poshtë: Licenca NS-9A është kërkuar duke marrë në konsideratë natyrën dhe specifikën e punimeve të parashikuara në objekt. Punimet nuk konsistojnë vetëm në rehabilitimin e kanalit ujitës, por përfshijnë edhe realizimin e elementeve strukturore, ndërtimi i pusetës së marrjes dhe veprave të vogla të artit. Një nga zërat e preventivit parashikon ndërtimin e tombinove ne tuba betoni 600 mm , të vendosura mbi shtresë betoni, punime të cilat përfshijnë elemente kostruktive prej betoni dhe kërkojnë zbatim sipas kërkesave teknike për garantimin e qëndrueshmerisë dhe jetëgjatësisë të veprës. Për rrjedhojë duke qënë se objekti përmban punime që lidhen me realizimin e strukturave dhe elementëve konstruktive prej betoni është vlerësuar e nevojshme kërkimi i licences NS-9A .

•Gjetje në akt konstatimet Nr. 1, Nr. 2 dhe Nr. 3, mbi Publikimin me vonesë të Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar, pas lidhjes së kontratës, sqarojmë se:

Nga ana e personave përgjegjës për prokurimet publike të Bashkisë Pogradec, janë evidentuar rastet e lëna në akt konstatim si vonesa në publikim të Njoftimitt ë Kontratës së Nënshkruar dhe na rezulton se në disa prej tyre ka qënë dita e parafundit dhe e fundit e publikimit ditë pushimi (e shtunë - e diele) dhe ngarkimi në SPE është bërë ditën e nesërme të punës. Në disa raste të tjera rezulton se është ngarkuar në system Njoftimi Brenda afatit prej 5 ditësh por për shkak të ndonjë pasaktësie në Nr. Ref ose datë është refuzuar Njoftimi nga APP dhe është ngarkuar përsëri nga personi Përgjegjës. Në një rast, si pasoje e harreses së personit Përgjegjës nuk është publikuar për disa ditë Njoftimi I Kontratës së Nënshkruar, dhe kjo gjë është deklaruar në Dritaren Përshkrimi në SPE, në momentin e ngarkimit në SPE.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Së pari theksojmë se puna e grupit të auditimit ka si qëllim parësor vlerësimin e situatave dhe lënien e rekomandimeve me qëllim zhvillimin e aktivitetit publik në përputhje me kriteret ligjore dhe jo ndëshkimin e punonjësve. Në lidhje me

observacionin e paraqitur mbi deklarimin e konfliktit të interesave grupi i auditimit, pasi shqyrtoi pretendimet e ngritura, rikonfirmon gjetjen duke e cilësuar observacionin si të pabazuar në interpretimin e drejtë dhe të plotë të kuadrit ligjor në fuqi, për arsyet si vijon: Nga ana juaj pretendohet se punonjësit që bëjnë marrjen në dorëzim nuk ndikojnë në garë, por vetëm verifikojnë mallin apo shërbimin. Gjithashtu i njëjti argumentim vlen edhe për anëtarin e komisionit të shqyrtimit të ankesave. Ky argument është i pasaktë pasi procesi i prokurimit nuk përfundon me shpalljen e fituesit por faza e zbatimit dhe ekzekutimit të kontratës duke përfshirë edhe marrjen në dorëzim është gjithashtu pjesë administrative e procesit. Në referimin që i bëhet Udhëzimit Nr. 1, datë 21.01.2022 të APP-së duhet të kini parasysh hierarkinë ligjore dhe faktin se udhëzim i APP-së është në zbatim dhe jo në kundërshtim me frymën e VKM-së apo LPP-së. VKM-ja nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 73, pika 4, përcakton në mënyrë të qartë se: "*Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit*".

-Në lidhje me zbatimin e afateve për vlerësimin e ofertave, së pari vlerësojmë se është në diskrecion të çdo titullari apo personi të autorizuar, të organizojë punonjësit në komisione, në atë mënyrë të cilën të mund të zbatohen dispozitat ligjore si dhe të sigurohet vijimësia e angazhimeve institucionale. Nga ana tjetër afatet ligjore për vlerësimin e ofertave janë të mirëpërcaktuara në ligj dhe për këtë arsye, për anëtarët e komisioneve mbi prokurimin publik sugjerohet që herë pas here të marrin pjesë në trajnimet që organizohen nga APP-ja. Afati ligjor i përcaktuar (15-ditë), në kuptim të dispozitave, i referohet momentit apo periudhës nga data e hapjes së ofertave deri tek publikimi i njoftimit të fituesit (paraptak).

-Në lidhje me pretendimin mbi gjetjen në procedurën me objekt: "Rehabilitim Skema Ujitëse "Rezervuari Bregu I Lëndinave , Çërravë", ritheksojmë se kërkesa e AK në lidhje me pikën e liçencës N.P -6 A (Diga dhe tunele hidroteknike), konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventiv), rezulton se nuk ka të parashikuar lloje të punimeve të përfshira në përkufizimin e licencës N.P-6. Në rastin konkret, sipas VKM-së Nr. 42, datë 16.01.2008, liçensa N.P-6 konsiderohet për punime: "Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes. Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali". Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.

-Në lidhje me pretendimin mbi gjetjen në procedurën me objekt: "Rikonstruksion Kanali Ujitës Rezervuari Pusisë – Gjollet, Leshnicë", ritheksojmë se: Së pari, në lidhje me këtë kriter, konsatatohet se Njësia e Prokurimit nuk ka kryer një argumentim teknik në bazë të së cilit të konkludohej se për cilin zë konkret të preventivit kërkohet një liçensë e caktuar. Në procesverbalin "Për argumentimin e miratimin e kritereve" citohet se "Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit…", por grupit të auditimit nuk i është paraqitur një analizë teknike konkrete (zërat dhe vlerat përkatëse).

Së dyti, kërkesa e AK në lidhje me pikën e liçencës N.S -9 A (Punime strukturore speciale), konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës pasi referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se nuk ka të parashikuar lloje të punimeve të përfshira në përkufizimin e licencës N.S-9. Në rastin konkret, sipas VKM-së Nr. 42, datë 16.01.2008, liçensa N.S-9 konsiderohet për punime: "Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratori nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve.

Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve". Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kriter të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës.
-Në lidhje me pretendimin mbi gjetjen në lidhje me vonesat në respektimin e disa afateve ligjore mbi publikimet, sqarojmë se pavarësish arsyeve të përmendura nga ana juaj, dispozitat ligjore të cituara nga grupi i auditimit e kanë të mirëpërcaktuar si afatin për kryerjen e veprimit ashtu edhe personin përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit.
Si përfundim, vlerësojmë se nuk janë paraqitur argumente, prova ligjore apo dokumentacion për të ndryshuar qëndrimin e grupit të auditimit dhe për këtë arsye, pretendimet e paraqitura nuk merren në konsideratë.

2.2.3. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve për punë publike.

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i kontratave për punë publike për periudhën e auditimit, 01.01.2023 deri 31.12.2025 rezultoi si më poshtë.
Në total për periudhën e auditimit, janë lidhur **20 (njëzet)** kontrata për punë publike në vlerën **519,115,540** lekë me TVSH, e ndarë sipas viteve, si vijon:
Për vitin 2023 janë lidhur **9** (nëntë) kontrata për punë publike me vlerë **356,466,449** lekë me TVSH (Tabela Nr. 1).
Për vitin 2024 janë lidhur **7** (shtatë) kontrata për punë publike me vlerë **120,349,800** lekë me TVSH (Tabela Nr. 3)..
Për vitin 2025 janë lidhur **4** (katër) kontrata për punë publike me vlerë **42,299,291** lekë pa TVSH (Tabela Nr. 3).
Në zbatim të pikës së Programit të Auditimit, në Bashkinë Pogradec, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve për punë publike të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqituara në tabelë:

Tabela nr. 1 (Realizimi i kontratave për punë publike Viti 2023)

Nr.	Elementi i Regjistrit	Lloji i procedurës së prokurimit	Fondi Limit i Procedures (pa TVSH)	Data e zhvillimit te procedures se prokurimit	Data e lidhjes se kontrates	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vlera kontratës (Pa TVSH)
1	Rehabilitim i objekteve në rrezik shembje	Open Simple	4,009,181.00	18/12/2023 10:00 AM	12/28/2023 12:00:00 AM	A	3,052,251.00
2	Rehabilitim i Shkolles "Myredin Bashalli", Fshati LIN, Nj. Adm. Udënisht	Open Local	50,886,277.00	07/09/2023 10:00 AM	11/14/2023 12:00:00 AM	*V.K.*	49,487,636.38
3	"Mirëmbajtje objekti Muzeu i Qytetit"	Small Value	916,523.00	06/03/2023 03:30 PM		*A.*	827,690.00
4	"Rehabilitim i Lumit të Çërravës"	Open Local	12,499,950.00	28/03/2023 10:00 AM	6/7/2023 12:00:00 AM	"*B.*"	12,196,899.00
5	Rikonstruksion "Salle pritje per te moshuarit"	Open Simple	2,499,404.00	09/10/2023 10:00 AM	11/14/2023 12:00:00 AM	*A.*	1,979,411.00
6	Ndertim Mur Mbajtes, Lagjja nr. 1, Lumi i Verdoves	Open Simple	4,061,279.21	14/08/2023 10:00 AM	10/13/2023 12:00:00 AM	"*B.*"	3,361,505.00
7	Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore	Open Local	79,282,029.00	19/09/2023 10:00 AM	12/22/2023 12:00:00 AM	R.	70,743,198.00
8	Ndertim Muri mbajtes	Open	1,878,394.00	18/12/2023	12/28/2023	*I.*	1,530,309.27

	tek Prroi i Caprazit	Simple		10:00 AM	12:00:00 AM		
9	Loti IV Ura e Zëmçës - Kryqëzimi Proptisht Bishnicë	Open Local	220,320,000.00	02/11/2022 11:00 AM	3/1/2024 12:00:00 AM	A.	153,876,474.78

Tabela nr. 2 (Realizimi i kontratave për punë publike Viti 2024)

Nr.	Elementi i Regjistrit	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri i Thirrjes	Fondi Limit i Procedures (pa TVSH)	Data e lidhjes se kontrates	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vlera kontratës (Pa TVSH)
1	Rehabilitimi i skarpateve te lumit te qytetit dhe kanalizimi i ujrave te zeza	Open Simple	REF-21953-09-27-2024	6,666,666.00	11/25/2024	*I.*	4,650,350.00
2	Rikonstruksion dhe shtese objekti per shkollen "Kajo Karafili", Geshtenjas, Bashkia Pogradec	Open Local	REF-27702-11-01-2024	88,879,920.00	12/18/2024	R.	58,464,150.36
3	Rehabilitim skema ujitese "Rezervuari Bregu i Lendinave, Çerrave"	Open Simple	REF-31036-11-26-2024	5,783,857.36	12/27/2024	*A.*	4,338,002.00
4	Rikonstruksion / Rehabilitim i banesave sociale per vitin 2024	Open Local	REF-16891-08-23-2024	20,083,333.00	10/10/2024	*R.*	15,269,688.00
5	Perfundim punimesh objekti "Sistemim i lumit te Bucimasit dhe rehabilitim i infrastruktures rrugore pergjate tij"	Open Local	REF-18495-09-10-2024	13,329,189.00	10/31/2024	*A.*	9,004,010.00
6	Rikonstruksion kanali ujites "Rezervuari i Pusis-Gjollet, Leshnice"	Open Local	REF-25463-10-18-2024	11,941,854.68	12/11/2024	*I.*	8,075,300.00
7	Perfundim i punimeve tek Vendpushimi veror per te moshuar	Small Value	REF-07486-05-30-2024	539,175.00		*A.*	490,000.00

Tabela nr. 5 (Realizimi i kontratave për punë publike Viti 2025)

Nr.	Elementi i Regjistrit	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri i Thirrjes	Fondi Limit i Procedures (pa TVSH)	Data e lidhjes se kontrates	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vlera kontratës (Pa TVSH)
1	Rehabilitim dhe ambiente shtese, kopshti "Liri Çomo", Pogradec	Open Local	REF-58806-08-22-2025	34,169,003.00	16/10/2025	*A.*	26,353,427.20

2	Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale për promovimin e përfshirjes dhe zhvillimin e aftësive	Open Simple	REF-42532-03-26-2025	3,886,722.00	12/05/2025	R.	3,127,138.00
3	Ndertim mure mbajtese ne fshatin Rodokal i Siperm	Open Simple	REF-47488-05-09-2025	7,499,712.00	25/06/2025	*I.*	5,118,844.50
4	Riparim tualetesh ne shkollen e mesme te bashkuar "Deshmoret e Pojskes", Udenisht	Small Value	REF-44147-04-08-2025	999,072.26		*A.*	649,999.00

Mbështetur sa më sipër, janë audituar **9** (nëntë) kontrata për punë publike në vlerën **547202178 lekë me TVSH**, që mbulon **75 %** të vlerës totale të objekteve të përfunduara dhe të marra në dorëzim.

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara**,** si vijon:

1. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale" REF-42532-03-26-2025		
14.Lidhja e kontratës: Nr. 695/13 prot., datë 12.05.2025 OE fitues "R." SHPK	**15.Vlera e kontratës:** Vl e prev ofertues 3,752,565 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 2,755,405 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 996,324 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 3,751,729 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 12.06.2025 Përfundimi punimeve: 09.07.2025	**19. Zgjatja e kontratës** -
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE " *P.*" SHPK	Licenca MK. 4507	Kontratë me nr. 1382/3 prot., datë 12.05.2025
21. Kolaudatori i punimeve Shoqëria "*P.C.*" SHPK	Licenca Nr: MK. 0899/21	Kontratë me nr. 2954/3 prot., datë 05.08.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. -- prot., datë 05.09.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE R.SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*P.*" SHPK" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*P.C.*" SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. --- prot., datë 12.09.2025 në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve "R."SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*P.*" SHPK" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*P.C.*" SHPK si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (K.I., M.T. dhe R.J.).	

u konstatua problematikat si vijon.

Përshkrimi i situatës.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e

situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Pogradec, në vlerën **104,800 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
							Vol.	**Vlera**
	Punime bojatisje							
Zëri 11 (2.404/1).	Bojë hidroplastike cilësi e lartë	m2	400	495	495	233	262	104,800
	Totali në lekë pa TVSH							**104,800**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë "**R." SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;* - ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3*.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë **"*P.*" SHPK**" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;* - ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. *D.XH.*, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

2. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari i Pusit-Gjollet, Leshnicë**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari i Pusit-Gjollet, Leshnicë".		
14.Lidhja e kontratës: Nr. 4324/6 prot., datë 11.12.2024. BOE fitues "*I.* & *T.*" SHPK	**15.Vlera e kontratës :** Vl e prev ofertues 9,690,360 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 8,738,400 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar: Sit. përf në vlerën 951,960 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në ditë:** Fillimi punimeve: 11.12.2025 Pezullimi i punimeve: 27.01.2025 Rifillim punimesh: 04.08.2025 Përfundimi punimeve: 21.08.2025	**19. Zgjatja e kontratës:** - Amendim kontrate me nr. 422/2 prot., datë 05.08.2025.
20. Mbikëqyrësi i punimeve: OE " *N.S.*" SHPK	Licenca: MK: 1811/10	Kontratë me nr. 4443/24 prot., datë 11.12.2024
21. Kolaudatori i punimeve: Ing. *D.LL.*	Licenca Nr: MK. 4327	Kontratë me nr. 3387/3 prot., datë 22.09.2025
22.Akt Kolaudimi: -Me akt kolaudimin me nr. --- prot., datë 20.10.2025 është realizuar kolaudimi i objektit,	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. --- prot., datë 23.10.2025 në Bashkisë Pogradec është bërë marrja e përkohshme në dorëzim, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "I." SHPK & "L." SHPK , mbikëqyrësi i punimeve "*N.S.*" SHPK si dhe	

dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "I." SHPK & "L." SHPK , mbikëqyrësi i punimeve "*N.S.*" SHPK si dhe kolaudatori Ing. *D.LL.*.	kolaudatori Ing. *D.LL.*, si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (A.L., M.T., *M.T.*) sipas urdhrit të Kryetarit të AK nr. 608, datë 13.12.2024)

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Pogradec, në vlerën **271,710 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime gërmimi							0
Zëri 1(3.89/b).	Gërmim kanalesh me ekskavator 0.25 m3, në kanale gjerësi >2m, tok zak, kategoria III, me shkark në mjet	m3	300	1465	1465	1,421.8	43.2	12,960
Zëri 2(3.46/1).	Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion deri 0.75 m2	m3	2500	251	251	233.9	17.10	42,750
Zëri 4(3.48/b).	Rrafshim skarpatesh, me krahë, në gërmim tokë të zakonshme	m2	150	3240	3240	1800	1440	216,000
	Totali në lekë pa TVSH							**271,710**

Nga ana e zbatuesit të punimeve BOE I.SHPK & L.SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;* - ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "***N.S.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;* - ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. *E.N.*, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

3. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rehabilitimi skema ujitëse "Rezervuari Bregu i Lendinave, Çërravë**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi skema ujitëse "Rezervuari Bregu i Lëndinave, Çërravë". REF-31036-11-26-2024.		
14.Lidhja e kontratës: Nr. 4530/12 prot., datë 27.12.2024.	**15.Vlera e kontratës :** Vl e prev ofertues 5,205,602.40 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 4,945,322.4 lekë me TVSH

BOE fitues "*A."* & "*D."* SHPK		
17- Situacioni Përfundimtar: Sit. përf në vlerën 260,280 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në ditë:** Fillimi punimeve: 27.12.2024 Përfundimi punimeve: 27.01.2025	**19. Zgjatja e kontratës:** --
20. Mbikëqyrësi i punimeve: OE " *M.K.*" SHPK	Licenca: MK: 1811/10	Kontratë me nr. 4443/27 prot., datë 26.12.2024
21. Kolaudatori i punimeve: OE "*V.E.*" SHPK	Licenca Nr: MK.3835/2	Kontratë me nr. 916/2 prot., datë 07.04.2025
22.Akt Kolaudimi: -Me akt kolaudimin me nr. --- prot., datë 05.05.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "*A.* & *D."* SHPK , mbikëqyrësi i punimeve "*M.K.*" SHPK si dhe kolaudatori BOE "*V.E.* & *E.*" SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. --- prot., datë 29.05.2025 në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "*A.* & *D."* SHPK , mbikëqyrësi i punimeve "*M.K.*" SHPK si dhe kolaudatori BOE "*V.E.* & *E.*" SHPK. si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (*J.D.*, E. P., A.L.)	

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **Bashkisë Pogradec**, në vlerën **148,200 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime gërmimi							
Zëri 1(3.45/1).	Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë me seksion deri 0.25 m2	m3	1300	385.14	385.14	271	114	148,200
	Totali në lekë pa TVSH							**148,200**

Nga ana e zbatuesit të punimeve BOE "***A. " &" D. " SHPK*** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8; - **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "***M.K.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7; - **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. *T.S.,* në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

4. Kontrata për punë publike me objekt: "**Ujësjellësi i Mokrës Faza e Dytë, Bashkia Pogradec**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

<table>
<tr><td colspan="3">13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ujësjellësi i Mokrës Faza e Dytë, Bashkia Pogradec”.</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës:
Nr. 162/20 prot., datë 08.04.2021
BOE fitues “R.” SHPK & “A.” SHPK</td><td>15.Vlera e kontratës:
Vl e prev ofertues 264,000,172.34 lekë me TVSH.</td><td>16.Likuiduar:
Sit. 1 në vlerën 52,999,418.16 lekë me TVSH
Sit. 2 në vlerën 26,551,217 lekë me TVSH
Sit. 3 në vlerën 25,472,440.28 lekë me TVSH
Sit. 4 në vlerën 50,834,144.59 lekë me TVSH
Sit. 5 në vlerën 29,182,026 lekë me TVSH</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar
Sit. përf nr. 6 në vlerën 77,880,419.65 lekë me TVSH.

Punimet kanë përfunduar në vlerën 262,919,665.68 lekë me TVSH.

Shuma prej 9,575,775.69 lekë ekuivalente me 5% të vlerës me të cilën mbyllen punimet do të zbllokohet në favor të kontraktuesit pas përfundimit të periudhës së garancisë së defekteve (12 muaj nga data e kolaudimit të punimeve).</td><td>18.Afati i kontratës në dite
Fillimi punimeve: 14.04.2021
Përfundimi punimeve: 25.11.2024</td><td>19. Zgjatja e kontratës
- me nr. 16/3 prot., datë 06.04.2022 është bërë amendim i kontratës me objekt shtyrje afati të kontratës bazë me 75 ditë kalendarike deri me datë 28.04.2023.
- me nr. 449/2 prot., datë 26.04.2023 është bërë amendim i kontratës me objekt shtyrje afati të kontratës bazë nga data 30.01.2023 deri 19.04.2023 (79 ditë kalendarike) do të zgjaten me 79 ditë kalendarike.
- me nr. 1155/1 prot., datë 06.03.2024 është bërë amendim i kontratës me objekt shtyrje afati të kontratës bazë për shkak se punimet në objekt pezulluan në datë 11.07.2023 për një periudhë prej 4 (katër) muajsh nga nënshkrimi i këtij amendamenti, nga data 06.03.2024 deri me datë 06.07.2024, pa ndryshuar kushtet e kontratës dhe në vijim me datë 06.03.2024 mbahet proces verbal ndërmjet sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit të punimeve për rifillimin e punimeve. Pra, afati shtyhet nga data 06.03.2024 deri me datë 06.07.2024.
- me nr. 1155/8 prot., datë 25.09.2024 është bërë amendim i kontratës me objekt shtyrje afati të kontratës bazë me 27 ditë kalendarike afat kohor ky i pezulluar nga Amendamenti i kontratës nr. 1155/1 prot., datë 06.03.2024, për shkak se punimet në objekt janë pezulluar me datë 10.06.2024, ndërkohë që afati i fundit i punimeve ishte parashikuar data 06.07.2024. zgjatja do të bëhet për 33 ditë kalendarike, si pasojë e ndryshimit të gjurmës së linjës së transmetimit në fshatrat Golik Sipër – Golik Poshtë, nga nënshkrimi i këtij amendamenti. Nëpërmjet këtij amendamenti kontrate përcaktohet afati i ri përfundimtar i punimeve, data 24.11.2024.</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
BOE “ N.G.& E. & H.C.” SHPK</td><td>Licenca MK. 2720/5</td><td>Kontratë me nr. 224 prot., datë 13.04.2021</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
-A.XH.
-K.B.</td><td>-Licenca Nr: MK. 1006/1 (A.XH.)
-Licenca Nr: MK. 4521 (K.B.)</td><td>Kontratë me nr. 648/6 prot., datë 16.10.2025</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi.
-Me akt kolaudimin me nr. -- prot., për periudhën 13.11.2025 deri 05.12.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “R.” SHPK përfaqësuar nga Z. L.K.,</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim:
-Me me nr. --- prot., datë 05.12.2025 në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “R.” SHPK përfaqësuar nga Z. L.K., mbikëqyrësi i punimeve BOE “N.” SHPK & “E.” SHPK & “H.C.” SHPK përfaqësuar nga “H.C.” SHPK me Drejtues ligjor Ing. H.H., nga kolaudatorët Ing. K.B. dhe Ing. A.XH. si dhe Kryetari i Bashkisë Pogradec Z. I.XH.. si dhe komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje: (K.I., F.K. dhe A.L.)</td></tr>
</table>

mbikëqyrësi i punimeve BOE "*N.*" SHPK & "*E.*" SHPK & "*H.C.*" SHPK përfaqësuar nga "*H.C.*" SHPK me Drejtues ligjor Ing. *H.H.*, nga kolaudatorët Ing. *K.B.* dhe Ing. *A.XH.* si dhe Kryetari i Bashkisë Pogradec Z. *I.XH.*.	

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Pogradec, në vlerën **350,000 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 2(2.47/An).	Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir	m3	1,750	1,530	1,530	1,280	200	350,000
	Totali në lekë pa TVSH							**350,000**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë "**R." SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- Ligjit nr. 8402*, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;* ***- Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve përfaqësuesit të BOE, shoqëria "***H.C.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- Ligjit nr. 8402*, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;* ***- UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. *H.H.,* në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

5. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rikonstruksion dhe shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Geshtenjas, Bashkia Pogradec**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion dhe shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Geshtenjas, Bashkia Pogradec". REF-27702-11-01-2024		
14.Lidhja e kontratës. Nr. 453/11 prot., datë 18.12.2024 OE fitues "*R.*" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 70,156,980.43 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 + 2 në vlerën 46,741,512 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 23,395,140 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 18.12.2024 Përfundimi punimeve: 17.06.2025	**19. Zgjatja e kontratës** ---

vlerën 70,136,652 lekë me TVSH.		
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE " *G.C."* & "XH. & *M.* " SHPK	Licenca MK.2928/17	Kontratë me nr. 4076/9 prot., datë 18.12.2024
21. Kolaudatori i punimeve Shoqëria "*H.C.*" SHPK	Licenca Nr: MK.1967/1	Kontratë me nr. 2534/1 prot., datë 11.07.2027
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. --- prot., datë 20.08.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*R."* SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*G.C.*" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*H.C.*" SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me nr. --- prot., datë 04.11.2025 në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*R."* SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*G.C.*" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*H.C.*" SHPK si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (K.I., M.T. dhe A.L.)	

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Pogradec, në vlerën **245,519 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime ndërtimi (Punime prishje dhe çmontimi)							-
Zëri 12(2.37/3)	Transport materiale ndërtimi	m3	300	679.95	679.95	98.36	581.59	174,477
	Punime tavani, suvatimi dhe veshje							-
Zëri 1(2.310)	Suva brenda mur tulle h-4m me krah, llaç përzier M 25	m2	700	1895	1895	1631.54	263.46	18,442
	Punime bojatisje							-
Zëri 1(2.404/1)	Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë	m2	200	3843.5	3843.5	3579.54	263	52,600
	Totali në lekë pa TVSH							**245,519**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë "***R."* SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8; - **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "***G.C.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. *L.H.*, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

6. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rehabilitim i shkollës "Myredin Bashalli", Fshati Lin, Njësia Administrative Udënisht**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitim i shkollës "Myredin Bashalli", Fshati Lin, Njësia Administrative Udënisht".		
14.Lidhja e kontratës. Nr. 1495/20 prot., datë 14.11.2023 OE fitues "V.K."SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 59,385,163.66 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 24,142,063.20 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 15,975,893.80 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 18,559,246.48 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 58,677,203.48 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 17.11.2023 Përfundimi punimeve: 27.08.2024	**19. Zgjatja e kontratës** ---
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE " *G.C"*.& "*A.*" SHPK	Licenca: MK. 2928/10 Lic: MK. 2892/5	Kontratë me nr. 3882/26 prot., datë 15.11.2023
21. Kolaudatori i punimeve PF "*V.B.*"	Licenca Nr: MK. 0181/1	Kontratë me nr. -- prot., datë 19.09.2024 Urdhri nr. 394, datë 19.19.2024
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. --- prot., datë 10.10.2024 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE V.K.SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*G.C.*" SHPK si dhe kolaudatori PF "*V.B.*".	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. --- prot., datë 10.10.2024 në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*V.K.*" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*G.C.*" SHPK si dhe kolaudatori PF "*V.B.*" si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (K.I., M.T. dhe A.L.). -Me datë 18.11.2025 është bërë certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve përfundimtare dhe është nënshkruar nga palët: [AK, Zbtuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve si dhe komisioni përfaqësues nga AK, me përbërje: (K.I., M.T. dhe A.L.)].	

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë Dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Pogradec, në vlerën **531,633 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	I. Punime ndërtimi (Punime prishje dhe çmontimi)							-
Zëri 11(2.37/5)	Transport materiale ndërtimi	m3	450	393	393	275	118	13,924
	III. Punime çatie							-
Zëri 3 (2.209/b)	Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø 120 mm	ml	5300	61.6	61.6	61.6 ml realizuar me çmim 693 lekë dhe jo me çmim 5300	-	283,791

						lekë		
Zëri 4 (2.212/b)	Ulluk shkarkimi horizontal me bakër 33 cm	ml	2800	118.26	118.26	118.26 ml realizuar me çmim 822 lekë dhe jo me çmim 2800 lekë	-	233,918
	Totali në lekë pa TVSH							**531,633**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë "**V.K." SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "***G.C.*& *A.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Z. *L.H.*, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

7. Kontrata për punë publike me objekt: "**Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "**Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I**". REF-78330-08-25-2023		
14.Lidhja e kontratës. Nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023 OE fitues "*R.*" SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 84,891,838 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 46,149,992 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 15,207,533 lekë me TVSH 61,357,525
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 23,534,313 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 84,891,838 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 22.12.2023 Përfundimi punimeve: 17.09.2024	**19. Zgjatja e kontratës** -Amendim kontrate me nr. 374/8 prot., datë 06.08.2024
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE " *P.C.* & *Z.*" SHPK	Licenca MK.0899/19	Kontratë me nr. 3882/32 prot., datë 19.12.2023
21. Kolaudatori i punimeve Shoqëria "*M.*" SHPK	Licenca Nr: MK. 3119/5	Kontratë me nr. 4088/3 prot., datë 11.11.2024
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. --- prot., datë 02.12.2024 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*R.*" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*P.C.*" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*M.*"	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. --- prot., datë 27.12.2024 në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*R.*" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*P.C.*" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*M.*" SHPK si dhe grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: (K.I., A.I., A.L.) sipas urdhrit nr. 415, datë 24.07.2025.	

SHPK.	

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Pogradec, në vlerën **191,343 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Kategoria nr. 3. Kanalizime të ujërave atmosferike							-
Zëri 4(2.261).	Shtresë rëre	m3	1130	13.10	13.1	-	13.1	14,803
Zëri 7 (3.245/1).	Struktura të holla betoni C 25/30 për kuneta	m3	12890	59	59	57.872	1.128	14,540
	Kategoria nr. 4. Veprat e artit							-
Zëri 11(3.352).	Mbushje me material shkëmbor mbas mureve	m3	1620	100	100	-	100	162,000
	Totali në lekë pa TVSH							**191,343**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë "***R.*" SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;* - ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3*.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "***P.C.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;-* ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Znj. *V.G.,* në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

8. Kontrata për punë publike me objekt: "**Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I, vazhdim**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "**Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I**". REF-18495-09-10-2024		
14.Lidhja e kontratës. Nr. 3573/9 prot., datë 31.10.2024 OE fitues "*A.* " SHPK	**15.Vlera e kontratës** Vl e prev ofertues 10,804,812 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 8,413,200 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 2,391,612	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve:	**19. Zgjatja e kontratës** ---

lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 10,804,812 lekë me TVSH.	13.11.2024 Përfundimi punimeve: 07.01.2025	
20. Mbikëqyrësi i punimeve: OE " *P.C.* " SHPK	Licenca MK.0899/19	Kontratë me nr. 4443/9, datë 13.11.2024
21. Kolaudatori i punimeve OE "*M.*" SHPK	Licenca Nr: MK.1967/1	Kontratë me nr. 723/7 prot., datë 25.03.2025
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. --- prot., datë 07.04.2025 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*A.* SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*P.C.*" SHPK si dhe shoqërisë "*M.*" SHPK	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me me nr. --- prot., datë ---- në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*A."* SHPK, mbikëqyrësi i punimeve " *P.C.* " SHPK si dhe shoqërisë "*M.*" SHPK SHPK.	

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **Bashkisë Pogradec**, në vlerën **45,080 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 2(2.286).	Shtresë pllaka betoni dekorative C 25/30 6 cm mbi shtresë rëre/granil t=5 cm	m2	1420	920	920	920 m2 me çmim 1,371 lekë dhe jo me çmim 1420 lekë	-	45,080
	Totali në lekë pa TVSH							**45,080**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë **"*A.* " SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;* - ***Udhëzimin Nr. 2****, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3*.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "***P.C.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- ***Ligjit nr. 8402****, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;-* ***UKM Nr. 3****, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Znj. *V.G.,* në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

9. Kontrata për punë publike me objekt: "**Rikonstruksion dhe shtesa shkolla e mesme "14 Engjëjt" dhe shkolla 9-vjeçare "Servet Agolli", Buçimas, Pogradec**", me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës së mëposhtme,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion dhe shtesa shkolla e mesme "14 Engjëjt" dhe shkolla 9-vjeçare "Servet Agolli", Buçimas, Pogradec".		
14.Lidhja e kontratës: Nr. 3688/16 prot., datë 14.11.2022 OE fitues "*R."* SHPK	**15.Vlera e kontratës:** Vl e prev ofertues 139,314,684 lekë me TVSH.	**16.Likuiduar**: Sit. 1 në vlerën 37,333,334 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 25,002,550 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar Sit. përf në vlerën 76,978,800 lekë me TVSH. Punimet kanë përfunduar në vlerën 139,195,960 lekë me TVSH.	**18.Afati i kontratës në dite** Fillimi punimeve: 09.12.2022 Përfundimi punimeve: 09.08.2023	**19. Zgjatja e kontratës** -60 ditë
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE " *P.C.*" SHPK	Licenca MK. 0899/19	Kontratë me nr. 4548/23 prot., datë 09.12.2022
21. Kolaudatori i punimeve Shoqëria "*S. E.* " SHPK	Licenca Nr: MK. 3574/2	Kontratë me nr. 4532/3 prot., datë 10.11.2023
22.Akt Kolaudimi. -Me akt kolaudimin me nr. -- prot., datë 23.11.2023 është realizuar kolaudimi i objektit, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "*R."* SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*P.C.*" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*S. E.* " SHPK.	**23.Akt i marrjes në dorëzim:** -Me nr. --- prot., datë 13.12.2023 në Bashkisë Pogradec, dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE "R." SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "*P.C.*" SHPK si dhe kolaudatori Shoqëria "*S. E.* " SHPK si dhe grupi i marrjes në dorëzim i AK.	

U konstatua si vijon:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të **Bashkisë Pogradec**, në vlerën **314,300 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	I. Punime shtresash							-
Zëri 2(2.2 62/1).	Shtresë betoni C 7/10 t=10 cm niveluese	m3	11,600	90.35	90.35	73.20	17.15	198,940
	Shtesa 1							-
	VIII. Punime dyersh e Dritaresh							-
Zëri 3(2.3 83/1)	F.V Dyer të brendshme importi cilësi e I-rë	m2	21,400	16.20	16.20	16.2 m2 realizuar emçmim 14,279	-	115,360
	Totali në lekë pa TVSH							**314,300**

Nga ana e zbatuesit të punimeve shoqërisë "***R."* SHPK** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

*- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 8;- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve shoqërinë "***P.C.***" SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:
- Ligjit nr. 8402*, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7;- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Znj. *V.G.,* në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:
*Nga Auditimi i **9** (nëntë) kontratave për punë publike në vlerën **647,202,178** me TVSH, u konstatuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **2,202,585 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, **Kreu III, neni 7**, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, **respektivisht:***

***1. Vlera 104,800 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 695/13 prot., datë 12.05.2025 me objekt: "Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale" të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "R." SHPK.*
***2. Vlera 271,710 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 4324/6 prot., datë 11.12.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe (BOE) "I." SHPK & "L." SHPK.*
***3. Vlera 148,200 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 4530/12 prot., datë 27.12.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive (BOE) "A." SHPK Tiranë & "D." SHPK.*
***4. Vlera 350,000 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 162/10 prot., datë 08.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik (BOE) "R."SHPK dhe "A." SHPK.*
***5. Vlera 245,519 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 4531/11 prot., datë 18.12.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë" R." SHPK.*
***6. Vlera 531,633 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 1495/20 prot., datë 14.11.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "V.K." SHPK.*
***7. Vlera 191,343 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "R." SHPK.*
***8. Vlera 45,080 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 3573/9 prot., datë 31.10.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "A. " SHPK.*

9. Vlera 314,300 lekë pa TVSH, *përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike nr. 3688/16 prot., datë 14.11.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "R." SHPK.*

2.3. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

2.3.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

2.3.2. Auditim mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj.

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit me nr. 870/1 prot.; datë 11.09.2025, me objekt: *"**Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit",*** i ndryshuar, prej datës 01.01.2023 deri më 31.12.2025, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin *"e-lejet"*;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacion i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Pogradec ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** (këtu e në vazhdim PPV) dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (këtu e në vazhdim KKT) nr. 05, datë 27.07.2022, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

- Dhënia e lejes së zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura;
- Dhënia e lejes së ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi, zbatimi i treguesve parametrikë;
- Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë;
- Dhënia e certifikatës së përdorimit.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUDHËN 01.01.2023 - 31.12.2025

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Pogradec, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2023 deri në 31.12.2025**, ka pasur **659** aplikime në sistem (145 aplikime për vitin 2023; 236 aplikime për vitin 2024; 278 aplikime për vitin 2025) për lloje të ndryshme lejesh, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, sipas tipologjive të lejeve të aplikuara:

Tabela nr. 1: *Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2023-31.12.2023*

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	14	11	3
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	8	6	2
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	4	3	1

Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m^2	9	6	3
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m^2	3	-	3
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	4	3	1
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	53	33	20
Certifikatë përdorimi	15	6	9
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	6	3	3
Leje për ndryshim funksioni	1	1	-
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	6	2	4
Njoftim fillim punimesh	13	7	6
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	6	1	5
Leje infrastrukture	3	1	2

Tabela nr. 2: *Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2024-31.12.2024*

Lloji i lejes	**Total**	**Miratuar**	**Refuzuar**
Leje zhvillimi	35	17	18
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	6	5	1
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	7	5	2
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m^2	11	10	1
Leje ndërtimi për shtesë në nd. ekzistues me sip. më të madhe se 250 m^2	3	2	1
Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	1	-	1
Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	1	1	-
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	92	41	51
Certifikatë përdorimi	17	10	7
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	4	2	2
Leje për ndryshim funksioni	11	8	3
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	1	1	-
Njoftim fillim punimesh	36	26	10
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	4	2	2
Leje infrastrukture	7	4	3

Tabela nr. 3: *Aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2025-31.12.2025*

Lloji i lejes	**Total**	**Miratuar**	**Proces**
Leje zhvillimi	60	17	2
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m^2	10	4	1
Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2	14	8	3
Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sip. deri në 250 m^2	9	4	2
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	132	47	-
Leje rind., rikonst. dhe ripar. të nd. së dëmtuar pa shtim apo ndrysh. funk.	1	-	-
Certifikatë përdorimi	5	3	-
Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	5	2	1
Leje për ndryshim funksioni	5	2	1
Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	4	4	-
Njoftim fillim punimesh	26	9	-
Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	1	-	-
Leje infrastrukture	6	2	3

Burimi: *DPKZHT, Bashkia Pogradec* ***Përpunoi:*** *Grupi i auditimit*

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DPKZHT) e Bashkisë Pogradec, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në tabelën e mëposhtme:

Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2				
Nr.	**Emërtimi**	**Zhvilluesi**	**Preventivi**	**Sipërfaqe**
1	Strukturë akomoduese "Bujtina Mari", me 3 kate mbi tokë, me nënçati, me pishinë dhe mur rrethues	*E.E.*	20,600,601.96	585.76

2	Rindërtim dhe shtesë kati në objekt ekzistues (Qendër Historike) dhe ndërtim i ri (Zonë e Mbrojtur)	*E.P.*	18,859,048	503.40
3	Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë	"*E.*" ShPK	225,500,508.7	6,783.90
4	Magazinë për shërbime tregtare dhe biznesi, 2 kat	*H.D.*	40,202,356	1,291.00
5	Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nën tokë	"*F.C.*" ShPK	161,522,176	4,585.52
6	Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë	"*L.E.*"	193,679,000	5,927.00
7	Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë	"*A.*" ShPK	152,209,376	4,653.80
8	Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë	"*E.*" ShPK	257,599,576.9	7,809.27
9	Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë	"*A.A.*" ShPK	169,055,270.2	3,499.58
Certifikata Përdorimi				
Nr.	**Emërtimi**	**Zhvilluesi**		**Miratuar**
10	Ndërtesë 1-5 kate me çati dhe podrum, hoteleri dhe shërbime	"*G.*" ShPK		03.08.2023
11	Godinë banimi dhe shërbime 7 kate + çati e shfrytëzuar	"*L.K.*" ShPK		25.04.2024
12	Godinë rezidenciale (banimi) 9 kate + 1 kat nën tokë	"*E.*" ShPK		20.11.2024

Përveç rasteve të mësipërme, janë audituar dhe dy raste të tjera, për të cilat nuk janë konstatuar problematika. Këto raste janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2				
Nr.	**Emërtimi**	**Zhvilluesi**	**Preventivi**	**Sipërfaqe**
1	Banesë vetjake 2 kat + podrum	*D.T.*	10,145,209	310.40
Certifikata Përdorimi				
Nr.	**Emërtimi**	**Zhvilluesi**		**Miratuar**
2	Godinë me karakter hotelerie 4-5 kat + 1 kat nën tokë	"*E.*" ShPK		19.11.2024

Nga auditimi i rasteve të mësipërme, janë konstatuar problematikat si më poshtë vijon:

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit është konstatuar se në 11 raste (nga 14 raste të audituara), dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë. Gjithashtu, në tre raste është konstatuar se shqyrtimi i aplikimeve është kryer me afate të tejzgjatura. Në një rast është konstatuar se zhvilluesi nuk i ka filluar punimet brenda afateve ligjore. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për ***"Strukturë akomoduese "Bujtina Mari", me 3 kate mbi tokë, me nënçati, me pishinë dhe mur rrethues"***, miratuar me Vendim nr. 105, datë 06.07.2023, në favor të subjektit "*E.E.*" PF, me adresë në fshatin Tushemisht, Njësia Administrative Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit hidraulik, të mbrojtjes nga zjarri dhe të impianteve të ngrohje / ftohje / ventilimit;
- Zhvilluesi nuk ka filluar punimet brenda afateve ligjore. Referuar nenit 40 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, afati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më i gjatë se 1 vit nga data e miratimit të lejes së ndërtimit. Nga kontrolli në sistemin elektronik të lejeve, si dhe nga informacioni i vendosur në dispozicion nga DPKZHT, nuk evidentohet asnjë dokument i miratuar në lidhje me aplikimin / konfirmimin për fillimin e punimeve. Në këto kushte, kjo leje ndërtimi e ka humbur vlefshmërinë e saj.

2. Leje ndërtimi për ***"Shtesë kati në objekt ekzistues (Qendër Historike) dhe ndërtim i ri (Zonë e Mbrojtur)"***, miratuar me Vendim nr. 112, datë 10.07.2023, në favor të subjektit "*E.P.*" PF, me adresë në rrugën "Naim Frashëri", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Dokumentet e ngarkuar nga restauratori z. *G.S.* nuk janë nënshkruar elektronikisht prej tij. Projekti arkitektonik është hartuar nga ark. *L.B.* dhe rest. *G.S.* Kjo bashkëautorësi është mbështetur në nenin nenin 10, pika 3 dhe nenin 11, pika 1 dhe pika 4 të VKM-së nr. 554, datë 18.6.2015 *"për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj"*, ku përcaktohet se projektet e ndërtimit në qendrën historike dhe zonën e mbrojtur duhet të hartohen nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve. Dokumentet e ngarkuar për z. *S.* janë: **i.** Deklarata e përgjegjësisë profesionale; **ii.** Deklarata e bashkëautorësisë; **iii.** Licenca e restauratorit. Asnjë prej këtyre dokumenteve nuk është i nënshkruar elektronikisht nga z. *S.*;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për bashkë-hartuesin e projektit arkitektonik, z. *G.S.*;
- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna dhe detaje për mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet (mure mbajtëse, pilota, palankola, etj.);
- Projekti elektrik për objektin 2 nuk është i plotë, pasi mungojnë: **i.** Instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike; **ii.** Detajet e montimit të sistemit rrufepritës; **iii.** Detajet e instalimeve elektrike; **iv.** Planimetritë e instalimeve të rrjetit të televizionit, telefonisë dhe citofonisë;
- Deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesit e projektit elektrik nuk është nënshkruar elektronikisht nga hartuesi i këtij projekti, por nga aplikanti. Licenca profesionale e hartuesit të këtij projekti nuk është e nënshkruar elektronikisht;
- Mungon kontrata e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit.

3. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 44, datë 11.03.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Vllazërimi", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 70 ditësh pune;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë / saktë, pasi: **i.** fasadat teknike nuk janë të materializuara; **ii.** dy prej posteve të parkimit nuk plotësojnë kushtin minimal të lartësisë dysheme – tavan;
- Mungon kontrata e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit.

4. Leje ndërtimi për ***"Magazinë për shërbime tregtare dhe biznesi, 2 kat, me mur rrethues"***, miratuar me Vendim nr. 92, datë 30.04.2024, në favor të subjektit "*H.D.*" PF, me adresë në fshatin Vërdovë, Nj. Adm. Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 74 ditësh pune;
- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi: **i.** mungojnë detajet e elementeve konstruktivë të strukturës; **ii.** fasadat teknike janë të pa-materializuara;
- Mungon kontrata e sigurimit, me përfitues autoritetin publik përgjegjës për miratimin e lejes së ndërtimit.

5. Leje ndërtimi për ***"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 148, datë 12.06.2024, në favor të subjektit "*F.C.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale e hartuesit të projektit arkitektonik;
- Projekti arkitektonik (në lidhje me katin nëntokë) nuk është i saktë. Të paktën tre prej posteve të parkimit nuk janë fizikisht të aksesueshme. Për postin G28, është e pamundur parkimi i një automjeti; për postin G30 nuk ka lartësi për të hyrë automjeti

apo njeriu (lartësia është 140 cm, për shkak të pjerrësisë së rampës); për postin G31, bie ndesh me fillimin e shkallës.

6 . Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 196, datë 26.08.2024, në favor të subjekteve "*L.K.*" & "*E.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon një prerje teknike (nga dy që duhet të ishin);
- Projekti konstruktiv nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna dhe detaje për mbrojtjen e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet (mure mbajtëse, pilota, palankola, etj.).

7. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 48, datë 27.02.2025, në favor të subjektit "*A.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 70 ditësh pune.

8. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 229, datë 30.07.2025, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Mendu Zavalani", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna mbi lidhje e rrjetit të furnizimit me ujë dhe shkarkimit të ujrave të zeza me rrjetin e qytetit.

9. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 327, datë 12.12.2025, në favor të subjekteve "*A.A.*" ShPK, me adresë në Rrugën e Volorekës, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti hidrosanitar nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhëna mbi lidhje e rrjetit të furnizimit me ujë dhe shkarkimit të ujrave të zeza me rrjetin e qytetit.

10. Certifikatë përdorimi për ***"Ndërtesë 1-5 kate me çati dhe podrum, hoteleri dhe shërbime"***, miratuar me Vendim nr. 121, datë 03.08.2023, në favor të subjektit "*G.*" ShPK, me adresë në fshatin Tushemisht, Nj. Adm. Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti as-built është i njëjtë me projektin e miratuar. Nga auditimi i këtyre dy projekteve konstatohet se ata janë të njëjtë, edhe pse janë konstatuar ndryshime midis objektit të miratuar dhe objektit të zbatuar.

11. Certifikatë përdorimi për ***"Godinë me karakter hotelerie 4-5 kat + 1 kat nën tokë"***, miratuar me Vendim nr. 285, datë 19.11.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në fshatin Tushemisht, Nj. Adm. Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Raporti përfundimtar i auditimit të eficiencës së energjisë nuk është i plotë, pasi nuk është për të gjithë ambientet (parkim, shërbim, banim);
- Dokumentacioni si: **i.** polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar; **ii.** aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), të lëshuara nga shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane; **iii.** situacioni përfundimtar i punimeve; **iv.** projekti as-built; **v.** fotot e objektit të përfunduar në të gjitha drejtimet; **vi.** kontrata midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve; **vii.** projekti për mirëmbajtjen e objektit; **viii. c**ertifikimi i montimit të ashensorëve; **ix.** certifikatat përfundimtare të performancës së energjisë dhe deklarata e përgjegjësisë profesionale të audituesit të licencuar; nuk është ngarkuar elektronikisht në sistemin elektronik të lejeve, por janë dorëzuar fizikisht në protokollin e Bashkisë Pogradec.

<u>Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me:</u>

- Ligji nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, neni 39; neni 44, pika 2;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ç), e), ë), g); neni 15, pika 1/1, nënpika i), ii) iii),iv), v); neni 20, pika 2, nënpika a); neni 21; neni 26, pika 5; neni 27/2, pika 1, nënpika e), ë), g), gj), h), i), j), l), ll); neni 45/1, pika 3.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit të trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. *I.XH.*,** me funksion Kryetar i Bashkisë Pogradec *(për rastet 1-12)*;
- **Z. P.Z.,** me funksion drejtor i DPKZHT *(për rastet 1-12)*;
- **Znj. *F.Z.*,** me funksion përgjegjëse e kontrollit të dokumentacionit të kërkesave *(për rastet 1-12)*;
- **Z. *T.F*,,** me funksion specialist / jurist *(për rastet 1-12)*;
- **Znj. *M.K.*,** me funksion specialist i kontrollit të dokumentacionit *(për rastet 10-12)*.

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, është konstatuar se në gjashtë raste (rastet 2, 5, 6, 7, 8, 9, nga dhjetë raste të audituara), Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Pogradec nuk ka kërkuar / respektuar mendimin e të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6, DPKZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Në gjashtë raste, nga ana e DV ASHK nuk është kthyer asnjë përgjigje, duke e miratuar në heshtje kërkesën për mendim, edhe pse në dispozitat ligjore specifikohet se kjo drejtori nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë / kartelat e pasurive. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më lartë cituar, është konstatuar se:

1. Leje ndërtimi për ***"Strukturë akomoduese "Bujtina Mari", me 3 kate mbi tokë, me nënçati, me pishinë dhe mur rrethues"***, miratuar me Vendim nr. 105, datë 06.07.2023, në favor të subjektit "*E.E.*" PF, me adresë në fshatin Tushemisht, Njësia Administrative Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:
- DV ASHK nuk ka kthyer asnjë përgjigje, duke e miratuar në heshtje kërkesën për mendim.

2. Leje ndërtimi për ***"Shtesë kati në objekt ekzistues (Qendër Historike) dhe ndërtim i ri (Zonë e Mbrojtur)"***, miratuar me Vendim nr. 112, datë 10.07.2023, në favor të subjektit "*E.P.*" PF, me adresë në rrugën "Naim Frashëri", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:
- DV ASHK nuk ka kthyer asnjë përgjigje, duke e miratuar në heshtje kërkesën për mendim;
- Zhvilluesi ka aplikuar për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, nëpërmjet aplikimit me nr. *AN010920240008*, i cili është miratuar. Gjatë shqyrtimit të këtij aplikimi është kërkuar mendimi vetëm i DV ASHK, e cila ka miratuar në heshtje. Nuk është kërkuar mendimi Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

3. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 44, datë 11.03.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Vllazërimi", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- DV ASHK nuk ka kthyer asnjë përgjigje, duke e miratuar në heshtje kërkesën për mendim.

4. Leje ndërtimi për ***"Magazinë për shërbime tregtare dhe biznesi, 2 kat, me mur rrethues"***, miratuar me Vendim nr. 92, datë 30.04.2024, në favor të subjektit "*H.D.*" PF, me adresë në fshatin Vërdovë, Nj. Adm. Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- DV ASHK nuk ka kthyer asnjë përgjigje, duke e miratuar në heshtje kërkesën për mendim.

5. Leje ndërtimi për ***"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 148, datë 12.06.2024, në favor të subjektit "*F.C.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- DV ASHK nuk ka kthyer asnjë përgjigje, duke e miratuar në heshtje kërkesën për mendim;
- Nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet e UPT IGJEUM. Në kthim-përgjigjen e datës 31.05.2024 (sipas nënshkrimit elektronik), me lëndë *"Dhënie mendimi"*, UPT IGJEUM është shprehur se kërkohet së paku plotësimi i kërkesave: *"**1.** Për vlerësimin e parametrit Vs30 duhet që në sheshin e ndërtimit të realizohen matje sizmike me një nga metodat: MASË. doën- hole, cross-hole. Këto matje duhet të jenë të dokumentuara në raportin përkatës. **2.** Vlerësimi i nxitimit maksimal të vibrimit të truallit për periudhë përsëritje 475 vjet. **3.** Vlerësimi i nxitimit maksimal të vibrimit të truallit për periudhë përsëritje 95 vjet. **4.** Spektrat elastikë horizontalë dhe vertikale të reagimit për periudhë përsëritje 95 dhe 475 vjet, të vlefshëm për projektin e objektit në funksion të kategorisë së truallit sipas standardit të Eurokodit 8"*. Këto rekomandime nuk janë marrë në konsideratë, pasi nuk ka ndonjë dokument të ngarkuar nga aplikanti pas datës 31.05.2024.
- Nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit për të marrë konfirmimin se rekomandimet e lëna nga ky autoritet në oponencën teknike janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në projektin ndërtimor.

6. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 196, datë 26.08.2024, në favor të subjekteve "*L.K.*" & "*E.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- DV ASHK nuk ka kthyer asnjë përgjigje, duke e miratuar në heshtje kërkesën për mendim;
- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë për Zhvillimin e Territorit. Objekti zhvillohet në Zonë me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, referuar VKM-së nr. 01, datë 26.07.2018 *"Për shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e RSH"* dhe hartës bashkëlidhur. Referuar këtij përcaktimin, zhvilluesit që aplikojnë për pajisje me leje ndërtimi në këto zona duhet që të marrin mendim pozitiv nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në përputhje me pikën 3 të VKM-së nr. 41, datë 03.12.2020 *"Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të mbrojtura dhe zonave me përparësi zhvillimin e turizmit"*. DPKZHT ka njoftuar aplikantin dhe zhvilluesin se duhet të kërkojnë mendimin e autoriteteve me anë të shkresës me lëndë *"Mbi plotësinë e dokumentacionit të kërkesës"*, datë 14.06.2024 (sipas nënshkrimit elektronik). Në këtë shkresë nuk është përmendur AZHT.

7. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 48, datë 27.02.2025, në favor të subjektit "*A.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST);

- Nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit për të marrë konfirmimin se rekomandimet e lëna nga ky autoritet në oponencën teknike janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në projektin ndërtimor.

8. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 229, datë 30.07.2025, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Mendu Zavalani", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit për të marrë konfirmimin se rekomandimet e lëna nga ky autoritet në oponencën teknike janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në projektin ndërtimor.

9. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 327, datë 12.12.2025, në favor të subjekteve "*A.A.*" ShPK, me adresë në Rrugën e Volorekës, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit për të marrë konfirmimin se rekomandimet e lëna nga ky autoritet në oponencën teknike janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në projektin ndërtimor;
- Nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Gjeoshkencave (UPT IGJEUM);
- Nuk është kërkuar mendimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Objekti i miratuar zhvillohet në Zonë me Përparësi, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe hartës bashkëlidhur. Referuar përcaktimeve të Vendimit nr. 41, datë 03.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, pika 3, nënpika b) dhe c), objektet të cilat zhvillohen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit duhet të marrin mendim pozitiv nga ***Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)*** për zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, si dhe akt përputhshmërie nga AZHT. Vlen të theksohet se me anë të shkresës me lëndë *"Mbi plotësinë e dokumentacionit të kërkesës për "Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2" nr. AN090920250069, datë 09.09.2025 me aplikues "I. R. S" Sh.p.k dhe zhvillues "A. " Sh.p.k, "A.Gj." Sh.p.k.*, Bashkia Pogradec e ka njoftuar aplikantin dhe zhvilluesin se duhet të marrin mendimin, ndër të tjera, dhe të MTM e UPT IGJEUM. Aplikanti dhe zhvilluesi nuk e kanë kërkuar mendimin e këtyre autoriteteve.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. *I.XH.*,** me funksion Kryetar i Bashkisë Pogradec *(për rastet 2, 5-9)*;
- **Z. P.Z.,** me funksion drejtor i DPKZHT *(për rastet 2, 5-9)*;
- **Znj. *F.Z.*,** me funksion përgjegjëse e kontrollit të dokumentacionit të kërkesave *(për rastet 2, 5-9)*;
- **Z. *T.F.*,** me funksion specialist / jurist *(për rastet 2, 5-9)*.

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit është konstatuar se në pesë raste (nga dhjetë raste të audituara), nuk është respektuar numri minimal i vend-parkimeve ose nuk është respektuar Koeficienti i Shfrytëzimit të Territorit (KSHT). Për të pesta rastet, zhvilluesit dhe projektuesit kanë parashikuar vend-parkime si në katin nëntokësor, po ashtu dhe në kuotën e sistemimit. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është specifikuar nëse këto vend-parkime janë për shitje apo për përdorim publik. ***Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për shitje***, atëherë nuk është respektuar Koeficienti i Shfrytëzimit të Territorit. ***Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për përdorim publik***, atëherë parkimet në kuotën e sistemimit nuk do të duhej të merreshin në konsideratë në përllogaritjen e numrit faktik të vend-parkimeve. Nëse i referohemi nenit 5 të Ligjit nr. 10 112, datë 09.04.2009 *"Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"*, pika 1, marrim informacionin se objekte në pronësi

të përbashkët janë të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë. Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, që nuk janë destinuar për përdorim individual dhe nuk janë pronë publike, si truallin, mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimin, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

3. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 44, datë 11.03.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Vllazërimi", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi dhe projektuesi kanë parashikuar vend-parkime si në katin nëntokësor (45 vend-parkime), po ashtu dhe në kuotën e sistemimit (15 vend-parkime). Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është specifikuar nëse këto vend-parkime janë për shitje apo për përdorim publik.

  Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për shitje, atëherë nuk është respektuar Koeficienti i Shfrytëzimit të Territorit. Parcelat që zhvillohen kanë një sipërfaqe totale prej 1,842 m^2. Sipërfaqja e katit përdhe e objektit në zhvillim është 732.8 m^2. Sipërfaqja e zënë nga parkimet në kuotën e sistemimit është 187 m^2. Nëse i referohemi nenit 5 të Ligjit nr. 10 112, datë 09.04.2009 *"Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"*, pika 1, marrim informacionin se objekte në pronësi të përbashkët janë të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë. Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, që nuk janë destinuar për përdorim individual dhe nuk janë pronë publike, si truallin, mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimin, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat. Duke marrë në konsideratë dhe sipërfaqen e parkimeve të hapura, KSHT do të ishte: (732.8 + 187) / 1842 = 50%, pra më e madhe se KSHT e lejuar për njësinë strukturore (40%).

  Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për përdorim publik, atëherë parkimet në kuotën e sistemimit nuk do të duhej të merreshin në konsideratë në përllogaritjen e numrit faktik të vend-parkimeve. Referuar nenin 26 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pogradec, pika 5, marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat e banimit është 1 vend-parkim / apartament, ndërsa për hapësirat e shërbimit është 1 vend-parkim / 100 m^2. Referuar këtyre përcaktimeve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, ku rezulton se numri total i apartamenteve është 63. Si rrjedhim, numri minimal i vendparkimeve do të duhej të ishte 63. Duke marrë në konsideratë përcaktimet e nenit 5 të Ligjit nr. 10 112, datë 09.04.2009 *"Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"*, pika 1, shprehemi se nuk është respektuar numri minimal i vend-parkimeve. Numri i vend-parkimeve ekzistuese është 43.

5. Leje ndërtimi për ***"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 148, datë 12.06.2024, në favor të subjektit "*F.C.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi dhe projektuesi kanë parashikuar vend-parkime si në katin nëntokësor (35 vend-parkime), po ashtu dhe në kuotën e sistemimit (13 vend-parkime). Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është specifikuar nëse këto vend-parkime janë për shitje apo për përdorim publik.

  Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për shitje, atëherë nuk është respektuar KSHT. Parcela që zhvillohet ka një sipërfaqe totale prej 1,439 m^2. Sipërfaqja e katit përdhe e objektit në zhvillim është 593.5 m^2. Sipërfaqja e zënë nga parkimet në kuotën e

sistemimit është 178.1 m^2. Duke marrë në konsideratë dhe sipërfaqen e parkimeve të hapura, KSHT do të ishte: (593.5 + 178.1) / 1,439 = 53.6%, pra më e madhe se KSHT e lejuar për njësinë strukturore (45%).

Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për përdorim publik, atëherë nuk është respektuar numri minimal i lejuar i vendparkimeve. Numri total i apartamenteve është 44, ndërsa sipërfaqja e dedikuar për shërbime është 304.9 m^2 (për të cilën nevojiten 4 vend-parkime). Pra, numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 48. Numri i vend-parkimeve ekzistuese në katin nëntokë është 35.

6. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 196, datë 26.08.2024, në favor të subjekteve "*L.K.*" & "*E.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi dhe projektuesi kanë parashikuar vend-parkime si në katin nëntokësor (42 vend-parkime), po ashtu dhe në kuotën e sistemimit (17 vend-parkime). Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është specifikuar nëse këto vend-parkime janë për shitje apo për përdorim publik.

  Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për shitje, atëherë nuk është respektuar KSHT. Parcela që zhvillohet ka një sipërfaqe totale prej 1,867 m^2. Sipërfaqja e katit përdhe e objektit në zhvillim është 777.9 m^2. Sipërfaqja e zënë nga parkimet në kuotën e sistemimit është 215 m^2. Duke marrë në konsideratë dhe sipërfaqen e parkimeve të hapura, KSHT do të ishte: (777.9 + 215) / 1,867 = 53%, pra më e madhe se KSHT e lejuar për njësinë strukturore (45%).

  Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për përdorim publik, atëherë nuk është respektuar numri minimal i lejuar i vendparkimeve. Numri total i apartamenteve është 49. Pra, numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 49. Numri i vend-parkimeve ekzistuese në katin nëntokë është 42.

7. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 48, datë 27.02.2025, në favor të subjektit "*A.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi dhe projektuesi kanë parashikuar vend-parkime si në katin nëntokësor (43 vend-parkime), po ashtu dhe në kuotën e sistemimit (15 vend-parkime). Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është specifikuar nëse këto vend-parkime janë për shitje apo për përdorim publik.

  Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për shitje, atëherë nuk është respektuar KSHT. Parcela që zhvillohet ka një sipërfaqe totale prej 1,698 m^2. Sipërfaqja e katit përdhe e objektit në zhvillim është 612.5 m^2. Sipërfaqja e zënë nga parkimet në kuotën e sistemimit është 198.5 m^2. Duke marrë në konsideratë dhe sipërfaqen e parkimeve të hapura, KSHT do të ishte: (612.5 + 198.5) / 1,698 = 47.5%, pra më e madhe se KSHT e lejuar për njësinë strukturore (45%).

  Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për përdorim publik, atëherë nuk është respektuar numri minimal i lejuar i vendparkimeve. Numri total i apartamenteve është 43. Pra, numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 43. Numri i vend-parkimeve ekzistuese në katin nëntokë është 32.

8. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 229, datë 30.07.2025, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Mendu Zavalani", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi dhe projektuesi kanë parashikuar vend-parkime si në katin nëntokësor (60 vend-parkime), po ashtu dhe në kuotën e sistemimit (27 vend-parkime). Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është specifikuar nëse këto vend-parkime janë për shitje apo për përdorim publik.

Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për shitje, atëherë nuk është respektuar KSHT. Parcela që zhvillohet ka një sipërfaqe totale prej 2,620 m^2. Sipërfaqja e katit përdhe e objektit në zhvillim është 978.78 m^2. Sipërfaqja e zënë nga parkimet në kuotën e sistemimit është 270 m^2. Duke marrë në konsideratë dhe sipërfaqen e parkimeve të hapura, KSHT do të ishte: (978.78 + 270) / 2,620 = 47.6%, pra më e madhe se KSHT e lejuar për njësinë strukturore (40%).

Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për përdorim publik, atëherë nuk është respektuar numri minimal i lejuar i vendparkimeve. Numri total i apartamenteve është 87. Pra, numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 87. Numri i vend-parkimeve ekzistuese në katin nëntokë është 60.

Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. *I.XH.*,** me funksion Kryetar i Bashkisë Pogradec *(për rastet 3, 5, 6, 7, 8)*;
- **Z. P.Z.,** me funksion drejtor i DPKZHT *(për rastet 3, 5, 6, 7, 8)*;
- **Znj. *F.Z.*,** me funksion përgjegjëse e kontrollit të dokumentacionit të kërkesave *(për rastet 3, 5, 6, 7, 8)*;
- **Z. *T.F.*,** me funksion specialist / jurist *(për rastet 3, 5, 6, 7, 8)*.

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të pardorimit është konstatuar se në gjashtë raste (nga katërmbëdhjetë raste të audituara) metodologjia e përllogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI), referuar paketës fiskale, nuk është e saktë. Në paketën fiskale të Bashkisë Pogradec nuk është parashikuar përllogaritja e TNI-së me dy mënyra (mbi preventiv dhe mbi vlerën e shitjes, dhe më pas të merret në konsideratë ajo metodologji që jep vlerën më të lartë), por vetëm sipas mënyrës së parë (mbi preventiv). Sipas VKB-së nr. 132, datë 22.11.2022, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec"*, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi dhe shërbimi është **4-5%** mbi vlerën e preventivit. Referuar nenit 46 të Ligjit 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, si rrjedhojë, nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për *"Sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, pika 1, marrim informacionin se: *"Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri."*. Pra, në paketën fiskale nuk është parashikuar përllogaritja e TNI-së me dy mënyra (sipas preventivit dhe sipas vlerës në lekë të çmimit të shitjes). Çmimi mesatar referues i shitblerjes në qytetin e Pogradecit është 49,900 lekë/m^2. Këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

3. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 44, datë 11.03.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Vllazërimi", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 225,500,508.72 lekë. Duke marrë në konsideratë përcaktimet e paketës fiskale, rezulton se TNI është përllogaritur e saktë (225,500,508.72 lekë * 4% = 9,020,020.34 lekë). Por, përcaktimet e paketës fiskale nuk janë të harmonizuara me dispozitat ligjore. Nëse do të llogarisim vlerën e TNI-së sipas mënyrës së dytë, kemi:

	Sip. totale	**Vlera e shitjes/investimit sipas EKB**	**Vlera në % e TNI-së**	**Koefic.**	**Totali**
Parkim	1,654.3	49.900 lekë	4%	0.7	2,311,387 lekë
Banim	5,129.6	49.900 lekë	4%	1	10,238,681 lekë
TOTALI					**12,550,068 lekë**

Vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Pogradec është **9,020,020 lekë**. Diferenca midis vlerës së llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Pogradec është **3,530,048 lekë**.

5. Leje ndërtimi për ***"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 148, datë 12.06.2024, në favor të subjektit "*F.C.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 161,522,176 lekë. Duke marrë në konsideratë përcaktimet e paketës fiskale, rezulton se TNI është përllogaritur e saktë (161,522,176 lekë * 5% = 8,076,109 lekë). Por, përcaktimet e paketës fiskale nuk janë të harmonizuara me dispozitat ligjore. Nëse do të llogarisim vlerën e TNI-së sipas mënyrës së dytë, kemi:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koefic.	Totali
Parkim	1,024	49.900 lekë	5%	0.7	1,788,416 lekë
Shërbime	304.9	49.900 lekë	5%	1.5	1,141,088 lekë
Banim	3,248.8	49.900 lekë	5%	1	8,105,756 lekë
TOTALI					**11,035,260 lekë**

Vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Pogradec është **8,076,109 lekë**. Diferenca midis vlerës së llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Pogradec është **2,959,151 lekë**.

6. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 196, datë 26.08.2024, në favor të subjekteve "*L.K.*" & "*E.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 193,679,000 lekë. Duke marrë në konsideratë përcaktimet e paketës fiskale, rezulton se TNI është përllogaritur e saktë (193,679,000 lekë * 5% = 9,683,950 lekë). Por, përcaktimet e paketës fiskale nuk janë të harmonizuara me dispozitat ligjore. Nëse do të llogarisim vlerën e TNI-së sipas mënyrës së dytë, kemi:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koefic.	Totali
Parkim	1,259.63	49.900 lekë	5%	0.7	2,199,943 lekë
Banim	4,667.4	49.900 lekë	5%	1	11,645,163 lekë
TOTALI					**13,235,203 lekë**

Vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Pogradec është **9,683,540 lekë**. Diferenca midis vlerës së llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Pogradec është **3,551,663 lekë**.

7. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 48, datë 27.02.2025, në favor të subjektit "*A.*" ShPK, me adresë në Rrugën e "Drilonit", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 152,209,376 lekë. Duke marrë në konsideratë përcaktimet e paketës fiskale, rezulton se TNI është përllogaritur e saktë (152,209,376 lekë * 4% = 6,088,375 lekë). Por, përcaktimet e paketës fiskale nuk janë të harmonizuara me dispozitat ligjore. Nëse do të llogarisim vlerën e TNI-së sipas mënyrës së dytë, kemi:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	984	49.900 lekë	4%	0.7	1,374,844 lekë
Banim	3,685.2	49.900 lekë	4%	1	7,355,659 lekë
TOTALI					**8,730,503 lekë**

Vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Pogradec është **6,088,375 lekë**. Diferenca midis vlerës së llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Pogradec është **2,642,128 lekë**.

8. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 229, datë 30.07.2025, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në rrugën "Mendu Zavalani", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 257,599,576.93 lekë. Duke marrë në konsideratë përcaktimet e paketës fiskale, rezulton se TNI është përllogaritur e saktë (257,599,576.93 lekë * 4% = 10,303,983 lekë). Por, përcaktimet e paketës fiskale nuk janë të harmonizuara me dispozitat ligjore. Nëse do të llogarisim vlerën e TNI-së sipas mënyrës së dytë, kemi:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	1,521.95	49.900 lekë	4%	0.7	2,126,468 lekë
Banim	6,388.54	49.900 lekë	4%	1	12,751,525 lekë
TOTALI					**14,877,994 lekë**

Vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Pogradec është **10,303,983 lekë**. Diferenca midis vlerës së llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Pogradec është **4,574,011 lekë**.

9. Leje ndërtimi për ***"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"***, miratuar me Vendim nr. 327, datë 12.12.2025, në favor të subjekteve "*A.A.*" ShPK, me adresë në Rrugën e Volorekës, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 169,055,270.22 lekë. Duke marrë në konsideratë përcaktimet e paketës fiskale, rezulton se TNI është përllogaritur e saktë (169,055,270.22 lekë * 4% = 6,762,210 lekë). Por, përcaktimet e paketës fiskale nuk janë të harmonizuara me dispozitat ligjore. Nëse do të llogarisim vlerën e TNI-së sipas mënyrës së dytë, kemi:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Parkim	756.21	49.900 lekë	4%	0.7	1,056,576 lekë
Banim	2,743.37	49.900 lekë	4%	1	5,475,766 lekë
TOTALI					**6,532,342 lekë**

Vlera e TNI-së e përllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Pogradec është **4,106,770 lekë**. Diferenca midis vlerës së llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Pogradec është **2,425,572 lekë**.

12. Certifikatë përdorimi për ***"Godinë rezidenciale (banimi) 9 kate + 1 kat nën tokë"***, miratuar me Vendim nr. 289, datë 20.11.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në lagjen nr. 1, rruga "Mihal Ballkameno", Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:

- Për këtë objekt Bashkia Pogradec ka përllogaritur TNI-në duke u bazuar tek vlera e preventivit, sipas llogarisë: 70,588,045 lekë * 3% = 2,117,641 lekë. Duke marrë në konsideratë faktin se përcaktimet e paketës fiskale nuk janë të harmonizuara me dispozitat ligjore, grupi i auditimit ka ri-llogaritur vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas metodologjisë *"Vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri"*:

	Sip. totale	Vlera e shitjes/investimit sipas EKB	Vlera në % e TNI-së	Koeficienti	Totali
Depo	202.5	49.900 lekë	4%	0.7	282,933 lekë
Banim	1,915.8	49.900 lekë	4%	1	3,823,936.8 lekë
TOTALI					**4,106,869.8 lekë**

Diferenca midis vlerës së llogaritur nga grupi i auditimit dhe asaj të llogaritur nga Bashkia Pogradec është **1,973,750.8 lekë** (4,106,869.8 lekë - 2,117,641 lekë - 15,478 lekë).

Për mangësitë në evidentimin e përputhshmërisë së paketës fiskale të Bashkisë Pogradec me dispozitat ligjore, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Znj. E.K.,** me funksion drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore Dhe Prokurimeve Publike *(për rastet 3, 5, 6, 7, 8, 9, 12)*;
- **Znj. *A.P.* ,** me funksion drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore *(për rastet 3, 5, 6, 7, 8, 9, 12).*

➢ Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të pardorimit është konstatuar se, në dy raste (nga katër raste të audituara), DPKZHT në bashkëpunim me IMTV nuk kanë marrë të gjitha masat për kryerjen e verifikimeve përpara pajisjes me certifikatë përdorimi. Më konkretisht, këto parregullsi kanë të bëjnë me:

10. Certifikatë përdorimi për ***"Ndërtesë 1-5 kate me çati dhe podrum, hoteleri dhe shërbime"***, miratuar me Vendim nr. 121, datë 03.08.2023, në favor të subjektit "*G.*" ShPK, me adresë në fshatin Tushemisht, Nj. Adm. Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Vendosja e objektit në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit është i ndaluar dhe i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika f), ku citohet: *"Përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë"*. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, si dhe referuar informacionit të kërkuar nga DPKZHT dhe IMTV, Bashkia Pogradec, nuk janë kryer inspektime dhe nuk janë marrë masa për adresimin e kësaj kundërvajtje.
- Objekti i miratuar ka ndyshime nga objekti i zbatuar. Nga auditimi i projektit të miratuar, fotove të ngarkuara në sistemin *e-lejet*, si dhe inspektimit në terren, janë konstatuar ndryshime midis objektit të miratuar dhe objektit të zbatuar. Këto ndryshime evidentohen në fasadën lindore (çarje në katin përdhe, çarje në katin përdhe e mbyllur me qepen, dritare të shtuara në katin përdhe). Veprimet e mësipërme janë të ndaluar dhe të dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e).





11. Certifikatë përdorimi për ***"Godinë me karakter hotelerie 4-5 kat + 1 kat nën tokë"***, miratuar me Vendim nr. 285, datë 19.11.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, me adresë në fshatin Tushemisht, Nj. Adm. Buçimas, Pogradec, me problematika si më poshtë vijon:
- Objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Vendosja e objektit në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit është i ndaluar dhe i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika f), ku citohet: *"Përdorimi i objektit pa*

lëshimin e certifikatës së përdorimit dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë". Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, si dhe referuar informacionit të kërkuar nga DPKZHT dhe IMTV, Bashkia Pogradec, nuk janë kryer inspektime dhe nuk janë marrë masa për adresimin e kësaj kundërvajtje.
Për gjetjet e konstatuara në lidhje me procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit të trajtuara më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. *I.XH.*,** me funksion Kryetar i Bashkisë Pogradec *(për rastet 10 dhe 11)*;
- **Z. P.Z.,** me funksion drejtor i DPKZHT *(për rastet 10 dhe 11)*;
- **Znj. *F.Z.*,** me funksion përgjegjëse e kontrollit të dokumentacionit të kërkesave *(për rastet 10 dhe 11)*;
- **Z. *T.F*,,** me funksion specialist / jurist *(për rastet 10 dhe 11)*;
- **Znj. *M.K.*,** me funksion specialist i kontrollit të dokumentacionit *(për rastet 10 dhe 11)*.

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit:
1. Nga auditimi i procedurave për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit rezultoi se në 11 nga 14 rastet e verifikuara dokumentacioni teknik dhe administrativ nuk ishte i plotë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. U konstatuan mungesa të policave të sigurimit profesional, deklaratave të përgjegjësisë, kontratave të sigurimit, mangësi në nënshkrimin elektronik të dokumenteve, si dhe mangësi në projektet arkitektonike, konstruktive, elektrike dhe hidrosanitare. Në tre raste, shqyrtimi i aplikimeve është kryer me tejkalim të afateve ligjore. Gjithashtu, në një rast zhvilluesi nuk ka filluar punimet brenda afatit të përcaktuar me ligj, duke sjellë humbjen e vlefshmërisë së lejes së ndërtimit. U evidentuan edhe raste të dokumentacionit të paplotë për certifikatat e përdorimit, përfshirë projekte "as-built" jo në përputhje me gjendjen faktike të objektit dhe mungesë të dokumenteve të detyrueshme teknike e ligjore në sistemin elektronik të lejeve.
2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit rezultoi se në 6 nga 10 rastet e verifikuara DPKZHT nuk ka kërkuar ose nuk ka respektuar mendimet e të gjitha autoriteteve kompetente që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve. Konkretisht, në 6 raste Drejtoria Vendore e ASHK-së nuk ka kthyer përgjigje dhe kërkesa për mendim është konsideruar e miratuar në heshtje, pa u administruar dokumentacioni i detyrueshëm mbi statusin e pronësisë. Në 1 rast nuk janë kërkuar mendimet e MTTM, AKZM dhe AZHT, gjatë shqyrtimit të lejes për ndryshimin e projektit. Në 1 rast nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet e UPT-IGJEUM dhe nuk është kërkuar konfirmimi i Institutit të Ndërtimit mbi reflektimin e rekomandimeve të oponencës teknike. Në 1 rast nuk është kërkuar mendimi i AZHT. Gjithashtu, në 3 raste nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit, në 1 rast nuk është kërkuar mendimi i OST; në 1 rast nuk janë kërkuar mendimet e UPT-IGJEUM dhe MTM.
3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit rezultoi se në 5 nga 10 rastet e audituara nuk është respektuar numri minimal i vend-parkimeve / KSHT. Në të pesë rastet, projektet kanë parashikuar vend-parkime si në katet nëntokësore ashtu edhe në kuotën e sistemimit, pa përcaktuar nëse këto parkime do të ishin për shitje apo për përdorim publik. Si pasojë, nëse parkimet në kuotën e sistemimit konsiderohen për shitje, rezulton tejkalim i KSHT-së së lejuar, ndërsa nëse konsiderohen për përdorim publik, nuk plotësohet numri minimal i detyrueshëm i vend-parkimeve.
4. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit rezultoi se në 6 nga 14 rastet e verifikuara metodologjia e përdorur për përllogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. U konstatua se Bashkia Pogradec e ka llogaritur TNI-në vetëm mbi bazën e vlerës së preventivit, sipas paketës fiskale vendore, ndërkohë që

legjislacioni parashikon që baza e taksës të përcaktohet sipas vlerës më të lartë që rezulton nga krahasimi ndërmjet preventivit dhe vlerës së shitjes së investimit për metër katror. Diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit variojnë nga 1,973,751 lekë deri në 4,574,011 lekë për rast. Kjo situatë vjen si pasojë e mos-harmonizimit të paketës fiskale të Bashkisë Pogradec me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 dhe Ligjit nr. 9632/2006.
5. Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit rezultoi se në 2 nga 4 rastet e audituara, DPKZHT në bashkëpunim me IMTV nuk kanë marrë masat e nevojshme për kryerjen e verifikimeve dhe inspektimeve përpara pajisjes me certifikatë përdorimi. Në të dy rastet është konstatuar se objektet janë vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Në një rast janë konstatuar ndryshime midis objektit të miratuar dhe atij të zbatuar.

2.4. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
2.4.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi
2.4.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilat kanë kryer kundërvatje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.
2.4.3. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërin e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Në zbatim të pikës 4 (katër) *"Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025"*, të programit të auditimit nr. 870/1 prot.; datë 11.09.2025, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes;
- Vendimet e masave administrative (gjobave);
- Vendimet e pezullimeve të punimeve;
- Vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme;
- Planet mujore, tremujore dhe/ose vjeçare të punës;
- Dokumentacioni i IMTV-së në lidhje me gjobat e vendosura, arkëtimet, urdhrat ekzekutivë, vendimet e gjykatës etj;
- Dokumentacioni financiar në lidhje me kontabilizimin dhe arkëtimet e gjobave;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga IMTV dhe Drejtoria e Financës.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 *"Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme"*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 *"Për kundërvajtjet administrative"*;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore"*;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *"Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".*

Për kryerjen e aktivitetit të tij, IMTV, Bashkia Pogradec disponon vetëm një automjet për nevoja të inspektimit ditor. Për ekzekutimin e vendimeve të prishjes, Bashkia Pogradec nuk

disponon mjet. Për ekzekutimin e këtyre vendimeve, IMTV, Bashkia Pogradec ka bashkëpunuar me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, dhe përputhshmërisë me dispozitat ligjore, konstatohet se:

2.4.1 Mbi strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

Referuar strukturës organizative të Bashkisë Pogradec për vitin 2023 – 2024 - 2025 dhe informacionit të kërkuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore**,** në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, rezulton se: është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Struktura e miratuar e IMTV ka në përbërjen e saj 6 pozicione pune, nga të cilët 1 Kryeinspektor dhe 5 inspektorë. Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, struktura organizative e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor është miratuar me:
- Vendim nr. 15, datë 20.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Pogradec;
- Vendim nr. 09, datë 11.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Pogradec;
- Vendim nr. 13, datë 20.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Pogradec;

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, IMTV ka pasur në strukturën e tij, punonjësit sipas tabelës në vijim:

Tabela nr. 2.4.1: *Struktura e IMTV, Bashkia Pogradec*

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni	Lloji i arsimit/dega	Data e emërimit	Data e largimit
1	*K.L.*	Kryeinspektor	Master Profesional në sistemet Moderne të TelekomuNcionit dhe Teknologjinë e Interentit	30.06.2025	Në punë
2	*G.SH.*	Inspektor	Arsim i Mesëm Industriale	14.04.2017	Në punë
3	*E.B.*	Inspektor	Arsim i Mesëm	16.07.2021	Në punë
4	*E.B.*	Inspektor	Bachelor, Studime Ligjore	25.10.2022	Në punë
5	*G.Ç.*	Inspektor	Bachelor, Juridik i Përgjithshëm	17.04.2020	Në punë
6	*H.H.*	Inspektor	Bachelor, Studime Ligjore	01.02.2025	Në punë
7	*N.Ç.*	Kryeinspektor	Master Shkencor, ne Marketing	13.10.2021	25.06.2025
8	*K.Ç.*	Drejtor / Inspektor	Master shkencor, Menaxhim Biznesi	02.07.2021	12.01.2024

Burimi: *Bashkia Pogradec* ***Përgatiti:*** *Grupi i auditimit*

Duke qenë se ka pasur ndryshime të shpeshta të kryeinspektorit të IMTV, lëvizjet janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër	Periudha
1	*N.Ç.*	13.01.2021 – 01.03.2023
2	*E.D.*	01.03.2023 – 01.06.2023
3	*N.Ç.*	01.06.2023 – 13.10.2023
4	*K.L.*	17.10.2023 – 23.01.2024
5	*N.Ç.*	23.01.2024 – 25.06.2025
6	*K.L.*	30.06.2025 – në vijim

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arsimin e nevojshëm profesional rezulton se në IMTV Bashkia Pogradec, para periudhës objekt auditimi dhe gjatë periudhës në auditim, është punësuar staf që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit,

arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Në IMTV Bashkia Pogradec janë punësuar staf me profil arsimor si: Master Profesional në sistemet Moderne të TelekomuNcionit dhe Teknologjinë e Interentit; Arsim i mesëm; Marketing; Akademia e Rendit; Menaxhim Biznesi. Inspektorët nuk kanë profilin e duhur arsimor për të ushtruar detyrën. Mungesa e stafit të kualifikuar sipas profilit përkatës, përbën element risku për cilësinë e kryerjes së punës të IMTV-së, për përcaktimin dhe përshkrimin teknik në aktet e kontrollit respektive të situatave të konstatuara gjatë inspektimit në terren.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- *Z. I.XH.*, me funksion Kryetar i Bashkisë Pogradec.

2.4.2 Mbi planifikimin e inspektimeve dhe raportimin periodik:

2.4.2.1 Mbi planifikimin e inspektimeve:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet t'i ushtrojë detyrat e tij funksionale në bazë të planeve mujore, tremujore dhe / ose vjeçare të punës, sipas planifikimit, i cili hartohet nga kryeinspektori i IMTV-së, në zbatim të VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii. Nga grupi i auditimit është kërkuar dokumentacion dhe informacion mbi hartimin e tyre, në mënyrë periodike dhe përcjelljen tek strukturat e varësisë.
Nga IMTV Bashkia Pogradec janë vendosur në dispozicion të grupit të auditimit planet e punës për periudhën Nëntor 2023 – Dhjetor 2024, ndërkohë që për periudhën 01.01.2023 – 31.10.2023 dhe 01.01.2025 – 31.12.2025 planet e punës nuk janë hartuar.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- *Z. K.L.,* me funksion kryeinspektor i IMTV (17.10.2023 – 23.01.2024 dhe 30.06.2025 – në vijim);
- *Z. E.D.,* me funksion ish-kryeinspektor i IMTV (01.03.2023 - 01.06.2023);
- *Z. N.Ç.,* me funksion ish-kryeinspektor i IMTV (13.01.2021 - 01.03.2023; 01.06.2023 – 13.10.2023 – 23.01.2024 – 25.06.2025);

2.4.2.2 Mbi raportimin periodik:
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor duhet të përgatisë dhe t'i japë të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, si p.sh. vendimet e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara (pezullim, gjobë, prishje të objektit të kundërligjshëm), kallëzimet penale, si dhe kërkesat për heqje të licencave profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f). Nga ana e IMTV nuk është vendosur në dispozicion asnjë raportim për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025. Si konstatohet, raportimi nuk është kryer, për të gjithë periudhën nën auditim.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- *Z. K.L.,* me funksion kryeinspektor i IMTV (17.10.2023 – 23.01.2024 dhe 30.06.2025 – në vijim);
- *Z. E.D.,* me funksion ish-kryeinspektor i IMTV (01.03.2023 - 01.06.2023);
- *Z. N.Ç.,* me funksion ish-kryeinspektor i IMTV (13.01.2021 - 01.03.2023; 01.06.2023 – 13.10.2023 – 23.01.2024 – 25.06.2025);

2.4.3 Mbi dokumentimin e kundërvajtjeve dhe proceseve të prishjeve me evidenca fotografike:

Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë. Gjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2025, IMTV, Bashkia Pogradec ka mbajtur në total 28 procedura. Nga këto, janë anuluar 3 procedura. Gjithashtu, 5 prej këtyre procedurave kanë të bëjnë me shkeljen e afatit për fillimin ose përfundimin e punimeve. Nga 20 procedurat e mbetura, në një rast, kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me evidenca fotografike, paraqitur më poshtë:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	000144	18.08.2023	*A.K.*	Nga inspektimi në objekt u konstatua hapja e dy dritareve të reja (me përmasa 150 x 150 cm dhe 60 x 150 cm), pa leje ndërtimi, si dhe vendosja e dy dritareve alumini me hapje dhe me xham.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. *N.Ç.*,** me funksion ish-kryeinspektor i IMTV;
- **Z. *E.B.*,** me funksion inspektor i IMTV;
- **Z. *K.L.*,** me funksion inspektor i IMTV.

2.4.4 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të pezullimit të punimeve:

Vendimi për pezullimin e punimeve në ndërtim nxirret në rastin kur është i nevojshëm një afat kohor paraprak, për marrjen e vendimit, për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe të urbanistikës, ose për marrjen e vendimit për prishjen e objektit. Pezullimi i punimeve në ndërtim ka afat deri në 60 ditë. Një vendim i tillë merret në rastet kur:
- subjekti i kontrolluar mungon në objekt ose nuk i paraqet grupit të inspektimit dokumentacionin teknik e/ose ligjor të punimit/ndërtimit;
- mungojnë masat e sigurimit teknik në objekt dhe mjetet mbrojtëse të jetës së punëtorëve;
- plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor kërkon proces miratimi nga autoriteti përgjegjës i planifikimit;
- vendimi i pezullimit të punimeve të ndërtimit për plotësimin e dokumentacionit teknik e/ose ligjor ka rezultuar i pamjaftueshëm dhe subjekti ndërtues kërkon zgjatjen e afatit, duke e argumentuar në mënyrë zyrtare.

Nga ana e kryeinspektorëve nuk është nxjerrë asnjë vendim për pezullimin e punimeve.

Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, është konstatuar se në 6 raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, kur do të duhej t'i ishte dhënë kohë subjektit të konstatuar për plotësimin e dokumentacionit ose përmirësimin e masave të sigurimit teknik në objekt dhe shtimin e mjeteve mbrojtëse të jetës së punëtorëve, paraqitur në tabelën e mëposhtme. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Data		
1	000139	20.03.2023	*"Ç.P."*	Nga inspektimi i kryer në *"Objekt grumbullimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale"*,me leje ndërtimi nr. 1326 prot., datë.21.03.2021,u konstatua se objekti i ndërtuar kishte ndryshim të

				përmasave nga 40 m * 30 m = 1200 m^2 të cituara në leje, në përmasat aktuale 40 m * 26.7 m = 1068 (Diferencë prej 132 m^2).
2	000148	10.10.2023	"*TH.*" ShPK	Shkelja e afatit të fillimit / përfundimit të punimeve
3	000096	01.02.2024	"B." "B."	Shkelja e afatit të fillimit / përfundimit të punimeve
4	000098	23.02.2024	"T." "M."," J. L."	Shkelja e afatit të fillimit / përfundimit të punimeve
5	000099	13.03.2024	"G. Ç.", "A. Ç."	Shkelja e afatit të fillimit / përfundimit të punimeve
6	000104	15.07.2024	"M." "T.", "L. T."	Shkelja e afatit të fillimit / përfundimit të punimeve

Burimi: *Bashkia Pogradec* ***Përpunoi:*** *Grupi i Auditimit*

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. *N.Ç.*, me funksion ish-kryeinspektor i IMTV, për rastet 1 – 6.

2.4.5 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të dënimit me masë administrative gjobë:
Vendimi për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë merret për të gjitha rastet kur konstatohen shkelje në veprimtarinë ndërtimore. Ky vendim bashkë-shoqëron gjithmonë vendimin për pezullimin e punimeve dhe vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm. Vlera e masës administrative përcaktohet sipas dispozitave ligjore, ndërsa për objektet e ndërtuar pa marrë paraprakisht miratimin e autoriteteve vendore ose qendrore, gjoba përcaktohet në raport të drejtë me vlerën e investimit.
Nga ana e kryeinspektorëve të IKMT, Bashkia Pogradec janë nxjerrë në total 25 vendime për dënimin e kundërvajtësit me masë administrative gjobë, me vlerë totale **4,980,885 lekë**.

Situata nr. 1: Auditim mbi saktësinë e llogaritjes së vlerës së masës administrative
Referuar këtyre përcaktimeve, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, në lidhje me saktësinë e përllogaritjes së vlerës së masës administrative dënim me gjobë, grupi i auditimit mori në shqyrtim disa raste, me përzgjedhje. Referuar auditimit të këtyre vlerave, është konstatuar se:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
1	000097	19.02.2024	K. BR / B.Xh.	Nga konstatimi i kryer në objekt të tipit kult fetar (Xhami), u evidentuan këto të dhëna: Planimetria e katit përdhe: 8.33 m × 13.9 m; Planimetria e katit të parë: 8.33 m × 11 m; Lartësia totale e objektit: 6.1 m. Objekti ka edhe një ambient ndihmës me funksion tualet, me përmasa 3.7 m × 3.6 m dhe lartësi 2.6 m. Gjithashtu është ndërtuar një minare me përmasa të bazamentit 1.8 m × 1.8 m.	500,000 lekë

Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Duke qenë se në këtë rast kemi të bëjmë me ndërtimin e një objekti (me disa pjesë përbërëse), kryeinspektori i IMTV do të duhej t'i ishte referuar Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 *"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016"*, nga ku marrim informacionin se kosto mesatare e ndërtimit (për sipërfaqe ndërtimi) në qytetin e Pogradecit është 32,381 lekë/m^2. Për këtë rast, përllogaritja e saktë e vlerës së masës administrative do të ishte: [(8.33 m * 13.9 m + 8.33 m * 11 m + 3.7 m * 3.6 m + 1.8 m * 1.8 m) * 32,381 lekë/m^2] = 7,252,599 lekë. ***Vlera e gjobës e vendosur nga IMTV është 6,752,599 lekë më pak se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit.***

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
2	000100	30.04.2024	S. M.	Nga konstatimi i kryer rezultoi një objekt i ndërtuar me blloqe betoni, me përmasa 8.5 m × 2.5 m dhe lartësi h = 2.2 – 2.4 m, i mbuluar me llamarinë të tipit panel. Gjithashtu, u konstatua një mur rrethues i ndërtuar me blloqe betoni, me gjatësi l = 13.5 m dhe lartësi h = 2.2 m.	500,000 lekë

Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Duke qenë se në këtë rast kemi të bëjmë me ndërtimin e një objekti dhe një muri rrethues, kryeinspektori i IMTV do të duhej të kishte përdorur dy metodologji për llogaritjen e vlerës së masës administrative:

I. Për objektin, kryeinspektori do të duhej t'i referohej Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 *"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016"*, nga ku marrim informacionin se kosto mesatare e ndërtimit (për sipërfaqe ndërtimi) në qytetin e Pogradecit është 32,381 lekë/m^2. Për këtë rast, përllogaritja e saktë e vlerës së masës administrative do të ishte: [8.5 m * 2.5 m * 32,381 lekë/m^2] = 688,096 lekë.

II. Për murin rrethues, kryeinspektori do të duhej t'i referohej VKM-së nr. 629, datë 15.7.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"*, për të identifikuar çmimin e murit, sipas manualeve. Për këtë rast, përllogaritja e saktë e vlerës së masës administrative do të ishte: [13.5 m * 2.2 m * 0.25 m * 14,870.3 lekë/m^3] = 110,412 lekë.

Vlera e masës administrative do të duhej të ishte: 688,096 lekë + 110,412 lekë = 798,508 lekë. ***Vlera e gjobës e vendosur nga IMTV është 298,508 lekë më pak se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit.***

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
3	000102	19.06.2024	N. M.	U konstatua ndërtimi i një muri rrethues me blloqe betoni, me përmasa: gjatësi l_1 = 21.5 m dhe l_2 = 2.2 m, lartësi mesatare	50,000 lekë

				h_{mes} = 77 cm (h_1 = 76 cm, h_2 = 95 cm, h_3 = 60 cm). Gjithashtu, është realizuar brez b/a me trashësi t = 15 cm, në gjatësi totale l = 23.7 m. Mbi brez është inkastruar tel me lartësi 1.2 m.	
Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Për këtë rast, përllogaritja e saktë e vlerës së masës administrative do të ishte shumatorja e vlerës së investimit për ndërtimin e murit dhe brezit B/A, më konkretisht: [(21.5 m * 0.6 m * 0.25 m + 2.2 m * 0.6 m * 0.25 m) * 14,870.3 lekë/m^3] + [23.7 m * 0.15 m * 0.2 m * 22,288.72 lekë/m^3] = 68,716.18 lekë. Vlera 14,870.3 lekë/m^3 është marrë nga VKM nr. 629, datë 15.7.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"*. ***Vlera e gjobës e vendosur nga IMTV është 18,716 lekë më pak se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit.***					

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
4	000103	10.07.2024	M. M.	U konstatua ndërtim i jashtëligjshëm me funksion "garazh" me përmasa: lartësi H = 3 m, gjatësi L = 12 m dhe gjerësi B = 6 m.	500,000 lekë
Vlera e masës administrative nuk është përllogaritur e saktë, pasi, sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e), marrim informacionin se: *"kryerja e punimeve pa leje dënohet me **gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje**, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi"*. Duke qenë se në këtë rast kemi të bëjmë me ndërtimin e një objekti (garazh), kryeinspektori i IMTV do të duhej t'i ishte referuar Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 *"Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2016"*, nga ku marrim informacionin se kosto mesatare e ndërtimit (për sipërfaqe ndërtimi) në qytetin e Pogradecit është 32,381 lekë/m^2. Për këtë rast, përllogaritja e saktë e vlerës së masës administrative do të ishte: [12 m * 6 m * 32,381 lekë/m^2] = 2,331,432 lekë. ***Vlera e gjobës e vendosur nga IMTV është 1,831,432 lekë më pak se ajo e llogaritur nga grupi i auditimit.***					

Konklucion: Nga sa më sipër është cituar, në së paku 4 raste vlera e masës administrative nuk është llogaritur e saktë. Vlerat e gjobave të vendosura nga IMTV janë ***8,901,255 lekë*** më pak se ato të llogaritura nga grupi i auditimit.

Për llogaritjen e gabuar të vlerës së masës administrative dënim me gjobë, ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. *N.Ç.,* në cilësinë e ish - Kryeinspektorit.

<u>Situata nr. 2: Auditim në lidhje zhvillimin e objekteve pa leje, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me qëllime fitimi</u>
Një pjesë e konsiderueshme e qytetit të Pogradecit dhe zonave nën juridiksionin e Bashkisë janë përcaktuar si zona me përparësi zhvillimin e turizmit, kjo referuar Vendimit nr. 1, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit *"Për shpalljen e 17 zonave me përparësi*

zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë", si dhe hartës bashkëlidhur. Zhvillimi pa leje i ndërtimeve në këto zona është i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 51 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e.V), ku përcaktohet se:

e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror ***kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me****:*

v. Kryerja e punimeve ***pa leje brenda brezit të zhvillimeve të kontrolluara në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit****, në zonat e mbrojtura apo zonën kufizuese të një monumenti kulture dënohet me* ***5.000.000 (pesë milionë) lekë gjobë****. Lejet apo deklaratat paraprake të punimit, të miratuara në këto zona nga organet e pushtetit vendor, pa marrë paraprakisht aktin e konfirmimit nga KKT-ja, janë akte absolutisht të pavlefshme. Shkelja e këtij rregulli nga autoritetet vendore dënohet me 2.000.000 (dy milionë) lekë gjobë.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion është konstatuar se në tetë raste, është përllogaritur vetëm vlera e investimit, por nuk i është shtuar vlera prej 5,000,000 lekë, si penalitet për kundërvajtësit që ndërtojnë në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit. Këto raste janë evidentuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Shkelja e konstatuar	Kundërvajtësi	Vlera e gjobës
	Nr. serie	Data			
1	0000149	25.10.2023	Janë konstatuar punime ndërtimi shtesë objekti në katin përdhe me S≈50 m², me trashësi muri t=20 cm dhe lartësi kati h=2.75 m, si dhe soletë b/a ≈80 m² e mbështetur në kolona betoni (25x35) cm. Gjithashtu, shtesë mbi këtë soletë b/a me mure dhe ndarje me muraturë tulle t=20 cm, e lidhur me kolona b/a, 9 copë me përmasa (25x35) cm dhe lartësi h=2.9 m. Shtesa e katit të parë ka sipërfaqe sa ajo e soletës, ≈80 m². Total S≈130 m².	Q. Gj.	889,959
2	0000100	30.04.2024	Nga konstatimi i kryer rezultoi një objekt i ndërtuar me blloqe betoniti me përmasa (8.5x2.5) m dhe lartësi h=2.2-2.4 m, i mbuluar me llamarinë të tipit panel, si dhe një mur rrethues me blloqe betoniti me gjatësi l=13.5 m dhe lartësi h=2.2 m.	S. M.	500,000
3	0000103	10.07.2024	U konstatua ndërtim i jashtëligjshëm me funksion "garazh", me përmasa: lartësi h=3 m, gjatësi l=12 m dhe gjerësi b=6 m.	M. M.	500,000
4	0000109	03.02.2025	U konstatua ndërtimi i një çatie të shfrytëzuar, me ngritje të mureve anësore me lartësi ≈2 m dhe gjatësi 14.1 m, si dhe brez betoni sipas perimetrit të mureve me trashësi 10-15 cm.	A. Sh.	204,527

			Lartësia totale, bashkë me çatinë, shkon ≈3.3-3.5 m.		
5	0000110	07.02.2025	U konstatua hedhja e një shtrese (mbuluese) të tipit soletë b/a C16/20, me trashësi 15-20 cm sipas planimetrisë së objektit, me përmasa: gjatësi 14.5 m, gjerësi 8.2 m dhe 10.8 m, me sipërfaqe totale ≈155 m².	A. SH.P.K	500,000
6	0000111	10.03.2025	U konstatua dhe u verifikua prishja e objektit ekzistues dhe është kryer ndërtim i ri: kat përdhe dhe kati i parë me kolona b/a, si dhe soleta b/a deri në kuotën me lartësi ≈7 m.	P. M.	500,000
7	0000112	10.03.2025	Objekt i ndërtuar pa leje dhe pa dokumentet përkatëse, i tipit garazh, me përmasa: 3 m gjerësi, 7 m gjatësi dhe lartësi 2.8 m, si dhe një mur me blloqe betoniti me gjatësi 5 m dhe lartësi 1.6 m.	B. H.	500,000
8	0000118	25.07.2025	U konstatuan punime në tarracën e objektit "shtëpi banimi". Punimet e konstatuara janë mure me tulla me vrima (25x25), ku muret e konstatuara kanë përmasa: (1.78 m lartësi x 2.80 m gjatësi), (0.80 m lartësi x 3.20 m gjatësi), (1.80 m lartësi x 2.60 m gjatësi), (0.77 m lartësi x 5.90 m gjatësi), (0.25 m lartësi x 3 m gjatësi).	M. B.	500,000

Për të gjitha rastet e mësipërme , nga kryeinspektori i IMTV, Bashkia Pogradec, nuk është shtuar vlera e penalitetit prej 5,000,000 lekë në përllogaritjen e vlerës së masës administrative dënim me gjobë. Totali i kësaj vlere është ***40,000,000 lekë***.

Për llogaritjen e gabuar të vlerës së masës administrative dënim me gjobë, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. *K.L.***, në cilësinë e Kryeinspektorit, për 2 raste *(1, 8, referuar tabelës së mësipërme)*;
- **Z. *N.Ç.*,** në cilësinë e ish - Kryeinspektorit, për 6 raste *(2 - 7, referuar tabelës së mësipërme).*

2.4.6 Mbi ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit të prishjes së objektit të kundërligjshëm:
Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025 nga inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Pogradec, janë konstatuar gjithsej **34 subjekte** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit.
Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se IMTV Bashkia Pogradec ka proceduar vetëm për **28 subjekte** me vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, ndërsa në **6 raste** kryeinspektorët e IMTV nuk e kanë nxjerrë këtë vendim. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika d), si dhe në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 6. Rastet kur nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm janë cituar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Datë		
1	0000139	20.03.2023	*Ç.P.*	Nga inspektimi i kryer në "Objekt Grumbullimi i Produkteve Bujqësore dhe Blegtorale", me leje ndërtimi nr. 1326 prot., datë 21.03.2021, u konstatua se objekti i ndërtuar kishte ndryshim të përmasave nga (40x30) m² = 1200 m², të cituara në leje, në përmasat aktuale (40x26.7) m² = 1068 m², me diferencë prej 132 m²
2	0000142	24.07.2023	P.S.	Ndryshimi dhe zëvendësimi i plotë i mbulesës së çatisë (qaramidheve dhe lëndës drusore mbajtëse), me përmasa 14.5 m x 6.5 m. Gjithashtu, u konstatua edhe ndryshimi i pjerrësisë së çatisë
3	0000106	25.10.2024	D. M.	U konstatua tendë me konstruksion druri, me përmasa 7.5 m x 3 m, e mbështetur në profile druri me përmasa (10x10) cm, me lartësi 2-2.3 m dhe mbulesë me rrapote dhe tjegull kanadeze
4	0000113	14.04.2025	M. C.	U konstatua strukturë stacion plazhi me konstruksion metalik të çmontueshëm, me përmasa 10x10 m dhe mbulesë me panele sanduiç
5	0000511	01.08.2025	K.A.	U konstatua një parcelë me përmasa 90.7 m (lindje), 38.4 m (veri), 110.5 m (perëndim), e rrethuar me rrjetë teli me lartësi 1.5 m, e mbështetur mbi një mur rrethues b/a, i cili varion nga 10 cm deri në 80 cm nga ana lindore. Pjesa e sheshit brenda rrethimit është e niveluar me material inert (çakëll)
6	0000512	02.09.2025	A.H.	U konstatuan punime për ndryshim fasade, e cila ka qenë e hapur me derë aksesi hyrjeje me përmasa (2.9 m gjerësi x 2.7 m lartësi), tashmë e mbyllur me mur. Gjithashtu, u konstatua një mbulesë e tipit çati në një pjesë të objektit, ku më parë ka rezultuar të ketë qenë e mbuluar vetëm me soletë

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të prishjeve të objekteve të jashtëligjshëm është konstatuar se nga 28 raste kur është nxjerrë vendimi i prishjes, ky vendim është ekzekutuar vetëm në 7 (shtatë) raste, ndërkohë që për 21 raste (të paraqitura në ***Aneksin nr. 01***) nga ana e IMTV nuk janë marrë masa (kërkesa për asistencë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ose IKMT) për prishjen e këtyre objekteve.

Për mos-nxjerrjen e vendimit të prishjes së ndërtimit të kundërligjshëm, ngarkohen me përgjegjësi:
- **Z. *K.L.***, në cilësinë e Kryeinspektorit, për 2 raste *(5, 6, referuar tabelës së mësipërme)*;
- **Z. *N.Ç.*,** në cilësinë e ish - Kryeinspektorit, për 4 raste *(1, 2, 3, 4, referuar tabelës së mësipërme).*

2.4.7 Mbi nisjen e procedurave për të kallëzuar penalisht kundërvajtësit:
Në respektim të nenit 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika dh), si dhe nenit 52 i Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 7, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin e përgatitjes së kallëzimit penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe të paraqitjes së tij pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion është konstatuar se në së paku 20 raste (të paraqitura në ***Ankesin nr. 03***) kundërvajtja e konstatuar përbën vepër penale, në zbatim të përcaktimeve të nenit 199/a të Kodit Penal. Grupi i auditimit i kërkoi

informacion IMTV Bashkia Pogradec mbi nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për të gjitha këto raste. Nga auditimi konstatohet se nga ana e IMTV Bashkia Pogradec nuk është vendosur në dispozicion dokumentacion zyrtar, justifikues dhe vërtetues, për procedurën e nisjes së indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për asnjë nga rastet që përbëjnë vepër penale.

Për mos-nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese, për rastet që përbëjnë vepër penale, ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. K.L., në cilësinë e Kryeinspektorit, për 6 raste *(4, 5, 6, 7, referuar Aneksit nr. 03)*;
- Z. N.Ç., në cilësinë e ish - Kryeinspektorit, për 14 raste *(1, 2, 3, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, referuar Ankesit nr. 03).*

2.4.8 Mbi arkëtimin e masave administrative:
Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Pogradec për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025, rezulton se janë vendosur ***40 gjoba*** në vlerën ***15,634,137 lekë***, dhe janë arkëtuar prej tyre ***10 gjoba*** (ose 25%) në vlerën ***1,188,532 lekë*** (ose 7.6%). Rastet kur gjoba është paguar janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	PVKK		Kundërvajtësi	Shkelja e konstatuar
	Nr. serie	Datë		
1	0000148	10.10.2023	"TH." &"V." Sh.p.k	Shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve
2	0000093	12.12.2023	D.H.	Nga konstatimi i kryer në objekt rezultoi ndërtimi i një muri rrethues me betonitë me përmasa: gjatësi lineare ≈40 m, lartësi 1.6 m + themel dhe gjerësi 12 cm
3	0000094	13.12.2023	A. S.	Nga inspektimi i kryer në objekt rezultoi hedhja e një shtrese b/a (soletë) për mbulimin e objektit të tipit shtesë, me përmasa: gjerësi 170 cm, gjatësi 370 cm dhe trashësi të soletës 10 cm, si dhe një ngritje në lartësi prej 2 rreshtash tullash 20 cm
4	0000096	01.02.2024	B.I./ B.	Shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve
5	0000098	23.02.2024	T. M., J. L.	Shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve
6	0000099	13.03.2024	G.Ç., A. Ç.	Shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve
7	0000108	09.01.2025	"A. " SH.P.K	Dokumentacion tekniko-ligjor i pamjaftueshëm
8	0000110	07.02.2025	"A. " SH.P.K	U konstatua hedhja e një shtrese (mbuluese) të tipit soletë b/a C16/20, me trashësi 15-20 cm sipas planimetrisë së objektit, me përmasa: gjatësi 14.5 m, gjerësi 8.2 m dhe 10.8 m, me sipërfaqe totale ≈155 m²
9	0000113	14.04.2025	M. C.	U konstatua strukturë stacion plazhi me konstruksion metalik të çmontueshëm, me përmasa 10x10 m dhe mbulesë me panele sanduiç
10	0000511	01.08.2025	K.A.	U konstatua një parcelë me përmasa 90.7 m (lindje), 38.4 m (veri), 110.5 m (perëndim), e rrethuar me rrjetë teli me lartësi 1.5 m, e mbështetur mbi një mur rrethues b/a, i cili varion nga 10 cm deri në 80 cm nga ana lindore. Pjesa e sheshit brenda rrethimit është e niveluar me material inert (çakëll)

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a), ku përcaktohet se: *"Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj**. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas Ligjit"*. Rastet kur gjoba nuk është paguar janë paraqitur në ***Aneksin nr. 02***.

Për mos-marrjen e hapave për arkëtimin e masave administrative, ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. K.L., në cilësinë e Kryeinspektorit, për 9 raste *(1 – 4; 19 – 23; referuar Aneksit nr. 02)*;
- Z. N.Ç., në cilësinë e ish - Kryeinspektorit, për 14 raste *(5 – 18; referuar Aneksit nr. 02).*

2.4.9 Mbi auditimin në terren të rasteve të përzgjedhura nga grupi i auditimit:

Nga auditimi në terren i zhvillimit të objekteve në qytetin e Pogradecit, grupi i auditimit, nëpërmjet shkresës së dërguar në postën elektronike, në datë 18.03.2026, i kërkoi Kryetarit të Bashkisë, z. *I.XH.*, që nëpërmjet strukturës së IMTV-së, grupit të auditimit t'i vendosej në dispozicion informacion / dokumentacion për 7 raste:

- 4 foto të qarta, të objekteve të përzgjedhura;
- Të dhëna mbi lejen e ndërtimit, nëse ka;
- Masat e marra nga IMTV për këto objekte, nëse ka.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor është përgjigjur nëpërmjetë postës elektronike në datë 30.04.2026, ku ka bashkëlidhur informacionin e kërkuar, fotografitë, procedurat e mbajtura nga IMTV (për ato raste që është mbajtur procedurë) dhe lejet e ndërtimit (për ato raste që kanë qenë të pajisura me leje ndërtimi). Sipas kësaj shkrese dhe verifikimeve të bëra nga grupi i auditimit, është konstatuar se në 4 nga 7 rastet për të cilat është kërkuar informacion, subjektet kanë qenë të pajisur me leje ndërtimi apo deklarata paraprake punimesh. Në 3 raste është konstatuar se punimet janë kryer pa leje dhe nga ana e IMTV nuk janë kryer inspektime për evidentimin e këtyre ndërtimeve pa leje. Këto raste janë si më poshtë vijon:

Rasti nr. 1: Në lidhje rastin nr. 1, nga fotografimi satelitor i periudhën Tetor 2023 është konstatuar ndryshimi i çatisë së një objekti ekzistues, i cili në periudhën Tetor 2022, nuk ka ekzistuar. IMTV, Bashkia Pogradec i ka vendosur në dispozicion grupit të auditimit 3 foto të objektit. Gjithashtu, IMTV është shprehur se "Gjatë verifikimit në objekt nga grupi i inpektimit nuk ndodhej njeri dhe nuk është mundur të kontaktohet pronari. Punime në proces nuk u konstatuan,vetëm ndërrimi i tjegullave të çatisë dukej nga konstatimi".

Konkluzion: IMTV Bashkia Pogradec nuk i vendosi grupit të auditimit në dispozicion as dokumentin e lejes së ndërtimit, as akte kontrolli / procesverbale konstatimi të kundërvajtjes, për këtë rast. Duke qenë se nga fotografimi satelitor konstatohet se objekti është ndërtuar midis periudhës Tetor 2022 – Tetor 2023, grupi i auditimit doli në përfundimin se IMTV nuk ka ushtruar kontrolle në këtë objekt, ose së paku, nuk i ka reflektuar konstatimet në aktet përkatëse, duke lejuar ndryshimin e çatisë pa lejet përkatëse. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.



Tetor 2022



Tetor 2023

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:

- **Z. *N.Ç.*,** me funksion ish-kryeinspektor i IMTV.

Rasti nr. 2: Në lidhje me rastin nr. 2, nga fotografimi satelitor i periudhën Tetor 2023 janë konstatuar dy objekte të rinj (objekti më i madh: magazinë; objekti më i vogël: kotec) brenda të njëjtës parcelë, të cilët në periudhën Tetor 2022, nuk kanë ekzistuar. IMTV, Bashkia

Pogradec i ka vendosur në dispozicion grupit të auditimit shtatë foto të objekteve. Gjithashtu, IMTV është shprehur se "Në këtë vendndodhje u konstatua një objekt që përdorej për të mbajtur vegla pune bujqësore, si edhe bazë ushqimore për blegtorinë. Gjatë konstatimit nuk kishte persona në objekt dhe nuk është bërë e mundur të identifikohet personi që ka objektin. Objekti tjetër që ndodhej në këtë vendndodhje ishte një strukturë provizore e thjeshtë për mbajtjen e shpendëve (kotec pulash), me elementë druri, rrjete, plastmas".
Konkluzion: IMTV Bashkia Pogradec nuk i vendosi grupit të auditimit në dispozicion as dokumentin e lejes së ndërtimit / deklaratës paraprake, as akte kontrolli / procesverbale konstatimi të kundërvajtjes, për këtë rast. Duke qenë se nga fotografimi satelitor konstatohet se objekti është ndërtuar midis periudhës Tetor 2022 – Tetor 2023, grupi i auditimit doli në përfundimin se IMTV nuk ka ushtruar kontrolle në këtë objekt, ose së paku, nuk i ka reflektuar konstatimet në aktet përkatëse, duke lejuar zhvillimin e një objekti pa lejet përkatëse. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.



Tetor 2022



Tetor 2023

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. *N.Ç.*, me funksion ish-kryeinspektor i IMTV.

Rasti nr. 3: Në lidhje rastin nr. 3, nga fotografimi satelitor i periudhën Shkurt 2025 është konstatuar një objekt i ri, i cili në periudhën Tetor 2022, nuk ka ekzistuar. IMTV, Bashkia Pogradec i ka vendosur në dispozicion grupit të auditimit dy foto foto të objektit. Gjithashtu, IMTV është shprehur se "Nga verifikimi rezultoi ndërtimi i një tende në murin ekzistues rrethues duke krijuar një objekt që përdorej për të mbajtur vegla pune bujqësore, si edhe bazë ushqimore për blegtorinë. Gjatë konstatimit nuk kanë rezultuar punime të reja, nuk kishte persona në objekt dhe nuk është bërë e mundur të identifikohet personi që ka objektin".
Konkluzion: IMTV Bashkia Pogradec nuk i vendosi grupit të auditimit në dispozicion as dokumentin e lejes së ndërtimit, as akte kontrolli / procesverbale konstatimi të kundërvajtjes, për këtë rast. Duke qenë se nga fotografimi satelitor konstatohet se objekti është ndërtuar midis periudhës Tetor 2022 – Shkurt 2025, grupi i auditimit doli në përfundimin se IMTV nuk ka ushtruar kontrolle në këtë objekt, ose së paku, nuk i ka reflektuar konstatimet në aktet përkatëse, duke lejuar zhvillimin e një objekti pa lejet përkatëse. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.



Tetor 2022



Shkurt 2025

Për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:
- Z. *K.L.*, me funksion kryeinspektor i IMTV;
- Z. *N.Ç.*, me funksion ish-kryeinspektor i IMTV.

Konkluzion i përgjithshëm mbi aktivitetin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor:

1. Nga auditimi u konstatua se në strukturën e IMTV, Bashkia Pogradec, janë punësuar kryeinspektorë dhe inspektorë të cilët nuk plotësojnë kriteret e arsimit të lartë profesional të kërkuar në dispozitat ligjore.

2. Nga auditimi u konstatua se planifikimi i veprimtarisë inspektuese nuk është kryer në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme. Për periudhën 01.01.2023 – 31.10.2023 dhe 01.01.2025 – 31.12.2025 nuk janë hartuar plane pune mujore, tremujore apo vjetore, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 894, datë 01.11.2015.

3. Nga auditimi u konstatua se IMTV nuk ka kryer raportimin periodik tremujor pranë IKMT për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, në lidhje me masat administrative, prishjet e objekteve, kallëzimet penale dhe masat e tjera të marra në ushtrim të funksioneve të saj.

4. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për dokumentimin e kundërvajtjeve u konstatua se në një rast kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me evidenca fotografike.

5. Nga auditimi u konstatua se në 6 raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, megjithëse sipas natyrës së shkeljeve dhe dokumentacionit të munguar do të duhej t'u jepej subjekteve afati ligjor për plotësimin e dokumentacionit ose marrjen e masave të nevojshme.

6. Nga auditimi i saktësisë së përllogaritjes së masave administrative u konstatua se në së paku 4 raste vlera e gjobave nuk është përllogaritur sipas kërkesave ligjore. Diferenca ndërmjet vlerës së gjobave të vendosura nga IMTV dhe asaj të përllogaritur nga grupi i auditimit është në shumën ***11,330,867 lekë***.

7. Nga auditimi u konstatua se në 8 raste të ndërtimeve pa leje të realizuara në zona me përparësi zhvillimin e turizmit, nuk është aplikuar penaliteti shtesë prej ***5,000,000 lekë*** për çdo rast. Vlera totale e penaliteteve të paaplikuara rezulton ***40,000,000 lekë***.

8. Nga auditimi u konstatua se për 34 raste të ndërtimeve pa leje ose me shkelje të lejes së ndërtimit, IMTV ka proceduar me vendim prishjeje vetëm për 28 raste, ndërsa në **6 raste** nuk është nxjerrë vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

9. Nga auditimi u konstatua se IMTV nuk ka vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion që provon nisjen e procedurave për kallëzim penal pranë organeve ligjzbatuese për rastet që

përbëjnë vepër penale sipas nenit 199/a të Kodit Penal, megjithëse janë evidentuar të paktën **20 raste** që kërkonin ndjekjen e kësaj procedure.

10. Nga auditimi mbi arkëtimin e masave administrative u konstatua se gjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2025 janë vendosur **40 gjoba** në vlerën totale ***15,634,137 lekë***, ndërsa janë arkëtuar vetëm **10 gjoba** në vlerën ***1,188,532 lekë***, ose vetëm **7.6%** e vlerës totale të detyrimeve, duke treguar mungesë të ndjekjes efektive të procedurave për arkëtimin e tyre.

11. Nga auditimi në terren i rasteve të përzgjedhura nga grupi i auditimit u konstatua se në **3 raste nga 7 rastet e verifikuara**, janë evidentuar objekte të ndërtuara pa leje, për të cilat IMTV nuk ka vendosur në dispozicion leje ndërtimi, deklarata paraprake apo dokumentacion inspektimi. Grupi i auditimit arriti në përfundimin se IMTV nuk ka ushtruar kontrolle ose nuk ka dokumentuar konstatimet e kryera, duke lejuar zhvillimin e ndërtimeve pa leje në territor.

2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

2.5.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.
2.5.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Për vitin 2024 me urdhrin nr. 9, datë 11.01.2024 "Për miratimin e strukturës , organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi për vitin 2024", është krijuar Sektori i Administrimi të Aseteve, Statistikës, Menaxhimit të Performacës dhe Bashkëpronësia.
Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t'u transferoheshin. Më poshtë janë VKM "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pogradec dhe të ish Komunave*".
Bashkia Pogradec, me VKM nr. 1240, datë 10.9.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Pogradec, të Qarkut Korçë", i është miratuar lista inventarit me nr. rendor 297 prona. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 18, datë 9.4.2003"Mbi miratimin e listës së inventarit të pronave publike shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi të Bashkisë Pogradec", këshilli bashkiak ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë me nr. rendor 297. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. rendor 297 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë)
Me VKM, nr. 1240 , datë 10.9.2008, Bashkisë Pogradec i janë transferuar 143 prona sipas listës së inventarit bashkëlidhur, gjithsej 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Nga këto 142(njëqind e dyzet e dy)në pronësi,1 (një)në përdorim.
Ish Komunës Çërravë, sot Njësia Administrative Çërravë, e Bashkisë Pogrdec, me VKM nr. 417,datë 8.6.2011"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Çërravë, të qarkut të Korçës" i është miratuar lista inventarit me nr. rendor 180 prona nga të cilat 83 prona në pronësi dhe 9 prona në përdorim.
Ish Komunës Dardhas, sot Njësia Administrative Dardhas, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr 7,datë 6.1.2011"Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore,që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Dardhas, të qarkut

të Korçës" i është miratuar lista inventarit me nr rendor 452 prona nga të cilat 96 prona në pronësi dhe 27 prona në përdorim.

Ish Komunës Buçimas, sot Njësia Administrative Buçimas, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr. 244,datë 4.4.2012"Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Buçimas, të qarkut të Korçës" i është miratuar lista inventarit me nr. rendor 372 prona nga të cilat 82 prona në pronësi dhe 15 prona në përdorim.

Ish Komunës Trebinjë,sot Njësia Administrative Trebinjë,e Bashkisë Pogradec, me VKM nr. 278,datë 18.3.2009"Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Trebinjë, të qarkut të Korçës" i është miratuar lista inventarit me nr. rendor 637 prona nga të cilat 139 prona në pronësi dhe 49 prona në përdorim.

Ish Komunës Udënisht, sot Njësia Administrative Udënisht, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr. 534,datë 1.5.2008"Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Udënisht, të qarkut të Korçës" i është miratuar lista inventarit me 300 prona nga të cilat 84 prona në pronësi dhe 27 prona në përdorim.

Ish Komunës Proptisht, sot Njësia Administrative Proptisht, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr. 1329,datë 1.10.2008 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Proptisht, të qarkut të Korçës" i është miratuar lista inventarit me nr. rendor 466 prona. Ky vendim, duke qenë vetëm listë inventari, nuk shoqërohet me Lidhjen 1 e cila ka të pasqyruar numrin e pronave që transferohen si dhe sa prej tyre janë në pronësi dhe sa janë në përdorim

Ish Komunës Velçan, sot Njësia Administrative Velçan, e Bashkisë Pogradec, me VKM nr 243,datë 27.2.2008"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Velçan, të qarkut të Korçës" i është miratuar lista inventarit me nr. rendor 530 prona. Ky vendim, duke qenë vetëm listë inventari, nuk shoqërohet me Lidhjen 1 e cila ka të pasqyruar numrin e pronave që transferohen si dhe sa prej tyre janë në pronësi dhe sa janë në përdorim.

Lidhur me pronat e transferuara deri në 31.12.2023 janë aplikuar gjithsej 430 pasuri, nga të cilat është bërë pajisja me certifikatë pronësie për 328 prej tyre. Për vitin 2024(periudhë auditimi), nga ana e Bashkisë Pogradec janë bërë 38 aplikime të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie, të detajuara në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m²	Sip nd. m²	Pasqyruar ose jo ne bilancin e Bashkisë
1	pemetore	268	-	23.8.2024	1832	Grabovice	58900	-	-
2	are	194	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	1000	-	-
3	are	189/2	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	4200	-	-
4	are	198/3	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	16000	-	-
5	are	184/3	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	12302	-	-
6	are	199	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	12500	-	-
7	are	196/2	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	1200	-	-
8	are	98	-	1.10.2024	2928	Peshkepi	13812	-	-
9	pemetore	185/1	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	26500	-	-
10	pemetore	184/1	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	107700	-	-
11	are	1896	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	237455	-	-
12	Pa fryteshme	250	-	21.5.2024	3664	Tushemisht	8700	-	-
13	are	153	-	1.10.2024	3529	Stropcke	10200	-	-

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m²	Sip nd. m²	Pasqyruar ose jo ne bilancin e Bashkisë
14	are	154	-	1.10.2024	3529	Stropcke	54900	-	-
15	are	98	-	1.10.2024	2928	Peshkepi	13812	-	-
16	are	84/22	-	18.7.2024	2928	Peshkepi	31545	-	-
17	are	98	-	1.10.2024	2928	Peshkepi	13812	-	-
18	pemetore	201	-	7.10.2024	2808	Nizhavec	12100	-	-
19	shesh	1/261	-	2.12.2024	8582	Pogradec	33.2	-	-
20	Trotuar	1/261	-	9.9.2024	8582	Pogradec	33.2	-	-
21	Trotuar	1/262	-	9.9.2024	8582	Pogradec	446.8	-	-
22	Kullote	195/1	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	147500	-	-
23	Kullote	219	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	6900	-	-
24	Kullote	191/3	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	6954	-	-
25	Kullote	191/2	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	3246	-	-
26	Kullote	221	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	2000	-	-
27	Kullote	225	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	7200	-	-
28	Kullote	195/2	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	15200	-	-
29	Kullote	186/1	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	7900	-	-
30	Kullote	183/2	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	3100	-	-
31	Kullote	183/1	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	3000	-	-
32	Kullote	186/2	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	2800	-	-
33	Kullote	190	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	1300	-	-
34	Pyll	34/1	-	23.12.2024	1208	Blace	40000	-	-
35	Pyll	34/2	-	23.12.2024	1208	Blace	326730	-	-
36	Kullote	187/1	-	18.10.2024	2808	Nizhavec	15800	-	-
37	Kullote	486	-	30.8.2024	1959	Homezh	230788	-	-
38	Kullote	811	-	30.8.2024	3665	hudenisht	243875	-	-

Për vitin 2025(periudhë auditimi) jane regjistruar 9 prona te cilat, janë pasqyruar në tabelën bashkëngjitur.

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. hipotekor	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m²	Sip nd. m²	Pasqyruar ose jo ne bilancin e Bashkisë
1	SHKOLLE	8/429	-	3.10.2025	8581	POGRADEC	4582	1296	-
2	PYLL	508	-	1.3.2025	3410	SHPELLE	123351	-	-
3	KULLOTE	272	-	24.4.2025	1832	GRABOVICE	20400	-	-
4	PEMTORE	82	-	27.8.2025	2420	LESHNICE	11877	-	-
5	ARE	324	-	7.7.2025	3745	VERDOVE	122200	-	-
6	ARE	265/65	-	30.4.2025	1214	BLETAS	303060	-	-
7	ARE	8/2	-	18.2.2025	3047	PRETUSHE	169200	-	-
8	PEMETORE	9	-	18.2.2025	3047	PRETUSHE	40300	-	-
9	PA FRUTSHME	159/65	-	8.1.2025	1903	GURAS	20000	-	-

Konkluzion: Nga auditimi mbi administrimin e pronave të Bashkisë Pogradec rezulton se procesi i regjistrimit të pasurive të transferuara mbetet i papërfunduar dhe kërkon masa të mëtejshme si përgatitja e dokumentacionit te duhur dhe llogaritja e kostove për përfundimin e regjistrimit të aseteve të paluajtshme.

Kërkese VKM nr. 433, datë 08.06.2016, *"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive", ndryshuar me VKM Nr.398,datë 13.5.2020 i janë kaluar në pronësi sipërfaqe:*
Gjithsej 26356. ha, nga këto:

- *Pyje 22104.76 ha,*
- *Kullotë 3863.9 ha*
- *Toka joproduktive 117.96.ha*
- *Shkëmbore dhe ujore 48.69ha.*
- *Djerrë 105.59ha*
- *Bimesi pyjore 115.1 ha*

Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Bashkia Pogradec nuk ka vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerave dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.

Në lidhje me auditimin e të ardhurave nga asetet, grupi i auditimit bëri kërkesë drejtuar Drejtorisë e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokës Bujqësore për vendosjen në dispozicion të kontratave të qirave të fondit pyjor/kullosor të cilat ushtrojnë aktivitet në sektorin e burimeve minerare në territorin që administron Bashkia Pogradec. Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Regjistrin e Lejeve Minerare të muajit shkurt të vitit 2025, Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2025, në territorin e Bashkisë Pogradec ushtrojnë aktivitet 19 subjekte, të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë, pasi nuk janë të evidentuara nga Bashkia Pogradec. Këto subjekte janë si më poshtë:

Nr. leje	Data QKB	Emri i subjektit	Nipt	Bashkia	Emertimi i vendburimit	S=km2	Lloji i mineralit
655	09.04.2002	"K." shpk	K.....A	Pogradec	Miniera e kromit Pojske	0.155	Krom
721/1	01.09.2003	"SH. " shpk	K.....C		Saselisht	0.045	Gur Gëlqeror
768/1	16.06.2004	"N. " shpk	K.....E		Çerrave	0.022	Gur Gëlqeror
831	18.12.2004	*"B.* " shpk	J.....H		"Mademi", Peshkepi, Pogradec	0.01	Kuarc
910	01.09.2005	"F." shpk dhe "A."shpk	K.....V		Damba e shllameve, fab e pasuri, Guri Kuq	0.023	Hekur Nikel
939/1	18.04.2006	*"B."* shpk	J.....H		Perroi I Gllaves, Çerrave	0.005	Gur Gëlqeror
980/1	04.12.2006	"A.N." shpk	L.....A		Debrovë	0.53	Hekur Nikel
981	12.12.2006	"D." shpk	K.....V		Damba Hudenisht, Pogradec	0.099	Hekur Nikel
1022/1	13.06.2007	"R."	L.....B		Çervenake	0.079	Hekur Nikel
1114	12.12.2007	"J. " shpk	K.....O		Çervenaka Juglindore	0.65	Hekur Nikel
1242	24.09.2008	"R." shpk	J.....Q		Cervenaka Jug Lindore	0.55	Hekur Nikel
1357	04.06.2009	"J. " shpk	K.....N		Cervenaka Lindore	0.0175	Hekur Nikel
1530	24.12.2010	"O." shpk	K.....P		Guri I Kuq, perendim te liqenit te Pogradecit	8.934	Hekur Nikel
1665	04.09.2013	"D. S. " shpk	L.....U		Memlisht - 4, Komuna Udenisht	0.160	Krom
1781	13.11.2015	*"B."* shpk	J.....H		Objekti Leshnicë	0.088	Rërë kuarcore

1854	23.02.2018	*"B."* shpk	J.....H		Objekti Bllace	0.022	Kuarc
1882	30.12.2019	"C. "shpk	L.....A		Proptisht	0.48	Hekur Nikel
1892	02.07.2020	"A."	L.....P		Miniera qymyrit Alarup, Nj.Ad Çerrave	0.291	Qymyr Guri
1938	13.10.2022	"P. " shpk	K.....A		Objekti Homesh	0.177	Hekur Nikel

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Neni 17, të Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007, "Për Fondin kullosor", pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor".

2.6. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Gjatë punës audituese në fazë terreni, pranë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është paraqitur një kërkesë/ankesë (për dijeni) në lidhje me veprimtarinë e subjektit Bashkia Pogradec, për të cilën nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet përkatëse.

Në kuadër të verifikimit, në bazë të pikës "*të tjera*" të programit të auditimit nr. 870/1 prot., datë 11.09.2025, i ndryshuar, me objekt "*Auditim Përputhshmërie*", si dhe bazuar në nenet 15 pika "dh", "e" dhe 26 të ligjit nr. 154/2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nga grupi i auditimit të KLSH-së, u vlerësuaua e nevojshme verifikimi i dokumentacionit objekt ankese si dhe intervistimi i përfaqësuesve të Bashkisë Pogradec (Sekretar i Përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Ligjore dhe Prokurimit Publik).

Nga verifikimi rezultoi që:

I-Në lidhje me pretendimin e ngritur në ankesë, në mënyrë të përmbledhur:

Ankuesit (z. T. B. dhe studio e Avokatisë "B." e përfaqësuar nga av. T. B.), në "ankesën" e tyre, ndër të tjera, shprehen, në mënyrë të përmbledhur, se: *"Materiali i cituar përbën mundësi për verifikimin dhe hetimin e elementëve penalë të mundshëm...*".

Grupi i auditimit thekson se "ankesa" e sipërcituar është dërguar "për dijeni" pranë KLSh-së, Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Korçë. Në të njëjtën kohë "ankesa" i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në periudhën e auditimit, nga punonjësit e subjektit Bashkia Pogradec është bërë me dije se një kopje të praktikës e kanë dërguar pranë organit të prokurorisë me kërkesë të këtij të fundit.

II-Në lidhje me kronologjinë e veprimeve administrative dhe gjyqësore të ndërmarra rezulton se:

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 114, datë 16.12.2021 "*Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor për qëllime studimi të potencialit të erërave, me synim ndërtimin e parqeve eloike në Bashkinë e Pogradecit*", Këshilli Bashkiak Pogradec ka miratuar dhënien në përdorim të një sipërfaqeje të fondit pyjor/kullosor publik për studimin e potencialit të erërave.

Në vijim të kësaj vendimmarrje, Bashkia Pogradec ka lidhur kontratë qiraje njëvjeçare me shoqërinë "R. A." ShPK me nr. 3468 prot datë 09.07.2022 për vendosjen e pajisjeve të matjes së erës (anemometra), për një sipërfaqe rreth 0.2 ha.

Me Vendimin nr. 122 datë 25.11.2025 "*Për miratimin e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor*", për qëllime ndërtimin e parkut eloik në Bashkinë e Pogradecit, kjo e fundit ka miratuar një zgjerim të siperfaqes së përdorimit të pasurise publike, duke autorizuar ndërtimin e një parku eolik me gjashtë turbina, për një sipërfaqe rreth 4.5 ha dhe me ndërtimin e infrastrukturës përkatëse.
Në vijim të këtij Vendimi më datë 17.12.2025 është lidhur kontrata noteriale e qirasë midis Bashkisë Pogradec dhe shoqërisë "R. A." ShPK.
-Nga Studio Ligjore "B." i është kërkuar informacion Bashkisë Pogradec, nëpërmjet shkresës nr. 51/1 prot, datë 24.12.2025, me lëndë "*Kërkojmë informacion...*", protokolluar pranë Bashkisë Pogradec, me nr. 3056/1 prot, datë 29.12.2025.
Nga ana e Bashkisë Pogradec i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 509 prot, datë 27.01.2026, me lëndë: "*Informacion i kërkuar nga Studio Ligjore "B." Tiranë*".
Me informacionin që i është vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Pogradec, Studio Ligjore "B.", z. T. B. i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me një kërkesë-padi kundër:
- Këshillit Bashkiak Pogradec
- Bashkisë Pogradec
- Shoqëria "R. A." ShPK
Person i Tretë: Prefekti i Qarkut Korçë
Objekti i Padisë:
1. Shfuqizimi i Vendimit nr. 122, datë 25.11.2025 të Këshillit Bashkiak Pogradec.
2. Shfuqizimi i Vendimit nr. 122, datë 25.11.2025 të Këshillit Bashkiak Pogradec.
3. Konstatimi i pavlefshmerisë së kontratës së qirasë nr. 3134 Rep, Nr. 1866, Kol, datë 17.12.2025 të lidhur midis Bashkisë Pogradec dhe Shoqërisë "R. A." ShPK.
4. Marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë.

Lidhur me masën e Sigurimit të padisë për: "*Pezullimi i zbatimit të projektit energjetik dhe cdo veprimi administrativ të lidhur me të, deri në përfundimin e gjykimit*", Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka dalë me Vendimin nr. Rregj. Them. 8335 (31155-02883-80-2026), Datë Vendimi 26.03.2026, për refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së Sigurimit të Padisë të palës paditëse *T.B.*
Konkluzion përfundimtar:
Grupi i auditimit vlerëson se, pavarësisht për sa është trajtuar më sipër, në kushtet kur palët kanë angazhuar gjykatën për zgjidhjen e problematikës, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, ndër të tjera, përcaktohet se: "*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata*", zgjidhja e probletikës në fjalë do të jetë apo do të diktohet nga vendimi i gjykatës që ka në proces shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

V. REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi realizimi i buxhetit, referuar aktrakordimit me degën e thesarit për periudhën objekt auditimi rezultoi se nga 1,810,393 mijë lekë shpenzime të planifikuara janë realizuar 1,450,946 mijë lekë ose në masën 80 %, me mosrealizim në vlerën 359,447 mijë lekë. Gjithashtu u konstatuan diferenca të dukshme midis planifikimit dhe

realizimit të shpenzimeve operative në vlerën 204,997 mijë lekë *(planifikuar 616,091 mijë lekë, realizuar 411,094 mijë lekë ose 67%)* dhe shpenzimet për investime në vlerën 89,490 mijë lekë *(planifikuar 272,202 mijë lekë, realizuar 182,712 mijë lekë ose 67%)* kjo si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, mosrealizimi i procedurave të prokurimit të planifikuara dhe shpenzimeve operative të planifikuara, me ndikimin në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, duke bërë që realizimi i këtyre zërave të jetë më i ulët se niveli mesatar i realizimit të buxhetit. Veprimet e mësipërme jo në përputhje me nenin 5 shkronja (a) të Ligjit nr. 68, datë 24.7.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec nëpërmjet strukturave përgjegjëse, gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe programeve buxhetore afatmesëm, të bazohet në parashikimet reale të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të vitit të mëparshëm, duke pasur në konsideratë mosrealizimin e të ardhurave dhe analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve, kryesisht të shpenzime për investime dhe shpenzimeve operative.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi kanë rezultuar detyrimet për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykate të raportuara në MFE në fund të vitit me shkresën nr. 995 Prot., datë 27.02.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025", për vlerën 203,975,819 lekë (shpenzime mirëmbajtje, shërbime e mallra në vlerën 80,870,684 lekë, shpenzime kapitale në vlerën 53,089,228 lekë, shpenzime gjyqësore në vlerën 41,548,355 lekë dhe shpenzime tatime të tjera sigurime shoqërore e shëndetësore, të ardhura personale dhe transferta te individë në vlerën 28,467,552 lekë), të cilat në raport me shpenzimet e kryera zënë 14,25% të tyre. Nga verifikimi i faturave të palikuiduara u konstatua se nuk është ndjekur radha e pagesës. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" neni 40, Udhëzimin i MFE nr. 9 datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", Kreu "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*", pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec të marrë masa për të paraqitur në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të detajuar mbi gjendjen aktuale të faturave të palikuiduara, në vlerën prej 203,975,819 lekë. Gjithashtu, të hartojë një plan për likuidimin e këtyre detyrimeve, duke respektuar rendin kronologjik të pagesave, me përparësi për detyrimet e krijuara përpara vitit buxhetor, me qëllim shmangien e kostove shtesë për buxhetin, të shkaktuara nga vonesat në pagesa.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, i llogarisë 202 "Studime dhe projektime" në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 55,620,029 lekë, e analizuar për 45 objekte inventari u konstatua se vlerat nuk janë të analizuara sipas projekteve përkatëse. Për projektet e periudhave të mëparshme nuk disponohet informacion nëse janë vënë në zbatim dhe nëse kostot e tyre janë sistemuar në llogaritë përkatëse të investimeve të përfunduara, si pjesë e kostos totale të objekteve, veprim në mospërputhje me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2, germa (a) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe 16-20, të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec të

marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në lidhje me pasqyrimin si pjesë të AAGJM të të gjithë elementëve të tyre përfshirë dhe vlerën e studim projektimeve.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, llogaria 211 "Pyje, kullota plantacione" paraqitet në vlerën prej 765,318,602 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se nga njësia shpenzuese Agjencia e Mbrojtjes së Territorit në këtë llogari ka kontabilizuar vlerën 37,723,682 lekë si shtesë aktivi kur në fakt janë shpenzime për inventarë qarkullues (Dru zjarri), duke mbivlerësuar këtë llogari për këtë vlerë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerën e saj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2, germa (b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe 16-40, të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Agjencia e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Pogradec të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në llogarinë 211 "Pyje, kullota plantacione" duke zbritur vlerën 37,723,682 lekë që janë shpenzime për inventarë qarkullues (Dru zjarri).

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, Llogaria 211 "Pyje, kullota plantacione" paraqitet në vlerën prej 765,318,602 lekë, llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" paraqitet në vlerën 1,415,697,397 lekë dhe llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën 2,359,160,943 lekë. Referuar analizës së regjistrit të aktiveve rezultoi se, regjistrimi i tyre nuk ka të përcaktuar datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim. Gjithashtu nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv afat gjatë, i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës së mëpasshme nëpërmjet kryerjes së investimeve shtesë, si vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, pasi përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtjet e aktiveve që kanë një kosto të mëpasshme, duhet ti shtohen kostos fillestare të AAGJM-së , por janë trajtuar si aktive më vete. Gjithashtu nuk jep informacion se sa nga asetet e transferuara me VKM me listë përfundimtare janë të regjistruara në kontabilitet, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me inventarin fizik, amortizimin dhe plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar , Kapitulli II, pika 5 dhe 11; Aneksin 1, pika 2 germa (b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec të marrë masa për vlerësimin e mëpasshëm të aktiveve, si dhe kontabilizimin e tyre në mënyrën e duhur, duke i shtuar kostos fillestare të aktiveve afatgjata materiale, vlerën e rikonstruksione; mirëmbajtje; riparime kur plotësohen kriteret; zëvendësim pjesësh etj.

5.2. Rekomandimi Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec të marrë masa për hartimin e Regjistrit të aktiveve sipas formatit të miratuar, regjistrimin kronologjik të të gjitha kostove shtesë të aktiveve, si dhe përllogaritjen e amortizimit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me vlerë kontabël (kosto-amortizim/provigjone) është larg vlerës reale të tyre. Vlera fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarëve kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione" janë për vlerën nga 2,400 – 99,700 lekë dhe për llogarinë 215 "Mjete transporti" janë 5 mjete me vlerë 1 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar, pika 105 dhe Aneksin 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pika 2, pasi nga ana e Bashkisë Pogradec, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë masa, për ngritjen e grupeve të punës për rivlerësimin e aktiveve të klasifikuara në llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe konstruksione*" dhe llogarinë 215 "*Mjete transporti*", si dhe sistemimin e veprimeve kontabël pas rivlerësimit të tyre.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, për 5 njësitë shpenzuese, 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" paraqitet në vlerën prej 138,216,794 lekë. Referuar inventarit kontabël u konstatua se Njësia shpenzuese Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike ka kontabilizuar në këtë llogari vlerën 41,663,840 lekë që i përket llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" nga transferimet që janë bërë nga bashkia për gjatë vitit 2025, duke mbivlerësuar llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" dhe nënvlerësuar llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me vlerën e saj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" i ndryshuar , Kap.(II), pika 5, 11, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2, germa (b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike, Bashkia Pogradec të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në lidhje me keqklasifikimin si pjesë të inventarit kontabël në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" të vlerës 41,663,840 lekë, që në fakt i përket llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore".

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se për aktivet afatgjata materiale Llogaria 212 "Ndërtime konstruksione" dhe llogaria 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" për linjat teknologjike të prodhimit, makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, amortizimi nuk është llogaritur veçmas me vlerën e mbetur për çdo artikull me normë 5% por në grup për gjithë vlerën e mbetur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, Kap. III, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1 faqe 25-42, të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec të marrë masa që amortizimin e aktiveve ta llogarisë veçmas me vlerën e mbetur për çdo artikull

kontabël.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në 9 (nëntë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2 "për prokurimet" pjesë e raportit të auditimit, u konstatua se, disa prej kritereve për kualifikim rezultojnë të paqartë apo të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht dhe/ose të ekzagjeruar dhe/ose të argumentuara mbi bazën e parakushteve jo reale. Në lidhje me këto kritere, njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontratës. Mungesa e një argumentimi teknik, i cili do të justifikonte dhe ligjëronte vendosjen e secilit kriter të kërkuar, vjen si rezultat i moszbatimit të plotë të kuadrit ligjor, në fazën e hartimit dhe argumentimit të kritereve nga personat përgjegjës, në kundërshtim me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", (i ndryshuar), si dhe nenet 2, 40, 39 dhe 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 42-144 të Raportit të Auditimit).
9.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, gjatë përcaktimit të kërkesave, specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, të marrë masa të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kritere të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2023 me objekt "Rehabilitim i Lumit të Çërravës", me operator ekonomik fitues "B." ShPK dhe atë të zhvilluar gjatë vitit 2024 me objekt "Përfundim Punimesh objekti "Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore – Loti 1", me operator ekonomik fitues "*A.* " ShPK, u konstatua se, nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë në kushtet kur, këta të fundit, nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 92, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 82, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 42-144 të Raportit të Auditimit).*
10.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Pogradec, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertuesve, të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarte të tenderit (DST).
Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO), gjatë fazës së vlerësimit të një procedure, të marrë masa që të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë, vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë apo dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Në 7 (shtatë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2 "për prokurimet" pjesë e raportit të auditimit, u konstatua se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave, duke mos dhënë një justifikim

ligjor. Shkak i problematikës është angazhimi i një numri të vogël dhe shpesh të njëjtë punonjësish në KVO si dhe moszbatimi i kuadrit ligjor në fazën e vlerësimit, në kundërshtim me nenin 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 52-60 të Raportit të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Pogradec (Personi i Autorizuar) të marrë masa për të angazhuar një numër më të madh dhe të ndryshëm punonjësish në Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, me qëllim vlerësimin e tyre brenda afateve të përcaktuara.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht, në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2025, me objekt "*Blerje mjeti, makinë borëpastruese*" dhe "*Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale*", u konstatua se, dosjet fizike të prokurimit, të cilat, ndër të tjera, përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., nuk janë pajisur me inventarin e brendshëm të dosjes. Sa më sipër, mosveprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për arkivat*", nenin 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale, si dhe Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 60-80 të Raportit të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Pogradec (*personi përgjegjës për prokurimin*), me qëllim mundësimin e audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit, në lidhje me procedurat e sipërcituara, si dhe ato që do të zhvillohen në vijim, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në 1 (një) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit, të zhvilluar gjatë vitit 2024, me objekt "*Rehabilitim skema ujitëse "Rezervuari Bregu i Lëndinave, Çërravë*", me operator ekonomik fitues *A.* & *D.* ShPK, u konstatua se, edhe pse fituesi i procedurës së prokurimit ka qenë një bashkim ekonomik operatorësh, kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar nga përfaqësuesi i Bashkisë Pogradec dhe vetëm një nga përfaqësuesit e BOE-së, veprim në kundërshtim me nenin 88, pika 5 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021. "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 100-144 të Raportit të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Pogradec (Personi i Autorizuar) në fazën e nënshkrimit të kontratës për finalizimin e procedurave të prokurimit, në rastet kur fituesi është një bashkim i operatorëve ekonomikë, të marrë masa që kontrata të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në 7 (shtatë) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", të specifikuara në aneksin nr. 2 "për prokurimet" pjesë e raportit të auditimit, u konstatua se, nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec, janë hartuar projekt-preventiva për investime publike nga grupe pune ku jo të gjithë anëtarët kanë qenë të pajisur me licencat përkatëse. Kjo situatë ka ndodhur pasi Bashkia Pogradec, me qëllim shmangien e shpenzimeve, ka angazhuar punonjësit e saj për hartimin e projekt/preventivave, duke mos

kryer një procedurë prokurimi të mirëfilltë për përfitimin e objektit. Hartimi i projekteve të zbatimit në mungesë të licencës së projektimit apo të kategorisë përkatëse është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", neni 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 42-144 të Raportit të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë si dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Pogradec, në lidhje me investimet që do të kryhen në të ardhmen, për të cilat është i nevojshëm hartimi paraprak i një projekt-preventivi, të marrë masa që ky i fundit të hartohet nga specialistë të pajisur me licencë profesionale për kategorinë përkatëse.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në 4 (katër) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2023 me objekt "*Sistemim i Lumit të Buçimasit dhe Rehabilitimi i Infrastrukturës Rrugore*", atë të zhvilluar gjatë vitit 2023 me objekt "*Shërbim transporti për materiale ndërtimi*", atë të zhvilluar gjatë vitit 2024 me objekt "*Blerje Mjeti për zhvillimin e kanaleve Ujitëse (Eskavator)*" dhe atë të zhvilluar gjatë vitit 2025 me objekt "*Blerje mjeti makinë borëpastruese*", u konstatua se, nga anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave apo Komisionit të Marrjes në Dorëzim, si rezultat i moszbatimit të plotë të kuadrit ligjor, nuk janë plotësuar deklaratat mbi konfliktin e interesave, mosveprim i cili bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 13, pika 5, si dhe neni 73, pika 4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 42-144 të Raportit të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Pogradec (Personi i Autorizuar) në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, të marrë masa që çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, të nënshkruajë një deklaratë mbi konfliktin e interesit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në 3 (tre) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2023 me objekt "*Rehabilitimi i shkollës Myredin Bashalli", fshati Lin Nj. A. Udënisht, Bashkia Pogradec*", atë të zhvilluar gjatë vitit 2023 me objekt "*Ndërtim mur mbajtës, Lagjja nr. 1, Lumi i Vërdovës*" dhe atë të zhvilluar gjatë vitit 2025 me objekt "*Rehabilitim dhe ambiente shtesë, kopshti "Liri Çomo", Pogradec*", u konstatua se, nga personi përgjegjës për prokurimin, si rezultat i moszbatimit të kuadrit ligjor, dërgimi për publikim i "Njoftimit të Lidhjes së Kontratës" është kryer jashtë afatit të përcaktuar, veprim apo mosveprim i cili bie në kundërshtim me nenin 86 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 75-83 të Raportit të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Personi përgjegjës për prokurimin publik pranë Autoritetit Kontraktor, në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, të marrë masa që, për çdo procedurë prokurimi me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, të dërgojë për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2024 me objekt "*Blerje Mjeti për zhvillimin e kanaleve*

Ujitëse (Eskavator)" dhe atë të zhvilluar gjatë vitit 2025 me objekt "*Blerje mjeti makinë borëpastruese*", u konstatua se, nga anëtarët e Komisionit të Përcaktimit të Specifikimeve Teknike, edhe pse specifikimet janë përcaktuar në mënyrë rendore dhe variabile (me marzh), ato janë shoqëruar me një argumentim ligjor por jo me atë teknik, në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 86-91 të Raportit të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë, të marrë masa që gjatë përcaktimit të specifikimeve teknike, përveç renditjes dhe argumentimit ligjor të tyre, të shoqërojë këto të fundit edhe me një argumentim teknik.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit "blerje me vlerë të vogël" të zhvilluara nga AK Bashkia Pogradec, për periudhën nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2025, rezultoi se, në 1 rast, në lidhje me procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2023, janë kryer dy procedura prokurimi "Uniforma për Policinë Bashkiake" dhe "Veshje pune për shërbimin zjarrfikës" duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat standarde të prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 160, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", neni 2 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" neni 3, pika 1 dhe neni 56, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 96-98 të Raportit të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), të marrë masa për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, bazuar në nevojat për punë, mallra dhe shërbime, në përputhje me udhëzimet e APP-së, duke grupuar mallrat dhe shërbimet e ngjashme për përcaktimin e saktë të kufirit monetar dhe shmangien e ndarjes së paarsyetuar të procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 14 rasteve të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u konstatuan mangësi në 11 raste, që lidhen me plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit teknik e shoqërues, ndërsa në 3 raste u konstatuan tejkalime të afateve të shqyrtimit dhe në 1 rast mosfillim i punimeve brenda afatit ligjor. Konkretisht:

- Në lejen e ndërtimit për *"Strukturë akomoduese 'Bujtina Mari'"*, miratuar me Vendim nr. 105, datë 06.07.2023, në favor të subjektit "*E.E.*" PF, mungojnë policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për disa hartues projekti, ndërsa zhvilluesi nuk kishte filluar punimet brenda afatit ligjor;
- Në lejen për *"Shtesë kati në objekt ekzistues (Qendër Historike) dhe ndërtim i ri (Zonë e Mbrojtur)"*, miratuar me Vendim nr. 112, datë 10.07.2023, në favor të subjektit "*E.P.*" PF, u konstatuan mangësi në dokumentacionin profesional dhe teknik, përfshirë mungesën e nënshkrimeve elektronike, policave të sigurimit, të dhënave dhe detajeve në projektet konstruktive dhe elektrike, si dhe mungesën e kontratës së sigurimit;
- Në lejen për *"Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 44, datë 11.03.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, procedura u shqyrtua me 70 ditë pune tej afatit, ndërsa projekti arkitektonik paraqet mangësi në materializimin e fasadave teknike dhe në dy poste parkimi. Gjithashtu mungonte kontrata e sigurimit;
- Në lejen për *"Magazinë për shërbime tregtare dhe biznesi, 2 kat, me mur rrethues"*, miratuar me Vendim nr. 92, datë 30.04.2024, në favor të subjektit "*H.D.*" PF, procedura u shqyrtua me 74 ditë pune tej afatit, ndërsa projekti arkitektonik nuk përmbante detajet e elementeve konstruktivë dhe fasadat teknike ishin të pamaterializuara. Mungonte kontrata e sigurimit të objektit;

- Në lejen për *"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 148, datë 12.06.2024, në favor të subjektit "*F.C.*" ShPK, mungonte deklarata e përgjegjësisë profesionale të hartuesit të projektit arkitektonik, ndërsa projekti paraqiste pasaktësi lidhur me aksesueshmërinë e të paktën tre posteve të parkimit;
- Në lejen për *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 196, datë 26.08.2024, në favor të subjekteve "*L.K.*" & "*E.*" ShPK, projekti arkitektonik nuk përmbante një prerje teknike, ndërsa projekti konstruktiv nuk kishte të dhëna dhe detaje për mbrojtjen e objekteve përreth;
- Në lejen për *"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 48, datë 27.02.2025, në favor të subjektit "*A.*" ShPK, procedura u shqyrtua me 70 ditë pune tej afatit;
- Në lejen për *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 229, datë 30.07.2025, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, projekti hidrosanitar nuk ishte i plotë, pasi mungonin të dhënat për lidhjen e rrjetit të furnizimit me ujë dhe të shkarkimit të ujërave të zeza me rrjetin e qytetit;
- Në lejen për *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 327, datë 12.12.2025, në favor të subjekteve "*A.A.*" ShPK, u konstatua e njëjta mangësi në projektin hidrosanitar, lidhur me mungesën e të dhënave për lidhjen me rrjetet e qytetit;

Në certifikatën e përdorimit për *"Ndërtesë 1-5 kate me çati dhe podrum, hoteleri dhe shërbime"*, miratuar me Vendim nr. 121, datë 03.08.2023, në favor të subjektit "*G.*" ShPK, projekti as-built rezultoi i njëjtë me projektin e miratuar, megjithëse nga auditimi u konstatuan ndryshime ndërmjet objektit të miratuar dhe objektit të zbatuar;
- Në certifikatën e përdorimit për *"Godinë me karakter hotelerie 4-5 kat + 1 kat nën tokë"*, miratuar me Vendim nr. 285, datë 19.11.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK, raporti përfundimtar i auditimit të eficiencës së energjisë nuk mbulonte të gjitha ambientet, ndërsa një pjesë e dokumentacionit nuk ishte ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, por ishte depozituar fizikisht në protokollin e Bashkisë Pogradec.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, neni 39; neni 44, pika 2; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ç), e), ë), g); neni 15, pika 1/1, nënpika i), ii) iii),iv), v); neni 20, pika 2, nënpika a); neni 21; neni 26, pika 5; neni 27/2, pika 1, nënpika e), ë), g), gj), h), i), j), l), ll); neni 45/1, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 145-159 të Raportit të Auditimit)*

19.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Pogradec, të merren të gjitha masat që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi:
- të kërkohet dhe të verifikohet plotësia, saktësia dhe përputhshmëria e të gjithë dokumentacionit teknik të projekteve ndërtimore (arkitektonik, konstruktiv, elektrik, hidrosanitar dhe sistemet e tjera teknike), duke siguruar që projektet të përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme si prerjet teknike, fasadat, detajet konstruktive, sistemet e mbrojtjes dhe lidhjet me infrastrukturën publike, si dhe që zgjidhjet teknike të jenë të zbatueshme dhe në përputhje me gjendjen faktike të objektit;
- të kërkohet ngarkimi në sistemin e-leje dhe verifikimi i dokumentacionit shoqërues të detyrueshëm, duke përfshirë deklaratat e përgjegjësisë profesionale, licencat dhe policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, të nënshkruara elektronik nga hartuesit përkatës; të mos pranohen dokumente të nënshkruara nga persona të ndryshëm nga hartuesit ose të dorëzuara jashtë sistemit elektronik, si dhe të sigurohet që për certifikatat e përdorimit të verifikohet përputhshmëria e objektit të zbatuar me projektin e miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 10 rasteve të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan mangësi në 9 raste, lidhur me moskërkimin, mosrespektimin ose mosverifikimin e mendimeve dhe rekomandimeve të autoriteteve përgjegjëse përpara miratimit të lejeve, jo në përputhje me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, pika 6. Në gjashtë raste (Vendim nr. 105, datë 06.07.2023; Vendim nr. 112, datë 10.07.2023; Vendim nr. 44, datë 11.03.2024; Vendim nr. 92, datë 30.04.2024; Vendim nr. 148, datë 12.06.2024; Vendim nr. 196, datë 26.08.2024) Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DV ASHK) nuk ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës për mendim, duke e miratuar praktikën në heshtje, pa përcjellë informacionin mbi statusin e pronësisë apo kartelat e pasurive, siç kërkohet nga kuadri ligjor. Gjithashtu është konstatuar se:

- Në lejen për *"Shtesë kati në objekt ekzistues (Qendër Historike) dhe ndërtim i ri (Zonë e Mbrojtur)"*, miratuar me Vendim nr. 112, datë 10.07.2023, gjatë shqyrtimit të aplikimit për ndryshimin e projektit (gjatë ndërtimit) nuk është kërkuar mendimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit;
- Në lejen për *"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 148, datë 12.06.2024, nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet e Institutit të Gjeoshkencave dhe nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit për konfirmimin e reflektimit të rekomandimeve të lëna në oponencën teknike;
- Në lejen për *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 196, datë 26.08.2024, nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, ndonëse objekti zhvillohet në zonë me përparësi zhvillimin e turizmit;
- Në lejen për *"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 48, datë 27.02.2025, nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, si dhe nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit për konfirmimin e reflektimit të rekomandimeve të lëna në oponencën teknike;
- Në lejen për *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 229, datë 30.07.2025, nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit për konfirmimin e marrjes në konsideratë dhe reflektimit të rekomandimeve të oponencës teknike në projektin ndërtimor;
- Në lejen për *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, miratuar me Vendim nr. 327, datë 12.12.2025, nuk është kërkuar mendimi i Institutit të Ndërtimit, i Institutit të Gjeoshkencave dhe i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, pavarësisht se objekti zhvillohej në zonë me përparësi dhe Bashkia Pogradec kishte njoftuar aplikantin dhe zhvilluesin për nevojën e marrjes së këtyre mendimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 145-159 të Raportit të Auditimit).*

<u>20.1. Rekomandimi:</u> Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Pogradec, të merren të gjitha masat që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi:

- të kërkohet dhe të verifikohet në mënyrë të plotë respektimi i detyrimit për marrjen e mendimeve të të gjitha autoriteteve kompetente përpara miratimit të lejeve të ndërtimit; të mos pranohet vijimi i procedurës në rastet kur mungon përgjigjja ose dokumentimi i shprehur i mendimit nga autoritetet për të cilat ligji kërkon shprehimisht përmbajtje aktive të mendimit (status pronësie/kartelë pasurie), dhe jo miratim të heshtur;
- të kërkohet në mënyrë të detyrueshme mendimi i të gjitha institucioneve të përcaktuara në legjislacionin përkatës sipas natyrës së zhvillimit (përfshirë ASHK, AZHT, MTM, AKZM, UPT IGJEUM, OST dhe Institutin e Ndërtimit), si dhe të sigurohet administrimi i dokumentacionit të plotë provues për marrjen në konsideratë të rekomandimeve të dhëna prej tyre, përpara miratimit të lejeve, si dhe gjatë shqyrtimit të kërkesave për ndryshim projekti gjatë ndërtimit.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit është konstatuar se në pesë raste (nga dhjetë raste të audituara), nuk është respektuar numri minimal i vend-parkimeve ose nuk është respektuar KSHT. Në të gjitha rastet, zhvilluesit dhe projektuesit kanë parashikuar vend-parkime si në katin nëntokësor, po ashtu dhe në kuotën e sistemimit. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është specifikuar nëse këto vend-parkime janë për shitje apo për përdorim publik. ***Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për shitje***, atëherë nuk është respektuar KSHT. ***Nëse marrim rastin se këto vend-parkime janë për përdorim publik***, atëherë parkimet në kuotën e sistemimit nuk do të duhej të merreshin në konsideratë në përllogaritjen e numrit faktik të vend-parkimeve. Nëse i referohemi nenit 5 të Ligjit nr. 10 112, datë 09.04.2009 *"Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"*, pika 1, objekte në pronësi të përbashkët janë të gjitha pjesët e një prone në bashkëpronësi, përveç njësisë. Prona e përbashkët përfshin të gjitha pjesët e ndërtesës, territorin, pajisjet, mjedisin dhe objektet në shërbim të saj, <u>që nuk janë destinuar për përdorim</u> individual dhe nuk janë pronë publike, si truallin, mbi të cilin është ngritur ndërtesa, oborret e rrethuara, parkimet, pishinat, gjelbërimin, themelet, muret mbajtëse, çatinë, tarracën, shkallët, sheshpushimet, ashensorët, kalimet, bodrumet, puset, pusetat, depozitat e ujit dhe kaldajat. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

- Për lejen e ndërtimit me objekt *"Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 44, datë 11.03.2024: Janë parashikuar 45 vend-parkime nëntokë dhe 15 në sistemim, pa përcaktim destinacioni. Në rast shitjeje, KSHT është 50% (732.8 + 187 / 1842), mbi kufirin 40%. Në rast përdorimi publik, nuk plotësohet numri minimal i vendparkimeve (63 të nevojshme, 43 ekzistuese);
- Për lejen e ndërtimit me objekt *"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 148, datë 12.06.2024: Janë parashikuar 35 vend-parkime nëntokë dhe 13 në sistemim, pa përcaktim destinacioni. Në rast shitjeje, KSHT është 53.6% (593.5 + 178.1 / 1,439), mbi kufirin 45%. Në rast përdorimi publik, nuk plotësohet numri minimal i vendparkimeve (48 të nevojshme, 35 ekzistuese);
- Për lejen e ndërtimit me objekt *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 196, datë 26.08.2024: Janë parashikuar 42 vend-parkime nëntokë dhe 17 në sistemim. Në rast shitjeje, KSHT është 53% (777.9 + 215 / 1,867), mbi kufirin 45%. Në rast përdorimi publik, nuk plotësohet numri minimal i vendparkimeve (49 të nevojshme, 42 ekzistuese);
- Për lejen e ndërtimit me objekt *"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 48, datë 27.02.2025: Janë parashikuar 43 vend-parkime nëntokë dhe 15 në sistemim, pa përcaktim destinacioni. Në rast shitjeje, KSHT është 47.5% (612.5 + 198.5 / 1,698), mbi kufirin 45%. Në rast përdorimi publik, nuk plotësohet numri minimal i vendparkimeve (43 të nevojshme, 32 ekzistuese);
- Për lejen e ndërtimit me objekt *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 229, datë 30.07.2025: Janë parashikuar 60 vend-parkime nëntokë dhe 27 në sistemim. Në rast shitjeje, KSHT është 47.6% (978.78 + 270 / 2,620), mbi kufirin 40%. Në rast përdorimi publik, nuk plotësohet numri minimal i vendparkimeve (87 të nevojshme, 60 ekzistuese).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqe 145-159 të Raportit të Auditimit)

<u>21.1. Rekomandimi:</u> Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Pogradec, të merren të gjitha masat që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, të kërkohet specifikisht qëllimi përfundimtar i vend-parkimeve në kuotën e sistemimit (nëse kanë për qëllim shitjen e tyre ose nëse janë për përdorim publik). Në varësi të këtij informacioni, DPKZHT duhet të kryejë verifikimin e respektimit ose jo të

Koeficientit të Shfrytëzimit të Territorit (nëse këto sipërfaqe do të përfshihen ose jo në llogaritjen e KSHT).

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se, në 7 raste nga 14 raste të audituara, përcaktimet e paketës fiskale të Bashkisë Pogradec për përllogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk janë në përputhje me metodologjinë e parashikuar në legjislacion. Konkretisht, paketa fiskale parashikon përllogaritjen e taksës vetëm mbi vlerën e preventivit, ndërkohë që baza e taksës duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë vlerën e investimit sipas preventivit ose vlerën e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri, duke aplikuar metodën që rezulton në vlerën më të lartë. Sipas VKB-së nr. 132, datë 22.11.2022, *"Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec"*, TNI për ndërtimet e reja llogaritet si 4–5% mbi vlerën e preventivit. Ndërkohë, neni 46 i Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, në lidhje me nenin 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore"*, i ndryshuar, përcakton si bazë të taksës vlerën e investimit sipas preventivit ose vlerën e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Për rrjedhojë, përllogaritjet e kryera nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit kanë rezultuar në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale në fuqi, por këto përcaktime kanë qenë të paplota dhe jo të harmonizuara me dispozitat ligjore, duke sjellë në rastet e audituara përllogaritje më të ulëta të TNI. Konkretisht: **i.** *"Godinë banimi 7 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 44, datë 11.03.2024: TNI është përllogaritur në shumën 9,020,020 lekë, në përputhje me paketën fiskale, ndërsa sipas metodës së bazuar në çmimin e shitjes për metër katror do të rezultonte 12,550,068 lekë, me diferencë 3,530,048 lekë; **ii.** *"Objekt banimi dhe shërbimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 148, datë 12.06.2024: TNI është përllogaritur 8,076,109 lekë, ndërsa sipas metodës tjetër do të rezultonte 11,035,260 lekë, me diferencë 2,959,151 lekë; **iii.** *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 196, datë 26.08.2024: TNI është përllogaritur 9,683,540 lekë, ndërsa sipas metodës tjetër do të rezultonte 13,235,203 lekë, me diferencë 3,551,663 lekë; **iv.** *"Godinë banimi 4,5 dhe 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 48, datë 27.02.2025: TNI është përllogaritur 6,088,375 lekë, ndërsa sipas metodës tjetër do të rezultonte 8,730,503 lekë, me diferencë 2,642,128 lekë; **v.** *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 229, datë 30.07.2025: TNI është përllogaritur 10,303,983 lekë, ndërsa sipas metodës tjetër do të rezultonte 14,877,994 lekë, me diferencë 4,574,011 lekë; **vi.** *"Godinë banimi 6 kat + 1 kat nëntokë"*, Vendim nr. 327, datë 12.12.2025: TNI është përllogaritur 4,106,770 lekë, ndërsa sipas metodës së bazuar në çmimin e shitjes për metër katror do të rezultonte 6,532,342 lekë, me diferencë 2,425,572 lekë; **vii.** Në rastin e certifikatës së përdorimit për *"Godinë rezidenciale (banimi) 9 kate + 1 kat nën tokë"*, Vendim nr. 289, datë 20.11.2024, TNI është përllogaritur 2,117,641 lekë, mbi bazën e preventivit, ndërsa sipas çmimit të shitjes për metër katror do të rezultonte 4,106,869.8 lekë, me diferencë 1,973,750.8 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 145-159 të Raportit të Auditimit)

22.1. Rekomandimi: Nga ana e titullarit të Bashkisë Pogradec të merren masa për ngritjen e një grupi pune me përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me qëllim propozimin e ndryshimeve në paketën fiskale në lidhje me metodologjinë e përllogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

Brenda datës 31.12.2026

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit është konstatuar se, në dy raste (nga katër raste të audituara), Drejtoria e

Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) nuk kanë marrë të gjitha masat për kryerjen e verifikimeve përpara pajisjes me certifikatë përdorimi. Më konkretisht, këto parregullsi janë konstatuar në rastet:
- Certifikatë përdorimi për *"Ndërtesë 1-5 kate me çati dhe podrum, hoteleri dhe shërbime"*, miratuar me Vendim nr. 121, datë 03.08.2023, në favor të subjektit "*G.*" ShPK;
- Certifikatë përdorimi për *"Godinë me karakter hotelerie 4-5 kat + 1 kat nën tokë"*, miratuar me Vendim nr. 285, datë 19.11.2024, në favor të subjektit "*E.*" ShPK.
Në të dyja rastet, objekti është vendosur në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit. Vendosja e objektit në përdorim përpara miratimit të certifikatës së përdorimit është i ndaluar dhe i dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika f). Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, si dhe referuar informacionit të kërkuar nga DPKZHT dhe IMTV, nuk janë kryer inspektime dhe nuk janë marrë masa për adresimin e kësaj kundërvajtje. Për rastin e parë, nga auditimi i projektit të miratuar, fotove të ngarkuara në sistemin *e-lejet*, si dhe inspektimit në terren, janë konstatuar ndryshime midis objektit të miratuar dhe objektit të zbatuar. Këto ndryshime evidentohen në fasadën lindore (çarje në katin përdhe, çarje në katin përdhe e mbyllur me qepen, dritare të shtuara në katin përdhe). Veprimet e mësipërme janë të ndaluar dhe të dënueshëm sipas përcaktimeve të nenit 52 të Ligjit 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 1, nënpika e). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4., faqe 160-174 të Raportit të Auditimit).*
23.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Pogradec, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor të merren të gjitha masat për të kryer inspektime të vazhdueshme në objektet në ndërtim, për të verifikuar nëse këto objekte janë vendosur ose jo në përdorim përpara pajisjes me certifikatë përdorimi, si dhe për të verifikuar përputhshmërinë e objektit të miratuar me objektin e ndërtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), planifikimit të programeve të punës, si dhe raportimit periodik në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), është konstatuar se:
- Në IMTV Bashkia Pogradec, para dhe gjatë periudhës në auditim, është punësuar staf që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Në IMTV është punësuar staf me profil arsimor si: Master Profesional në sistemet Moderne të TelekomuNcionit dhe Teknologjinë e Interentit; Arsim i mesëm; Marketing; Akademia e Rendit; Menaxhim Biznesi. Mungesa e stafit të kualifikuar sipas profilit përkatës, përbën element risku për cilësinë e kryerjes së punës të IMTV-së, për përcaktimin dhe përshkrimin teknik në aktet e kontrollit respektive të situatave të konstatuara gjatë inspektimit në terren;
- Planet mujore, tremujore dhe/ose vjetore të punës nuk janë hartuar për periudhën 01.01.2023–31.10.2023 dhe 01.01.2025–31.12.2025, ndërsa për periudhën nëntor 2023–dhjetor 2024 u administruan planet përkatëse të punës, veprime ne kundërshtim me VKM-së nr. 894, datë 01.11.2015, *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore",* nënpika b.ii.;
- Për periudhën 01.01.2023–31.12.2025, nuk është kryer raportimi tremujor pranë IKMT-së për masat e marra ndaj kundërvajtjeve të konstatuara, përfshirë vendimet për pezullim, gjobë dhe prishje, kallëzimet penale dhe kërkesat për heqjen e licencave profesionale, personale ose të shoqërisë. Veprime në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* pika f).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4., faqe 160-174 të Raportit të Auditimit)

24.1. Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Pogradec të merren masa që në strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të rekrutohet staf që plotëson kriteret arsimore të parashikuara, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve profesionale të IMTV-së, garantimin e zbatimit të kërkesave ligjore dhe rritjen e efektivitetit e cilësisë së veprimtarisë inspektuese në mbrojtjen e territorit.

Në vijimësi

24.2. Rekomandimi: Nga ana e kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Pogradec të merren masa për të përgatitur planet e punës dhe raportimin në IKMT në mënyrë periodike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, me qëllim sigurimin e planifikimit, organizimit dhe monitorimit efektiv të veprimtarisë inspektuese, garantimin e gjurmueshmërisë së aktiviteteve të kontrollit të territorit, si dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për informimin dhe raportimin institucional ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në lidhje me masat / vendimet e marra pas konstatimit të ndërtimit pa leje / devijimit nga leja e ndërtimit (vendim pezullimi / prishje / ekzekutim i vendimit të prishjes), dokumentimin e proceseve të inspektimit / prishjes së objekteve të kundërligjshëm me evidenca fotografike dhe nisjes së indices së veprës penale drejt organeve ligjzbatuese, është konstatuar se:

- Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 *"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, pika a), inspektorët kanë detyrimin e dokumentimit të kundërvajtjes së konstatuar me foto ose video, si dhe bërjen e tyre pjesë të dosjeve individuale të secilës procedurë. Gjatë periudhës 01.01.2023 – 31.12.2025, IMTV, Bashkia Pogradec ka mbajtur në total 28 procedura, ndërkohë që në një rast, kundërvajtja e konstatuar nuk është dokumentuar me evidenca fotografike, konkretisht për subjektin "*A.K.*", sipas PVKK me nr. serie 000144, datë 18.08.2023;
- Në zbatim të nenit 5, pika dh), të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, si dhe nenit 52, pika 7, të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, kryeinspektori i IMTV ka detyrimin të nisë indicien e veprës penale pranë organeve ligjzbatuese për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit. Nga auditimi u konstatuan të paktën 20 raste (***Aneksi nr. 03***) që përbëjnë vepër penale sipas nenit 199/a të Kodit Penal. Megjithatë, IMTV, Bashkia Pogradec, nuk vuri në dispozicion dokumentacion zyrtar që të vërtetojë nisjen e indicies së veprës penale pranë organeve ligjzbatuese për asnjë prej këtyre rasteve;
- Referuar përcaktimeve ligjore, si dhe nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, në 6 raste nuk është nxjerrë vendimi për pezullimin e punimeve, kur do të duhej t'i ishte dhënë kohë subjektit të konstatuar për plotësimin e dokumentacionit ose përmirësimin e masave të sigurimit teknik në objekt dhe shtimin e mjeteve mbrojtëse të jetës së punëtorëve, paraqitur në tabelën e mëposhtme. Veprimet në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar. Kjo parregullsi është konstatuar në rastet: **i.** PVKK me nr. serie 000139, datë 20.03.2023; **ii.** PVKK me nr. serie 000148, datë 10.10.2023; **iii.** PVKK me nr. serie 000096, datë 01.02.2024; **iv.** PVKK me nr. serie 000098, datë 23.02.2024; **v.** PVKK me nr. serie 000099, datë 13.03.2024; **vi.** PVKK me nr. serie 000104, datë 15.07.2024;
- Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025 nga inspektorët e IMTV, janë konstatuar gjithsej **34 subjekte** për ndërtime informale të ndërtuar pa leje ndërtimi dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit. Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se IMTV ka proceduar për **28**

subjekte me vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, ndërsa në **6 raste** kryeinspektorët e IMTV nuk e kanë nxjerrë këtë vendim. Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar, pika d), si dhe në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, pika 6. Rastet kur nuk është nxjerrë vendimi i prishjes së objektit të kundërligjshëm janë: **i.** *Ç.P.* (PVKK me nr. serie 000139, datë 20.03.2023); **ii.** *P.S.*(PVKK me nr. serie 000142, datë 24.07.2023); **iii.** *D.M.*(PVKK me nr. serie 000106, datë 25.10.2024); **iv.** *M.C.*(PVKK me nr. serie 000113, datë 14.04.2025); **v.** *K.A.*(PVKK me nr. serie 000511, datë 01.08.2025); **vi.** *A.H.*(PVKK me nr. serie 000512, datë 02.09.2025).
Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të prishjeve të objekteve të jashtëligjshëm është konstatuar se nga 28 raste kur është nxjerrë vendimi i prishjes, ky vendim është ekzekutuar vetëm në 7 (shtatë) raste, ndërkohë që për 21 raste (të paraqitura në ***Aneksin nr. 01***) nga ana e IMTV nuk janë marrë masa (kërkesa për asistencë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ose IKMT) për prishjen e këtyre objekteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 160-174 të Raportit të Auditimit)*

25.1. Rekomandimi: Nga ana e kryeinspektorit të IMTV, Bashkia Pogradec, të merren të gjitha masat për:
- zbatimin e plotë dhe të njëtrajtshëm të procedurave administrative, duke nxjerrë vendimet për pezullimin e punimeve në të gjitha rastet kur konstatohet nevoja për plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor, përmirësimin e kushteve të sigurisë në objekt ose kur kërkohet verifikim i mëtejshëm përpara marrjes së vendimit përfundimtar;
- nxjerrjen e vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshme në të gjitha rastet kur plotësohen kushtet ligjore për marrjen e tyre, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe operative për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

25.2. Rekomandimi: Nga ana e kryeinspektorit të IMTV, Bashkia Pogradec, të merren të gjitha masat për:
- sigurimin e dokumentimit të plotë të çdo kundërvajtjeje të konstatuar gjatë inspektimeve në terren me evidenca fotografike dhe/ose video, si dhe administrimin e tyre në dosjet përkatëse të procedurave administrative, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, transparencës dhe mbështetjes me prova të konstatimeve të inspektorëve;
- ndjekjen e procedurave për referimin pranë organeve ligjzbatuese të të gjitha rasteve kur gjatë ushtrimit të funksioneve inspektuese konstatohen elementë të veprës penale, si dhe dokumentimin dhe administrimin në dosjet përkatëse të dokumentacionit që provon paraqitjen e kallëzimeve penale dhe ndjekjen e mëtejshme të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren i zhvillimit të objekteve në qytetin e Pogradecit, grupi i auditimit kërkoi, që nëpërmjet strukturës së IMTV-së, të vendosej në dispozicion informacion / dokumentacion për 7 raste (4 foto të qarta, të objekteve të përzgjedhura; të dhëna mbi lejen e ndërtimit, nëse ka; masat e marra nga IMTV për këto objekte, nëse ka). IMTV vendosi në dispozicion informacionin e kërkuar, fotografitë, procedurat e mbajtura nga IMTV (për ato raste që është mbajtur procedurë) dhe lejet e ndërtimit (për ato raste që kanë qenë të pajisura me leje ndërtimi). Sipas kësaj shkrese dhe verifikimeve të bëra nga grupi i auditimit, është konstatuar se në 4 nga 7 rastet për të cilat është kërkuar informacion, subjektet kanë qenë të pajisur me leje ndërtimi apo deklarata paraprake punimesh. Në 3 raste është konstatuar se punimet janë kryer pa leje dhe nga ana e IMTV nuk janë kryer inspektime për evidentimin e këtyre ndërtimeve pa leje. Konkretisht, në

rastin e parë është konstatuar ndryshimi i çatisë së një objekti ekzistues, i realizuar gjatë periudhës Tetor 2022 – Tetor 2023; në rastin e dytë janë konstatuar dy objekte të reja (magazinë dhe kotec), të ndërtuara gjatë periudhës Tetor 2022 – Tetor 2023; ndërsa në rastin e tretë është konstatuar ndërtimi i një objekti të ri gjatë periudhës Tetor 2022 – Shkurt 2025. Për asnjërin prej këtyre rasteve nuk u vendos në dispozicion dokumentacion që të provonte pajisjen me leje ndërtimi apo ndërmarrjen e procedurave administrative nga IMTV për evidentimin dhe trajtimin e kundërvajtjeve. Për pasojë, IMTV nuk ka ushtruar kontrolle efektive në këto objekte ose nuk ka dokumentuar konstatimet e kryera, duke lejuar zhvillimin e ndërtimeve pa leje në territor, në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 160-174 të Raportit të Auditimit)

26.1. Rekomandimi: Nga ana e kryeinspektorit të IMTV, Bashkia Pogradec, të merren të gjitha masat për verifikimin administrativ dhe në terren të rasteve të evidentuara nga grupi i auditimit, me qëllim përcaktimin e statusit ligjor të objekteve dhe dokumentimin e situatës faktike. Në rastet kur konstatohet mungesa e lejes së ndërtimit ose e dokumentacionit ligjor përkatës, të ndiqen dhe të përfundojnë të gjitha procedurat administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe marrjen e masave për ekzekutimin e tyre, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë dhe forcimin e kontrollit të territorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren i zhvillimit të objekteve në qytetin e Pogradecit, grupi i auditimit kërkoi, që nëpërmjet strukturës së IMTV-së, të vendosej në dispozicion informacion / dokumentacion për 7 raste (4 foto të qarta, të objekteve të përzgjedhura; të dhëna mbi lejen e ndërtimit, nëse ka; masat e marra nga IMTV për këto objekte, nëse ka). IMTV vendosi në dispozicion informacionin e kërkuar, fotografitë, procedurat e mbajtura nga IMTV (për ato raste që është mbajtur procedurë) dhe lejet e ndërtimit (për ato raste që kanë qenë të pajisura me leje ndërtimi). Sipas kësaj shkrese dhe verifikimeve të bëra nga grupi i auditimit, është konstatuar se në 4 nga 7 rastet për të cilat është kërkuar informacion, subjektet kanë qenë të pajisur me leje ndërtimi apo deklarata paraprake punimesh. Në 3 raste është konstatuar se punimet janë kryer pa leje dhe nga ana e IMTV nuk janë kryer inspektime për evidentimin e këtyre ndërtimeve pa leje. Konkretisht, në rastin e parë është konstatuar ndryshimi i çatisë së një objekti ekzistues, i realizuar gjatë periudhës Tetor 2022 – Tetor 2023; në rastin e dytë janë konstatuar dy objekte të reja (magazinë dhe kotec), të ndërtuara gjatë periudhës Tetor 2022 – Tetor 2023; ndërsa në rastin e tretë është konstatuar ndërtimi i një objekti të ri gjatë periudhës Tetor 2022 – Shkurt 2025. Për asnjërin prej këtyre rasteve nuk u vendos në dispozicion dokumentacion që të provonte pajisjen me leje ndërtimi apo ndërmarrjen e procedurave administrative nga IMTV për evidentimin dhe trajtimin e kundërvajtjeve. Për pasojë, IMTV nuk ka ushtruar kontrolle efektive në këto objekte ose nuk ka dokumentuar konstatimet e kryera, duke lejuar zhvillimin e ndërtimeve pa leje në territor, në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 160-174 të Raportit të Auditimit)

27.1. Rekomandimi: Nga ana e kryeinspektorit të IMTV, Bashkia Pogradec, të merren të gjitha masat për verifikimin administrativ dhe në terren të rasteve të evidentuara nga grupi i auditimit, me qëllim përcaktimin e statusit ligjor të objekteve dhe dokumentimin e situatës faktike. Në rastet kur konstatohet mungesa e lejes së ndërtimit ose e dokumentacionit ligjor përkatës, të ndiqen dhe të përfundojnë të gjitha procedurat administrative të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe marrjen e masave për ekzekutimin e tyre, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë dhe forcimin e kontrollit të territorit.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e aseteve, u konstatua se Bashkia Pogradec nuk ka vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minierave dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.
Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në Regjistrin e Lejeve Minerare të muajit shkurt të vitit 2025, Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, u konstatua se për periudhën nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2025, në territorin e Bashkisë Pogradec ushtrojnë aktivitet 19 subjekte, sipas aneksit nr. 1, të cilat nuk paguajnë detyrime për aktivitetin që kryejnë, pasi nuk janë të evidentuara nga Bashkia Pogradec në kundërshtim me Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", neni 4, pika 4 dhe 5 dhe Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 36, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 179-183 të Raportit të Auditimit)*
28.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për identifikimin dhe evidentimin e plotë të subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar dhe/ose koncesionar në sipërfaqe pyjore e kullosore në administrim të saj të përcaktuara në ankesin nr. 1, të lidhë kontratat përkatëse të qirasë ose përdorimit të pasurisë sipas legjislacionit në fuqi dhe të llogarisë, arkëtojë dhe ndjekë detyrimet financiare që rrjedhin nga përdorimi i këtyre pasurive publike, me qëllim mbrojtjen e interesave pasurore të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe rritjen e të ardhurave në buxhetin vendor.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi administrimin e pronave të Bashkisë Pogradec rezultoi se, nga 652 prona të transferuara në pronësi dhe në përdorim të bashkisë me VKM-të përkatëse, gjatë periudhës objekt auditimi janë regjistruar vetëm 47 prona. Për pasojë, procesi i regjistrimit të pasurive të transferuara vijon të mbetet i papërfunduar, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe dispozitat e VKM-ve përkatëse të transferimit të pronave, duke krijuar risk për administrimin e plotë dhe mbrojtjen e pasurisë publike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 179-183 të Raportit të Auditimit).*
29.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit përkatës dhe përllogaritjen e kostove të nevojshme për përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 93, **Titullari i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të

gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,202,585 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale" me nr. 695/13 prot., datë 12.05.2025 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë R.SHPK, me vlerë të objektit 3,752,565 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 4 (katër) javë nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, *rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionua*r për zërin e punimeve: "*Bojë hidroplastike cilësi e lartë*", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **104,800** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 695/13 prot., datë 12.05.2025 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 1382/3 prot., datë 12.05.2025. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 132-133 të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga OE "R." SHPK të vlerës **104,800 lekë** pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës nr. 695/13 prot., datë 12.05.2025, me objekt "Rikonstruksion i Qendrës Multifunksionale".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari i Pusit-Gjollet, Leshnicë*" me nr. 4324/6 prot., datë 11.12.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe (BOE) "I." SHPK & "L." SHPK, me vlerë të objektit 9,690,360 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 2 (dy) muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve: "*Gërmim kanalesh meekskavator 0.25 m3, në kanale gjerësi >2m, tok zak, kategoria III, me shkarkim në mjet, Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krahë, me seksion deri 0.75 m2, Rrafshim skarpatesh, me krahë, në gërmim tokë të zakonshme*", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **271,710** lekë pa TVSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 4324/6 prot., datë 11.12.2024 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 3387/3 prot., datë 22.09.2025. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 133-134 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (BOE) "I." SHPK & "L." SHPK të vlerës **271,710** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 4324/6 prot., datë 11.12.2024 me objekt: "*Rikonstruksion kanali ujitës rezervuari i Pusit-Gjollet, Leshnicë*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "Rehabilitimi skema ujitëse "Rezervuari Bregu i Lendinave, Çërravë" me nr. 4530/12 prot., datë 27.12.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive (BOE) "A." SHPK Tiranë & "*D."* SHPK, me vlerë të objektit është 5,205,602.40 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të

kontratës 1 (Një) muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërin e punimeve: "Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë me seksion deri 0.25 m2", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **148,200 lekë** pa TVSH.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 4530/12 prot., datë 27.12.2024 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 3882/32 prot., datë 19.12.2023. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 135-136 të Raportit të Auditimit).*
3.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (BOE) "A." SHPK Tiranë & "*D."* SHPK të vlerës **148,200** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 4530/12 prot., datë 27.12.2024 me objekt: "*Rezervuari Bregu i Lendinave, Çërravë*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Ujësjellësi i Mokrës Faza e Dytë, Bashkia Pogradec*" me nr. 162/10 prot., datë 08.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomik (BOE) "R." SHPK dhe "*A.*" SHPK, me vlerë të objektit 264,000,172.34 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 22 (muaj) muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërin e punimeve: "Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **350,000 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 162/10 prot., datë 08.04.2021 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 276 prot., datë 18.01.2021. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 137-138 të Raportit të Auditimit).*
4.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (BOE) "R." SHPK dhe "*A.*" SHPK të vlerës **350,000** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 162/10 prot., datë 08.04.2021 me objekt: "*Ujësjellësi i Mokrës Faza e Dytë, Bashkia Pogradec*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rikonstruksion dhe shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Geshtenjas, Bashkia Pogradec*" me nr. 4531/11 prot., datë 18.12.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë R.SHPK Tiranë, me vlerë të objektit është 70,156,980.43 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 6 (gjashtë) muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve: "Transport materiale ndërtimi, Suva brenda mur tulle h-4m me krah, llaç përzier M 25, Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **245,519 lekë** pa TVSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 4531/11 prot., datë 18.12.2024 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 4076/9 prot., datë 18.12.2024. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 138-139 të Raportit të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (BOE) "R." SHPK dhe "*A.*" SHPK të vlerës **245,519** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 4531/11 prot., datë 18.12.2024 me objekt: "*Rikonstruksion dhe shtesë objekti për shkollën "Kajo Karafili", Geshtenjas, Bashkia Pogradec*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "Rehabilitim i shkollës "Myredin Bashalli", Fshati Lin, Njësia Administrative Udënisht" me nr. 1495/20 prot., datë 14.11.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë V.K.SHPK me vlerë të objektit 59,385,163.66 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve: "*Transport materiale ndërtimi, Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø 120 mm, Ulluk shkarkimi horizontal me bakër 33 cm*", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **531,633 lekë** pa TVSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 1495/20 prot., datë 14.11.2023 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 3882/26 prot., datë 15.11.2023. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 139-140 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (OE) V.K.SHPK të vlerës **531,633** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 1495/20 prot., datë 14.11.2023 me objekt: "*Rehabilitim i shkollës "Myredin Bashalli", Fshati Lin, Njësia Administrative Udënisht*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I*" me nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë *R.* SHPK Tiranë, me vlerë të objektit 84,891,838 lekë me TVSH dhe fat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Shtresë rëre, Struktura të holla betoni C 25/30 për kuneta, Mbushje me material shkëmbor mbas mureve", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **191,343 lekë** pa TVSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023 si dhe kontratën e

mbikëqyrjes me nr. 3882/32 prot., datë 19.12.2023. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 141-142 të Raportit të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (OE) R.SHPK të vlerës **191,343** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 578/18 prot., datë 22.12.2023 me objekt: "*Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I*" me nr. 3573/9 prot., datë 31.10.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec, dhe, sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "*A.* " SHPK Tiranë, me vlerë të objektit 10,804,812 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 2 (dy) muaj nga data e marrjes në dorëzim të sheshit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike për zërin e punimeve "(Zëri 2(2.286). Shtresë pllaka betoni dekorative C 25/30 6 cm mbi shtresë rëre/granil t=5 cm.", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **45,080 lekë** pa TVSH.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3573/9 prot., datë 31.10.2024 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 4443/9 prot., datë 13.11.2024. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 142-143 të Raportit të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (OE) "*A.* " SHPK të vlerës **45,080** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 3573/9 prot., datë 31.10.2024 me objekt: "*Sistemimi i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij - Loti I*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rikonstruksion dhe shtesa shkolla e mesme "14 Engjëjt" dhe shkolla 9-vjeçare "Servet Agolli", Buçimas, Pogradec*" me nr. 3688/16 prot., datë 14.11.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Pogradec dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë R.SHPK me vlerë të objektit 139,314,684 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 6 (gjashtë) muaj nga marrja në dorëzim e sheshit të ndërtimit, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve: "Shtresë betoni C 7/10 t=10 cm niveluese, F.V. Dyer të brendshme importi cilësi e I-rë", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec, në vlerën **314,300** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi*", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, kontratën e sipërmarrjes së punimeve me nr. 3688/16 prot., datë 14.11.2022 si dhe kontratën e mbikëqyrjes me nr. 4548/23 prot., datë 09.12.2022. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 143-144 të Raportit të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Pogradec, të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin nga (OE) R.SHPK të vlerës **314,300** lekë pa TVSH, të konstatuar si dëm ekonomik për diferencat ndërmjet volumeve të punimeve të situacionuara/paguara dhe atyre të realizuara faktikisht, sipas kontratës me nr. 3688/16 prot., datë 14.11.2022 me objekt: "*Rikonstruksion dhe shtesa shkolla e mesme "14 Engjëjt" dhe shkolla 9-vjeçare "Servet Agolli", Buçimas, Pogradec*".

Deri me datë 31 Dhjetor 2026

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore edhe pse ka zbatuar përcaktimet në Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konstatohet se në fund të periudhës janë debitorë progresiv 504 subjekte për vlerën 84,961,348 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën 26,571,119 lekë)* dhe debitorë progresiv familjarë janë 5135 familje për vlerën 122,516,163 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë për vlerën 41,925,714 lekë),* pra debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 207,477,511 lekë, **ku vlera prej 68,496,833 lekë** janë debitorë të vitit 2025 **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pogradec të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksa e tarifa vendore për 504 subjekte të biznesit të madh e të vogël dhe për 5135 familje, me vlerë 207,477,511 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për periudhën deri më 31.12.2025, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 458 persona me vlerë progresive 50,880,735 lekë, nga kjo detyrim i vitit 2025 **në vlerën 34,617,521 lekë**, **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë,** në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 3/c. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 458 persona me vlerë 50,880,735 lekë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje arkëtimin e detyrimeve për dhënie me qira toka bujqësore, vendosje Antena dhe HECE, për periudhën deri më 31.12.2025, rezulton se nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratave 54 subjekte me vlerë progresive 33,798,292 lekë nga kjo detyrim i vitit 2025 **në vlerën 13,347,371 lekë**. Mosarkëtimi i këtyre detyrimeve përbën të ardhura të munguara për

buxhetin e Bashkisë Pogradec dhe mospërmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga kontratat përkatëse, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 12, shkronja "g". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqe 16-42, të Raportit të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Pogradec nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për dhënie me qira toka bujqësore, vendosje Antena dhe HECE, për 54 subjekte me vlerë 33,798,292 lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në 1 (një) nga 19 (nëntëmbëdhjetë) procedurat e prokurimit të audituara, me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël", konkretisht në procedurën e prokurimit të zhvilluar gjatë vitit 2023 me objekt "*Rehabilitim i Lumit të Çërravës*", është konstatuar sa vijon:

-Në fazën e vlerësimit të kësaj procedure, operatori ekonomik i renditur i pari, "Z." ShPK, ka paraqitur dorëheqjen nga gara në datën 27.04.2023. Në kushtet kur braktisja e garës nga operatori ekonomik është kryer pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave (28.03.2023) dhe për sa kohë nuk rezulton që OE të jetë tërhequr përpara këtij afati, KVO-ja duhet të kishte kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës, çka nuk e ka kryer. Nga mosveprimi i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, është shkaktuar mungesa e përfitimit dhe cenimi i ekonomicitetit të buxhetit të bashkisë në vlerën **249 999 lekë** (vlera e sigurimit të ofertës). Mosveprimi i sipërcituar bie në kundërshtim me nenin 83, pika 3/a të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe nenin 30, pika 6/a të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 42-144 të Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor (*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave*), për çdo procedurë prokurimi me fond limit mbi atë të "blerjes me vlerë të vogël" që do të zhvillojë, të marrë masa për konfiskimin sigurimit të ofertës nga çdo operator ekonomik, i cili tërheq ofertën e tij pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në lidhje me vendosjen, llogaritjen dhe arkëtimin e masave administrative është konstatuar se:

- Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Pogradec për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025, rezulton se janë vendosur ***40 gjoba*** në vlerën ***15,634,137 lekë***, dhe janë arkëtuar prej tyre 10 gjoba (ose 25%) në vlerën 1,188,532 lekë (ose 7.6%). Nga ana e IMTV nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin e këtyre vlerave, në 20 raste, me vlerë ***11,910,942 lekë***. Në këto kushte, IMTV duhej të ndiqte në mënyrë sistematike procedurat për arkëtimin e gjobave, duke verifikuar afatet e pagesës së çdo gjobe, evidentuar gjobat e papaguara, llogaritur kamatëvonesat përkatëse, njoftuar kundërvajtësit për detyrimin për pagesë dhe, në rast të mospagesës brenda afateve të përcaktuara, ndjekur procedurat për ekzekutimin e detyrimit në rrugë gjyqësore, si dhe të monitoronte në vijimësi rezultatet e këtyre masave deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve. Rastet kur gjoba nuk është paguar janë paraqitur në ***Aneksin nr. 01*** (në këtë aneks nuk janë përfshirë rastet që janë subjekt i Ligjit nr. 127/2024, datë 19.12.2024). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve"*, i ndryshuar, pika a);
- Nga auditimi i saktësisë së përllogaritjes së masave administrative të vendosura nga IMTV, Bashkia Pogradec, në së paku 4 raste vlera e gjobës nuk është llogaritur në përputhje me kërkesat e nenit 52 të Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i

ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse. Konkretisht, në rastin e kundërvajtësit "K.", "B.R" / "*B.XH.*", PVKK me nr. serie 000097, datë 19.02.2024, për ndërtimin pa leje të një objekti me funksion kult fetar (xhami), është vendosur masë administrative në vlerën 500,000 lekë, ndërkohë që sipas përllogaritjes së grupit të auditimit gjoba duhej të ishte 7,252,599 lekë, me një diferencë prej ***6,752,599 lekë***. Në rastin e kundërvajtësit *S.M.*, PVKK me nr. serie 000100, datë 30.04.2024, për ndërtimin pa leje të një objekti dhe muri rrethues, është vendosur gjobë në vlerën 500,000 lekë, ndërsa sipas përllogaritjes së grupit të auditimit vlera duhej të ishte 798,508 lekë, me një diferencë prej ***298,508 lekë***. Në rastin e kundërvajtësit *N.M.*, PVKK me nr. serie 000102, datë 19.06.2024, për ndërtimin pa leje të një muri rrethues me brez betoni të armuar, është vendosur gjobë në vlerën 50,000 lekë, ndërsa sipas përllogaritjes së grupit të auditimit vlera duhej të ishte 68,716 lekë, me një diferencë prej ***18,716 lekë***. Po ashtu, në rastin e kundërvajtëses *M.M.*, PVKK me nr. serie 000103, datë 10.07.2024, për ndërtimin pa leje të një objekti me funksion garazh, është vendosur gjobë në vlerën 500,000 lekë, ndërsa sipas përllogaritjes së grupit të auditimit vlera duhej të ishte 2,331,432 lekë, me një diferencë prej ***1,831,432 lekë***.

- Nga auditimi i procedurave për vendosjen e masave administrative kundërvajtësve që kanë kryer ndërtime pa leje në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, u konstatua se në 8 raste kryeinspektorët e IMTV, Bashkia Pogradec, nuk kanë aplikuar penalitetin shtesë prej 5,000,000 lekë, të parashikuar nga neni 52, pika 1, nënpika e.v) e Ligjit nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar. Konkretisht, kjo parregullsi është konstatuar për: **i.** *Q.GJ.*(PVKK me nr. serie 0000149, datë 25.10.2023); **ii.** *S.M.* (PVKK me nr. serie 0000100, datë 30.04.2024); **iii.** *M.M.* (PVKK me nr. serie 0000103, datë 10.07.2024); **iv.** *A.SH.* (PVKK me nr. serie 0000109, datë 03.02.2025); **v.** "A. "ShPK (PVKK me nr. serie 0000110, datë 07.02.2025); **vi.** *P.M.*(PVKK me nr. serie 0000111, datë 10.03.2025); **vii.** *B.H* (PVKK me nr. serie 0000112, datë 10.03.2025); **viii.** *M.B.*(PVKK me nr. serie 0000118, datë 25.07.2025).

Duke qenë se jemi në kushtet kur janë miratuar Ligji nr. 127/2024, datë 19.12.2024, *"Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024, inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake"* dhe VKM nr. 274, datë 09.05.2025, *"Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara"*, gjobat e vendosura brenda periudhës 01.01.2015 – 30.11.2024 (PVKK me nr. serie 000100, datë 30.04.2024 – *për llogaritjen e gabuar dhe për mos-aplikimin e penalitetit prej 5,000,000 lekë*; PVKK me nr. serie 0000149, datë 25.10.2023), nuk do të jenë pjesë e vlerës totale të diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit.

Për pasojë, në katër raste masat administrative nuk janë përllogaritur mbi bazën e vlerës reale të investimit të kryer pa leje (***8,602,747 lekë***); gjithashtu, në tetë raste nuk është aplikuar plotësisht masa administrative e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për ndërtimet pa leje në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit (***30,000,000 lekë***). Vlera totale e masave administrative të llogaritura në mospërputhje me dispozitat ligjore është ***38,602,747 lekë***.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 160-174 të Raportit të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të merren masa për përmirësimin e procesit të përllogaritjes dhe vendosjes së masave administrative, duke garantuar që vlera e investimit dhe masat administrative të përcaktohen në mënyrë të saktë, të plotë dhe të njëtrajtshme, në përputhje me punimet faktike të konstatuara në terren dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, të forcohen procedurat e kontrollit dhe verifikimit të volumeve të punimeve, zërave të preventivit dhe mënyrës së aplikimit të penaliteteve, përfshirë trajtimin e rasteve të përsëritjes së kundërvajtjeve dhe të ndërtimeve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pogradec të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përllogaritjen e masave administrative pa ekonomicitet dhe efektivitet, me diferencë prej ***38,602,747 lekë***, vlerë e cila ndikon negativisht në buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2026

5.3. Rekomandimi: Nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Kryetarit të Bashkisë Pogradec të merren masa për evidentimin dhe ndjekjen sistematike të gjobave të papaguara, duke verifikuar afatet e pagesës, njoftuar kundërvajtësit për detyrimet përkatëse dhe ndjekur procedurat ligjore për ekzekutimin e tyre, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, deri në arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15 germa c); Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 37 "Masa disiplinore" dhe Kontratës individuale të punës, i rekomandojmë **Bashkisë Pogradec** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

Shënim: Për punonjësit e tjerë të cilët kanë rezultuar me mangësi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre institucionale, nuk rekomandojmë masa disiplinore, për shkak të nivelit të ulët të materialitetit sasior dhe cilësor.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT